


BIBLIOTEKA
SHTETIT

Gjergj
Znojji

VËZHGMË
METRIKE



8 JH. 08
24. 3P.

Gjergj Zhej

REGJESTRUE
BANDEU KODI

VËZHIGIME METRIKE




SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Elbaşan.
Gürel
Gürel

Redaktor:
PANDELI KOÇI

EZHEGİME
METRİK E



SALTILIA LÖWE - NAM'LAWHİ

A Y R J E

Studimi i dukurive dhe vlerave metrike mund të kryhet në disa mënyra. Para së gjithash ai mund të bëhet duke vënë në dukje ligjet, rregullat dhe ecuritë praktike, më të përgjithshme në thurjen e vargjeve, të strofave, të organizimit dhe instrumentimit të tyre. Në këtë rast, qoftë vargu, qoftë strofa apo qoftë çdo dukuri tjetër metrike mirret e shkëputur, e izoluar prej krejt kontekstit poetik konkret, pra pa u vështruar në funksionin e tij artistik, por vetëm në mekanizmin dhe teknikën e ndërtimit të tij. Një pjesë e mirë e librave metrike, botuar për qëllime shkollore, janë shkruar pikërisht në këtë mënyrë. Në libra të tillë përshkruhen dhe vargje, strofa etj. që në një letërsi mund të mos jenë përdorur fare, por që njihen në historinë e përgjithshme të zhvillimit të vargëzimit poetik.

Mënyra e dytë për të studiuar metrikë është ajo sipas së cilës dukuritë e saj shikohen e studiohen në raportet e tyre me melodinë, muzikën. Kjo përbën studimin e asaj që quhet prozodi. Studimi i këtyre raporteve reciproke midis këtyre dy fenomeneve — atyre poetike dhe atyre muzikore — ka një rëndësi të veçantë

për poetët e, në mënyrë të posaçme, për muzikantët. Ky studim të jep mundësinë, nga ana tjetër, të zbulosh rolin organizues të melodisë ndaj fjalës poetike, rolin e melodisë në origjinën e këtij apo atij vargu, të kësaj apo asaj strofe etj. Nuk është e rastit që studimi i teorisë së muzikës, që lindi që në kohën e vjetër, të përfshinte krahas studimit të harmonisë dhe të orkestracionit, edhe studimin e metrikës. Një gjë e tillë diktohej pikërisht nga raportet reciproke poezi-muzikë, raporte që janë të gjalla e vepruese sot e kësaj dite në mënyrë të vegantë në folklor.

Një mënyrë e tretë për të studiuar fenomenet dhe vlerat metrike është ajo në të cilën këto dukuri dhe vlera mirren në kontekstin e gjallë e konkret të poezisë ku ato janë zbatuar. Në një studim të tillë shqyrtohen ligjet e dukuritë e përgjithshme të ritmit ashtu si ato shprehen në krijimet poetike të këtij apo atij poeti, të kësaj apo asaj poezie të një vendi të caktuar; shqyrtohen format e ndryshme, në të cilat këto ligje e dukuri mund të mishërohen konkretisht. Këto forma, domosdo, janë të ndryshme në popuj dhe epoka të ndryshme; ato transformohen qoftë për shkak të evolucionit historiko-shoqëror, të evolucionit gjuhësor, qoftë për shkak ndikimi apo imitimi etj. Sidoqoftë në këtë rast, metrika mund të shikohet si një pjesë e ritmikës apo si një degë e historisë së letërsisë. Në këtë vështrim studimi i formave metrike të përdorura nga poetët dhe ndryshimet e tyre të herëpashershme janë të pandarë nga vetë studimi i poezisë. Jo vetëm kaq, por mund të thuash se studimi i fizionomisë së një poeti të caktuar nuk mund të quhet i plotë nëse nuk hetohet deri në fund edhe konceptimi i tij rrëth metrikës e zbatimit të saj konkret. Një studim i tillë i metrikës, sipas mendimit dhe të shumë studiuesve të ndryshëm, është i vështirë dhe delikat, por ai është në gjendje të të japë një pamje të gjallë të këtij fenomeni, të funksionit dhe të qëllimit të tij konkret.

Në vëzhgimet metrike që paraqiten në këtë libër është bërë një përpjekje për të hetuar fenomenet dhe

vlerat metrike në lidhje të ngushtë me poetët e poezinë tonë. Nuk kemi të bëjmë këtu me një studim të plotë e shterruar të të gjitha fenomeneve metrike, të procedurave për organizimin dhe instrumentimin e vargjeve, etj. Vëzhgimet janë vetëm konstatime për fenomene, procedura, për poetë e periudha të ndryshme të poeziës së sonë. Ato vetëm mund të kontribuojnë në formimin e një studimi të plotë e përgjithësues, së paku ky ka qenë edhe qëllimi i tyre. Për këtë arsyesh herë mund të haset ndonjë përsëritje argumentimi nga një vëzhgim te tjetri, ndonjë rikthim te ndonjë çështje etj. E vetmja vazhdimësi që i lidh, na bëhet se është ideja që ato përpilen të vënë bashkarisht në dukje, mendimi se poezia jonë më e mirë e së kaluarës, dhe ca më te-për e sotmja, i ka ngritur kurdoherë vlerat e saj metrike duke u mbështetur sidomos në përvojën e poeziës popullore. Poetët tanë më të mirë të së kaluarës dhe të ditëve tona janë përpjekur të lidhen me poezinë popullore, me tiparet e saj të qenësishme jo vetëm të brendisë, por edhe të formës, duke përfshirë në këtë të fundit edhe metrikën:

Sic do të vihet re, në këto vëzhgime nuk trajtohen një varg çështjes të së kaluarës dhe të së tashmes së metrikës së sonë, ashtu si mungon një punim kushtuar posaçërisht problemeve metrike të poeziës arbëreshë, që paraqitet shumë e pasur dhe shumë interesante sidomos me lidhjet e saj me poezinë gojore. Por studimi i aspektit metrik të poeziës arbëreshë do të kërkonte një studim të thelluar, në radhë të parë të poeziës gojore arbëreshë mbi të cilën ajo është mbështetur jo vetëm në fazat e saj të para, por edhe më vonë. Një kërkuesë e tillë, domosdø, të ve përpara vështirësish, që lypin një përpjekje e një punë të mëtejshme.

1. — VLERAT METRIKE DHE STUDIMI I TYRE

Poezia jonë e re jep shkas sot, me pasurinë e larminë e saj, me individualitetet e stilet e kristalizuar, për studime të gjithanishme e përgjithësuese. Në të vihen re tashmë qartë përmasa, tipare dhe veçori specifike, vihet re sidomos ndryshimi i madh midis saj dhe poezië së paraçlirimit, ndryshim që domosdo hetohet para së gjithash, në esencën ideore, në konceptimin ideoartistik, në pasurinë tematike, në përjetimet dhe fryshten e saj militante, në psikologjinë e *unit* poetik revolucionar, që është vendosur në qendër, me një fjalë në një tok elementë të brendisë. Ky pa dyshim është një kontribut i madh në thesarin e poezië shqiptare në përgjithësi. Por do të ishte jo shkencore të shikohej ky kontribut vetëm në brendi. Vlerat e brendisë së poezië së re shqiptare nuk mund të shkëputen nga vlerat e formës së poezië së re shqiptare. Këto elementë brendie dhe forme përbëjnë një unitet të vetëm, ndërtunë dialektikisht me njëri-tjetrin.

Poezia jonë e re nxori në pah një rritje të gjithanishme të poetëve tanë, rritje që asimiloi në vetvete e në mënyre krijuese gjithçka të mirë, përparimtare, demo-

kratike e revolucionare ofron tradita e poezisë sonë të
 së kaluarës, rritje që ka të bëjë para së gjithash me vlerat ideore. Këto vlera u kristalizuan në vargjet e poezisë së realizmit socialist në saje të filozofisë marksiste-leniniste, në sajë të pjesëmarrjes direkte të poetëve tanë
 në luftën e punën e popullit, në sajë të transformimeve kolosale socialiste që i ndërruan faqen Shqipërisë. Kjo
 rritje bie në sy edhe në mjeshterinë artistike, edhe në zotësinë pérherë e më të madhe të poetëve tanë pér të
 thurur e instrumentuar vargjet e tyre. Ata, ashtu siç
 kanë sjellë një kontribut të madh me brendinë e kësaj
 poezi, kanë sjellë një kontribut po aq të madh me vlerat e formës së kësaj poezi. Kështu, pér shembull,
 është përsosur sensibiliteti poetik, është pasuruar sistemi i figuracionit, gjuha artistike e përdorur ka ardhur
 duke u bërë pérherë e më e vetvetishme, më e afërt me popullin, më realiste; sistemi i vargëzimit ka ardhur
 duke u zhvilluar më tej, duke u pasuruar poezia shqiptare me ritme e rima të reja, me kombinime e trajtime
 të reja të vargjeve të përdorur edhe më parë, duke vënë pérherë e më tepër, më mirë e më bukur në bazë të
 saj vargëzimin populor, ritmin dhe muzikalitetin e poezisë populllore. Tërë ky bagazh kaq i pasur arritjesh meriton të studiohet në mënyrë të thelluar shkencore, jo
 vetëm pér të njohur katërcipërisht gjendjen e krijuar,
 por q'ka më tepër rëndësi, pér të veçuar e përgjithësuar
 arritjet më të mëdha, procedurat më të goditura në mënyrë që ato të pérhapen më lehtë e më mirë te poetët
 tanë, e sidomos te të rinjtë, veçanërisht ato procedura
 dhe arritje që do të jepnin dorë pér të forcuar ende më
 tej fryshtës kombëtare të poezisë sonë.

Pér metrikën shqiptare janë shkruar libra, por duhet thënë që në krye se kjo fushë studimi meriton të bëhet objekt punimesh shumë më të gjera e më të thelluara. Që më 1898 Benlou¹⁾ u interesua sidomos pér ritmin e rimenë në poezinë arbëreshe dhe shkroi një broshurë të

1) Benloew L. «Du rythme e de la rime dans la poésie épique des Albanais», Bükuresht 1896.

vogël, që citohet sot e kësaj dite nga studiuesit e metrikës shqiptare, mbasi në këtë broshurë njëmbëdhjetëfaqesh autori thotë disa të vërteta që të bëjnë përshtypje. Kështu, për shembull, që në krye ai shkruan: «Këngët epike të shqiptarëve paraqesin një interes real duke na bërë që të asistojmë në lindjen e rimës, e cila u bë elementi rregullues i krejt poezisë moderne.»¹⁾ Benlou nga ana tjetër mendoi se vargjet e poezisë popullore shqiptare janë të ritmit trokait. Ndonëse, sidomos poezia e re shqiptare, nuk i përmbahet strikt kësaj procedure, mbasi, së paku prej F. Nolit e këtej, poetët u përpoqën që të përdorin edhe ritmin ngjites (me këmbë të përshtatshme për t'ia arritur këtij ritmi) prapëseprapë pohimi i Benlout është i vlefshëm duke patur parasysh në tërësi poezinë popullore e të kultivuar shqiptare.

Interes për metrikën tonë shfaqën edhe studiues të tjerë si Lambertz, Markiano etj., por vetëm më 1906, me veprën *e studiuesit shqiptar Luigj Gurakugit*, «Var-
gënimini në gjuhë shqipe» (botuar me pseudonimin Le-
kë Gruda), ne kemi të parin libër të plotë metrik të
botuar në gjuhën tonë. L. Gurakuqi shtyhet të shkru-
ajë këtë libër nga dëshira për t'iu ardhur në ndihmë
poetëve të kohës që të mësonin ta organizonin më mirë
fjalën e tyre poetike. Thotë ndërmjet të tjerave në lib-
rin e tij:

«T'tana këto punë provojnë që edhe ndër na nuk
asht i panjoftun vjershënim i se edhe na nuk i kemi
n'mëni zanat; por megjithëkëtë vjershat tona nuk i ka-
në të gjitha virtytet e mjeshtrisë: mund t'jetë se një
herë i patën, e se i buernë pastaj tue ecë gojë nëpër
gojë prej babet n'djalë.

Mbasi qì pra vjershat tona mbetne t'pashkrueme e
mbas qì u njoħne gjithmonë si kangë popullore t'pér-
cjelluna me muzikë, nuk i vueme, për këte, fort oroe
vargjet. Mund t'thona se na nuk i këndueme gati kurr'
kangët me za t'ultë për me i shijue mirë harmonin e

1) *Idem, f. 3.*

vargut; e përcuellme gjithherë me muzikë, e kjo na i mëshehi e na i mblooi lajthimet e tija, herë tue zgjatë rrrokjet kur ishte ndonji mangut, herë tue i hangër kur ishte ndonji tepër, herë tue largue theksen prej vendit t'saj e tuej e ba me ra ku s'duhej etj. etj.

Kjo m'duket se asht arsyaja për t'cilën s'patëm deri sot vargje t'matun mirë; e edhe sot asht kjo që na ban mës me ia vue fort menden, sikur t'ish shartue n'gjak t'ynë vesi i moçëm. Por tash ma ka ardhë koha t'marrim udhën e drejtë e t'përpinqena...»

E sollëm këtë pjesë për të provuar shqetësimin e letrarëve të kohës për organizimin metrik të fjalës në vargjet e poezisë sonë. Duket qartë këtu, veç të tjerave, se L. Gurakuqi e njeh teknikën e thurjes së vargjeve popullore, lidhjen e tyre me muzikën, procedurat e ndryshme që hasen në poezinë popullore e të cilat ende sot nuk janë studiuar sa duhet e si duhet; duket qartë nga ana tjetër, se L. Gurakuqi kërkon të vështrohet metrika e vargjeve e shkëputur nga prozodia muzikore, në mënyrë që të kapen ritmet e nuancat e fjalës poetike, të kapet bukuria e fjalës së artikuluar etj.

Në librat që erdhën më pas, A. Xhuvani dhe K. Cipo «Fillimet e stilistikës e të letërsisë së përgjithshme» Tiranë 1930; J. Rrota «Letratyra shqype» Shkodër 1934, etj., kapitujt kushtuar metrikës janë shkruar duke u mbështetur kryesisht te vepra e L. Gurakuqit, ndonëse te libri i parë hasim një farë interes i për vargjet popullore, të cilët shpesh citohen edhe si shembuj për ilustrimet e llojeve të ndryshme të vargjeve. Megjithatë, duhet thënë se poetë si Naimi e Cajupi — për të mos përmendur vecse dy — kishin marrë prej kohësh si model vargjet popullore për të thurur veprat e tyre dhe kjo rrugë u ndoq përgjithësisht edhe prej poetëve tanë të tjera më të mirë, megjithëse një kërkesë e tillë nuk vihet re fare në shkrimet e asaj kohe kushtuar metrikës e ca më pak të gmohej. Nga ana tjetër, vetë zhvillimi i ngjarjeve historiko-shoqërore të vendit tonë, duke nxjerrë përherë e më tepër më paforcën e vullnetin e popullit — e këto ngjarje historiko-shoqërore arrijnë

kulmin me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare — bëri që letrarët të përpiken të lidhen përherë e më shumë e më mirë me letërsinë gojore të popullit. Kështu shpjegoheq që te libri i Dh. S.Shuteriqit «Metrika shqipe», botuar më 1947, vihet për herë të parë në bazë të studimit të vargëzimit shqiptar poezia populllore. Autori e thotë qartë qëllimin e tij që në parathënie kur shkruan: «Poeti ynë i ri ka nevojë të kthehet në traditat e shëndosha kombëtare, më shumë se sa të kërkojë format e reja të huaja».¹⁾ Kurse më tutje ai shkruan: «Teknika e poezisë populllore duhet të bëhet baza mbi të cilén të ngrihen vjershat e reja të letërsisë sonë të re, me qëllim që të krijohet një teknikë edhe më shqiptare në këtë letërsi».²⁾.

Nuk ka dyshim se këto mendime që cituan nga ky libër reflektonin situatën e re të krijuar mbas triumfit të revolucionit populor, reflektonin mësimet e Partisë për të vënë në qendër të veprave artistike popullin, reflektonin në fund të fundit atë prirje të fuqishme artistike që ishte dukur që gjatë luftës me veprat poetike të krijuara në mal, në luftë e sipër. Vepra si poezi e këngë të M. Metos, një poemë si «Epopeja e Ballit Kombëtar» e Sh. Musarajt, këngët partizane të K. Jakovës, A. Varfit, F. Gjatës, Sh. Peçit, A. Çacit etj. ishin krijuar duke patur si model vetë krijimtarinë e popullit, duke sfiduar kështu predikimet estetizante e klasikegjante të letrarëve borgjezë e reaksionarë.

Më 1958 R. Sokoli botoi studimin «Prozodia dhe metrika jonë populllore» (revista «Nëntori», Nr. 8 dhe 9, 1958). Në këtë studim të rëndësishëm bëhen përpjekjet e para të frytshme për të depërtuar në teknikën e ndërtimit metrik të poezisë populllore duke e parë atë lidhur ngushtë me muzikën. Nëse libri i Shuteriqit, duke u nisur prej metrikës populllore, shikonte (ose më mirë — kërkonte) reflektimin e saj edhe në poezinë e kultivuar, duke u bërë kështu libri i tij një farë

1) Dh.S. Shuteriqi «Metrika shqipe», Tiranë 1947, f. 3,

2) Vepër e cituar, f. 94.

manuali për poetët tanë të rinj, te R. Sokoli studimi i metrikës popullore bëhet pa iu referuar poesisë së kultivuar, është pra një studim drejtpërsëdrejti dhe ekskuluzivisht për prozodinë dhe metrikën popullore. Nuk ka dyshim se ky është një studim me shumë vlerë që mund të përdoret e duhet të përdoret sot e kësaj dite me shumë përfitim prej muzikologëve, kompozitorëve, libretistëve dhe poetëve të teksteve të këngëve, me një fjalë prej atyre që kanë të bëjnë me krijime veprash ku zbatohet raporti i muzikës me fjalën. Në studimin e R. Sokolit hasen shumë gjëra të vlefshme për vargun popullor në përgjithësi, për ritmin e sidomos për organizimin strofik të vargjeve popullore. Nuk ka asnje dyshim se vlera e një kënge popullore del e plotë në unitetin e saj muzikë-poezi (në mos edhe lëvizje koreografike) dhe poetët tanë do të përfitonin shumë duke njojur për së afërmë teknikën e brendshme të këtij uniteti, megjithëse ata, për nevojat e tyre praktike, do të përfitonin shumë më tepër në radhë të parë nga studimi që e merr krijimin popullor para së gjithash si poezi popullore e pastaj si këngë popullore.

Në studimet metrike të botuara për nevojat mësimore, shquan ajo e Jakov Xoxes për studentët e universitetit tonë. Ky është patjetër një punim i plotë dhe i kryer me kujdes e kompetencë për dukuritë metrike në përgjithësi, për metrikën klasike dhe tonën, për fenomene të së kaluarës dhe të së tashmes në këtë fushë. Materiali i paraqitur qartë dhe me shembuj të shumtë, shërben më së miri për t'i informuar studentët rrëthligjeve e rregullave të përgjithshme metrike, për t'i bërë që të kuptojnë bukurinë dhe dobinë e mjeteve metrike kur përdoren në harmoni me brendinë.

Të gjithë këta shembuj që u prunë këtu — e mund të silleshin edhe të tjera, qoftë edhe të një përmase më të vogël, si artikuj, shënimë, diskutime etj. — dëshmojnë se shkrimet kushtuar metrikës nuk mungojnë tekne. Por është e domosdoshme që ato të janë edhe më të shumta e, c'është më e rëndësishme, të lidhura më ngu-

shtë si me poezinë popullore ashtu edhe me poezinë tonë të re të realizmit socialist.

Poetët tanë të rinj, krahas të tjerave, janë të interesuar për një varg çështjesh që kanë lidhje edhe me vargëzimin. Ata kanë dhënë një kontribut të vyer edhe në këtë drejtim, që pret të studiohet më thellë. Problemet dhe kërkesat e tyre në lidhje me këtë çështje kanë të bëjnë, në analizë të fundit, me thellimin e përsosjen e frysës kombëtare edhe në një aspekt të formës së është organizimi i vargut. Fryma kombëtare, nga ana tjetër, nuk është diçka që këtu hyn — ta zëmë, në vargjet e rregullt dhe atje nuk hyn — ta zëmë te vargjet e lira. Kjo karakteristikë e poeziës së sonë hyn, këtu dhe atje, sepse ajo është një element i pandarë nga koncepcioni poetik i poeziës së sonë të re. Por që të mund të arrihet kjo edhe në elementët e formës — midis të cilave në poezi vend të rëndësishëm zë metrika — është e domosdoshme që të njihet thellë organizimi metrik i poeziës popullore. Sepse nuk mjafton të shkruash, për she mbull, në tetërokësh për të qenë brenda karakterit kombëtar. Është e domosdoshme që ky tetërokësh të përdoret, të thuret ritmikisht, të instrumentohet pikërisht ashtu siç e përdor, e thur dhe e instrumenton populli, ndryshe ai është një tetërokësh neutral, letraresk, që nuk ka të bëjë fare me «shqiptaren» ose ka të bëjë shumë pak (duke folur kurdoherë në vështrim të metrikës). Tetërokëshi është vërtet vargu ynë më popullor, por ai nuk është vetëm yni, atë e përdorim edhe popuj të tjerë. Ekskluzivisht yni, shqiptar, është vetëm përdorimi që i bëjmë ne, instrumentimi që i bën populli. Pikërisht kjo duhet njojur. E jo vetëm për tetërokëshin, por për të gjithë vargjet në tërësi, për të gjithë metrikën popullore. Vetëm kështu do të gjejnë zgjidhje shumë probleme metrike tek ne, vetëm kështu do të drejtohet edhe më mirë përdorimi sidomos i vargut të lirë tek ne pa shkarë më lajthitje apo prozai zém. Vetëm kështu, nga ana tjetër, do të jemi më të sigurt në përdorimin e kësaj apo asaj procedure.

2. — LARMIA E VARGJEVE POPULLORE SHQIPTARE

Organizimi artistik i fjalës poetike është një pune shumë e rëndësishme, që ka të bëjë jo vetëm me mjeshterinë, por, para se gjithash, me konceptimin ideo-artistik të vetë krijimtarisë poetike. Kjo kuptohet qartë po të kemi parasysh të vërtetën se forma e përbajtja është një vepre arti nuk mund të konceptohen jashtë lidhjeve dialektike midis tyre, jashtë unititetit të tyre të gjallë. Për këtë arsyesh kujdesi dhe puna këmbëngulëse për zgjedhjen e vargut, për zgjedhjen e ritmeve e të rinave, për instrumentimin e vargjeve,¹⁾ për tubëzimin e tyre, për përsosjen e muzikalitetit etj. janë faktorë që duhen cmuar së tepërmë dhe vënë në jetë në mënyrë krijuese sa më të plotë e më të përshtatshme.

1) Instrumentimi i vargut: një nga mënyrat e përpunimit të fjalës poetike, që qëndron në përdorimin në varg, në strofë ose në tërë tijershën të alteracionit, të onomatopesë, të anaforës etj. me një fjalë të mjeteve që i japin të folurit një ngjyrim të veçantë dhe forcë shprehëse.

Nuk éshtë fjala këtu për një *labor limae*¹⁾ të kthyer në qëllim në vete, që sjell si pasojë ftohjen e frymëzimit, lustrimin e rremë, artificin, në mos formalizmin. Përkundrazi, këtu éshtë fjala për një *labor limae* që t'i japë të gjitha mundësitë brendisë së pasur ideotematike të kristalizohet dhe të marrë trajtat më të përshtatshme e më të goditura në mënyrë që krijimi poetik të jetë i aftë të dialogojë deri në fund me lexuesin.

Populli ynë ka përpunuar gjatë kohëve një metrikë tē pasur, një arsenal tē gjallë e tē larmishëm elemen-tesh tē aftë për instrumentimin e vargut, një formë tē përkryer poetike, që éshtë në gjendje tē realizojë ide nga më tē ndërlíkuarat dhe t'i japë mundësi gjuhës sonë tē vërë në dukje tërë bukurinë e saj. Njohja e kë-saj teknike nga ana e poetëve éshtë një udhëkalim i domosdoshëm, éshtë një shkollë e madhe që kérkon punë e dashuri tē vazhdueshme.

Ajo që tē bën përshtypje, në radhë tē parë, te poe-zia popullore éshtë muzikaliteti i saj, harmonia e përsosur me tē cilën tingëllon gjuha shqipe në këto var-gje. Ka në vargjet më tē mira tē popullit një arki-tekturë tē përkryer, që shpesh tē jep përshtypjen se çdo fjali éshtë kthyer në një notë muzikore. Tërë kjo ndodh, domosdo, nga elementët e brendisë, nga kohe-rencia psikologjike e këngëtarit popullor. Por kjo ndodh, nga ana tjetër, edhe për shkak se poezia popullore vazhdon akoma sot e kësaj dite tē jetë e pandarë nga mu-zika, bile edhe nga vallja, siç ndodhët në periudhën e saj tē parë, në historinë e hershme, kur sinkretizmi ishte një fenomen i zakonshëm. Poezia jonë popullore sot e kësaj dite nuk lind para ose pas melodisë, por në tē njëjtën kohë me tē, në kushtet ideale pra, për krijimin e një pjese vokale-muzikore. Nga kjo bashkëlindje ajo fiton muzikalitet, fiton organizimin e saj tē brendshëm, fiton tërë atë larmi instrumentimi që vihet re lehtë në tē. Le tē mjaftojnë për këtë pak shembuj. Të sho-

1) Labor limae (*lat.*) — punë me limë. Punë e kujdeshshme dhe e hollë për ta bërë tē përkryer stilin, një vepër etj.

him, ta zemë, se me së mjeshtëri dhe me ç'organizim
të përsosur, do të thoshim muzikor, janë thurur var-
gjet e kësaj kënge të njohur:

Dit' e hanë, dit' e zezë,
Plasi pushka mu në Pezë!
Mu në Pezë, në Kryezi,
lufton Kajua me gjith' ushtri!
Me ushtri, me batalion
kanë rrëthue një grup gjerman,
grup gjerman, grup tradhtar...
Lufton Kajua, shok i rrallë!
Plasi pushka, luejti toka,
thonë bejlerët: «Cjanë kta topa?»
Nuk janë topat e gjermanit,
Por janë bumjet e Kajanit!

Muzikaliteti i vartjeve të kësaj poezië krijohet nga
pasuria e mireteve që janë përdorur për instrumenti-
min e tyre. Ky instrumentim është bërë në mënyrë in-
tuitive, kryesisht nën ndikimin e melodisë muzikore, e
për këtë arsyë komunikon natyrshëm. Në një pjesë të
mire, kjo është arritur me anë të llojeve të ndryshme
te verseritjes së fjaleve (epanastrofë, epanalepsë etj.),
me rimat e brendshme, me zgjedhjen e rimave, te ci-
lat në poezinë më të goditur popullore zakonisht nuk
janë foljore e të konsumuara, por të tillë që të bëjnë
pershtypje edhe me faktin që nuk janë të rëndomta. Po-
tëre ky muzikalitet nuk është ašpak i shkëputur nga
brendia, perkundrazi, është plotësisht në funksion të
brendisë dhe shërbën, veç të tjerave, për të vënë në
dukje më mirë, për të nënvízuar momentet, dukuritë,
njigjet, njerezit, dhe idetë kryesore. Poezia popullore
është e mbushur me shëmbuj të tillë e kurdoherë do të
bindeshim për lidhjen e ngushtë të saj me muzikën.
Sepse nuk ka asnjë dyshim se shumë lloje të përsërit-
jes, për shembull, janë diktuar drejtpërsëdrejti, nga
melodia, nga nevoja e organizimit të saj ose edhe nga

melodia dhe lëvizjet e valles njëkohësisht. Kjo është e qartë edhe në shembuj të tillë si:

Te ura, moj, te ura...

ku përdorimi i tmezës (në këtë rast *moj*) që futet në mes të fjalisë për të ndihmuar përsëritjen e fjalës së parë të vargut:

Te ura në Drashovicë...

është diktuar nga muzika apo edhe nga lëvizja e këmbës në valle.

Shembujt janë të shumtë e mund të sillen nga gjithë folklori ynë, i cdo krahine qoftë. Kurdoherë të rrëmbejn muzikaliteti i përkryer i vargjeve popullore dhe harmonia e përsosur, që nuk pranon as disonancën më të vogël.

Rima dhe asonanca, me tërë llojet e tyre të shumta, përdoren prej poetit populor me një efekt, që jo rrallë arrin në virtuoizëm të vërtetë. Nganjëherë muzikaliteti i rimës është përdorur për të theksuar, epizmin, herë tjetër për të nxjerrë më mirë në pah butësinë e lirizmit, herë tjetër për efekte ironike etj.

Le të ndalemi për një çast te kënga popullore që sjellim më poshtë dhe kemi për të ndier se sa shumë i shkon epizmit të saj monorima. Poeti e kalon këtë rimë në vargjet e këngës, sikur kërkon të ndërtojë me të strukturën e tyre, shtyllën që e mban në këmbë, tërë barrën ideoemocionale të këngës:

*Shqipëria, e varfëra,
tok' e bënë, po më të s'mba,
çorv' e bënë, po më të s'ha!
Sot ka dalë në dynja!
Ç'u përpoqnë burr' e gra,
tapraku me gjak u la,
dijti se përsë u vra.*



Kurse te kjo lirikë e rrallë për bukurinë e saj, hasim një muzikalitet tjetër:

*T'iu këndoymë-o trimave,
që flenë lëndinave!
Dyshek kanë tokën-o,
jorgan kanë gunat-o,
vëllezër. fishekët-o,
për sulm kanë bombat-o,
shtëpi kanë shpellat-o!
Ata vuajn' pér liri,
nuk duan robëri!*

Ka në muzikalitetin e këtyre vargjeve butësi, dhemje e krenari që jehon plot harmoni ritmike. Vëreni, p.sh. dy rimat e para, rima rrëshqitëse, të krijuara me fjalë proparaoksitone, ku ke përshtypjen se zëri vjen e shuhet në rrökjen e fundit; të duket sikur një dorë e butë kalon me dashuri mbi trimat e lëndinat... Kurse në vargjet që vijnë më pas, rima edhe është edhe s'është, atje sundon asonanca si pér të dashur të shprehë veç butësisë edhe shqetësimin, gjë që kumbon sidomos në o-të fundore, që ngjajnë secila si thirrje dhembjeje e jehona ninulle bashkë. Megjithatë mijaf-tojnë dy vargjet e fundit me një muzikalitet më të fortë, me një ritëm më të kadencuar, më të organizuar, pér të nënvizuar optimizmin e krenarinë e brendshme që ka gjithë këngë.

Kurse te një poezi tjetër popullore, po e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, humori buron edhe nga lëdra e rimës, siç duket qartë nga ky fragment:

*Ki prefekti, nur o nur,
gjisma turk, gjisma kaur,
një natë që ra një mur,
vate u fut në haur.
Në haur u fut i ngrati,
pati frikë a çfarë pati,
atje ish dhe veshëgjati,
mezi e nxori Fuati!*

Aliteracionet me u në pesë vargjet e parë dhe me a në vargjet e fundit, përsëritjet e fjalëve, rimat e brendshme, u japid forcë vargjeve duke shtuar edhe më te për dozën e tyre sarkastike. Domosdø, në këtë këngë nuk janë rimat që përbëjnë thelbin e satirës, por mjeshteria e përdorimit të tyre jep dorë së tepërmë përfuqizimin e saj.

Interesante do të ishte të vëreheshin edhe shumë veçori të tjera që kanë të bëjnë me muzikalitetin e vargut popullor dhe me mjetet e përdorura përfasurimin e këtij muzikaliteti.

Sistemi ynë metrik nuk është më kuantitativ, por ka kohë, që dikur para mesjetës, që është kualitativ. Dhe nga llojet e sistemit metrik kualitativ¹⁾ ne përdorim më shumë e kryesisht atë silabikun. Kjo nuk do të thotë se nuk hasen gjurmë të sistemit silabo-tonik, por vetë zhvillimi i gjuhës, vetë destinacioni i poezisë, bëri që të tërhiqet sistemi i vargëzimit silabo-tonik dhe tek ne të mbisundojë ai silabiku. Përpjekjet që bën De Rada te «Milosao» përf të riafir-muar sistemin silabo-tonik nuk u ndoqën nga të tjerët. Ne i numërojmë sot vargjet sipas numrit të rrokjeve dhe i ndërtojmë sipas ligjeve të konstanteve të theksave ritmikë. Një konstante e tillë është theksi i thekrueshëm ritmik në rrokjen e parafundit. Gjurmët

1) Sistemet metrike kualitative janë: *sistemi silabo-tonik*, (që quhet edhe *sistemi ritmik*) në të cilin vargjet formohen nga këmbë me rrokje të theksuara ose të patheksuara; ky sistem përdoret në poezinë angleze gjermane, ruse etj.; *sistemi silabik*, në të cilin vargjet janë të formuar nga një numër i caktuar rrokjesh dhe nga një numër i caktuar theksash ritmikë; ky sistem përdoret në poezinë tonë, në atë italiane, franceze etj.; *sistemi tonik*, në të cilin vargjet janë të formuar nga një numër i pakaktuar rrokjesh, por nga një numër i caktuar theksash ritmikë; në këtë sistem janë p.sh. vargjet e bilinave (rapsodive) ruse etj. Kurse në *sistemin metrik kuantitativ* hyn sistemi i përdorur nga letërsia e vjetër greke dhe latine. Sipas këtij sistemi vargjet ndërtohen me këmbë të formuara nga rrokje të gjata dhe të shkurtëra.

silabo-tonike, që ruan vargëzimi i poeziës sónë të shkruar, nuk përbëjnë sot bazën e tij. Në qoftë se bëhet fjalë pér poezinë tonë popullore, atëherë, po, mund të pohohet se sistemi silabo-tonik atje është i gjallë, mbasi lidhja me melodinë e detyron ta bëjë një gjë të tillë. Megjithatë prirja edhe e kësaj poezië është që pérherë e më tepér të shkëputet nga ky sistem dhe të lidhet me sistemin silabik.

Natyra e gjuhës shqipe, vendi që zë theksi tonik në fjalët (me një pëlgim pér rrokjet parafundore) ka bërë që vargjet popullore të jenë kryesisht me rrokje çift: tetërrokësh, gjashtërrokësh, dhjetërrokësh etj. Nga ana tjetër, kur flitet pér vargjet popullore është bërë zakon të pohohet se ata janë ndërtuar me këmbë trokaike. Në këtë pohim ka një të vërtetë të dukshme, por duhet thënë, në të njëjtën kohë, se realiteti konkret i vargjeve popullore flet pér diçka më tepér, flet pér faktin se vargëzimi popullor është shumë më i pasur me këmbë të ndryshme. R. Sokoli, që e vë re këtë ndër të parët dhe e ka provuar plotësisht në faqet e librit të tij, duke folur pér këtë çështje thotë: «Studimet e mëparshme nxirrin si përfundim se vjershat tona shtjellohen kryesisht në katër tipe vargjesh: me dhjetërrokëshin epik, me tetërrokëshin, me gjashtërrokëshin dhe me katërrokëshin. Që të gjitha këto masa vargjesh i paskemi gjoja trokaike. Ta përmbledhësh vetëm në kaq pak tipe të gjithë prozodinë tonë, do të thotë tа paraqesësh më të varfér se çështë në të vërtetë. Në visarin tonë kemi një larmi të madhe trajtash që burojnë prej vetë kushteve të jetës dhe prej rrëthanave të ndryshme që ndikuan në këtë lëmë. Pra vjershat tona nuk shtjellohen vetëm në tri-katër farë vargjesh trokaike, por thuren edhe me masa të tjera, ku përveç trokakëve, mund të gjenden këmbëza përirike, jambike, daktile, anapestike, amfibrake e rrallëherë peone dhe epitrite.»¹⁾

1) R. Sokoli «Folklori muzikor shqiptar» (Morfologjia), Tiranë 1968, f. 56.

Dhe në të vërtetë po t'u hedhim një sy qoftë edhe shpejt, siç do të bëjmë ne në rastin tonë, vargjeve popullore e strukturave të tyre, do të vëmë re menjëherë se ndodhemi përparrë një larmie e pasurie të madhe. Interesante është të vërehen për këtë çështje jo vetëm këngët, por edhe proverbat, të cilat siç dihet shpesh janë ndërtuar me vargje e rima. Në to gjejmë vargje të ndryshme, shpesh tepër të shkurtër, vargje të përbërë nga një këmbë e vetme siç ndodh në këtë rast:

*I shumi .
si lumë,
i paku
si gjaku.*

v - v

Te ky proverb kemi vargje trirrokësh të formuar nga këmbë amfi brake. Nuk do të ishte ë drejtë të mirej shembulli si një distik i formuar nga dy gjashtërrokësh, mbasi rimat e piketojnë fare qartë strukturën e vargjeve. Po kjo gjë ndodh edhe te ky proverb i marrë nga Mitkoja:

*Kush flet,
përet.*

Kurse me katërrrokësha janë ndërtuar këto proverba:

- 1) *Barku firë* - ✓ / - ✓
s'kërcën mirë. ✓ ~~✓~~
- 2) *Barku plot*
s'kërcen dot.
- 3) *Conj një kashtë*
e gjenj gjashtë.

Në të tre rastet vargu i parë është formuar nga dy troke, kurse vargu i dytë nga një këmbë pirrike dhe një troke (dipodi pirrike-trokaike). Kurse ky proverb

përbëhet nga vargje katérrokëshe të formuar nga këmbë peone:

*E mitura,
syqitura.*

Katérrokëshi përdoret mjafët edhe te këngët e loredrat e fëmijëve, ku pëlqehet për ritmin e tij të shpejtë:

1) *Hënë e re,
vashë e re,
tinë plakë,
un' e re,
ti gërshtet,
un' shëndet!*

2) *Flutur, flutur
zoj' e bukur,
bukën e re,
sillnaj ne.*

3) *Oloria
bororia!
Më dërgoi
zotënia,
për një setë,
për një petë,
për një vashë
bukurashë:
as e ngas,
as e vras etj.*

→ Mjafët përdoret ky varg i shkurtër edhe nëpër refrene: •

*Hiq' e dridhe vallenë,
moj sylarme!
me atë kondoshmadhenë,
moj sylarme!*

*C'vëngëron mbi nj'anë,
nuse lule?
Mos do trimnë pranë,
nuse lule?*

Sidoqoftë, sot katërrrokëshi është një varg që nuk
 haset thuajse kurrë i vetëm në një këngë, por kur-
 doherë i përzier më të tjerë. Shpesh ndihet se tetërrro-
 këshat e një kënge popullore kanë dalë nga bashkime
 katërrrokëshash, kaq të përsosur ritmikisht janë hemis-
 tikët e formuar nga këtò vargje të shkurtër. Dhe kjo
 mbase të bën të mendosh se dikur mvehtësia e këtij
 vargu duhet të këtë qenë më e madhe, por me kohë,
 për vetë zhvillimin e melodisë, ai ka vajtur duke u dy-
 zuar përfshirë dhënë tetërrrokëshin, drejt të cilit, siç do
 të kemi rast ta themi edhe më poshtë, duket sikur
 priren mjافت vargje popullore.

Pesërrrokëshi haset në proverba e gjëegjëza:

1) *Kush len këmbyem,* v —/ v — v
këmbyem des. v — v / —

2) *Shka ka bucela,*
e qet kangjela.

3) *Zhytet e mytet,* — v v/ — v
del n'breg e kotet. — v v/ — v

4) *Ferra e nisi,* — ✓ ✓/ — ✓
ferra e grisi. — ✓ ✓/ — ✓

Siç vihet re mund të jetë dykëmbësh jambiko-am-
 fibrak, një dykëmbësh amfibrako-jambik, një varg ado-
 nian (daktil plus troke).

Te një lodër fëmijësh, që nuk këndohet por thu-
 het me një kadencim të qartë, hasim pesërrrokësha:

C'e bëre, mishtë, moj nuse?
 E hëngri maceja.
 Maceja ç'u bë?
 Hypi në lis.
 Lisi ç'u bë?
 E preu sëpata.
 Sëpata ç'u bë?

E theu guri.

Guri ç'u bë?

E mori lumi.

Lumi ç'u bë?

E pinë qetë etj.

Ajetë sa sonë i ndepur ujku

ryja su bë vjen e gjetë

Në këngë eshtë vështirë të gjendet i vetëm, por refrene nuk eshtë i rrallë:

1) — *Mbush kupën me dukagjin,
moj bija ime!*

— *Si ta mbush, kujt të ia shpie,
nëneja ime?*

2) *Bini drandofillja n'derë,
moj shamiverdhë!
Casht njaj plak qi t'vjen përherë,
moj shamiverdhë?*

3) *C'u mbush mali plot me borë,
moj yplot me borë!
Mos e zër nusen me dorë,
nusen me dorë!*

Gjashtërokeshi eshtë tepër i përhaptur. E gjejmë proverba, në gjëegjëza, por sidomos në këngë lirike, valle etj. Ja disa shembuj të formuar nga këmbë të ndryshme:

1) *Më ranë ca halle,
faqeja portokalle...
Më ranë qedere,
në zemër më there!*

v — v/v — v
v — v/v

2) *Mes për mes avllisë,
sheqer i kutisë.
Ke babanë brenda,
këmbedorargjenda!*

— v/ — v/ — v

3) *Vasha, maj, vasha,* — v v/ — v
kërkëllin dërrasa! v v — v/ — v

• Përsa i përket shtatërrokëshit, shembujt që kemi na bindin se ai nuk është i pamundur në ritmikën e folklorit tonë. E hasim në proverba:

1) *Ku han' e nuk të apin,* v — v/ vv — v
ku flet s'të dëgjojnë,
zotynë mos të të shtiftë.

(2) *Ia dha drurit, u tha*
ia dha grurit, u çा,
ia dha njeriut, i mbajti.

E gjejmë në gjëegjëza:

E jëma pupulaqe, v — v/ vv — v
e bija dredharaqe.

Por e gjejmë edhe të ndonjë këngë. Ja një shembull ku është në funksionin e refrenit:

Më vate burri ndë kurbet,
nënoce, s'të vjen keq?

E mos ka pak, po nëntë vjet,
nënoce, s'të vjen keq?

Ja dhe një shembull tjeter:

Gushën-o plot gjerdane, vv — / vv — v
duart-o plot merxhane,
buzën-o karafile,
faqet-o trëndafile!¹⁾

1) Edhe ky shembull, si shumë të tjerë që sillen në këtë kapitull, është marrë nga vepra e cituar më parë e R. Sokolit.

Po t'u heqësh o-të, këto vargje kthehen e bëhen gjashtërokësh, por melodia që i përcjell kërkon patjetër ritmin e shtatërokëshit dhe kjo të shtyn të mendosh se shtatërokëshi dikur mund të ketë qenë më i përhapur. Sidoqoftë duhet pohuar se sot ky varg është gjë e rrallë, mbasi edhe atje ku hetohet priret në këngë e sipër drejt tetërokëshit.

Vijmë kështu te tetërokëshi, vargu më i përdorur jo vetëm në poezinë tonë gojore, por edhe atë të shkruar. Midis vargjeve me rrokje çift, tetërokëshi është padyshim më i preferuar, mbasi nuk paraqitet as tepër i shkurtër, as tepër i gjatë, është shumë i manovrueshëm e i përshtatshëm për tema të ndryshme, për emocione nga më të larmishmet, për epikën, lirikën dhe dramatikën bashkë. Me gjashtërokëshin mund të vallëzohet, por është vështirë të thuret një poemë epike; me dhjetërokëshin mund të tregohet një ngjarje, mund të shkruhet një poemë e gjatë epike, po vështirë se mund të kércehet me të; kurse me tetërokëshin mund të kércehet, të këndohet, të tregohet një ngjarje epike dhe muzikaliteti i tij të mos bjerë kurrë në monotonji. Kjo mbasi pasuria e tij e brendshme është jashtëzakonisht e larmishme. Le të mjaftojnë disa shembuj me skema ritmike të ndryshme, ku hasim ritme të matur, të ngadaltë, të shpejte, gazmori etj.

- 1) *Shtatë dit' kish hyrë prilli, — v/ — v/ — v/ — v
u tha bari e tërfili...*
- 2) *Kalaja në mes të detit, v — v/ v — v/ — v
Kurvelesh, lule xhenetit... vv — / — vv/ — v*
- 3) *Dolla, more shokë, dolla, — v/ vv — v/ — v
mora bajrakun e shkova... vv /v — v/ v — v*
- 4) *Në lëmë, te arrë e madhe,
vinë dhentë valle-valle...*

Nuk është vështirë të gjenden shembuj nga më të ndryshmit. Por nga ana tjetër duhet vënë në dukje

se me kalimin e viteve në gojën e popullit tetërrokëshi ka fituar kurdoherë një ritëm e muzikalitet të ri që pasqyronte ritmin e kohës. Ndryshe, p.sh. tingëllon ai te këngët e Tanzimatit e ndryshe te këngët e Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare, nëse tek të parat ai ruan një farë hiperbolizimi, një melodi harmonioze që herë-hërë të kujton baladat romantike:

*Hajde, mor Rrapo Hekali,
kur thërrret sa tundet mali!
Hajde, mor Rrapo, o lule,
lumthi ti ç'bilib që zure...*

te të dytët ritmi është më i natyrshëm, ruhet nga rrugët e kollajta të një harmonie tepër kumbuese, si për të vënë më mirë në dukje brendinë realiste të mendimeve dhe ndjenjave të shfaqura:

*• Matohiti me vlerë,
haj medet, o Mustafa!
Në Lekëdush keshe lerë
me shumë shokë tjerë...*

Poëtet tanë të Rilindjes e më pas e përdorën me sukses tetërrokëshin thuajse në të gjitha llojet e poe-zive të tyre. Ata, në krijimet më të mira, ditën të përdorin me mjeshtëri e me shumë përfitime përvojën e popullit. Kjo shpjegon edhe faktin që secili prej tyre diti të shprehë me këtë varg individualitetin e vet. Në se te Naimi tetërrokëshi rrjedih i qetë, i pasur me theksa ritmikë, i matur e i ngadalë:

*Pa dëgjo fyellin ç'thotë,
tregon mërgimet e shkreta,
qahet nga e zera botë
me fjalëzë të vërtetë!*

te Çajupi ai sikur merr tonin e një bisede e bëhet i aftë jo vetëm për lirikën dhe epikën, por edhe për komedinë.

*Bariu, shokë, bariu,
kur gjëmon e frys veriu,
është përjashta fatziu,
e rreh breshëri dhe shiu!*

Apo:

- *Dëgjo, burrë!*
- *C'ke, moj grua?*
- *Jam sëmurë!*
- *Që kur, ç'thua?*
- *C'them? Ja them që jam sëmurë,
koka më digjet si furre...*

Mjeda i jep vargut të tij një përpikmëri ritmike shumë më të madhe, gati-gati një arkitekturë të myllur, megjithatë tepër të këndshme për veshin dhe tepër të aftë për të dhënë tablo me përgjithësimë:

*Po njaj vaj qi je tui lëshue,
bybyl, zemrën ma copton;
ditë e natë rrrij tui përgjue,
vaj për mue! Kush mund t'ngushllon?*

Kurse te Asdreni tetërrorëshi këngëzon:

*Vështro Kocin si po tundet
me justanet klinda bërë,
udhës ecën, rrobës shkundet,
që ta shohë fshati i tërë!*

* Lasgushi sikur i hedh tetërrorëshit të tij një tis përmallimi; edhe kur shpreh gjëzimin duket sikur melodja mbetet në shkallët minore:

*Frym veriu në mal të thatë,
thotë vasha, lele ngriva!
Duro, vashë, të durojmë,
si duron mali dëborën!*

Sidoqoftë, te të gjithë shembujt e dhënë gjer këtu hetohet diçka e përbashkët, diçka që i lidh ritmet dhe, sado të ndryshëm, i bën prapë që të ngjajnë midis tyre. Kjo e përbashkët buron nga fakti që këta poetë, me pak përjashtime, i përkasin pak a shumë së njëjtës periudhë, qoftë edhe në fazë të ndryshme të saj. Kjo ka bërë që në ritmin e vargjeve të tyre të ndihet, ta themi kështu, ritmi i kohës, jehona e atmosferës romantike dhe patriotike, atmosfera e bashkimit, vëllazërimit dhe e luftës për liri. Është pikërisht ky ritëm i përbashkët që i lidh, i bën të ngjashëm dhe, nga ana tjetër, kaq të ndryshëm nga poetët e tjerë që erdhën më pas. Dhe, në të vërtetë, duke vërejtur këta poetë të fundit, sidomos Migjenin, të bie në sy fakti që tetërrrokëshi nuk është më ai i pari. tani e ka humbur butësinë e tij prej kadifeje, harmonia e tij e brendshme i zë vendin harmonisë së jashtme me realizmin e fushishëm; poetët që vijnë në këtë periudhë përpilen të sjellin jehonën e kohës në të cilën jetojnë në një mënyrë më të vetvetishme, pa artifice. Migjeni, siç e thamë, hedh këtu hapin i pari. Tetërrrokëshi i tij dallon kryekëput nga ai i Naimit, pa le pastaj nga ai i Mqedës apo Nolit:

*Prralla mbi fëmi rrugaça,
barkjashtë e me hundë të ndyta,
që dorë shtrijnë me vjedhë, me lypë
e ngihen me fjalë të ndyta.*

Ritmi i këtyre vargjeve është kaq i thyer, saqë herë-herë ke përshtypjen se ke të bësh më një gjuhë artritike. Por nuk është ashtu. Këto vargje, me ritmin dhe harmoninë e tyre disi të thatë, janë plotësisht në përshtatje me brendinë që zbulojnë, ato sjellin kohën e poetit me gjithë kontradiktat që e brenin atë përbrenda. Dhe në këtë rast tetërrrokëshi ynë nuk varfërohet, por, përkundrazi, pasurohet më arkitektura të reja ritmike, me aftësi të reja shprehëse, me një amplitudë më të madhe për të pranuar në gjirin e vet edhe fjalët më të rëndomta, më të përditshme.

Ky shqetësim i brendshëm përpinqet të thyejë skemat e mëparshme ritmike, deri atje saqë merr herë-hërë pamjen e vargut të lirë, kur nuk është as varg i përzier, por një varg i rregullt, siç ndodh me këtë poezi të Q. Stafës, ku me pak durim mund të rindërtojmë tetë-rrokëshin:

*Melodia kumbënuese
si një kange ledhatare,
n'perëndim atij i fliste:
— Mik, o mik,
e si jetove
përmes vjetësh
n'zbrazdësi?
Qfarë kange
ti këndove
mbi të poshtrën vogëlsi:
A e munde egërsirën
që t'kafshonte
pa mëshirë?*

Kështu vazhdon deri në fund, me vargje tetërrokësh kjo poezi e Q. Stafës që titullohet «Perëndimi». Po Q. Stafa nuk është i vetmi poet i kësaj periudhe që heton me talentin e tij nevojën pér një organizim të ri poetik, pér një strukturë të re ritmike në mënyrë që brendia e re të kishte mundësi të gjente ritmin, formën e re më të përshtatshme. Dhe po të vërehet me kujdes, ai i ruan vargut të tij herë-hërë një kadencë gati-gati marciale, si pér të shprehur me këtë ritëm nevojën e një mobilizimi të forcave shoqërore.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirintare dhe sidomos më pas, ke përshtypjen se tetërrokëshi e gjen sërisht ekuilibrin harmonik të mëparshëm. Poëtët tanë të kësaj periudhe lidhen me traditën më të mirë të Rilindjes e sidomos të poezisë popullore. Memo Metoja ka mjaft rregull e pasuri harmonike në vargjet e tij më të mirë. Megjithatë, do të ishte gabim të mendohej se ritmi i vargut të tij nuk bën gjë tjetër veçse përsërit

traditën. Aspak. Në tetërrokëshat e Memo Metos, ashtu si në ato të krejt poetëve të Luftës, kumbon e fortë jehona e kohës, e ritmit të ri të betejave partizane. Poetët e tjerë si Musaraj, Gjata, Varfi, Jakova, Çaci, Qafzezi etj., që krijuan në këtë periudhë apo vazhduan edhe më pas, ruajnë strukturën ritmike të tetërrokëshit, i cili, ndonëse nuk është më ai i pari, ka ende mjaft ngjashmëri me vargjet tepër të rregullta të Naimit apo Nolit etj. Ajo që i bëri të ndryshëm ritmikisht prej këtyre është, në radhë të parë, jehona që hedh koha, aktualiteti, në vargjet e tyre. Vetëm pas çlirimt, kryesisht në poetët e rinj, që lindën e u formuan të tillë në vitet e pushtetit popullor, tetërrokëshi filloi të trajtohet sërisht me kërkesa për ritme të reja. Le të shikojmë, p.sh. te Kadareja:

*Këtu afër shtëpis' sime,
ku u linda, ku u rrita,
rrjedh një prrua dhe, më tutje,
një pullaz me llamarinë.
Nënë shi e nënë breshër,
troket dimërit të gjatë;
kënga e saj më qe e dashur
që kur nisa ta dëgjoja...*

Apo te D. Agolli:

*Në grurë kish rënë drapéri,
ish tharë bari nér ara,
pëlciste për ujë gjarpéri
dhe binin mullareve zjarre...*

Te Kadareja, në përgjithësi, ruhet ritmi i tetërrokëshit, por ai lehtësohet shumë: nuk haset rregullshmëria strikte, kemi më tepër hije rimash se sa rima, pauzat brendë për brenda vargut i binden vetëm sintaksës emocionale. Te Agolli, ndonëse poeti u përmbarat rregullave ritmike popullore, tetërrokëshat hidhen

herë-herë tej kufirit të nëntërrorkëshit; dëshira për të krijuar tonin e një bisede të natyrshme, pa emfazë, pa pozime, e bën poetin të kërkjojë e të gjejë një ritëm ca të ndryshëm, që thyhet nga cezurat apo pauzat, të cilat vijnë e shtohen.

I trajtuar në këtë mënyrë tetërrorkëshi fiton një ritëm të ri, i ngjan disi atij të Migjenit, por prapë nuk është ai, sepse ka brenda tij diçka plot dritë, diçka të qeshur që nuk mund ta kishte as brendia as ritmi i vargjeve të Migjenit.

Duke u zgjatur kaq shumë me tetërrorkëshin, nuk duam në asnjë mënyrë të tërheqim vëmendjen për përdorimin e tij më tepër apo për mospërdorimin e tij ashtu siç duhet; e ca më pak të absolutizojmë nevojën e përdorimit të tij. Poetët tanë duhet të përdorin tërë larminë e madhe të vargjeve e të strofave popullore, ndryshe të ndalurit në një strofë apo një varg të caktuar nuk do të bënte gjë tjetër veçse do të varféronte ritmikën tonë. Nga ana tjetër, tetërrorkëshi nuk ka aspak nevojën e rekomanimit tonë, mbasi ai, sot e kësaj dite, zë në poezinë tonë një vend të merituar, domosdò, së bashku me vargjet e tjerë popullore. Mund të thuhet me plot gojën e pa frikë përgënjeshtrimi se poetët tanë i besojnë ritmit të tij çdo idë, ndjenjë, subjekt, shqetësim të tyre poetik. Ai e ka treguar veten të aftë ta kryejë me sukses një detyrë të tillë kur është përdorur me sens të vërtetë artistik. Nuk ka nevojë të përsëritim shembuj, por të bën përshtypje fakti që Naimi i besoi praktikisht tërë krijimtarinë e tij më të mirë këtij vargu. Madje edhe një poemë si «Iliada» u vu ta përkthejë e me sukses në tetërrorkësh, duke u treguar me këtë shumë novator. Sëpse dihet që vargjet e Homerit, Virgjilit, etj. është bërë zakon të përkthehen edhe te ne në njëmbëdhjetërrorkësh, gjë që nuk duam ta përashtojmë. Por sot, nga mjafit përkthyes përparimtarë në botë, po bëhen përpjekje për t'i ripërkthyer këto vepra në një gjuhë e në një metër sa më të afërt për popullin, për të dhënë atë që ishte karakteristikë për vepra të tilla në kohën kur u shkruan — karakterin e tyre po-

pullor. Naimi ynë, me intuitën e tij prej artisti në shërbim të popullit, e bëri këtë njëqind vjet më parë. Kështu veproi edhe Çajupi me Tibulin. Prandaj na tingëllojnë subjektive shprehje të tillë absolute për njëmbëdhjetërokëshin: «Eshtë më i përshtatshmi për të dhënë madhështinë dhe hijeshinë e hekzametrit, prandaj edhe kryeveprat antike në hekzametër janë dhënë shqip në vargje njëmbëdhjetërokësh.»¹⁾

○ Përsa i përket nëntërokëshit, R. Sokoli, në librin e tij jep dy shembuj që të bëjnë përshtypje dhe që ndihmojnë për të hedhur poshtë mendimin se në poezinë popullore nuk ekziston një varg i tillë, duke qenë se eshtë me një numër tek rrökjesht. Shembulli i parë eshtë nga Kolonja:

*Po mbani, moj shoqe, shandanë,
sa ti hedhim çupës kënanë!*

Po mbani, moj shoqe, kandilë,

sa ti hedhim çupës mazilë!

O kënga me hair ng goftë!

Po motra na u trashëgoftë!

Vargjet e kësaj kënge janë formuar nga amfibrakë: v-v/v-v/v-y., Shembulli i dytë eshtë nga Kruja:

O na bjer' buk' moj xhixhillloje,

buk' na bje, buk' na bje, lajle.

O na bjer' uj', moj xhixhillloje,

uj' na bje, uj' na bje, lajle.

Këmbët që formojnë këto vargje janë të përbërë këtë radhë nga daktile e troke. Kurse ky shembull tjetër eshtë nga Gjilani, i Kosovës:

Rrang e dang po na bon sahani,

bine dhondrin se u bo akshami!

Rrang e dang po na bon tepsi,

bine dhondrin se u ba jacija!

1) «Fjalori shqejegues i termave të letërsisë», Tiranë 1972, f. 155.

— Dhjetérrokëshi është më i përhapur, siç dihet; në rapsoditë e veriut, por kjo nuk do të thotë se nuk haset edhe në këngë lirikë. Ja shembuj nga lirika:

— *Moj Xhemile, ku t'xu ylli i dritës?*
— *Më, ka xanun ndër fushat e Dibrës!*

(Dibër)

— *Do të marr, o moj fëllëz' malit!*

— *S'më merr dot, o mor yll i karvanit!*
(Pogradec)

*Lumet na të lumet për kët' ditë,
lulja e jon-o sobën na e ka zdrítë
ani na e ka zdrítë, na e ka hjeshue,
me t'gendista e ka rrethekue!*

(Gjilan)

“Në të tre rastet kemi të bëjmë me vargje trokaikë të formuar nga bashkimi i katérrokëshit me gjashtérrokëshin. Dhjetérrokëshi mund të formohet edhe nga bashkimi i dy pesérrokëshave, gjë që e hasim sidomos në poezinë e shkruar.

Përsai i përket dhjetérrokëshit të rapsodive, ai parqitet i mirëfilltë sidomos në disa rapsodi, kurse në disa të tjera vërehet se luhatet herë-herë midis tetérrokëshit e nëntérrokëshit, në mos kapérceftë edhe në ndonjë varg me rrokje më shumë se dhjetë. Kështu nëse te këto vargje kemi dhjetérrokësha të mirëfilltë, ku mbësundojnë këmbët trokajke:

*Trim mi trima aj Gjergj Elez Alija!
Qe nand vjet, nand varra n'shtat m'i ka.
Veç nji motër nat' e dit' te kryet
ia lan varrt me ujt e gurrs nand vjeçe...*

te këto vargje të tjere hasim edhe «parregullsira».

*...se nuk janë t'bukrat e dheut,
por janë çikat e Behurit,
n'mollë t'shalës s'Mujit kryet qi po u rri vjerri,*

*kanë marrë rrugën për mërti n'Jutbinë
krushkë e parë jam vetë qì dritë po u baj!...
(Muji dhe Behuri)*

Duke parë të tilla raste, duhet të themi se që të mund të përcaktohet qartë fizionomia e ndërtimit të dhjetërrrokëshit tonë populor, sidomos e atij të rapsodive të kreshnikëve, është e domosdoshme që ky të studiohet lidhur ngushtë me melodinë që e organizon. Në këtë organizim ke përshtypjen se pavarësisht numrit të rrokjeve (8, 9, 10 apo më shumë) ky varg këndohet sikur të ishte dhjetërrokësh i mirëfilltë, siç ndodh edhe me shembulin e fundit. Kjo arrihet, kur është varg më i shkurtër, me anë shtesash (o, hej, sa, mor etj.) ose duke zgjatur zanoret etj; kur vargu është më i gjatë, duke i grupuar, duke i «shkurtuar» ato nëpërmjet një melodie më të shpejtë. Sidoqoftë në të dy rastet nabehet se vendi i konstantes ritmike nuk ndryshon (rrökja e nëntë), ashtu si mbetet thua jeshpō ajo edhe sasia edhe vendi i theksave të tjerë ritmikë. Mos vallë këtu kemi të bëjmë me ndonjë mbeturinë të sistemit tónik, ku, siç dihet, vargjet, pavarësisht numrit të rrokjeve, kanë një numër të caktuar theksash ritmikë? Nuk është aspak përtu çuditur, por, sidoqoftë një pohim i tillë do studiuar qjer në fund. Mbase mund të jetë fare bukur një gjenjim që na krijohet nga fakti, që përfat të keq, ky varg sot është diku e përdorur përherë e më pak. Rapsodët e rinx, në menyrë të vetëdijshme, ose jo, priren drejt tetërrrokëshit; kur me melodinë e dhjetërrrokëshit ata përcjellin, me lahitën e tyre tetërrrokësha, domosd, do të hasen lëkundje, «parregullsira», të cilat mund të japid edhe përshtypjen e gabuar për të cilën folëm më lart. Sepse duhet thënë, nga ana tjetër, se sot tetërrrokëshi është duke u bërë përherë e më tepër në folklorin tonë, një varg drejt të cilit priren mjaft vargje të tjerë. Kështu, p.sh. këto vargje gjashtërrrokësh;

*Diersa jot' e ballit,
er' e jargavanit!*

Djersa jot' e fakes,
Një s ëmber, e manushaqes!

këndohen si tetërokësha oksitonë:

Djersa jot' e ballitë,
evibozur, er' e jargavanitë!
Djersa jot' e fakesë,
er' e manushaqesë!

Unë Sidoqoftë dhjetërokëshi

është një metër me një
ritëm titël gjéré, plot frymëmarrje, me një madhështi
harmoneike që është shumë e përshtatshme pér epikën
dhe pér strukturën sintaktikore të gjuhës sonë. Duke
folur pér këtë varg, Dh. S. Shuteriqi thotë me të
drejtë: «Dhjetërokëshi popullor, si vargu i thjeshtë më
i gjati i poezisë popullore, ka mundësira të mëdha
shprehje dhe duhet të bëjmë që të mos zhduket bashkë
me rapsodinë, po të përdoret dhe të ruhet sa më shumë.
Me shumbjen e tij vërtet metrikë jonë do të pësojë,
do të vobekësohet. Vargjet e tjérë të gjatë të shqipes,
sidomos njëmbëdhjetërokëshi që kemi marrë nga ja-
shtë mund edhe ta zëvendësojnë. Po dhjetërokëshi, varg
i poezisë sonë, ka një thekës tonin, është i lidhur ngu-
shë me zhvillimin e poezisë sonë që së lashti fort dhe,
pér këtë, asnjë varg në shqipet nuk mund t'iia zërë ven-
din pa mbetur digka bosh.»¹⁾

Pér vargun njëmbëdhjetërokësh nuk mund të fli-
tet në poezinë popullore, mbasi gjer më sot nuk është
hasur në të. Më gjithatë është e mundur fare bukur që
të flitet pér «shqiptarizimin» e këtij vargu, pér përshtat-
jen e tij të plotë me psikologjinë dhe sintaksin e gjuhës
sonë. E kjo gjë arrihet nëpërmjet shpërndarjes së thek-
save ritmikë, por sidomos nëpërmjet përdorimit të
mijëteve popullore instrumentuese. Punë të madhe kanë
bërë në këtë vështrim më këtë varg poetë si Noli,

1) Vepër e cituar, faqe 32.

Mjeda, Migjeni, por qedhe poetë më të rinj si Siliqi, Agolli, Kadareja, Arapi etj.

Përsa u përket vargjeve të dyzuar — dymbëdhjetë rrrokëshit e gjashtëmbëdhjetërrrokëshit — ata janë të formuar që herët në poezinë popullore dhe, në fakt, më parë i gjejmë në popull e pastaj, në poezitë e Naimit apo Çajupit. Le të mjaftojnë për këtë vëtëm dy shembuj dymbëdhjetërrrokëshash, i pari nga jugu, i dytë nga veriu:

- 1) *Nga kurbeti arçë, pse s'më përshëndoshe?
Në mes të beharit, se ç'më plevitose..*
- 2) *Përcalla dilberin, ktheva hina n'odë,
ia gjeta manzeren, ia qava me lotë..*

Kurse në këto vargje të tjerë kemi gjashtëmbëdhjetë rrrokësha:

- 1) *Rinte dhëndëri te shkalla fort, i pikelluarë..
Mos djalo, për kryet tat, mos rri zemëruarë!*
- 2) *Ububut! nënoca ja ime, ç'pashë sonëte nd'ëndërrë!
Sikur më nise, më stolise e më dhe një dhëndërë!*

Sic u vu re edhe me kaq sa u tha gjer këtu, metrika popullore, edhe përsa i përket larmisë së vargjeve, është një thesar i madh e i pashtetur që vazhdimisht përtërihet. Pikërisht për këtë arsyе ia vlen që ajo të studiohet shumë më tepër nga ç'është bërë gjer më sot, duke zbuluar e njohur gjer në fund ligjet e vargjeve të saj, mjetet e shumta e të larmishme për instrumentimin e tyre, ritmin e tyre që di të marrë përherë nuanca të reja në harmoni të plotë me brendinë etj. Nga njëstudim i tillë, studim i kryer prej poetëve drejtpërsëdrejti mbi materialin e gjallë, nuk ka asnjë dyshim se do të përfitojë edhe më shumë vargëzimi i poeziës sonë, ndërsa vargu i lirë do të arrijë të bëhet, ta themi kështu, edhe më shqiptar, më i përshtatshëm për veçoritë e gjuhës sonë, të

psikologjisë dhe të realitetit tonë. Edhe përvoja e përpjekur botërore, e konkretizuar në veprat e poetëve më të mirë, na vërteton vazhdimisht se vargëzimi i tyre është pasuruar, është bërë më i larmishëm, ka fituar pérherë e më tepër aftësi e mundësi të reja shprehjeje duke u bërë gjithmonë e më i përshtatshëm për kohën, vetëm kur është mbështetur fuqimisht e në mënyrë krijuar në vlerat e metrikës popullore. Vargjet e shumë poetëve, si p.sh. Bérns dhe Hajne, i kanë rrënjet thellë në metrikën popullore; struktura e vargut të thyer të Majakovskit nuk mund të kuptohet pa patur parasysh, veç të tjerave, edhe vargun tonik të poeziës së vjetë ruse, kurse poezitë e një poeti bashkëkohës si Preveri kanë strukturën metrike sidomos të ninullave popullore franceze. Mund të përmenden shumë shembuj e jo vetëm nga poezia e huaj, por përfat të mirë, edhe nga poezia jonë e kaluar dhe e sotmja. Në vargjet e Naimit e De Radës, Çajupit e Nolit, Asdrenit e Poradecit, Migjenit dhe Musarajt, Gjatës e Siliqit, Agollit e Kadaresë etj., prania e vlerave më të mira të metrikës popullore bie kurdoherë në sy dhe, në shumë raste, ajo është komponentja kryesore në strukturën e vargjeve. Poetët tanë më të talentuar kështu kanë vepruar prej kohësh e kështu vazhdojnë të veprojnë edhe sot e kësaj dite.

3. INSTRUMENTIMI NË POEZINË POPULLORE SHQIPTARE

Duke i hedhur një vështrim qoftë edhe të shpejtë vargëzimit të poezisë sonë popullore, mund të vësh re disa tipare të qenësishme, për të cilat kanë folur studiues të ndryshëm si edhe të tilla tipare të tjera të qenësishme, për të cilat është folur fare shkarazi. Në këto radhë nuk duam të përsëritim ato që janë thënë, por vetëm të vëmë në dukje disa elementë të vargëzimit popullore, të cilët do të na duhen edhe në punën tonë të mëtejshme në këto vëzhgime.

Vargjet popullore, siç u tha, shquajnë para së gjithash për një ritëm të përkryer, që përputhet në harmoni të plotë me brendinë, me ndjenjat dhe mendimet e shfaqura. Pavarësisht se si është arritur kjo melodi ritmike (me anë të larmisë së theksave ritmikë, me anë të rimave, përsëritjeve etj.), në vargjet e poezisë popullore shqipja kumbon, shpalos tërë vlerat e saj shprehëse dhe artistike, shpërthen me tërë fuqinë e pasurinë e saj. I njëjti varg, ta, zemë tetërokëshi, di të marrë kadenca ritmike të ndryshme, herë *ngjitëse*, herë *zbritëse*, herë me ashpërsi, herë me butësi, herë me kumbime epike dhe herë me brishtësi lirike. Domosdo në tërë

këto ndikon në radhë të parë brendia, por organizimi metrik i vargut krijon pikërisht atë ritëm të përshtatshëm për rastet e ndryshme.

Në një këngë epike kumbon një ritëm si te këto vargje:

*Gryk' e Kuçe, o gryk' e thellë,
o Çipin përmbi Bolenë...*

Kurse në një këngë lirike, këngë dashurie:

*Çke, moj syskë, që po trëmbe?
Folna, moj, për kokën tënde...*

Në një këngë dasme, ta zëmë në një valle, ritmi është më i shpejtë:

Dhëndëri ndëpër limonj...

Në këngët e vajit tetërrokëshi mund të ecë me buftësi të rrallë, pa u ngutur, i pasur në theksa ritmikë:

*I hoge kyçet e brezit,
si trëmi armët e mezit...*

Ose:

*Qaj, o mëma, qaj, o motra,
për djëmtë që men në kodra...*

Dëket qartë se poeti popullor bën çmos për të arritur një ritëm të përkryer, plotësisht të përshtatshëm me mendimet e ndjejnjat që shfaq. Siç shikohet, ritmi i poezisë popullore nuk është një standard përherë njësoj, nuk është ndërtuar në mënyrë mekanike, do të thoshja simetrike, por ka një liri të plotë në organizimin e tij. Që këndejej vijmë kështu në një karakteristikë tjetër, në teknikën e theksimit ritmik të vargjeve, pikërisht te liria e theksimit.

Studimet e botuara para Çlirimt japin rregulla fikse pér theksimin e vargjeve, rregulla të huajtura zakonisht nga poezitë e huaja, më tepér se sa tē nxjerra nga vargëzimi ynë popullor. Kështu pér shembull, në to pranohet pér tetërokëshin vetem theksimi në rrokjen e tretë dhe tē shtatë. Cdo theksim tjeter quhet i gabuar, një lajthim që duhet luftuar. Kurse populli, farkëtues i mrekullueshm ritmesh, novator i guximshem, i ka thyer prej kohësh këto rregulla strikte. Me pérjashtim të rrokjes para theksit tē detyrueshm fundor (*konstantes ritmike*), theksi tjeter apo theksat e tjerë mund tē bien praktikisht në tē gjitha rrokjet e tjera. Është kjo pikërisht një nga mënyrat me anë tē së cilës vargjet popullore largohen nga uniformiteti, monotonia dhe ditojnë një larmi dhe pasuri tē rrallë ritmesh; është pikërisht kështu që vargjet nga njësi tē mbyllura, tē ngurtësuara sipas një rregulle fikse, kthehen e bëhen njësi tē gjalla artistike, tē shkathëta, tē manovrueshme, burime tē pashtershme ritmesh me kombinimet e pafund tē theksave ritmikë etj. Poezia jonë e kultivuar ka mbajtur një qëndrim pérherë e më tē dukshem në pérkrahje tē teknikës popullore në përdorimin e theksave ritmikë. Në se te poetët shkodranë tē së kaluarës, siç e vë në dukje edhe Dh. S. Shuteriqi, «është zor tē gjesh vargje tē tjerë tetërokësh vec atij tē skemës 3.7, që ndër ta konsiderohet i rregullt», te Naimi dhe Çajupi ndodh krejt ndryshe mbasi ata «i qëndrojnë mjart besnikë metrikës popullore». ¹⁾ Më pas edhe tek ndonjë poet i jugut (si p.sh. F. Noli, L. Poradeci etj.) vihet re një mbi-zotërim i skemës 3.7 pér tetërokëshin e përgjithësisht një besnikëri ndaj skemave tē kataloguara nga studimet. Megjithatë edhe te këta poetë prirja drejt teknikës popullore është e dukshme. Kjo prirje vjen e bëhet pérherë e më e dukshme, më e fuqishme më pas, saqë kthehet e bëhet një vijë e vërtetë, një rregull te poetët tanë tē rinj.

Një nga elementët e qenësishem tē organizimit të

1) Vepër e cituar, faqe 28.

vargjeve popullore na bëhet se është përdorimi me mjeshtëri i një sistemi të tërë përsëritjesh. Përsëriten tinguj, përsëriten fjalë, përsëriten vargje të tëra. Domosdo gjithë kjo nuk kryhet vetëm pér punë të harmonisë, melodisë, ritmit, por para së gjithash pér të vënë në dukje një mendim, një ndjenjë, një aspekt a një figurë të rëndësishme. Gjithçka, edhe këtu, është në shërbim të idesë. Por sidoqoftë, përsëritja, me të gjithë larminë e saj, është një tipar karakteristik qenësor në instrumentimin e vargut popullor.

Përsëritja paraqitet në forma të ndryshme, disa prej të cilave duken lehtë se e kanë burimin nga muzika, por tashmë ato kanë fituar një mvehtësi e pavarësi të plotë, saqë janë bërë karakteristike, bashkë me mjetet e tjera të instrumentimit, të poezisë popullore.

Më e përdorur është, patjetër, përsëritja e thjeshtë brenda të njëjtë varg, që sipas rastit mund të marrë nuancë të gëzuar apo të trishtuar. Kjo lloj përsëritjeje herë-herë ngjan si një farë thirrjeje pér të ndjellur shokët qark që të këndojnë ose, sido që të jetë puna, një si farë paralajmërimi pér llojin e këngës që do të këndohet.

Ja disa shembuj të llojeve të ndryshme ku mbi-sundon epanalepsi:

1) *Thuaja, o bilbil, thuaja,*
më të lumtë kjo gojëza...

2) *Haj, e mjera dynja, haj,*
si do bënet hall' i saj...

3) *O nishan, more, nishan,*
të më dije se ku jam...

4) *Vera, vera, guduvera,*
një pulë që paç e thera...

5) *Më nxori nenia, më nxori,*
më nxori përmes oborrit...

- 6) *Erdhi koha, erdhi dita,*
shumë e bukura për ne...
- 7) *Dit' e zezë e dit' e hanë,*
filloj lufta/*mu* në Fangë...
- 8) *Mori kullë e mjera kullë,*
me dyfek s'u more kurrë!...

Ndër përsëritjet më të përdorura në poezinë populllore është pa dyshim edhe epanastrofa. Kjo lloj përsëritjeje i jep muzikalitetin e reprizës vargut e në të njëjtën kohë i jep ligjératës poetike një frysë bisede. Sidoqoftë epanastrofa është një karakteristikë, një shenjë e qartë dalluese e stilit popullor. Shembujt janë të shumtë e të ndryshëm, por ke përshtypjen se ajo është më e përrhapur në folklorin e pjesës veriore të vendit tonë. Ja disa shembuj të marrë nga folklori i së kaluarës dhe së sotmes, nga këngë të llojeve të ndryshme:

- 1) *Rrëmbe kapetanenë
kapetan-sylarmenë...
Sylarme, moj grykëzënë,
q'deshe në mëhallë tënë?*
- 2) *Kam një lëmsh ndër zëmër,
s'kam kujt t'i rënkokhem...
T'u rënkokhem maleve?...
Malet po largonenë...*
- 3) *Skënderbegu me ushtrinë e vet-e
ka dalë malit *kep* më *kep-e*
kep më *kep* e prue më prue.*
- 4) *Kodër m'kodër *bjen boria*,
bjen boria, vaj medet.
Sali Mani hip me 'i *kep*,
po u piskatka *djelmet vet*,
djelmet vet na u ka ngërmue...*

Kurse në shembujt e mëposhtëm epanastrofa zhvillohet më tej duke marrë trajtën e një epanalepsi:

- 1) Dyle Çelën na e kanë vra!
*Na kanë vra nji shok të ranë,
komandant nér partizanë.
Na ërrafë teli për Tiranë,
për Tiranë na ërrafë teli...*
- 2) Cokë Dinua si felah,
*dhëntë te furra i pa.
Kur i pa dhëntë të furra,
sokëlliti Cokë — murra!*
- 3) Mike, mëre mënt e mia,
*seg të kuqonte shamia,
shamia po të kuqon,
ma bën me si, më vështron...*
- 4) Ata hidh e ti për gryke,
*me ballonë i zhurite,
i zhurite me ballonë,
u jam Stalini që thonë,
i madh sa një mal me borë...*

Sig vihet re epanastrofa mund të përsërítë një fjalë por mund të përsërítë krejt vargun me një inversion në trajtën e epanalepsit, që bën tepër efekt mbasi po ato fjalë që janë thënë në vargun e parë, si-kur rivendosen tanë në një drithë tjeter, rimerren edhe një herë për t'u vlerësuar sérish, për të nxjerrë prej tyre një efekt më të madh ideoartistik.

Ka raste që përsëritet në fund të vargut të dytë fjalë e parë e vargut të parë (një farë epanalepsi edhe këtu) duke krijuar një efekt tepër sugjestiv. Ja një shembull nga një këngë e Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare kushtuar Mustafa Matohitit dhe që këndohet në Kûrvelesh:

Ti je hero pér atdhe,
në zemër të kemi ne.
Na dhe dije dhe idhe,
moll' e trëndafil na dhe.

Një lloj tjetër i përsëritjes që haset dendur në poezinë tonë popullore është anafora. Duhet pohuar se përdoret me efekt të madh dhe me sens mase. Kështu, prej saj burojnë si nënvizimi i një ideje, si ironia, si forca, si butësia sipas rastit, kontekstit dhe dëshirës së poetit. Haset në poezi të ndryshme epike dhe lirike.

1) *Ububu, ndër ato male!*

Ububu, qënke një valle!

Ububu, çpaske dyfeknë!

2) *Karadaku brigje-brigje,*

digje, Dervish pasha, digje,

një këlliç të mirë hiqe,

një këlliç të mirë jepi...

3) *As i krih ato baluke,*

as i krih e i lidh prapa

se je nuse e të zë vapa!...

Një lloj përsëritjeje shumë interesante është ajo që ka vënë re në studimin e tij R. Sokoli dhe të cilën ai e quan përsëritje zinxhir. E përdorur me shije kjo lloj përsëritje mund të ketë sukses edhe në poezinë e shkruar e jo vetëm në atë satirike. Nga përsëritja zinxhir vjen e përftohet një farë dinamizmi që të kujton vrullin e valles, rendjen e hareshme, diçka që lëviz, shtjellohet e nuk ndalet kurrë. Shikoni lëvizjen e këtyre vargjeve:

Mbas asaj kalaje, një bahçe me lule,
një bahçe me lule mbushun plot me cuca,
mbushun plot me cuça! Cila asht ma e bukra?
Cila asht ma e bukra? Ajo faqekuqna!

Le tē shikojmë edhe këto përsëritje, që shërbejnë herë-herë edhe pér tē formuar strofat:

1) *Jatje poshtë ic mullini,
luftë po bante Rexhep trimi,
luftë po bante Rexhep trimi,*

pér gojet na i dilte timi...

2) *Ja thona nji valle*

me dert e me hulle,

me dert e me halle,

thuej së mirës: «Hajde!»

3) *Hajde, ku u vonove?*

Të kapsha pér dore,

të kapsha prej krejet,

të sjellsha prej mejet!

Është thuajse e pamundur tē kapen tē gjitha llojet e përsëritjeve që përdor popullinë organizimin e vargjeve. Një gjë është e sigurt se përsëritja luan një rol shumë tē rëndësishëm në punë tē vargjeve popullore. Këtë e vë re edhe R. Sokoli në studimin e tij, ndonëse ai ka parasysh më tepër prozodinë muzikore, përsëritjen e melodisë. Por prapërserapë ngā fjalët e tij kuptohet qartë se ç'thuhet pér melodinë është e vlefshme, në rastin tonë, edhe pér organizimin e fjalës në këtë melodi. Pér këtë R. Sokoli shkruan: «Funksioni i përsëritjes është shumë i rëndësishëm në trajtimin e këngëve popullore. Përsëritjet bëhen pér arsyé tē ndryshme: si pér tē forcuar ndonjë mendim, ashtu edhe pér tē plotësuar vargje dhe vjersha që janë më tē shkurtra se jonia e tyre. Mënyrat e përsëritjes në folklorin tonë janë tē shumta, më e pa rrëgulla tē caktuara: ato janë tē njëjtë pér disa këngë, por nga ana tjetër mund tē ndryshojnë bash brenda një këngë nga strofa në strofë, nga vargu në varg. Përsëritjet mund tē jenë tē pjesëshme, tē plota dhe tē kombinuara. Përsëritjet e pjesëshme mund tē jenë nga fillimi i vargut, nga mezi i vargut ose nga fundi i tij. Kurse përsëritjet e plota mund tē bëhen me një varg, më një distik, më një treshe, me një katër-

she e deri në polistikun. Përveç këtyre kemi edhe përsëritje me shkallëzim (klimatizëm). Ja, për shembull, një këngë labe:

*Te ura, moj, te ura,
te ura në Drashovicë,
te ura në Drashovicë,
gjëmon topi i Italisë!*

*Gjëmon to, moj, gjëmon to,
gjëmon topi i Italisë!»¹⁾*

Përsa i përket frazës, duhet thënë se në poezinë popullore bëhet çmos që cdo varg të ketë një farë mendimi, që qëndron disi dhe i plotë. Mund të pohohet se poezia popullore nuk e njeh bartjen, që është kaq e përhapur në poezinë e kultivuar e sidomos në poezinë e re. Në popull thuajse çdo varg sikur i mjafton vvetves. Domosdo kjo pavarësi bëhet më e plotë kur vjen puna për strofat që janë plotësish të mbyllura, njësi të pavarura përsa i përket ndërtimit të frazës nga njëra tjetra.

Mjeshtéri të rrallë tregon poeti popullor në përdorimin e rimës, të cilën e vë plotësish në shërbim të mendimit, të idesë, të asaj që do të thotë. Edhe këtu, patjetër, ai shfaqet original aq sa në përdorimin e rimës mund të vëmë re një karakteristikë dalluese.

Dihet se rima lindi relativisht vonë. Sistemet metrike klasike greko-romake mund të bënin edhe pa atë për të organizuar ritmin e vargut, kurse kur vlera e këmbëve me rrokje të gjata e të shkurtra u zëvendësua me elemente të tjera (këmbë me rrokje të theksuara e të patheksuara të sistemit silobo-tonik, rrokjet e sistemit silabik), atëherë u ndie nevoja e rimës, e cila duke kufizuar fundin e vargut, na bën që të ndiejmë ritmin. Kuptohet kështu përse rima, bashkë me faktorë të tjera, luan një rol të dorës së parë edhe në poezinë tonë popullore, për të vënë në dukje pra ritmin i cili

1) «Nëntori», 1958, Nr. 9, f. 177.

duhet të dëgjohet me vesh. Dhe në fakt populli kujdeset që rima të shquhet mirë, të ndihet dhe të mos dobësohet efekti i saj nga bartjet, të cilat, siç e thamë më lart, thua jse nuk përdoren fare prej popullit. Jo vetëm kaq, po rima shërben si për të formuar strofat ashtu edhe për të bashkuar gjymtyrët e një fraze. Duke lënë më njanë larminë e rimave të puthura, të kryqëzuara, të alternuara, të forta, të buta, rrëshqitëse etj., duhet të themi se përvëç rimave të mirëfillta, populli përdor së tē përmë asonancën dhe aspak (konsonancën), e cila fillot tē duket vetëm në poetët tanë të rinj (sidomos Kadare, Agolli etj.).

Duke u hedhur një sy edhe vetëm shembujve që do të sjellim më poshtë, do të bindemi për mjeshterinë e përdorimit të tyre.

Këtu, në dy vargjet e parë, rimat (edhe rimat e brendshme bashkë me aliteracionin) janë përdorur me efekte komike:

*Nana e nuses o'shku n'mulli,
i kish hi nji mi n'dimi...
Briti, briti e piskati,
duel mullisi e hallakati...*

Ose:

*Në valle ç'u zu qeleshi,
përvjek këmbëtë pas sheshi;
çerreja si rrënje preshi,
duket si dhallë pëersheshi,
moj leshprera, qysh tē deshi?*

Kurse te kjo këngë, një krijim i përkryer, plot hollësi e brishtësi ndjenje, dhembja e çobanit, të cilit po i martohet e dashura në fshat, gjëmon te rimat në o, që tē ngajnjë si tē qarat e zamares së tij...

Ra sahati e vate' shtatë, u zu valleja në fshat:

bëhej një sehir i madh, s'mbeti djalë e s'mbeti plak; duall gjithë në "sokak":

Dhë çobani atje lart, sec i bin zamares-o,

*sheqe qan të shkretën-bl...
La valleja vallen-o:*

mbante vesh zamares-o!...

Ajo që të bën përshtypje, nga ana tjeter, është fakti se në poezitë që priren pér monorimë, zakonisht rima shtrihet deri kur mbylllet një mendim. Kur nis një mendim tjeter, në më të shumtën fillon edhe një rimë e re. Kështu, pér shembull, ndodh edhe në vargjet e mësipërme.

Është pér të vënë re këtu se në këtë mënyrë të fundit e gjejmë të përdorur këtë rimë nga Çajupi, Poredci apo K. Jakova te poema «Heronjtë e Vigut».

Këtu mund të ndaleshim edhe në elemente të tjera, në mjete të tjera artistike që shërbejnë në një farë mënyre pér të organizuar vargjet, ritmin e tyre, pér t'i dhënë tonin hera herës gjithë poezië. Mund të përmendej këtu përzierja e vargjeve, aliteracioni apo edhe pyetja retorike. Përsa i përket aliteracionit është lehtë të sillen shembuj qoftë me bashkëtingëllore, qoftë me zanore. Le të mjaftojë vetëm kjo:

*Fërfellon fëllanxa n'ujë,
fërsellon e del mbi ujë...*

Kurse pér pyetjen retorike, duhet thënë patjetër se ka një përdorim original. E kemi fjalën pér përdorimin e saj në krye të këngës apo sa herë që në këngë futet një ide e re, ndriçohet një aspekt i ri i ndonjë fenomeni. Pyetja retorike shërben fare bukur pér ta futur

poezinë menjëherë, në tonin e një bisede të përzemërt me dëgjuesit. Ajo herë-herë të duket sikur është një zhurje që i fton të gjithë të bisedojnë për diçka, për çështjen a fenomenin që zihet në gojë. Sidoqoftë, një përdorim i tillë është tepër origjinal dhe në letërsinë tonë Çajupi e ka përdorur së tepërmë e me sukses pikërisht në këtë mënyrë. Ja dy shembuj nga folklori kosovar:

- 1) *Kush po zdirgjet asaj ane?*
Kjo suzeza gjyksin me pare...

2) *E kush o kon' sïkur ti?*
Ti je konë zemër gjonë
e je konun bukëdhonë...

1. EASZELIA E STROFIS NII ROZSZERZ.

4. PASURIA E STROFËS NË POEZINË POPULLORE SHQIPTARE

POPULAR STRIKE was the name given to the following conflict in Mexico, which took place between the Federal troops and the Constitutionalists, who were supported by the United States. It began in 1911, following the overthrow of Porfirio Díaz, and continued until 1917, when the Constitutionalists, under the leadership of Alvaro Obregón, triumphed.

Folklori ynë është jashtëzakonisht i pasur me organizime strofike. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshë. Strofa në poezinë popullore është rezultat i një fenomeni ku kani vepruar dhe veprojnë sot e kësaj dite tre faktorë — fjala; melodja dhë vallja. Në këtë mes, nuk ka dyshim, vendin e pafë e zë melodja, megjithatë ky bashkëveprim do kuptuar patjetër në mënyrë dialéktike, duke mos harruar, pra, për asnjë çast veprimet reciproke midis këtyre forcave, ndikimet mbi njëra-tjetrën. Kjo, domosdo, bën që bukuria dhë forca e një strofe popullore të dalë me të gjitha përmasat dhë vlerat e saj pikërisht kur ajo merr gjallëri në të tre aspektet e veta — si organizim melodik, si ndërtim fraze poetike, si tërësi lëvizjesh koreografike. Kur ndodh një gjë e tillë, atöhëre edhe detaje që herë tjeter mund të mos na bëjnë përshtypje, të shoqëruara me melodinë apo me lëvizjen e përshtatur koreografike, fitojnë forcë e vlerë ideoartistike të veçantë.

Folklori ynë është shumë i vjetër dhe, për rrjedhim, ai paraqet një pasturi të rrallë vlerash artistikë. Dukë fo-

lur pikërisht për këtë lashtësi, shoku Enver Hoxha ka thënë: «Më vonë populli shqiptar ka jetuar nëpër dallgë të reja, po në të gjithë zhvillimin dhe në të gjitha etapat e historisë së vet shihet konkretisht kultura e tij. Kjo është e gjallë më shumë në folklorin tonë, në këngët, në kanunet tona jo brenda 100 ose 200 vjetëve, po qysh 600-700 vjet më parë.¹⁾ Nuk duam të shkojmë më tutje në kohë dhe të zemë në gojë këtu faktin që vjetëria e gjuhës shqipe dhe e kulturës sonë materiale e shpirtërore lidhet me dëshmitë më të lashta pellazge, gjë që na jep të drejtë të pohojmë se populli ynë është më i vjetri në Ballkan e nga më të vjetrit të Evropë; nuk duam të zëmë në gojë këtu faktin që p.sh. këmbët të metrikës greko-latine kanë emërtimë që shpjegohen vetëm me traditën pellazge, pra, shqiptare; kështu, p.sh. këmbët *peon* (*vv-v*) dhe *mollos* (—) lidhen me sa duket me valle të fiseve peone e mollose të ilirëve, kurse këmba *pirrike* (*vv*) lidhet me *masën e valleve luftarake* të epirotëve; *nuk duam të përmendim* këtu faktin që, ta *zemë, emri* i muzës greke të komedisë, *Talia, shpjegohet* drejt vetëm me shaipen *tallja*, që *emri* i *Panit, i Cili* lidhet kaq shumë me të gjitha muzat, shpjegohet vetëm me fjalën *shqipe me pa* (me shikue, me ruese) etj. Të gjitha këto e shumë prova të tjera nga sfera të *ndryshme*, dëshmojnë edhe për lashtësinë e këngës dhe të valles sonë. Sidoqoftë ky është një problem që duhet të térheqë shumë më tepër vëmendjen e studiuesve. Për ne mjaftojnë edhe 600-700 vjet të lashtësisë së folklorit tonë (lashtësi që provohet në mënyrë fare të kollajtë nga tërë pasuria e dëshmive të mbledhura gjer më sot) për të patur të drejtë të mendojmë se në këtë folklor janë formuar gjatë dialektikës së kohës grupime, organizime, zhvillime dhe vlera përherë të reja. Kjo, domosdo, duhet thënë edhe për strofën. Melodia popullore, që ndikon kaq shumë e kaq vendosmërisht në organizimin e vargjeve të një kënge, pra të strofave të saj, mënyrat e organizimit të kësaj melodie popullore, më-

1) E. Hoxha «Vepra», v. 25, Tiranë 1977, f. 531-532.

nyrat e ekzekutimit të saj (qoftë polifonike apo homofonike) dëshmojnë për lashtësi. Por kur pranojmë lashësinë e organizimit melodik të këngës sonë do të gabojmë rëndë nëse bashkë me këtë nuk pranojmë edhe lashtësinë e organizimit strofik të vargjeve të saj. Megjithatë, sado e çuditshme të duket, gjë vonë është besuar dhe është pohuar e kundërta. Studimet metrike të botuara para Çlirimt, në më të shumtën heshtin për strofat popullore, sikur ato të mos ekzistonin fare. Ose, e shumta, nëse thuhet një fjalë për to, pohohet vetëm prania e distikut dhe e katrenit dhe asgjë më itepër. Kështu p.sh. E. Koliqi e thoshte hapur më 1937 në tezën e tij të diplomës: «Me përjashtim të distikut dhe të kuartinës, poezia shqiptare nuk njeh tjetër trajtë strofe». Një pohim i tillë është sa absurd aq edhe antishkencor. Sidoqoftë një mendim i tillë mohues, herë i shprehur haptazi, herë në mënyrë të tërthortë, haset tutje tëhu në shkrimet e kohës. Gati-gati qe përfthuar një si e vërtetë tashmë e pakontestueshme për mungesën e strofave **në poezinë popullore, qe krijuar kështu një mendim mohues gjoja i provuar katërcipërisht** (!) dhe që për këtë duhej të pranohej pa as më të voglen rezistencë. Mendime të tilla, për inerci, vazhduan gjatë, thuajse deri në ditët tona. Kjo shpjegon përsë më 1947, në librin e tij për metrikën popullore, Dh. S. Shuteriqi e nis nën-kapitullin kushtuar strofës popullore me një titull në formë pyetjeje: «A ka strofa në poezinë popullore?» Kjo, patjetër, është diçka shumë kuptimplotë. Të duket sikur kjo pyetje hedh sfidën e ngrihet me forcë kundër gjithë mohimeve pa baza të së kaluarës, sikur kërkon t'i kalojë ato një për një në shtrungën e provave të fakteve reale. Dhe kësaj pyetjeje autori i përgjigjet me plot gojën, pa hezitim më të vogël kështu: «Ne mendojmë se poezia popullore ka strofa. Biles disa prej tyre shquhen mirë, siç janë katershët e këngëve popullore shkodrane, bejtet etj. Veç se këtu ndihet influenca e poesisë së shkruar.¹⁾ Dhe me këtë përgjigje, si-

1) Vepër e cituar, f. 72.

domos me frazën e saj të parë, duket sikur mbylllet një herë e përgjithmonë çështja e ekzistencës ose jo të strofës popullore. Nga ana tjetër, në këto faqe kaq të rëndësishme për studimin e strofës popullore, autori përpinqet të depërtojë edhe në format e ndryshme të strofave. Megjithatë, pasi pohon me të drejtë lidhjen e tyre me melodinë, e cila i organizon ato, pasi vë në dukje që edhe kur melodia nuk mjafton për një tubëzim të tërë vargjesh, ky tubëzim «ka njësi kuptimi, ka dhe një njësi metrike, megjithëse s'i përgjigjet, si e tërë, një melodie të vetme muzikore»,¹⁾ autori ngul këmbë në ndikimin e bejtexhinjve për lindjen e strofave në poezinë popullore, për rrezatimin e këtij ndikimi qoftë edhe nga dy qendra qytetare siç qe Shkodra e Gjirokastra etj. Ai përpinqet t'i gjejë shqetësuar kësaj kontradikte duke i inkadruar bejtexhinjtë te poetët popullorë. Thotë ndër të tjera: «Tërë» bejtexhinjtë» e Shkodrës ose, të Gjirokastrës nuk kanë qenë «me shkollë», besojmë ne. Dhe fakti se një njeri «ka shkollë» nuk mjafton që të na bëjë në të mos e qasim si poet popullor. Përkundrazi. Meritë e tij është që të sjellë diçka të re në poezinë popullore dhe ta shtyjë këtë drejt evolucionit natyral të saj (...»²⁾ Po këto mendime hasen pak a shumë edhe më 1959 në vëllimin e parë të «Historisë së Letërsisë Shqipe»: «Me zhvillimin e rrymës së bejtexhinjve, që nga shekulli XVIII, shumë këngë të këtyre u bënë pronë e «folklorit dhe mbetën anonime. Këto këngë sollën në poezinë popullore strofat katërshe me vargje të alternuara ose edhe strofat katërshe të tipit AAAB, ku vargu i fundit është refren dhe përsëritet gjatë gjithë vjershës. Elemente të reja strofike e ritmike solli në poezinë tonë historike edhe letërsia e Rilindjes. Këngët e ndryshme patriotike të Gramenos, Asdrenit, Mosit dhe shumë të tjera e u bënë popullore. Shkrimtarë dhe këngëtarë të ndryshëm të Luftës Nacionalçirimitare sollën edhe ata në poezinë tonë popullore historike një ndikim

1) vepër e cituar, f. 72.

2) Vepër e cituar, f. 78, 79.

të poezisë artistike. Kështu Memo Metoja përdori shpesh strofën katërshe ABCB, ku rimojnë vetëm vargjet e shkurtra (...). Si bejtexhinjtë dhe poetët e Rilindjes, edhe ata të Luftës Nacionale clirimtare sollën në këngët historike refrenet strofike të poezisë artistike, kurse refreni i zakonshëm i epikës populllore ishte «një varg që përsëritez pas çdo vargu».¹⁾

Në tërë këto radhë që cituam ka pohime shumë të vlefshme, vërejtje dhe të dhëna shumë interesante, por, nga ana tjetër, edhe pasaktësi, kufizime, që nuk mund veçse të të çojnë në rrugë jo të drejtë.

Para së gjithash këtu duhet vënë në dukje që, në rrymë të kohës, vihet re, kurdo e kudo, se në krye nis ndikimi i poezisë gojore mbi atë të shkruarën dhe pastaj i kësaj mbi të parën. Bile ndikimi i poezisë populllore mbi atë të shkruarën vazhdon praktikisht i pandërprerë. Po ta vëresh mirë, poezia jonë gojore nuk ka fare nevojë, që, për t'u pasuruar me strofa, të ndikohet prej asaj të shkruarës, mbasi ajo ka, në lidhjen e saj më melodinë populllore, mëkanizmin e vet të brendshëm që i shërben më së miri për të krijuar edhe sot e kësaj dite tubëzime strofike nga më të larmishmet. Prá këtu më parë duhet folur për ndikimin e poezisë gojore mbi atë të shkruar e vetëm pastaj e shumë më vonë të kësaj të fundit mbi poezinë folklorike. Këtë e dëshmon historiá e poezisë sonë, këtë e dëshmon edhe ajo e poezisë botërore. Në letërsinë evropiane, p.sh. dihet se Provansa e Francës, me këngëtarët popullorë, sidomos me trubadurët e saj, njihet si një nga vendet që krijojnë mesjetë strofat më të larmishme, të cilat u përhapën më vonë edhe në vëndet e tjera, si Itali, Angli, Gjermani etj. Kështu, p.sh. *estriboti* spanjoll, pasi kaloi nëpër Provansë u përhap kudo dhe dha strofat katërshe, pesëshe, gjash-tëshe etj. Në Itali *estriboti* kaloi me sa duket në krye në poezinë popullorë të Siqelisë dhe që këndej u përhap nëpër tërë krahinat me emrin *stramboto* dhe, zakonisht,

1) «Historia e Letërsisë Shqipe», Tiranë, 1959, V. I, f. 113, 114.

ka skemën e rimës ABABCC. Te stramboti e kanë zanafillën shumë strofa të përdorur prej poetëve të shkolluar italianë. Kurse D. Aligeri mori një strofë të thjeshtë popullore të quajtur *serventeze*, e modifikoi në skemën e rimës (nga AAB – BBC – CCD...) siç ishte, e bëri: ABA – BCB – CDC...) dhe krijoi kështu tercinat e famshme të «Komedisë Hyjnore».

Folklori shqiptar jo vetëm që nuk ka se ç'ti ketë zili krijimtarisë gojore të këtyre vendeve, por përkundrazi ai është shumë më i pasur dhe më i larmishëm se to edhe përsa i përket organizimit strofik. Këngëtari e poeti popullor shqiptar ka përdorur dhe përdor ende një larmi të mahnitshme strofash, që shkojnë që prej strofës së përbërë nga një varg i vetëm (p.sh. rapsoditë e veriut etj.) dhe deri te strofat me dhjetë vargje, duke kaluar nëpër distikët, tercinat, katrenët etj. Këto janë forma të hershme, mesjetare, ndonjëra mbasë edhe paramësjetare. Sidoqoftë ato paraqesin sot një aktualitet në folklorin tonë, janë të gjalla, përdoren lirisht e me mjeshëtëri në popull e për këtë duhet patjetër të tërheqin akoma edhe më shumë vëmendjen sidomos të poetëve tanë. Elasticiteti i strofës popullore, shkathtësia e dinamizmi i saj i brendshëm, befasia e reprizave, lodra e lajmotiveve kthesat e kundërtheshat, theksimet e kundërtheksimet,¹⁾ anakrusat dhe teknika e përdorimit të tyre, largimi nga çdo uniformitet dhe monotonji, janë vlera që nuk mund të injorohen lehtë e që, përkundrazi, duhet të reflektohen; patjetër e me forcë në krijimtarinë tonë.

Kjo pasuri strofike, me të drejtë ka tërhequr vëmendjen e poetëve tanë që herët. Nuk po ndalemi këtu te De Radâ, që mori formën e kangjelevë popullore arbëreshë për «Milosaon» e tij, mbasi kjo do të kërkonte një studim të vëçantë, por po përmendim këtu punën e N. Frashërit, A. Z. Çajupit, Asdrenit, L. Poradecit, M. Metos, K. Jakovës etj. për të dëshmuar pikërisht

1) Kemi kundërtheks, kur, në një varg dy rrrojje të theksuara vijnë njëra pas tjetrës: Atje tek rri, janë qipariz' e varre.

për faktin se poezia e shkruar shqiptare u ndikua që herët prej organizimit strofik popullor dhe vazhdon sot e kësaj dite të ndikohet. Kështu p.sh. Naimi distikun e poemës së tij «Bagëti e bujqësi» e mori pezull prej folklorit; Çajupi, veç të tjerave, strofen e poeziës «Shqiptar» e mori nga poezia popullore; këtu, në poezinë popullore, e merr këtë lloj strofe edhe M. Metoja; Asdremi përdor me efekt tercinën popullore (tri vargje me rime të përputhur) te poezia «Lumtësia e shpirtit», kurse Poradeci ka një sërë strofash popullore p.sh. tercinën popullore te «Gjarpërushja», distikun te «Baladë», një strofë interesante popullore të përbërë nga një varg e një refren me dy vargje te «Ku m'u rrite vogëlushe» (Ku m'u rrite vogëlushe/ vogëlo si flutura/ mes-hollë-këputura) etj. Për ndonjëren nga strofat e përdorura prej Naimit, Çajupit, Nolit, K. Jakovës etj., si p.sh. përstrofën katërshe me skemë rime AAAB (shih «Këngë për Heronjtë e Shkodrës»), është shfaqur mendimi se e ka origjinën nga bejtexhinhjtë ose se është marrë nga jashtë, kurse e vërteta, me sa duket, është më e thjeshtë e më e natyrshme. Një strofë e tillë gjendet që herët si në veri si në jug të vendit tonë, siç do ta tregojmë edhe më poshtë.

Megjithatë, duhet të pohojmë se mëse organizimi strofik i poeziës popullore pret ende të reflektohet akoma më shumë në poezinë tonë të shkruar, ai ka kohë që është bërë bazë e krijuar tarisë së kompozitorëve tanë më të mirë. Dhe më fakt ai është studiuar dhe vazhdon të studiohet me përfitim jashtëzakonisht të madhi prej tyre, ai studiohet në shkollat tonë të mësme e të larta muzikore, ai është bërë prej kohësh objekt hulumtimesh e studimesh të pasionuara nga muzikologët e kompozitorët tanë etj. Kështu, p.sh. në librin e R. Sokolit «Folklori muzikor shqiptar», që përdoret prej kohësh si teksti mësimi, një kapitull i rëndësishëm i kushtohet pikërisht strofës popullore e parë kjo, domosdo, si organizim mëlodik dhe poetik bashkë. Dhe më fakt (e kjo është tashi më një gjë e ditur dhe e pranuar prej të gjithëve) kur studiohet targëzimi i poeziës popullore në

tërë aspektet e larminë e tij, ai duhet parë kurdoherë lidhur ngushtë me muzikën, mbasi vetëm në këtë simbiozë mund të gjejnë shpjegim fenomene të ndryshme që kanë të bëjnë me organizimin dhe instrumentimin e tij. Një gjë e tillë, domosdo, nuk është më e nevojshme kur studiohet vargëzimi i poeziës së shkruar, mbasi shkëputja dialektike prej melodisë muzikore në këtë rast, ka kohë që ka ndodhur dhe vargëzimi ndjek tashmë rrugën e zhvillimit të vet të pavarur. Për këtë arsy, përtë zbuluar tërë thesarim e gjenuin strofik të poeziës gojore popullore, duhet t'u drejtoshesh këngëve popullore. Atëherë ke për të vënë re se ç'larmi formash, ç'kombinime të pafund e plot efekt vargjesh do të zbulohen para teje. Këtë punë gjer më sot tek ne e kanë bërë, siç e thamë, vetëm muzikantët, por këtë punë, me po aq pasion, duhet ta bëjnë edhe më shumë letrarët e poetët tanë, duke ndjekur kështu, nga ana tjetër, edhe shembullin e poetëve tanë të shquar si Naimi me shokë, që, me intuitën e hollë të poetit dhe me dëshirën e zjarrtë përti dhënë poezië së vet një frysme sa më kombëtare, jo vetëm përsa i përket brendisë, por edhe formës, iu drejtuam me përfitim të madh këngës popullore. Sot, për poetët tanë, një punë e tillë është edhe më e lehtë, mbasi studimet muzikologjike në këtë vështrim nuk mungojnë, megjithëse ato lipset të jenë akoma edhe më të shumta, duke qenë se thesari folklorik shqiptar – e në këtë mes edhe organizimi strofik – pret ende të zbulohet e të studiohet tërësisht. Për të dhënë një pasqyrë sado të kufizuar, qoftë dhe gjysmake, të pasurisë së strofës popullore, edhe ne në këtë shkrim jemi mbështetur. Kryesisht në këto studime muzikologjike, me shpresë që mendimi ynë do të tërheqë vëmendjen e poëtëve tanë dhe do t'i shtyjë ata t'i përdorin këto forma strofike, edhe më shumë në krijimet e tyre.

Siç del edhe nga një vështrim sado i shpejtë, në poezinë tonë gojore distiku është patjetër strofa më e përdorur dhe, në një farë mënyre, edhe në bazë të krijimit të ndonjë strofe tjetër. Në distikë këndohen tema nga më të ndryshimet dhe në vargjet me gjatësi

nga më të ndryshmet. E gjejmë, para së gjithash, me vargje tetërrokësh:

*Sheg' e ambël, sheg' e butë,
më shkoi vera pa t'këputë!*

Por edhe me vargje të tjera:

*Laj, mike, laj
me sapun kallaj!*

*Më ranë ca halle,
faqjaportokalle!*

*Rrinte dhëndri te shkalla fort i pikëlluarë...
Mos, djal-o, për kryet tat, mos rri zemëruarë!*

*C'paska nusja jonë lulet e dynjasë,
un-o c'i kam bërë që s'do të më flasë?*

Në disa mbledhje të këngëve popullore gabimisht nganjëherë distikët paraqiten si strofa katërshe, por prania e rimës është përherë atje përtë treguar se në këtë rast kemi të bëjmë me distikë e jo me katrenë. Kështu, në shembullin e mëposhtëm, duke u marrë sezura si fund vargu, kënga është paraqitur si e ndërtuar me strofa katërshe të tillë:

*Të rriti nënoja,
një çupë jetime,
në një mot të shtrënjtë,
gjithë hidhërimë...¹⁾*

Kurse këtu shihet qartë se kemi të bëjmë me distikë:

*Të rriti nënoja një çupë jetime,
në një mot të shtrënjtë, gjithë hidhërimë...*

1) «Këngë lirike popullore», Tirana 1955, f. 28.

Që këndej, kuptohet se edhe Naimi, siç e thamë edhe më lart, distikun e tij me vargje gjashtëmbëdhjetërrokësh, në të vërtetë e mori prej popullit duke e përsosur e pasuruar, domosdo, me mjete shprehëse e ritmike, për ta përshtatur kështu plotësisht për nevojat e veta ideoartistike.

Nganjëherë distikët shërbejnë për të formuar strofa të tjera, ta zemë, katërshe si në këtë rast:

*O kungull t'u shoftë fara,
kudo shkoj të gjej përpëra!
Kungulli çallm' e kadinjet,
kamillaf i priftërinjet!*

Që kemi të bëjmë me një strofë katërshe me skemë rime AABB dhe jo me distikë, këtë na e zbulon melodja e cila mbyllët pikërisht pasi marrin fund të katër vargjet.

Nganjëherë me distikë përftohen katërshe në të cilat dy vargjet e fundit përsëriten si refren:

*Cupat e Kreshovës —
berzelik i dorës!
Ububu e obobo,
ma kënda të los me to!*

Shpesh distikët shoqërohen me refrene duke përfshuar kësisoj, një harmoni me të vërtetë sugestionuese:

*O moi delja, delja rudë,
a s'ma fal nji qingj të butë,
verë, verë aman!*

Në gojë të popullit, në këngë e sipër distiku transformohet shpesh dhe merr me shtesat, reprizat etj., pamje tepër interesante, të cilat, na e thotë mendja, mund të përdoren me shumë efekt edhe pa melodji. Kështu p.sh. në këtë këngë satiriqe popullore të Luftës Antifa-

shiste Nacionalçlirimtare, në të vërtetë kemi distikë, qoftë dhe të formës së shembullit që sollëm më lart:

*Abaz aga don me ardhe
me na fol për Zog'n' e parë!*

Vaj medet!

*Lëshoi qent e tij zagare
gë u sollën në pazar!...*

Ham, ham! ham!

Nji vendim Bazi ç'e mori!

Ashtu hyni, ashtu doli...

Kastravec!

Këto distikë, në këngë organizohen në mënyrë mjeshtërore, e para, me anë të një shëses, e cila, duke qenë jashtë rimës (vaj medet, ham ham ham, kastravec) del më minë, në pah, nenyizohet dhe ka më forcë emocionale; e dyta, duke përsëritur vargut e fundit edhe një herë. Në këtë mënyrë distikët e mësipërm këndohen me këtë organizim:

*Abaz aga don me ardhe,
me na fol për Zog'n' e parë + vaj medet!*

Me na fol për Zog'n' e parë + vaj medet!

Lëshoi qent e tij zagare, gë u sollën në pazar! — ham! ham! ham!

*Që u sollën në pazar!
Nji vendim Bazi ç'e mori...*

Ashtu hyni, ashtu doli... — kastravec!

Ashtu hyni, ashtu doli...

Kurse këta distikët, një këngë të mësuar krutane formohen duke t'përsëritur një pjesë e vargut në më-

nyrë zinxhir dhe duke përfuar një skemë të tillë rime:
ab, bc, cd etj.: *mbushun plot me cuca!*

*Mbas nj' asaj kalaje, moj, nji bahçe me lule,
nji bahçe me lule, moj, mbushun plot me cuca!*

*Mbushun plot me cuca, moj... Cila asht ma e bukra?
Cila asht ma e bukra, moj... Nj' ajo faqekuqja!...*

E njëjta gjë haset edhe te kjo këngë nga Pogradeci,
megjithëse këtu refreni sikur e përmban pak ritmin e
valles:

*Mu ndë baçën tënde, dyzet drurë mollë,
fëllëzë moj,
gushëkuqe moj!*

*Do të marr një sharrë, sharrën t'i sharroj;
sharrën t'i sharroj, t'i sharroj të gjitha;
t'i sharroj të gjitha, të lëshoj sehirë,
të lëshoj sehirë, të shëkoj bandillë...*

Nuk ka si mos të bëjë përshtypje ritmi i var-
gjeve të shembujve të mësipërm dhe përsëritja e ri-
mave sa në fund sa dhe në mes të vargut duke të
dhënë idenë e një valleje, që vjen rrotull pa pushim.

Shumë tërheqëse janë edhe kombinime të tilla var-
gjesh, ku përftohen distikë interesantë. Shembujt janë
marrë të gjithë nga rrëthi i Elbasanit, nga folklori i
ditëve tona:

1) *Sa të gëzuar jemi ne
aqë hedhëm vallen e re!*

*Që hedhëm vallen e re!
Lum e lum ku jemi ne,*

*Lum e lum ku jemi ne,
në Shqipërinë tonë të rel!
(Mollas)*

- 2) *Ku traktori sot plugon nē arë, rrofsh. o moj Parti, ty tē qofshim falë! Mbjellim lule djelli, misër, grur', panxhar, rrofsh. o moj Parti, ty tē qofshim falë!*
 (Shtërmen)
- 3) *Pse m'i mban sytë përdhe? Façepartokalle je!*

A frikë a turp mënke? Façepartokalle je!
 (Përparim)

- 4) *Nina nana djalin-o, djalin-o tē mbarin-o!*
Nina nana trimin-o, zemrën-o tē bardhin-o!
Nina nana trimin-o, trimin-o tē pushkës-o!
Nina nana bujkun-o, bujkun-o tē palodhur-o!
 (Gostime)

Mund tē sillnim edhe shembuj tē tjerë, por mjaf-tojnë edhe këta pér tē deshmuar, e para, se organizimi strofik popullor është një aktualitet nē folklorin tonë, ku forma nga më tē hershmet janë plotësisht tē gjalla dhe, e dyta, se larmia e kombinimeve praktikisht nuk ka fund. Kështu nē se te shembulli (1) kemi reprizën zinxhir tē vargut tē dytë; që bëhet varg i parë i strofës së dytë e kështu me radhë, te shembujt (2) dhe (3) refreni kryen punëm e një vargu, por jo rrallë edhe nē trup tē së njëjtës këngë ndryshon e nuk është më një refren (d.m.th. përsëritje e së njëjtës fratzë), por një varg i mirëfilltë i ndryshëm nga tē tjerët. Kurse nē shembullin e fundit duket sikur vargu i dytë

zhvillohet kurdoherë nga epanstrofa, sikur është një lulëzim i saj:

Shumë interesante janë dhe organizimet muzikore që iu bëhen distikëve në këngët polifonike të jugut. Në të tilla raste përftohen strofa të rrejshme, siç i quan R. Sokoli, në të cilat përsëritjet apo edhe cungimet e fjalëve u binden si melodisë ashtu edhe lëvizjes koreografike. Kështu, nga ky distiku:

*Yve male me dëborë,
pse s'qani hallet e mia?*

vjen e formohet një strofë fiktive e tillë:

*Yve male me dëborë,
yve male me dëborë, oi!
Yve male me dëborë, oi!
Yve male me dëborë,
pse s'qani, oi, oi, o hallet e mia,
oi, pse s'qani, lele, o hallet e mia,
o pse s'qani more, o hallet ore të mia,
o pse s'qani, oi, oi, o hallet, o more, hallet e mia!*

Por strofa fiktive mund të përftohet edhe ndryshe, me anë të përsëritjes në shkallëzim. Kështu distiku:

*Te ura në Drashovicë,
gjëmon topi i Italise!*

Nga ana' tjetër, në këngë e sipër, një 'distik' mund të zhvillohet edhe kështu, siç ndodh me këto dy vargje:

*O shoqe për këtë jetë
e lumiur me të vërtetë...*

që organizohen në këtë mënyrë:

*O shoqe, moj, o shoqe,
o shoqe, për këtë jetë,
o shoqe, moj; o shoqe,
o shoqe, për këtë jetë
o shoqe, për këtë jetë
e lumiur më të vërtetë
o shoqe, për këtë jetë,
e lumiur me të vërtetë,
e lumiur, e lumiur,
e lumiur me të vërtetë.*

(Zhej)

Sidoqoftë, duhet thënë se distikët janë strofa shumë të përdorura edhe nga poetët tanë, sidomos nga D. Agolli, I. Kadarë, S. Mato, P. Jorgoni, etj. Shpesh hetohet në distikët e tyre një prejardhje drejtpersëdrejtë nga folklori, siç ndodh, ta zemë, me këto vargje të një poezie të F. Gjatës, që ndërtohet, veç të tjerave, ashtu siç ndodh dëndur me poezinë gojore, në formën e një dialogu:

*Kapërceva jazin, më ra shamia në ujë.
— Ore partizan, tă kam gjetur unë!
Ngjita malin lart, kisha etje shumë.
— Ore partizan, të jep të pish unë!*

(Ore partizan!)

Vlen të thuhet këtu se strofat fiktive, që janë kaq origjinale përmuzikën, nuk janë spal interesi edhe për

poezinë. Ato ose pjesë të procedurave të tyre mund të përdoren me sukses edhe nga poetët tanë, nga autorët e teksteve të këngëve etj. Sidoqoftë në poezinë satirike mendojmë se suksesi i tyre është i padyshimtë. S. Çomora na jep një shembull te komedia «Snobizmi», kur e bën njërin nga personazhet të këndojë kështu:

*Vate, fi, moj, vate fi,
vate fisi u ndërrua,
që kur mbe, mor, që kur mbe,
që kur mbesa u diplomua!*

S. Çomora ka përdorur këtu mënyrën e cungimit të fjalëve (një lloj sinkope) si edhe teknikën e përsëritjes. I organizuar kështu, distiku ka më tepër efekt satirik se sa po të qe dhënë në formën e tij të mirëfilltë:

*Vate fisi, u ndërrua
që kur mbesa u diplomua!*

Edhe strofë trishe (tercina) është shumë e përdorur në poezinë gojore të të gjitha krahinave. Ja tre shembuj, i pari nga Veriu, i dyti nga Shqipëria e Mesme dhe, i treti, nga Jugu:

*Moj e mira që shkon me dhi,
ç'se qe verg majte zi
për njat djal'qi t'nejti n'vrri!*

*Arthsh e t'gjeta lala vetëm, obobo!
Jo vetëm po me lalën-e, obobo!
Tuke shartu dardhën-e, obobo!...*

*Nga kurbeti arçë, pse s'më pëershëndoshe?
Ndë mes të behari seç më plevitose...
Vetullat e tua, shishane me qoshe...*

Tercina mund të marrë edhe një formë të tillë si

te kjo këngë nga Pogradeci, krahinë që shquhet për larmi strofike:

*Ballën me sedefe,
se o moj sedefe,
me sërma qendisur!*

*As, o moj sevda,
e shkreta sevdâ,
ku paske kondisur!*

*Ne ky djalë i vogël,
shum'. o mój i vogël,
mustaqja padisur!*

Ndryshe nga shembujt e parë ku kemi skemën e rimës AAA, BBB etj., te shembulli i fundit gjejmë një rimë zinxhir që lidh vargjet e fundit të çdo strofe, pra AAB, CCB, DDB... Këtë skemë ritme e gjejmë edhe te kjo këngë që këndohet në Shmil të Elbasanit:

*Dje me shpirtin nëpër dhëmbë:
ferra, driza nëpër këmbë,
sot gjëzojmë lumturi!*

*Lulzonjeta n'vatra, male!
Për Partinë Shmili hedh valle.
Rrofsh, o moj Parti!*

Sic vihet re nga të gjithë shembujt, kemi të bëjmë me një strofë tepër delikate, me një muzikalitet tepër të brishtë, shumë të përshtatur për lirikën. Për këtë e gjejmë të përdorur edhe nga poetët tanë. Ja një shembull:

*Haj të mirremi për dore,
neyma zemrën që më more,
gjarpérushe pikëlore.
(Poradeci «Gjarpérushja»)*

Për strofën katërshe mund të flitet gjatë. Ajo mund të jetë e formuar nga dy distikë, siç u tha më lart dhe atëherë rimat janë AABB. Nganjëherë ajo formohet nga vargje masash të ndryshme. P.sh.:

- 1) *Bën konak, moj gjeraqinë
bën konak!*
*Bën konak, se krushqit vinë,
bën konak!*
- 2) *Nji fellanx' qì ish mësue
ditë për ditë
me ba mrriz te nji përrue
me uj t'ngrit!*

Pikërisht këtë strofë merr Çajupi dhe e përdor te «Shqiptar» e, më pas, edhe M. Metoja në pjesën më të madhe të poezeve të tij, duke hequr rimën nga vargu i parë dhe i tretë.

Tepër e përdorur është katershja me dy vargjet e fundit që marrin formën e refrenit si te kjo këngë e re nga Bradasheshi i Elbasanit:

*Llamba në faqe të murit,
ç'ke që s'bën dritë?
Mos më luani sonte,
se unë jam e ligë!*

*Llamba në faqe të murit,
ç'ke, moj, që s'bën flakë?
Mos më luani sonte,
se s'mund t'jap xhevapë!*

*Drita elektrike
atje në tavan,
po përhap shkëlqimin
fshatit anembanë!*

Në dy strofat e këtij shembulli hasim edhe feno-

menin e iterativitetit, por në përgjithësi në të duket qartë se si vetë organizimi strofik është duke u evoluar. Në strofen e fundit, megjithëse melodia muzikore është e njëjtë, refreni nuk është më, iterativiteti është zhdukur.

Një katërshe tjetër shumë interesante është ajo me rimë AAAB. Ja disa shembuj:

1) *Karajfil në kodër,*

drandofill në kodër,

vajza e mir' në Shkodër,

moll' e vogël-o!

2) *Malli yt, moj, malli yt,*

m'u bë det, njëmen më mbyt,

tjetër më s'më ryn ndë syt...

mjeri unë, ah, un'a i mjeri!

Për këtë strofë kaq të përdorur, të cilën më pas e gjejmë edhe te F. Noli, K. Jakova etj., ka mendime, siç e thamë edhe më lart, se vjen si rezultat i ndikimit të bejtexhinjve. Megjithatë, po të vërehet mirë, na bëhet se kjo është autentike popullore. Midis strofës së bejtexhinjve dhe kësaj katërsheje popullore vëmë re se në strofen popullore vargu i katërt, në të vërtetë, është një refren, kurse në strofen e bejtexhinjve ky varg, si rregull, nuk është i tillë. Kjo të bën të mendosh se strofa popullore është formuar në këtë rast nga një tercinë plus një vargu refren e për këtë nuk ka nevojë të mendohet si e futur patjetër nga bejtexhinjtë.

Strofa katërshe mund të formohet edhe nëpërmjet iterativitetit, fenomen për të cilin do të flasim më poshtë. Në të tillë raste strofat dallojnë fare pak nga njëra-tjetra. Ja një shembull nga rrathi i Tiranës:

Tundu, shkundu, kumbull-o,

tund e shkund të njomat-o!

Vijnë të mbledhin gocat-o,

njato faqefortat-o!

*Tundu, shkundu, kumbull-o,
tund e shkund të kuqet-o!
Vijnë të mbledhin nuset-o,
njato faqekuqet-o!*

*Tundu, shkundu, kumbull-o,
tund e shkund të thatat-o!
Vijnë të mbledhin plakat-o,
njato faqezhabkat-o!*

Në këtë strofë kaq interesante, plot rima të brendshme, anafora, harmoni imitative, skema e rimës mund të paraqitet ABBB, ACCC, ADDD... Është, siç vihet re, një strofë plot gjallëri, me një ritëm tepër lozonjar, që ia vlen të përdoret edhe prej poetëve tanë.

Në strofat katërshe, siç e thamë, gjemjë mjaft variante, disa prej të cilave janë thurur me mjeshtëri të madhe e me shumë efekt artistik. Vëreni, p.sh. se sa bukur thyhet ritmi i strofës te kjo këngë nga Elbasani në vargun e katërt, ku nis refreni i përbërë nga dy vargjet e fundit:

*Hypa me'j degë fiku,
pashë të bukrën ke iku.
Larg e pashë, me dorë s'e ngava,
më piku në zemër!*

*Hypa me'j degë lisi,
pashë të bukrën ke krisi.
Larg e pashë...
etj.*

Shpesh nëpër këngë, strofat me sasi vargjesh të ndryshme bashkohen mes tyre. Megjithatë ato individualizohen ashtu siç ndodh p.sh. te kjo këngë popullore e rrëthit të Korçës, ku vemë re, veç të tjera, edhe skemën ABAB për katrenin:

I

*E vjen kjo kupa
e rrëth e rrëth, ore,
floriri që zverdh!*

*E se ç'u derdh, moj,
për fund fustanit,
si do t'ia bëj, moj,
këtij beqarit?*

II

*Gjysmën e piva,
gjysma m'u derdh, ore,
floriri që zverdh!*

*E ç'm'u derdh, moj,
për fund pëqirite,
si do t'ia bëj, moj,
këtij bandillitë?*

Përsa i përket strofës pesëshe, ajo, si në jug si në veri, ndërtohet në mënyrë identike. Ja disa shembuj:

1) *Sume, ik' e more dhenë,*

më zure Dombrenë!

Atje ku më shkelne;

sikur më karxenje,

çunat m'i gënjenje!

Hysen, pa m'lep shishanenë,

më more Dombrenë etj.

2) *Kur më veje në vërrri,*

me një mijë dhën e dhi,

Zenel Çareja, shah ty,

(zjarrshuari që s'ka hi)

kuj, kuj; kuj, të kegenë!

*Kur më veje mbë kurorë,
posi Xhafer beu në Vlorë,
Zenal Çareja, shah ty etj. etj.*

- 3) *Shkova n'krue për uej,
m'u vnu krosi mrapa...
Krosi m'lipi faqen,
faqen s'und ia dhash:
«Puthe i herë!» i thash!*

*Shkova n'krue për uej,
m'u vnu krosi mrapa...
Krosi m'lipi sijt etj.*

- 4) *Gardalinat porsi bleta
si njiktu kurkund nuk gjeta,
si babën e dhandrit-o,
qi sillet nëpër odë,
si zamaku n'gjotë!*

Disa prej këtyre strofave janë nga këngë fshatare, disa nga këngë qytetare. Por, sidëqoftë, autenticiteti i tyre gjenuin popullor është i pamohueshëm. Ato, si megjithat diken të formuara nga një distik plus një tercimë. Këtë strukturë gjejmë sidomos te shembujt 1,2 dhe 4, kurse te shembulli 3 skema është tercinë plus distik. Nga ana tjetër te këto strofa vëmë re elementë, fjalë apo edhe vargje të tëra që përsëriten nga një strofe te tjetra; strofat herë-herë ndryshojnë vetëm nga një apo dy fjalë. Tipike për këtë janë strofat e shembullit të tretë. Në këtë rast kemi të bëjmë me, të ashtu-quajturat strofa *iterative* (me përsëritje) fenomen tepër i përhapur në këngën tonë folklorike. Këngë iterative janë këngët në të cilat i njëjti motiv rimerret në intervale të barabartë në strofa që janë krejtësisht identikë, midis të cilave ndryshimi qëndron vetëm në faktin (dhe ky ndryshim i jep mundësi këngës për të vazhduar) që zë-vendësohet ndonjë emër apo ndonjë hollësi me ndonjë emër apo hollësi tjetër. Këtë procedurë e hasim edhe në

strofat e tjetër, bila me sa më shumë vargje, të jenë strofat, aq më i ndijshëm bëhet ky fenomen, i cili, në analizë të fundit, nuk është veçse një formë e vëçantë e fenomenit të përsëritjes, tipar kaq karakteristik për krejt poezinë popullore.

Një strofë tjetër pesëshe, tepër interesante sidomos për përzierjen e vargjeve me gjatësi të ndryshme, për lodrën e rimave (AABAB ose ABABA), dhe për përsëritjet, është kjo e kësaj këngë të vjetër kolonjare:

*Ky Ali Arapi mblođhi gjithë kazanë:
O burra, o shokë! Dhoskën na e vranë!
Mik me të vërtetë!
Ngrënë bukë bashkë! E kishin vëllamë!
Një nga ne mos mbetë!*

*Vjen Feim Prodani vet'i tetëdhjetë,
i nipi lëftohti si për të vëllanë,
posi trim me fletë!
O burra, o shokë! Edhe nipn' e vranë!
Një nga ne mos mbetë!*

Eshtë një strofë madhështore, me një plastikë harmònike plot hije-dritë, që të mahnit me aftësinë e rrallë për të vënë në pah levizjen e ndjenjave, për të shpërthyer me forcë atje ku duhet, për të shprehur me një përmbytje burrërore tërë dhembjen e madhe. Dhe është një strofë gjenuine popullore që shoqërohet me një melodji po aq gjenuine popullore. Kush do të orvatej të mohonte autenticitetin populor shqiptar të kësaj strofe, duhet të orvatet më parë të mohojë autenticitetin popullor shqiptar të melodisë së saj, e cila e organizon. Por si melodia ashtu edhe tubëzimi i vargjeve, janë të kulluara popullore dhe të tillë tingëllojnë ato edhe në operën «Komisari» të N. Zoraqit (libreti D. Agolli) në gojën e Rrapo Tabanit, i cili e këndon këtë melodi plot mall e dhembje në një çast meditimi intim.

Strofa gjashështë paraqitet në disa forma. Ajo haset në të gjitha llojet e këngëve dhe është e përhapur në

të gjitha krahinat. Në të, herë-herë, hasim edhe fenomenin e iterativitetit, por herë të tjera ajo ka një formë që të kujton fare qartë strambotin. Strofa iterative janë pa dyshim këto:

1) *Oh ky limoni i artë
mbështjellë me 'i copë kartë!
Na ka ardhë nji vashë,
po na e mshin shtëpinë.
Mshije, vashë, mshije,
se do të rrim' t'dy bashkë!*

(Elbasani)

2) *Po kndon zogu, kndon turreci:
mjer njaj djali nuse-keqi,
kush a burr në gjam s'e thrret,
se aj mort ka në shpi t'vet,
e shkon ditën me dreq n'sy,
t'gjith natën me ferr' në gji.*

(Puka)

Në shembullin e parë, po të sillnim edhe strofën tjetër të këngës, do të vinim re se tre vargjet e parë janë njëloj, vargu i katërt është «po han bukë e gjellë», kurse vargu i pestë, duke ruajtur strukturën e vargut të pestë të strofës së parë, është «bani, vashë, bani»; kurse vargjet e fundit ndryshojnë vetëm në filillin midis tyre: «se do i ham t'dy bashkë». Po kjo gjë ndodh pak e shumë edhe me strofën e këngës pukiane. Këtu zëvendësimi bëhet me kontrast: *turreci* zëvendësoshet me *bylbyli, nuse-keqi* me *nuse-miri, gjamë e mort* me *darsëm*, kurse dy vargjet e fundit tingëllojnë kështu:

*Gjithë ditën lulet ndër sy,
flen gjithë natën me moll n'gji!*

Sic vihet re lehtë, këtu, për rimat, kemi skemën **AABBCC**.

Po kjo ndodh edhe te dy strofat e kësaj këngë të vjetër nga Përmeti:

*U nisa vajta për ujë,
harrova kënaçenë.
Më dolli një djale mbudhë,
më rrëmbeu kënaçenë.
«Nem, djale, kënaçenë,
pa të të jap faqenë!»*

Në strofën e dytë kemi këto zëvendësime: në vend të kënaçenë, tërkuzënë, në vend të faqenë, buzënë.

Disi më ndryshe tingëllon kjo strofë nga një këngë beratase:

*Celi manushaqja, dhe moj,
s'bëra, moj, me shëndet.
Të mora të vogël,
keçe dyimbëdhjetë vjeç!
S'të mora për punë,
po për muhabet!*

Këtu skema e rimës është ABABCB. Por me sa duket vargu i pestë ka prirje të rimojë me vargun e pestë të strofës pasardhëse, pavarësisht se në rastin tonë hasim një asonancë:

*Erdhi o vjeshta, dhe moj,
do shkoj në kurbet...
Për ty un' mejtoj,
për ty m'erdhhi keq...
Bëhu napolon
të të fus në xhep!*

Po pa dyshim vëmendjen tonë e tërheqin në mënyrë të veçantë këta katër shembuj të tjerë:

1) *Hapu, moj bunacë,
bëju vetëtimë,*

*se vemi te nuni
dhe s'gjejmë shtëpinë.
Zoti nun i madh, i rëndë,
me kurorë të ergjendë!*

2) «*Seç të vetëtin surrati,
moj me dollamasham!*

*Shuko sa vate sahati,
se ngenë s'ta kam!»*

*«Të tetat i ka shkuarë
e ti më s'je kujtuarë!»*

3) *A s'të thashë, moj e mjerë,
të mos dalç atje,*

*frym veriu të ngre çëmberë
pa dikush të shëh!*

*Dikush të sheh, dikush të pikas,
vetulla jote po të bën tallas!*

4) «*Bilbil, more bilbil-o,
bilbil, të thérresin-o!*

*«Thuaj të më presin-o,
sd të stolis ballët-o,*

*ballët e telisur-o,
letr' e mylhedisur-o!»*

Sic vihet re, disa nga këto strofa kanë skemën ABABCC, gjë që të kujton një nga llojet e strambotit. Megjithatë kjo strofë është thjesht popullore shqiptare dhe, me sa duket nga shembujt (sidomos shembulli 1) shumë e vjetër. Mund të jetë që ndonjëra nga strofat e prura më lart të jetë e ndonjë kënge bejtexhiu, por kjo nuk mund të errësojë aspak të vërtetën për autenticitetin popullor shqiptar të strofës në përgjithësi, e cila ka edhe melodinë e vet popullore që e organizon. Nga ana tjetër, thuajse në të gjithë shembujt, dy vargjet e fundit kanë rimë oksitone e në këto vargje sikur përbyllet mendimi, nënvizohet thuajse me ritmin e një

batute finale, një ide, një fakt, një ndjenjë e rëndësi-shme pér këngën, gjë kjo që është karakteristike pér-vargëzimin popullor. Duke u nisur nga esenca shqiptare e kësaj strofe, nga fakti që ajo është kaq e përhapur në popull, na bëhet se kemi të drejtë të mendojmë që Naimi apo Çajupi, të cilët e përdorën këtë strofë, ta kenë marrë atë nga populli pa qënë nevoja t'i drejtoheshin ndonjë modeli të huaj. Mbase pér L. De Martinon e L. Gurakuqin mund të flitet pér ndikim nga stramboti, po pér Naimin e Çajupin e ndonjë tjetër nuk është e drejtë të pohohet kjo. Aq më tepër që stramboti i futur në poezinë shqipe nga L. De Martino e L. Gurakuqi është në vargje njëmbëdhjetërokësh, kurse strofa e Naimit dhe e Çajupit ndjek pér së afërmë shembullin popullor, zakonisht me tetërokësha apo dhjetërokësha.

Strofat *shtatëshe*, *tetëshe* dhë *dhjetëshe*, që është e vërteta nuk janë të shpeshta. Zakonisht ato janë strofa iterative me rimë të përputhur, në mos qofshin të formuara disa herë nga bashkime distikësh, terçinash, katrenësh etj. Bejtexhinjtë sollën llojë të ndryshme strofash të tilla, në më të shumtën heterometrike, por ne nuk e kemi fjalën pér to, po pér strofat e pastra; thjesht popullore.

Ja dy shembuj pér strofenët *shtatëshe*, e para nga Rranxa e Shkodrës, e dyta nga Gjirokastra, që të dyja strofa iterative; në shembullin e parë mjafton që në vend të *dallandyshen-o* të vendoset *sokolin-o* dhe të kri-johet strofa vazhduese, kurse në shembullin e dyte mjafton të zëvendësohet *mollë* dhe e *holle* me *dardhë* dhe e *bardhë*.

- 1) — *Mjeri un nji cirk i vetëm.*
 — *Lumja un se shum se shum!*
 — *Nji ka nji t'i marrsha, un!*
 — *Kë merr ti, mor faqesi?*
 — *Njat qi t'kesh ma pér dobi..*
 — *Ta mora dallnyshen-ot!*
 — *Na ta dhamë t'ngërdheshten-ot!*

2) — Ç'u ngreçë sabah me natë,
mora shportën në dorë,
vajta tek një degë mollë...
Ikë tutje, vajzë e hollë!
Mos m'i prek koqetë mollë,
se n'të paça kurrë,
do të t'zë me gurë!

Një gjë e tillë ndodh pak a shumë edhe me strofën tetëshe dhe dhjetëshe. Ja një strofë dhjetëshe e një këngë satirike nga Këlcyra:

E po deli Demo sarajet me bojë...
Të di, o Demo, të di
se çfarë saraje ke ti...
Ti thoshe saraje me bojë,
po ti s'ke saraje me bojë,
kishe një kasoll' me kashtë,
kokën brenda, këmbët jashtë...
Ytyty! Me këto fjalë,
bëre maskara dynjanë...
Të di, o Demo, të di!

Në strofën e dytë Demoja mburret se ka kalë me shalë, kurse në të vërtetë ka një gomar të çalë; në të tretën, se ka këpucë me prroqe, kurse ka këpucë prej shoshe; në të katërtën Demoja mburret se ka sahat flori-ri, kurse në të vërtetë ka dy zhaba vidhi... Siç kuptohet edhe në këtë rast kemi të bëjmë me strofa iterative.

Përtej dhjetëvargëshit strofat janë të rralla, por jo të pamundura. Ja një shembull nga Çamëria, një strofë, domosdø, iterative:

Ç'u nis djali e plaku bashkë,
u nisnë, vanë pér punë,
u pojnë me vajzë n'udhë.
Thosh plaku: «Ta marr unë.»
Thosh djali: «E dua unë.»
Thosh vajza: «S'e dua plakun,

*se s'ka dhëmbë e dhëmballë.»
«Sos e kam nga pleqëria,
po e kam nga sëkëlldia!
Vajta një ditë me pela,
më shqelmoi pelë e bardhë,
më theu dhëmbë e dhëmballë!»*

Strofat e dyta e të treta të kësaj këngë ndryshojnë prej së parës kryesisht në tri vargjet e fundit. Në to nuk flitet për dhëmbët e plakut, por për «kurrizin e dalë» dhe «mjekrëtë të bardhë», kurse tre vargjet e fundit:

*— Vajta një ditë me dhi,
kaptova një drizë,
ra shpella më zu kurrizë!
— Vajta një ditë në nulli,
friti erë e drekësë,
më ra miell mjekrësë!*

Nuk kemi ndër mend të zgjatemi më tutje lidhur me larminë e strofave të poezisë sonë gojore. Kjo pasuri pret ende të studiohet në mënyrë më të plotë. Studimet që do të kryhen do të zbulojnë edhe të tjera veçori, tipare e kombinime larmish, shumë të efektshme artistikisht, që përputhen në mënyrë të jashtëzakonshme me lëvizjen e mendimeve dhe të ndjenjavë të bredisë. Sidoqoftë, me aq sa u tha gjer këtu, na bëhet se del i qartë fakti që strofa jonë popullore është shumë e pasur dhe e larmishme, se ajo është e përhapur në të gjithë poezinë tonë folklorike, të fshatit e të qytetit, në jug e në veri të vendit. Ka rëndësi që tërë ky thesar strofik i zbuluar apo që pret të zbulohet, të tërheqë më tepër vëmendjen e letrarëve tanë.

5. DISA TIPARE TË METRIKËS SË POEZISË SE RILINDËSVE. NAIM FRASHERI

Në krijimin e letërsisë artistike shqiptare, rilindësve iu desh të kapercenin vështirësi e pengesa të ndryshme, jo vetëm të sferës së brendisë, por edhe të formës. Një punë të madhe ata bënë, veç të tjerave, pikërisht edhe me metrikën. Përvoja e sukseset e tyre kontribuan për t'i dhënë fisionominë vargëzimit shqiptar, përmëtë kristalizuar disa prej tipareve dhe përmëtë celur perspektiva të mëtejshme përmëtë metrikën tonë. Poetët që erdhën më pas, patën e kanë ende sot e kësaj dite një bagazh të madh arritjesh metrike në përvojën e rilindësve, një bagazh që i ndihmoi dhei i ndihmon përmëtë ekip përparrë. Është e ditur se problemet formale të arritit, nuk janë të shkëputura prej atyre të brendisë dhe përmëtë, kush do t'i shikonte arritjet metrike, sukseset në punë të vargëzimit të vecuar nga brendia, do të futej në një qorrsojak e nuk do të ishte në gjendje të shpjegonte deri në fund çështjet. Dhe në fakt poezia e re shqiptare, lindja e së cilës konkretizohet me veprat më të mira të Naimit me shokë, pikërisht se diti të reflektoante kohën, kontradiktat themelore të saj, hovin patrio-

tik, qe në gjendje të sillte me vete edhe një përvojë të madhe për formën, përvojë mjeshterie artistike, përvojë në teknikën e thurjes së vargjeve. Domosdo, rilindësit nuk e patën të lehtë të drejtohen në këtë përpjekje prej novatori, por prirja e tyre demokrati, kredoja e tyre artistike, që e vinte krijimtarinë në shërbim të popullit, dëshira imperative pér t'u bërë më të afert e më, të kuptueshëm pér popullin, i çoi te përvoja poe-
tike e vetë popullit, te folklori. Kështu, nëse atyre u munguan teoricienë e traktate vjershërimi të poezisë shqiptare, nuk u mungoi një shkollë e madhe, e fuqishme dhe e pashtershme artistike, siç është krijimtaria gojore popullore. Është pér këtë arsy që përfundë kuptuar deri në fund edhe punën e kryer prej tyre me vargëzimin, duhet marrë kurdoherë parasysh modeli popullor, që ata patën, model, të cilin shpesh ata e zgjodhën jo vetëm të shtyrë nga intuita poetike, por edhe nga një punë e vetëdijshme, nga një logjikë artistike e diktuar nga vetë faktet historiko-shoqërore të kohës. Interesi pér folklorin, që konkretizohet në mbledhjet e para folkloristike, të botuara pikërisht në atë periudhë, qe tepër dobiprurës, veç të tjerave, pikërisht edhe në organizimin artistik të fjalës poetike, në instrumentimin dhe temperimin ritmik të vargut, në zgjedhjen e një seri mjetesh të përshtatshme pér një poezi që buronte nga populli dhe i drejtohej popullit.

Zakonisht kur flitet pér krijuesit e letërsisë sonë artistike, flitet shumë për studimet e tyre, pér lidhjet me poezinë klasike të vjetër, pér ndonjë kontakt më poezinë arabe, turke, frëngje, italiane etj. Domosdo, kultura që kanë marrë këta njerëz, qoftë edhe kulturë e huaj, ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e tyre, por ata, me mprehtësinë e talentit nuk u bënë kurrë skllevër të kësaj kulture, e panë atë dhe e përdoren kurdoherë në shërbim të idealeve të vendit duke e përshtatur, duke shqiptarizuar atë që mirrin e duke mos i dhënë kurrë trajta të huaja esencës shqiptare. Që flitet pën këtë përgatitje kulturore të tyre, bëhet mirë, por është e udhës që të flitet shumë më tepër

e shumë më mirë për raportet e tyre të shumta e të vazhdueshme me folklorin tonë. Ata u rritën në gji të urtisë popullore, shpirtërisht nuk u ndanë kurrë prej saj, plazmuan edhe nëpërmjet saj psikologjinë e tyre thjesht shqiptare, ményrën e të menduarit prej shqiptari, ményrën e të jetuarit prej shqiptari. Ç'erdhi më pas në jetën e tyre kulturore i pasuoi këto tipare, por nuk i zëvendësoi dot kurrë. As Naimi e as ndonjë tjetër nuk mund të bënte atë që bëri pa e konsideruar veten në radhë të parë si një këngëtar të thjeshtë, të dalë nga gjiri i popullit. Gjithë kultura që kishte marrë u vu prej Naimit në shërbim të këtij qëndrimi, të këtij konceptimi artistik. Kjo duhet thënë më pas edhe për Çajupin e gjithë të tjerët.

Kjo prirje dréjt përvojës artistike të popullit sa vjen e forcohet tek autorët e Rilindjes derisa kthehet e bëhet ca nga ca një normë e vërtetë. Kjo duhet thënë për shumë komponentë artistikë e, domosdo, edhe për vargëzimin. Dhe në fakt vizioni që të krijohet duke parë nga kjo anë krijimtarinë poetike të kësaj periudhe është ajo e një sistemi vargëzimi, duke përfshirë këtu organizimin e instrumentimin e vargut, që lidhet vazhdimit me përvojën popullore. Mbështetja në këtë përvojë është e pranishme në punën artistike thuajse të të gjithë poetëve. Është e vërtetë se pati hera-herës prirje, të pavetëdijshme në ndonjë rast, të vetëdijshme në ndonjë rast tjetër, për ta larguar vargëzimin shqiptar nga kjo rrugë e madhe, por fjala kryesore poetike shqiptare, fjala e zjarrtë e Naimit, e Çajupit, Mqedës, Asdrénit etj. nuk u lëkund nga kjo linjë. Edhe Mjeda, preferenca e të cilat për poezinë klasike është e njohur, e di mirë që poezinë nuk e bëjnë vetëm vargjet e saktë metrikisht, por përjetimi i brendshëm, forca e tyre intrinske, ideoemocionale, lidhja me jetën e jo me letrat, lidhja me popullin e me psikologjinë e tij. Në një artikull ai thotë: «Disa tjerë tue folë për poezi kujtojnë se masa (metri) asht nji gja e domosdoshme për poezi. Por ka shprehje të lidhuna me masë, me rrrokje, theksa e rima që s'mund të thohen përnjimend poezi: auktorët

e tyne munden me u thanë vjershëtorë, por jo poetë. E thomi edhe na se masa e plotëson poezinë, por nuk asht një gja e domosdoshme e natyrës së saj».¹⁾ Dhe në veprat e tij më të mira ai synoi pikërisht në këtë lloj poezie. Kjo domosdo e lidhi me popullin qoftë në brendi, qoftë në shumë elementë të formës.

Konceptimi metrik i lidhur për herë e më shumë me përvojën popullore është pra një karakteristikë e qartë e poezisë së Rilindjes sonë, që, në analizë të fundit, reflekton vetë thelbin ideoemocional të kësaj poezie. Nuk mohojmë këtu se pati raste lëkundjeje, ndonjë orvatje që, e nxitur nga një qëllim i mirë, për të ngulitur te krijuesit ndjenjën e rregullit, të kulturës, dëshirën për t'u përsosur, në mjeshtërinë artistike, kalon herë-herë me dashje a pa dashje në një farë mohimi të përvojës popullore. Me këtë frymë u botua edhe ndonjë libër apo artikull në shtypin e kohës, sidomos kjo në pjesën e dytë të Rilindjes, por tashmë ishte vonë për të çbërë atë që ishte bërë, Rilindja kishte hyrë prej kohësh në fazën e saj të pjekurisë artistike dhe tradita popullore ishte konsoliduar në poezinë tonë me kryeveprat e Naimit e të Çajupit, që ndikojnë shumë më tepër te brezi i ri i poetëve nga q'do të mund të bënte një traktat metrik. Poezia nuk del nga librat e metrikës, por buron nga jeta. Artistët tanë e kishin të thellë këtë bindje, qoftë edhe në një mënyrë intuitive, dhe për këtë nuk gabuan dhe ecën përpara. Libri i Gurakuqit për metrikën e ndonjë shkrim tjetër i kohës, ndihmoi për të, vënë ca rregull, për të ngritur problemin e kulturës së poetëve, për të futur edhe ndonjë formë të re apo për të konsoliduar më tej ndonjë varg — sidomos vargjet tek — në poezinë tonë, por, në përgjithësi vargëzimi ynë ndoqi rrugën që kishte zgjedhur Naimi me shokë dhe kjo rrugë vazhdon akoma sot e kësaj dite, domosdo me evoluimet dhe pasurimet që kuptohen, edhe në poezinë tonë më të re.

1) N. Jorgaqi «Antologji e mendimit estetik shqiptar» Tiranë, 1979, f. 285.

* * *

N. Frashëri ka lidhje të gjalla me folklorin, që ka-lojnë nga psikologjia popullore, e cila është vënë në bazë të konceptimit poetik, gjë që hetohet edhe në vlerësimet që u bën fenomeneve, njerëzve, realitetit e deri të gjuha e pasur me frazeologji popullore, e sigurt në përdorimin e sintaksit dhe ritmit popullore të frazave etj. Por Naimi, i pari ndër të parët, hodhi sytë të teknika e vargjeve popullore dhe me sensin e tij të rrallë poetik e mori dhe e përdori me mjeshtëri në veprat e tij. Ai u rrëmbye sidomos nga bukuria, nga pasuria harmonike e këtij vargu popullore dhe e përdori praktikisht ashtu siç e përdor populli, me liri në vendosjen e theksave ritmikë, duke ndjellë mbi kokë kështu, ndofta edhe vërejtjet e ndonjë kritiku, që nuk ishte në gjëndje të kuptonte vlerën e madhe prej novatori të punës së Naimit. E duhet thënë se gjer vonë, para Çlirimt, vargjet e Naimit ka patur raste që nuk janë quajtur të rregullta, janë quajtur të ndërtuara pa «kulturën» e duhur (!). Kurse vargu i Naimit çau kohërat dhe erdhë gjer tek ne pérherë e më i bukur. Në vargjet e tij hasim mjeshtëri në kombinimin e ritmeve, modelin e të cilët ai e merr, pra, nga populli. Dhe na bëhet se këtu qëndron dhe puna prej novatori e tij në organizimin ritmik të vargut. Duket si gjë e thjeshtë por në fakt nuk është ashtu. Po të kishte vepruar siç e mësonin librat e huaja mëtriike, duke i mbetur rob p.sh. rregullës fikse të skemës 3.7, tetërokëshat e tij kishin për të na lodhur me monotoninë e tyre, siç na ndodh me ndonjë poet tjetër. Por Naimi e kuptoi se duke vepruar kështu, ai do ta varfëronte këtë varg, që në modelin popullore e gjente kaq të pasur. Dhe dëuke menduar e vepruar në këtë mënyrë, ai ia arriti suksesit. Kështu p.sh. vetëm te një strofë e poezisë «*Fyelli*» ai arrin të ketë skema të ndryshme theksimi:

(3.4.7)
Pa dëgjó fyelli ç'thôtë,
tregôn mërgimet e shkrëta, (2.4.7)

qahet nga e zéza bótë (1.5.7)
me fjalëzë të vërtéta. (2.7)

Ose le tē shikojmë këtë shembull tjetër, ku tē bie menjëherë nē sy efekt i madh, që arrihet nga varia-cioni i theksave.

Thotë, ndër tē tjera Vojsava te «Histori e Skënder-beut», kur i kërkojnë djemtë peng:

*Cila mëm' e cili atë
djemtë penk i ka dërguar?
Punë fort shum' e mëkatë,
kurrëkush s'e ka punuar!
Shpirtin e jap, djemtë s'venë,
pa ta s'bëj dot asnje dite,
dhe ata neve s'na lenë,
s'bëhenë kështu miqësitë!
Djemtë, q'i kam gjithnj' afër...*

Në këto vargje, ritmi, që këmbej hera-herës, kon-tribuon pér tē dhënë me efekt tē madh gjendjen e tra-zuar shpirtërore tē kësaj néné. Vini veshiri sidomos vargut tē pestë, që thyen; thuajse befas, ritmin e përpars-hëm.

Ky elasticitet ritmik vërehet, domosdo, nē tē gjitha llojet e vargjeve tē përdorura prej Naimit Kështu, p.sh. edhe gjashtëmbëdhjetërrorëshi i tij i largohet vazhdimi-sht skemës fiksë dhe e përshtat strukturën ritmike me brendinë ideoemocionale tē poezisë. Në se te «Bagëti e bujqësi» hasim vargje, nē tē cilat cezura e madhe vendoset nē mes duke ndarë dy hemistikët tetërror-kësh:

*O male! e Shqipërisë// e ju o lisat e gjatë
hasim nē tē njëjtën kohë edhe vargje, që këmbejnë strukturën e ritmit nē mënyra nga më tē ndryshme, por kurdoherë nē funksion tē një shërbimi ideoartistik. Kështu, p.sh. vihet re se sa herë fillon*

një pjesë e re në poemë, ritmi nuk është më ai i pari.
Në se te këto vargje

*...dashç, perndinë, pa më thuaj, a mos na pe bagëtinë?
— Pash' atje pas më të gdhirë... ja atje përtet tek vinë! —*

ritmi është tepër i thyer, i aksidentuar, te vargu që hap pjesën e re ai merr një ecuri tjetër, gati-gati të qetë, madhështore, plot frymëmarrje:

O sa bukuri ka tufa, sa gaz bie bagëtia!

Kështu ndodh edhe në raste të tilla analoge. Po nuk mjafton me kaq. Shikoni p.sh. këto vargje:

- 1) Te këndon thëllëza me gaz edhe zogu me dëshirë...
- 2) Një zog i helmuar mi varr, rri si mëmëz dhe e qan.
- 3) ...q'eshtë thier, bërë milë copë, posa një pasqirë...
- 4) ...një pret e qep, një merr e jep, një mbath, një shikon mullinë...

Në shembujt 1 dhe 2 kemi theksa ritmikë në rrrokjen e tetë, një farë *kapercimi*, bile në rastin e parë me theksin tjetër që vjen menjëherë pas, ndeshim në fenomenin e *kundërtheksit*. Në formën normale vargu mund të që ndërtuar kështu:

Tek këndon me gaz thëllëza edhe zogu me dëshirë

Por poeti i është larguar me qëllim dhe natyrshëm kësaj strukture. Ashtu siç i është larguar edhe në shembullin 3 dhe 4. Në rastin e parë copëzimi i vargut në tri vargje të vegjël, me dy cezura që evidencohen qartë, jepet ritmi i mendimit poetik, që shpreh në këto momente poezia. Edhe në shembullin 4 kemi një ndërtim të gjashtëmbëdhjetërrrokëshit jo nga dyzimi i tetërrrokëshit, por nga bashkim vargjesh më të shkurtra, duke përfshuar në këtë rast jo dy, por tri cezura. Dy cezurat e para theksohen edhe nga rima e brendshme.

Gjashtëmbëdhjetërrrokëshi i Naimit ruan në përgjithësi karakterin trokaik, ndryshe nga c'ndodh me gjashtëmbëdhjetërrrokëshin e Poradecit, që formohet nga peone. Megjithatë nuk janë të rrallë përdorimet e jambave, në mos edhe i krejt ndonjë vargu jambik, Në të tilla raste jambi, qoftë edhe një i vetëm në një varg, shërbën për të thyer ritmin ose pér të kriuar një muzikalitet tjetër, siç ndodh te shembulli 4.

Naimi përdor lloje të ndryshme vargjesh, kryesisht çift, por dendur edhe vargjet tek, me përjashtim të njëmbëdhjetërrrokëshit që nuk haset kund në poezi-të e tij. Kështu gjejmë shtatërrrokëshin te poezia «Varfëria», «Gjuha jonë», pesërrrokëshin te poezia «Shpreh» etj»

Përsa u përket strofave, Naimi përdor mjaft distikun popullor («Bagëti e bujqësi» është shkruar në distikë), por pëlqen sidomos katershën me rimë të alternuar. Kjo nuk dò të thotë se nuk hasim tek ai strofa të tjera. Kështu te «Shpreh» gjejmë strofen gjashtëshe, siç e vemi re zakonisht te poetët tanë të veriut, me ske-mmën e rimës ABABCC, të cilën Naimi duhet ta ketë marrë nga populli, siç e pamë dhe siç do ta shohim duke folur edhe pér Çajupin:

*Kam shumë shpresë
te perëndia
që të mos jesë
kështu Shqipëria,
po të ndritohet,
të lulëzohet:*

Po këtë strofë e gjejmë edhe gjetkë, p.sh. te fabula «Gomari dhe kafshët e egra»:

*Gomari hodhi lëkurë dragoi
dhe erdh e t'u bë posa dragua,
dolli me mburrim, më një brek qëndroi,
thua se thoshte: Kush më del mua?
Kafshët e tjera posa e panë,
të gjitha me vrapi ikën, e lanë.*

Nganjëherë Naimi ka krijuar strofa vetë, si ndodh te poezia «Përse?», apo tek fabula «Plaku dhe vdekja». Në të dyja këto strofa hasim vargje masash të ndryshme, ku nuk mungojnë vargjet tek, përkundrazi. Kështu te «Plaku dhe vdekja» kemi skémén e rimës: AABCCB, me katër vargje dhjetërrrokësh e dy shtatërrrokësh:

*Një plak i thinjur, me dru ngarkuar.
buzë një rripe kishte qëndruar,
fort ishte lodhur, këputur ishte,
dhe qe shumë mërzitur,
e fare zvetëtitur,
se gjë në jetë i gjori s'kishte.*

Eshëtë e kuptueshme që një poet si Naimi të ketë përdorur së tepërmë monokolonën popullore, pavarësisht se mënyra e shpérndarjes së rimës në këto raste nuk përputhet sa duhet me modelin popullor, ashtu siç ndodh p.sh. te Çajupi. Por këtu dëshirojmë të ndalemi, meqë jemi në çështjen e grupimit, te karakteristikat e vargjeve të përzier të Naimit. Naimi, ndër të parët në letërsinë tonë, përdori vargjet e përzier, duke tubëzuar vargje me masa të ndryshme. Këtë ai e bën edhe në poezi të tjera, por kjo gjë bie në sy, sidomos te fabulat. Fabulat janë interesante për t'u studiuar nga ana metrike, mbasi, veç të tjerave, me qëllim që t'i afrohet sa të jetë e mundur tonit të tregimit, të bisedës, Naimi i shmanget simetrisë ritmike, dhe jo vetëm përzien vargjet me metër të ndryshëm, por përdor edhe kapërcimet, kundërtheksat, bile edhe bartjet. mjete që i shtie në punë pak use aspak në poezitë e tij të tjera. Kështu te fabula «Mbreti» ka distikë me vargje tetë dhe shtatërrrokësh; te «Të dy qetë dhe ujku» ka strofa gjashtëshe, po ku tubëzohen pa rregull fikse vargje dhjetërrrokësh, nëntërrrokësh, tetërrrokësh dhe shtatërrrokësh; te «Dimri dhe vera» hasim gjashtë-pesë-tetë-katër dhe dhjetë-rrrokësh e kështu me radhë. Çështë e vërteta nuk kemi struktura përzierje vargjesh ashtu siç do t'i gjejmë te

Çajupi, por në fabulat e Naimit ritmi, siç e thamë, sikur humbet ekuilibrin e simetrisë dhe i bindet më tepër lëvizzjes së ngjarjes, që tregohet, se sa melodisë së fjalës. Në këto fabula përdorej mjaf dymbëdhjetërrrokëshi, por poeti bën çmos që të mos ndihet cezura në mes të hemistikëve, prish, pra, simetrinë, diku ha një rrrokje, diku shton një më tepër, këtu përdor *kapërcimin*, atje *kundërtheksin* etj. Kështu përfshohet një melodi tepër e afërt me bisedën, ndërsa te Çajupi edhe në fabula ruhet melodia e këngës.

Në këtë mënyrë në se një varg si ky:

Korbi në një deje na kishte qëndruar

është formuar nga dyzimi i gjashtërrrokëshit, vargje të tjerë si këto, nuk mund të quhen të tillë:

Mirëdita! — tha; mikë i dashur im!

Do të ishe mbret ti mi sa shpesh janë.

Dhelpra me të math gas u hodh edhe' e rrëmbeu

Ca pëllumbashkin bashkë në një fole...

Pikërisht nër fabula gjiejmë bartjet më të shumta të Naimit, të cilat në poezitë e tij të tjera, siç e thamë, janë fort të rralla. Kështu mund të hasim ndonjë të tillë te poezia «Gjuha janë»:

po sot pendë dhe kartë

na duhet, nukë tjetër.

Apo te poezia «Paraisa»:

Gjithë botënë Romanët

e viunë poshtë, vëç tanët

u pren udhn' e s'i lani.

Apo dhe disa herë te «Historia e Skënderbeut»:

Duke qenë se në mëdelen popullor bartjeti nuk hasenj Naimi, që e ndiqte këtë mëdel, u është shman-

gur atyre, po të fabulat ato ia kërkonte nevoja e prishjes së simetrisë, nevoja për krijimin e një ritmi të thyer, më afër bisedës së përditshme etj. Ja disa shembuj nga këto fabula:

*Qet' e muarr vesh dhe u afruan
njeri tjetrit...*

(Të dy qetë dhe ujku)

*Ujku erdhi, dhe nga vrima
e gardhit si vetëtima
hyri në vathë, laduti.*

(Ujku dhe qengji)

*Dhelprës një kockë i kishte mbetur
në gryk' e kishte rënë e mekur...
(Dhelpra dhe lejleku)*

*Një i pasur i kish zënë
guguçen dhe e kish vënë
në kuvliz' dhe e mbante*

*Kur u nis përvant të huaj
i zoti, dhe gjith' i thirri...*

(Guguçeja)

Kjo gjë do të ndodhë, siç do ta shohim, edhe me Çajupin në përdorimin e bartjes. Megjithatë edhe me bartjet, fabulat tingëllojnë me një frysme shumë popullore, mbasi vetë poezia e sintaksit popullor, frazeologjia, lodra e rimave etj. kontribuojnë për të plazmuar edhe harmonikisht këtë frysme, që ishte kaq shumë themelore për Naimin me shokë.

Duke ardhur te rima, duhet thënë se Naimi në përgjithësi njeh atë të mirëfilltën, fare pak asonancën dhe aspak konsonancën. Haset tek ai rima e brëndshme,

por edhe kjo — si për të kompensuar të tjerat — ndeshet më dendur te fabulat:

U tha: «Thoni, ç'gjë kërkon;
që t'u bijë gjithë ç'doni?»
(Guguçeja)

E s'do të ligën, po do të mirën,
do butësirën, nuk egërsirën.

Të drejtënë do dhe urtësinë,
s'do faqezinë e babëzinë.

Mua të lirë më bëri zoti
përse më bën ròp' nga unë ç'do ti!

(Zogu dhe djali)

Ndërkaq vëmë re këtu shkarazi se te kjo fabul haset mbase e vetmja rimë e përbërë (Zoti — ç'do ti) në krejt veprën poetike të Naimit (rasti në fabulën «Kunadhja veshur si këndes»: Kaposhi i tha — ah, tani, a! është një asonancë e përbërë). Sidoqoftë raste të tilla (ashtu edhe rasti i bartjeve) dëshmojnë se Naimi i njihet mirë këto procedura, artifice, gjetje metrike, por ai iu shmang me sa duket me qëllim një praktike të tillë për t'i ndeñjur sa më afër modelit popullor.

Naimi pikërisht për këtë arsyе përpinqet, veç të tjerave, edhe ta instrumentojë vargun ashtu siç bën populli. Është e vërtetë se këto mjete instrumentimi ai nuk i përdor me shumicë dhe larmia e ritmit, larmia e shpërndarjes së theksave ritmikë mbetet procedura kryesore që ai përdor në vargëzimin e vet. Mëgjithatë në poezinë e tij hasim disa lloje përsëritjesh, që të kujtojnë patjetër frysni popullore. Kështu ai thotë:

... asgjë tjetër nukë jemi,
jemi vetëm shqiptarë...
(Korça)

*Dhe në mejtim të madh rashë,
më ra në det mendja, m'u mbyt...*
(Bukuria, 5)

*... vetullat më paskan vrarë,
më vrau harku, jo shigjeta!*
(Bukuria, 8)

Në mënyrë të vegantë me efekt të fuqishëm ide-artistik është kjo epanastrofë, që të kujton së tepërmi mënyrën popullore:

*... ngriti gishtin e tha: «Kurrë!
Kurrë s'trembet Shqipëria!...*

(Histori e Skënderbeut, I)

Edhe anafora përdoret prej Naimit jo rrallë, ashtu si edhe aliteracioni e sidomos enumeracioni, i cili na bëhet se është një nga mjetet artistike më të përdorur prej tij.

Sidoqoftë Naimi e përdor përsëritjen dendur dhe do të thoshim se di të japë kurdoherë diçka të frysës së popullit në këto raste. Ja disa shembuj të tillë:

*Delni, të dalim të tërë!
Mjerë, mjer' ai i gjorë!*

(Histori e Skëndërbëut, I)

*... fort ishte lodhur, këputur ishte...
Jakë, tha plaku, jakë!*
(Plaku dhë vdekja)

*Nat' atje është tjetër natë, edhe dita tjetër ditë...
Ngaha qelli, ke zbritur, ver' o e bukura verë?...
Mos e lerë pa të kurrë, kurrë thatë mos e lerë...
(Bagëti e bujqësi)*

Shembulli, i fundit, sidomos me përsëritjen e «mos e lerë», të kujton një lloj përsëritje popullore, për të

cilën kemi folur më parë dhe që te shembujt e më poshtëm bëhet më e dukshme:

Pse s'vjen o ditë e mirë?

Pse vallë nukë vjen?

(Përse?)

*... edhe dita u shënuar,
opopo! e zeza ditë!*

(Histori e Skënderbeut, II)

Ose vargu:

C'pate që më vrave, c'pate?

(Bukuria, 8)

Varg, që të kujton vargjet e poezisë popullore të ndërtuar me një përsëritje të tillë, siç e gjejmë edhe sot tek ndonjë këngë, si p.sh.:

Pati frikë a çfarë pati?

Atje qe edhe veshëgjati...

Naimi është tepër i ndieshëm ndaj natyrës së tingujve, që, përbëjnë një fjalë. Përgjithësisht u shmanget fjalëve apo vargjeve, që do të krijonin bashkime të forta bashkëtingëllorë dhe preferon kurdoherë melodinë e butë, të hollë, e të qetë, të zanoreve dhe të bashkëtingëllorëve të buta, të tingëllta. Nga ana tjetër, ai merr liri poetike kur është puna për të fugizuar muzikalitetin. Megjithatë, domosdo, këto liri riuk cënojnë thuajse kurrë natyrën e gjuhës. Kështu p.sh. fjalën *gaz* mund ta shkruarë edhe në formën *gas*, kur këtë e kërkon rima:

... një gaz t'embël e të shumë, o, sa bukur e sa mirë!

*Pelën e ndjek mëz' i bukur, lopës i vete viçi pas,
dallëndyshja punëtore bën folenë me të madh gas.*

(Bagëti e bujqësi)

Por patjetër, interesante është të studiohet gjer në fund funksioni që poeti i jep ë-së në thurjen e vargjeve. Zakonisht ke përshtypjen se vargjet e Naimit rëndohen me ë më shumë kur janë të gjatë, se sa kur janë të shkurtër, kështu mjaft fjalë, që në poezi të tjera me metër të shkurtër do t'i gjejmë pa ë, te «Bagëti e bujqësi» mund t'i gjejmë edhe me ë. Kuptohet se ë shërben për të krijuar rrrojje të reja, për të shtuar rrrokjet e një fjale. Kështu p.sh. gjejmë:

Njeriu duhetë t'i shohë, t'i ketë kujdes, t'i dojë...
(Bagëti e bujqësi)

*Sot duhet trimëria,
nukë duhet më mentimi...*

(Histori e Skënderbeut, I)

*Ishin engjej ato vasha
Kishin leshëra të arta...*

...

*S'kishin gjë të pëlqyer
ishinë të sgurdulluar...*

(Histori e Skënderbeut, II, III)

Unë jetënë q'e desha...

(Histori e Skënderbeut, II)

Sa e dua gjithë jetën
(Jeta)

*Bien zilet e këmborët dhe fyelli e xhuraja...
cjeptë, ziletë, këmborët...
e kecërit nëpër rrripat dhe në gjethet e në
miqt' e tij shqerrat janë, kecërit, dhitë, dhentë...
(Bagëti e bujqësi)*

Në shembujt që dhamë më sipër shtesa ose mungesa e ë-së, ndihet në fund të fjalës dhe përcakton numrin e rrrokjeve, por interesante janë shtesat apo heqjet në trung të fjalës. Kështu p.sh.

Kështu tha e zemëruar...

këshu u tha i zi u atë...

s'bënenë kshu miqësitë.

Dit' e zezë afërohej...

koh' e ndarjes u afrua.

(Histori e Skënderbeut, II)

Në trung të fjalës këto manovrime fitojnë herë-herë një nuancë të theksuar artistike, ato sikur nënvisojnë ritmikisht një fjalë, një figurë siç ndodh p.sh. në këto vargje nga «Historia e Skënderbeut»

...edhe dukej e tmerruar...

...

Një natë të témerruar...

Ësja e shtuar në rastin e dytë sikur bën të qën-drojmë më shumë te ky epitet. Me efekt më të madh artistik është liria poetike te ky varg, ku në vend të *tmerr*, poeti shkruan:

*témerr e frikë përhapni,
përpini qiejt e retë...*

Edhe në këtë rast ka mjaftuar një ë për të na bërë që të ndalemi më shumë te një fjalë me rëndësi për anën figurative të vargut. Ndërkaj duhet vënë re edhe një herë, se në të gjitha këto raste, edhe kur poeti në vend të çmon thotë çëmon, në vend të *i shëmtuar* thotë

i shëmëtuar, herë shkruan i veshur herë i veshurë, i mbaruar apo i mbaruarë etj., ai ruhet shumë që karakteri i gjuhës shqipe të mos cënohet e të tillë manovrime të jenë plotësisht në harmoni, sidomos më muzikalitetin e gjuhës sonë.

Mjaftojnë edhe këto që u thanë këtu për disa nga tiparet metrike të poezisë së Naim Frashërit, për t'u bindur, se ai ishte një novator i vërtetë edhe në punë të vargëzimit të poezisë sonë të re.

The first author would like to thank the anonymous referee for valuable comments.

1976-1977-1978-1979
1980-1981-1982-1983
1984-1985-1986-1987
1988-1989-1990-1991
1992-1993-1994-1995

6. A. Z. CAJUPI é um dos principais nomes da literatura brasileira contemporânea. Nascido em 1935, na província de São Paulo, é autor de numerosos livros, entre os quais se destaca "O Pássaro e o Céu", que lhe rendeu o Prêmio Jabuti de 1980. Sua obra é caracterizada por uma profunda reflexão sobre a natureza humana e a sua relação com o mundo exterior. Seus escritos são reconhecidos como obras de grande profundidade e complexidade, que exploram temas como a identidade, a memória, a morte e a existência. Sua prosa é rica em metáforas e simbolismos, criando uma atmosfera misteriosa e poética. Sua escrita é marcada por uma linguagem clara e concisa, que consegue transmitir complexas ideias de forma simples e acessível. Sua obra é considerada uma das mais importantes da literatura contemporânea brasileira.

6. A. Z. CAJUPI

Die 20.05.2006 u. 21.05.2006
Bildungsseminar Hochschule für

Për Çajupin Naimi qellnjë mësues i madh, që i tregoi shtegun se nga duhej të skalonte. Çajupi e kuptoi që herët mësimin e vyer të Naimit përfolklorin dhe bëri çmos në vargjet e tij, ta dojë një fund mësimin e marrë. Dhe në pjesën më të madhe ai ia arriti qëllimit. Është punë fortë fyrتshme përmës sot të studiojmë, veç të tjerave, edhe procedurat këqë Çajupi mori nga vargëzimi popullor dhe i përdori me mjeshtëri përinstrumentimin e vargut të tij.

Duke llënë mënjanë faktin që edhe ai, osi Naimi, përdori lirinë e shkërndarjes së theksave ritmikë, në shërbim të brendisë ideoëmocionale, siç bënoj popullin, i vlen të ndalemi të disa elemente të tjerë të organizimit të vargut, përdorimin e të cilëve Çajupi e thellon, e çon më tej, duke përtuar kështu një ngjyrim e një frymë tepëri popullor. Po më parë, përsai i pënket theksimit, dëshirojmë të vemi në dukje këtu që, ashtu siç veporan populli zakonisht te disa këngë vajti, ku dy vargjet e fundit përdoren më të shkurtër (gjë të cilën e ka

vënë re edhe Shuteriqi),¹⁾ ashtu vepron edhe Çajupi.
P. sh.:

*Vajte lëftove për botë,
u mundove dëm e kotë!
Bir, o djal' i vetëmë,
se ç'më nxive jetënë!*

(Vaj)

Këtu, ndërkaq, duhen vënë re dy gjëra.

E para, që Çajupi e ka shtrirë praktikën e kësaj procedure popullore jo vetëm në vaje, por edhe në raste të tjera, kur mendon sidomos që në narracion ka ardhur një moment kulmi, është vendosur, një tension i tillë, që kërkon ndërrim të befast ritmi, një theksim më të përqëndruar, më intensiv. Kështu te «Atdheu e dashuria» gjejmë:

*Të dy trimat hapnë gjitë
dhe shukonin hajmalitë,*

*Sp. lib. qepur me ëpe të floritëri M. çajupi D. 67
-qui o iqsi mijëra, siljetëra, ndal, qani se rrejtëzuar, qenët
enët njoftë të dy, të njëjëra, të dy, të njëjëra. Vjeni që do i
-ën brasi përbrenda, spshehur, në kartë, në çetë, në çetë! Gjatë
dijës së gjenë nga mijë kryq të artë! Gjatë së shumë
së jashtë Mbëqë të maniturë mët. Gjedh që t'karrë
kuptë! Spdhe sëstë goditurë! Gjatë së përvjetorit
-fletëm qëndrojnë i mbët qëndrojnë, qëndrojnë*

E dyta, gjatë kësaj procedure Çajupi, duke i ndënjuro kurdoherë, afër popullit, ndërron, nashduket, i sistemin vargëzimit, dhe nga ai silabik hidhet në sistemin silabo-tonik (ritmik), duke lexuar kështu më tek fushatangro si bëjti si ëndezet, si i këndoj, si i këndoj

1) Eshtë përtu shënuar se në Toskëri, vajt, me vargje tetë-rrokësh, përfundojnë me dy gjashtërrokësha, Kështu, fjala vjen, kënga shumë e njohur, «Vajtimi i Gjolekës, embaron me dy gjashtërrokësha», «O Gjolekë lapi, se ç'të humbi, namira» (Vepër, e cituar, f. 65).

për se fjalët, këmbët. Në këtë mënyrë ai lexon vargjet me theks në rrrojën e fundit duke i kthyer praktikisht nga gjashtë në tetërrrokësh:
*Ai që jam vluarë dje përmes së shpejtës së vjetës
dhe për të martuarë, tjetër që nuk
është trim sa s'gjin detë, i bështë rreth qëllimit
i mirë sa s'bënëtë... Si njëra, si tjetëra, i tashq
të dya të vjetëra... Mbenë të maniturë
dhe, si të goditura!*

Një procedurë e tillë popullore, e përdorur për herë të parë në poezinë e shkruar nga Çajupi, haset më pas te Asdreni, Poradeci, Kadareja, Arapi e ndonjë tjetër.

Çajupit i pëlqen që shpesh, ashtu si ndodh në popull, t'i japë tetërrrokëshit një simetri të përkryer duke e ndarë nëpërmjet cezurës në dy hemistikë. Një gjë e tillë arrihet prej tij shpesh edhe menjë të epanalepsit. Ja disa shembuj, që të duken hera-herës sikur janë marrë pezull nga folklori:

Qajnë burra, qajnë gra!

(Sultani)

Kaqë dita, kaqë thashë...

(Letër S. Dines)

Gjithë lule, gjithë bar...

(Korrik)

Një tjetër e gjithë është i përmendur me shembullin e gomari jatros (Gomari jatro) që ka qenë i vlefshëm në këtë rast:

Kur pa ngrën' e kur pa pire...

Kur pa buk' e kur pa gjumë...

Shtatë dit e shtatë net...

(Kurbeti)

Edhe për Çajupin vargu më i përdorur është tetërrokëshi, por edhe vargjet e tjerë popullorë, siç është gjashtërrokëshi, dhjetërrokëshi, dymbëdhjetërrokëshi etj. Interesante është të vërehet puna që kryen ky poet edhe me vargjet e dyzuar si dymbëdhjetërrokëshin apo dhjetërrokëshin. I formuar nga dy gjashtërrokësh, dymbëdhjetërrokëshi i Çajupit zakonisht e ka të theksuar mirë cezurën e madhe, po kur e do puna poeti di të kombinojë edhe pauza të tjera. Kështu, për shembull, te «Vajet» kemi vargje të këtij lloji:

Që ditën që vdiqe/ që kur s'të kam parë

Po hasim edhe vargje të tillë:

1) *Motëmot që rrojtim bashkë s'më hurreve*

2) *Atje tek rriljanë qipariz' e varre...*

Këto vargje, që përftojnë një ritëm tjeter, që aksidentojnë ritmin e krejt poeziës, duke u shkrirë më dënesat e dhëmbjes, dhe të frymëmarrjes së trazuar të poetit nga dhembja, duket sikur janë formuar nga bashkime vargjesh të tjerë, jo gjashtërrokësh. Kështu në rastin e parë, kemi tetërrokëshin plus një katërrokësh, kurse në rastin e dytë një pesërrokësh plus një shtatërrokësh. Duke qenë se pesërrokëshi është oksiton përfshohet një kundërtheks (*rriljanë*), që e thyen edhe më tepër ritmin.

Kurse te ky varg i dyzuar dymbëdhjetërrokësh kemi fenomenin e kapërcimit ose, si i thonë ndryshe, bartjen e brendshme. Në fakt kapërcehet cezura e madhe dhe ndalesa bëhet më tutje;

Maniten të tërë trimati/ kur e shonë

Pauza, në vend që të vijë mbas fjalës *të téré*, vjen pér efekt të kapercimit (ndonëse më e shkurtër saqisë dhe mezi vihet re), pas fjalës *trimat*.

Pak a shumë kjo ndodh edhe me dhjetërrrokëshin. Le të shikojmë pér këtë dy poezitë, «Baba Tomori» dhe «Misiri». Ndërsa te poezia «Baba Tomori», mbisundon bashkimi i katërrrokëshit me gjashtërrrokëshin, te «Misiri» kemi dyzimin e pesërrrokëshit. Domosdo ritmet janë të ndryshme:

*Baba Tomor, kish 'e Shqipërisë...
Fushë dhë fushë dhe fushë prapë...*

Duhet thënë, nga ana tjetër, se në poezinë e parë mbisundon skemë katërrrokësh plus gjashtërrrokësh, po në ndonjë rast hasim edhe skemën gjashtërrrokësh plus katërrrokësh, si pér shembull:

Kanë qenë trimë/ të lëvduar

Nëse ky varg do të mirret il ndërtuar sipas skemës së parë:

Kanë qenë/ trimë/ të lëvduar

atëherë këtu do të kemi fenomenin e kapercimit.

Përsa u përket strofave, te Çajupi gjemë sidomos distikun popullor, monokolonën popullore me prirje pér monorimë dhe katrenin. Me distikë janë shkruar poezi si «Baba Tomori», «Misiri», «Vajet», «Mëmëdhëu», «Punërat e perëndisë», «Kur jeshmë/ të vegjël», «E mba mënt, moj Marë» etj. Edhe te strofat katërshe poeti merr modelet nga populli. Nuk ka asnjë dyshim, p.sh., që strofa e poezisë «Shqipëtar», siç u tha, është marrë prej tij nga kënga popullore.

Te katrenet vihet re edhe ndonjë afrim tjetër me frysmin popullore. Kështu p.sh. strofa e «Kopshtit të

dashurisë» është e njohur në popull siç e pamë edhe më lart:

*O pëllump' i shkruar,
do t'të marr në duar
dheduke kënduar
gjetkë do t'të shpie.*

(Çajupi)

*More Bendo Shapërdani
në Stamboll të vate nami:
lëfton Bendo Kapedani!*

Bini, o trima, të luftojmë!

(Popullore)

Në këtë katren vihet re skema e rimës: AAAB — CCCB etj. Po kështu, na duket se ka një natyrë popullore edhe strofa e poezisë «Robëria», një gjashtëshe që e gjejmë siç pamë edhe të Naimi ë që të kujton strambotin popullor italian mesjetar:

*Qajni pyje, fusha, gurë,
qajni male me tëborë!
Shqipëria mbet e gjorë
dhe nukë she dritë kurrë:
një mjengull e keq' e shkretë
e ka mbuluar përjetë!*

Po përf këtë lloj strofe kemi folur në kapitullin kushtuar strofës popullore.

Një origjinë popullore duhet të ketë edhe strofa e poezisë «Ku kemi lërë?»:

*Në ç'vend kemi lërë?
ku na bëjnë riderë?*

— Në Shqipëri

Një strofë të tillë e ka edhe Naimi psh. te poezia «Vera vate, shkoj» dhe Çajupi duhet ta ketë marrë prej tij.

Eshtë fare e qartë që vargu i shkurtër pesërrokësh, të jetë këtu në vend të një refreni. Kjo afri me organizimin strofik popullor shpjegohet te Çajupi edhe me faktin që ai e ka konceptuar poezinë dhe si një këngë të destinuar për t'u veshur me melodi. Kjo prirje duket në mënyrë të hapur te «Fyelli i bariut», «Robëria», «Naim Frashëri», «Obobo» etj, por edhe shumë krijime të tij të tjera janë të lidhura me këngën dhe këtë e dëshmon vetë fakti që shumë prej tyre këndohen sot në popull sipas melodisë populllore. Të tillë janë «Fshati im», «Vajet» etj.

Një strofë katershë e Çajupit eshtë ajo në të cilën rima e vargut të parë dhe të tretë eshtë oksitone (mashkullore), kurse në vargun e dytë dhe të katërt e sheshtë (femërore). Me një strofë të tillë eshtë shkruar e tërë poezia D e ciklit «Dashuria»:

*Si për burra edhe për gra,
dashuria, djaleria,
janë si motër e vëlla,
s'i ndan döt as perëndia.*

Një strofë të tillë Çajupi e ka marrë nga bejtëxhinjtë. Në folklor katershja ka një ndërtim rimë tjetër: vargu i parë dhe i tretë janë zakonisht me rimë të sheshtë (femërore), kurse vargu i dytë dhe i katërt me rimë oksitone ose të katër vargjet me rimë të sheshtë. Kjo sidomos përfolklorin e jugut, kurse në veri, sidomos në Shkodër, hasen dhe këngë popullore që kanë skemën e parë, por, me sa duket, do të jenë krijime bejtëxhinjsh.

Interesante paraqitet poezia e Çajupit edhe përsa i përket rimës. Ashtu si edhe Naimi, ai përdor rimën e mirefilltë, aspak konsonancën dhe rrallë asonancën. Përsa i përket kombinimit të rimave këtu duam të térheqim vëmendjen se Çajupi përdor tepër monorimën dhe, ashtu siç gjendet në popull, ai preferon që vargjet, të cilët formojnë një frazë të plotë sintaktikisht, t'i lidhë me të njëjtën rimë. Shembujt janë të shumtë. Kështu e hasim

shpërndarjen e rimës në poezi si : «Trimi i Shqipërisë», «Fyelli i bariut» e shumë të tjera.

*Kush ka qenë trim një herë?
Alekandri i Madh i vjerë,
Pirru me shokë të tjerë,
në Shqipëri kanë lerë,*

*Po nga gjithë m'i zoti?
Skënderbeu Kastrioti.*

*Ku je, more Skënder be?
Si duron ti nënë dhe?
Nukë të vjen keq pér ne?
Që ditën që na le,
vendi yn' u bë raje...*

Gjen në vargjet e Çajupit edhe rimën e brendshme, por ajo që të tërheq më shumë në këtë lloj rime është pozita e saj. Çajupi pëlqen të rrimojë cezurat apo hemistikët e vargjeve, gjë që i lidh edhe më tepër vargjet midis tyre duke nënvizuar në të njëjtën kohë edhe më shumë vlerën ideologjike të poezisë. Ja disa shembuj:

*Na shkretoi, na preu, na griu,
na çnderoi dhe gjaknë na piu,
na mundoi, shpyrtinë na nxori.*

(Baba Tomorri)

*Vajte, lëftove pér botë
u mundove dëm e kotë...
(Vaj).*

*Shumë vjet u bënë, sot u mbushën dhjetë
që kur në ke lenë dhe s'të sho ndë jetë...*

(Vaje).

**Apofi me Petefrinë,
bashkë rrinë, han' e pinë...
(Zolejka)**

Rimën e brendshme, sidomos në të tilla pozicione, ne do ta gjejmë më vonë të përdorur me mijeshtëri te poezitë e Fan Nolit.

Me pyetjen retorike, ashtu siç ndodh shpesh në folklorin tonë, edhe Çajupi nis shumë nga poezitë e tij ose edhe i ndërpret herë pas here. Po në lidhje me pyetjen retorike, Çajupi ka edhe një përdorim, të cilin nuk e hasim te ndonjë tjetër dhe që, megjithatë, ka diçka të frymës popullore për tonin e bisedës që krijon. Ja disa shembuj, të cilët janë herë me një nuancë humori apo edhe satirike, herë tjetër jo:

**Bëre... Po ç'nukë kë bërë?
(Punërat e perëndisë)**

**Na merr gjakn' e na merr gjënë,
na merr... Po ç'nukë na merr?
(Dhjatë e vjetër)**

**Qajnë!... Po kush nukë qa?
(Sultani)**

Shihet qartë qëdheonga këta shembuj serikëtu me pyetjen retorike gërshtohet edhe përsëritja. E në fakt, Çajupi nuk mund të mos i kishte me kaq ibollëk përsëritjet në poezinë e tij, përderisa kishte marrë përmodel poezinë popullore. Ne i hasim tek ai në përsëritje të thjeshta, epanalepse:

**Bariu, shokë, bariu...
(Fyelli)**

**Duro, ibvarfëri, duro...
S'genë njerëz të mëdhenj; s'genë...
Nukë ka m'ësligë, nukë...**

*Na mori dregi, na mori...
U trete, Gjon Lekë, u trete...
Vanë mënd e mia, vanë...
(Dhjatë e vjetër)*

Bir, o bir! ç'më mori malli!

(Vaj)

*O Lulo, Lulo Malësori!...
Mos! Mos! Për kokë të Norës...*

(Balta)

Hasim dendur anaforën dhe mjaft me efekt epanastrofën:

*...mëmatë më mallëkojnë,
më mallëkojnë të vatë...*

(Sulltani)

*Cdo pun' e bëfë vëtë,
bëre yjetë dhe dhenë...*

(Punërat e përendisë)

*Gjykotë gjykkon edhe të vret,
të vret edhe s'të paguan.*

(Dhjatë e vjetër)

Po gjejmë edhe një përsëritje të tillë që, siç e kemi thënë, haset dendur në popull:
Gratë venë ndër arë, gratë venë ndër arë
ngati më parë kam lerë, ngati më parë kam lerë
prandaj u plakshë më parë...

(Plaku)

Ashtu si Naimi, edhe Çajupi përdori vërgjet e përzier, sidomos në fabulat e tij. Kjo nuk që një gjë e rastit dhe ai e thotë shkoqur në parathëniën e shqipë-

rimeve ku shkruan: «Përdora vjersha të këmbyera me vargje të trazuara, se desha të shkel ndë gjurmë të vjershëtorit që përmenda».¹⁾ Vjershëtori për të cilin bëhet fjalë është domosdo, La Fonteni, që në një parathënie të fabulave e shpjegonte kështu arsyen e përdorimit të vargjeve të përzier nga ana e tij: «Autori, dëshinë të provojë se cili karakter (vargjesh — Gj. Zh.) është më i përshtatshëm për të vënë në poezi të tregimet. Ai ka menduar se vargjet e çrrëgullt (les vers irréguliers) duke qenë se kanë një pamje që i afrohet shumë prozës, kjo mënyrë e të shkruarit do të mund të dukej më e natyrshme e, për rrjedhim, më e mira». 901

Po Çajupi nuk kopjon në mënyrë të verbër, vargjet e tij të përzier nuk janë ato të La Fontenit. Nëse në zgjedhjen e këtyre vargjeve u shty nga La Fonteni, në realizimin e tyre konkret ai shfrytëzoi me sukses përvjetorin e Naimit. Sido që të jetë puna, Çajupi edhe këtu nuk largohet nga vargjet popullore dhe, ndryshe deri-diku edhe nga vetë Naimi, preferoi më shumë përzierjen me vargjet çift, kurse të Naimit hasim hera-herës edhe vargje tek. Kjo gjë u jep vargjeve të tij të përzier një ecuri ritmike, që i afrohet në më të shumtën melodisë së këngës dhe të baladës popullore, kurse te Naimi ritmi i vargjeve të përzier është më asimetrik, më i afert përi këtë me muzikalitetin e prozës. Në realizimet më të mira të tij, në këto shqipëritë, Çajupi arrin t'u jepë vargjeve një muzikalitet, një eje ritmike tepër në përputhje me momentet e ngjarjes së treguar. Kështu p.sh. fabula: «Të dy mushkât» nis me katër tetërrrokësha, që rrjedhin qetë, ndjekës së vargun e dytë e të katërt ndodhet nga një bartje, që vlen për të shtuar ecurinë e shtruar të rrëfimit dhe, sidomos bartja e dytë sikur konkretizon ecjen e rendë, gati-gati madhështore të mushkës së ngarkuar më lira...

Dy mushka një ditë muar

udhë bashkë ndë rrëpira:

1) A. Z. Çajupi «Vepra», Tiranë 1957, f. 134.

*njerën e kishnë ngarkuar
me dy thaşë plot me lira...*

Kurse mushka tjetër, ngarkuar me bar, vjen pas me cap që tē shpejtë si një «kopile», prandaj edhe vargu ndryshon:

*...tjetra me samar,
ngarkuar me bar,
dukej si kopile;
e para me zile,
kapistra me lule,
na mbahej fodulle...*

Kështu, vargjet gjashtërrokësh ecin tē lehtë derisa mushkave u dalin përparrë hajdutët... Atëherë ritmi i gjashtërrokëshave prishet, turbullohet nga bartjet... Nga druri që ha mushka me lira:

*S'qëndron dot në këmbë
s'i mbenë dhëmballë
ndë nofull...*

Efekte tē mëdha arrihen në këto fabula nëpërmjet thyerjes së vargjeve, rimave tē brendshme etj. Shpesh mjafton lodrave rimave, befasia e tyre pér tē krijuar një atmosferë humori. Ja puna e miut te «Luani dhe miu»:

*Po miu, me dhëmbë
ep e merr
sa e nxjerr;
ryn e del,
prish një tel,
të téré dhokanë,
dhe shpëton luanë...*

Ose te këto vargje, tē cilat tē duket sikur picturojnë baritjen e lepurit frikacak, zhurmën e bretkosave, që kridhen në luje:

*Lepuri një zë mëdëgjori
 dhe vate nga vatrat, së
 dolli, iku me të katrat.
 Shkon e breth, që është
 leth, më leth, më brek,
 brek më brek,
 shtek më shtek,
 ndë të mbjella,
 ndëpër shpella,
 ndëpër zall,
 ndëpër dra,
 gjen përpata
 një moçal.*

Shqipëri i Naimit e sëmboj

Sëmboj i lidhës së Naimit

*Kagëzozat; kurrë panë
 të tëra tok ndë pellk ranë
 me rrëmbim.
 «Qenkëtë trim!»*

Thirri, ljeputi me gas...

(Ljeputi dhe kagëzoza)

Domosdo kjo është shkolla e Naimit, që çohet më tutje, prej Çajupit. Një shenjë tjetër e lidhjes me Naimin është edhe përdorimi i bartjeve. Duke i ndejnur besnik organizimit të vargut popullor, edhe Çajupi si Naimi nuk e pëndor bartjen në poezitë e tjera, por te fabulat ato janë të shumta. Një gjë të tillë ia ka kërkuar vetë tregimi i ngjarjes, vetë nevoja për t'i dhënë hera-herës rrëfimit tonin e bisedës. Në fabulat e Çajupit, ashtu si në fabulat dhe në «Historinë e Skënderbeut» të Naimit, bartjet hasen dendur dhe jo rrallë më efekte të dukshme ideoartistike, siç do të shohim t'i përdorë më vonë me mjeshteri të rrallë (Mjéda). Jandisa e bartjeve nga fabulat per Çajüpitet: ndërsa që i kthejë nga vëprave i foliqeq mëngoset një mënyrë e Njëaditë së shnë bartjet. Mëngosat e dhë gjithashtu që ndëstan, uqmet atë ditë qëllimisht

*gjithë tok hidhen e zenë
sa mündin nga bagëtitë,
dhe i shpien duke çjerrë
tek presën shokët e tjerë,
brënda ndë pyll; tek një brek.*

(Uqrët dhe dhentë)

Atë që kemi thënë për Naimin, duhet të themi këtu edhe për Çajupin në lidhje me përdorimin e ë-së, si element në funksion të vargut, që shërben për të shtuar ose pakësuar rrökjet. Le të vërejmë për shembull këto vargje:

*Qysh u duketë kjo punë?
Nuk u duket si çudi?*

(Për ata që s'pëlqejnë gjë kurrë)

*Një ditë të shtunë
një sorkadhe zunë...*

(«Lopa, dhia, delja dhe luani»)
(Instituti i Kulturës, 1973)

«Sot është, tha, e shëtunë

dylo sparrat ditë e kremte për çifunë.»

(E shtunë! E dielë)

Moj mike, të bëj porsi

vetëmë mua të duash...

(Dëshirë, XI)

Dë të ham' e do të pimë,

të dy, vetëm do të rrime...

(Zolejka)

Vërehet qartë, edhe me kaq sa u tha për Çajupin, se konceptimi popullor i poezisë nga ana e tij, përfshin edhe elementët formalë të metrikës, edhe strukturën, organizimin dhe instrumentimin e vargjeve të tij. Në

këtë mënyrë, duke u lidhur me traditën popullore nëpër rrugën e çelur prej Naimit, Çajupi diti të plazmojë shpesh me shumë sukses një formë të përshtatshme për brendinë realiste e demokratike të poezisë së tij. Nuk ka dyshim se një punë e tillë, e kryer jo vetëm me forcën e intuitës poetike, por edhe me logjikën e vetëdijes artistike, ndikoi për të mirë në lidhjen e mëtejshme të poezisë sonë përparimtare me vlerat e poezisë populllore.

АСИЛЕЯ СЕМЕЙСТВО

Die Wissenschaften sind nicht nur die Theorie des Wissens, sondern auch die Praxis des Wissens. Sie sind nicht nur die Theorie der Wissenschaften, sondern auch die Praxis der Wissenschaften. Sie sind nicht nur die Theorie der Naturwissenschaften, sondern auch die Praxis der Naturwissenschaften. Sie sind nicht nur die Theorie der Sozialwissenschaften, sondern auch die Praxis der Sozialwissenschaften. Sie sind nicht nur die Theorie der Geisteswissenschaften, sondern auch die Praxis der Geisteswissenschaften. Sie sind nicht nur die Theorie der Technik, sondern auch die Praxis der Technik. Sie sind nicht nur die Theorie der Medizin, sondern auch die Praxis der Medizin. Sie sind nicht nur die Theorie der Rechtswissenschaften, sondern auch die Praxis der Rechtswissenschaften. Sie sind nicht nur die Theorie der Politik, sondern auch die Praxis der Politik. Sie sind nicht nur die Theorie der Philosophie, sondern auch die Praxis der Philosophie. Sie sind nicht nur die Theorie der Religion, sondern auch die Praxis der Religion. Sie sind nicht nur die Theorie der Künste, sondern auch die Praxis der Künste. Sie sind nicht nur die Theorie der Sportswissenschaften, sondern auch die Praxis der Sportswissenschaften. Sie sind nicht nur die Theorie der Erziehungswissenschaften, sondern auch die Praxis der Erziehungswissenschaften. Sie sind nicht nur die Theorie der Psychologie, sondern auch die Praxis der Psychologie. Sie sind nicht nur die Theorie der Soziologie, sondern auch die Praxis der Soziologie. Sie sind nicht nur die Theorie der Anthropologie, sondern auch die Praxis der Anthropologie. Sie sind nicht nur die Theorie der Biologie, sondern auch die Praxis der Biologie. Sie sind nicht nur die Theorie der Chemie, sondern auch die Praxis der Chemie. Sie sind nicht nur die Theorie der Physik, sondern auch die Praxis der Physik. Sie sind nicht nur die Theorie der Astronomie, sondern auch die Praxis der Astronomie. Sie sind nicht nur die Theorie der Geographie, sondern auch die Praxis der Geographie. Sie sind nicht nur die Theorie der Geschichte, sondern auch die Praxis der Geschichte. Sie sind nicht nur die Theorie der Literatur, sondern auch die Praxis der Literatur. Sie sind nicht nur die Theorie der Kunst, sondern auch die Praxis der Kunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Musik, sondern auch die Praxis der Musik. Sie sind nicht nur die Theorie der Theaterkunst, sondern auch die Praxis der Theaterkunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Filmkunst, sondern auch die Praxis der Filmkunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Fotokunst, sondern auch die Praxis der Fotokunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Malerkunst, sondern auch die Praxis der Malerkunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Skulpturenkunst, sondern auch die Praxis der Skulpturenkunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Architekturkunst, sondern auch die Praxis der Architekturkunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Designkunst, sondern auch die Praxis der Designkunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Modekunst, sondern auch die Praxis der Modekunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Schmuckkunst, sondern auch die Praxis der Schmuckkunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Dekorationskunst, sondern auch die Praxis der Dekorationskunst. Sie sind nicht nur die Theorie der Raumgestaltung, sondern auch die Praxis der Raumgestaltung. Sie sind nicht nur die Theorie der Beleuchtung, sondern auch die Praxis der Beleuchtung. Sie sind nicht nur die Theorie der Farbe, sondern auch die Praxis der Farbe. Sie sind nicht nur die Theorie der Form, sondern auch die Praxis der Form. Sie sind nicht nur die Theorie der Struktur, sondern auch die Praxis der Struktur. Sie sind nicht nur die Theorie der Proportion, sondern auch die Praxis der Proportion. Sie sind nicht nur die Theorie der Rhythmus, sondern auch die Praxis der Rhythmus. Sie sind nicht nur die Theorie der Harmonie, sondern auch die Praxis der Harmonie. Sie sind nicht nur die Theorie der Kontrapunkt, sondern auch die Praxis der Kontrapunkt. Sie sind nicht nur die Theorie der Melodie, sondern auch die Praxis der Melodie. Sie sind nicht nur die Theorie der Harmonielehre, sondern auch die Praxis der Harmonielehre. Sie sind nicht nur die Theorie der Tonlehre, sondern auch die Praxis der Tonlehre. Sie sind nicht nur die Theorie der Modulation, sondern auch die Praxis der Modulation. Sie sind nicht nur die Theorie der Dynamik, sondern auch die Praxis der Dynamik. Sie sind nicht nur die Theorie der Artikulation, sondern auch die Praxis der Artikulation. Sie sind nicht nur die Theorie der Phrasierung, sondern auch die Praxis der Phrasierung. Sie sind nicht nur die Theorie der Ausdrucksweise, sondern auch die Praxis der Ausdrucksweise. Sie sind nicht nur die Theorie der Stilistik, sondern auch die Praxis der Stilistik. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetik, sondern auch die Praxis der Ästhetik. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Erfahrung, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Erfahrung. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Wirkung, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Wirkung. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Werte, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Werte. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Formen, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Formen. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Gegenstände, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Gegenstände. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Prozesse, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Prozesse. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Beziehungen, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Beziehungen. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Gestaltung, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Gestaltung. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Ästhetik, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Ästhetik. Sie sind nicht nur die Theorie der Ästhetischen Ästhetik, sondern auch die Praxis der Ästhetischen Ästhetik.

Leitende Stelle für Fortschritte ist ein Kreis aus
sechs Säulen. Der zentrale ist mit einer Kugel verziert und
darüber steht eine Kugel mit einem Kreis, der die Säulen umschließt.
Die Säulen sind von links nach rechts beschriftet mit:
1. Die Entwicklung der Erde und des Menschen.
2. Die Entwicklung der Naturwissenschaften.
3. Die Entwicklung der Technik.
4. Die Entwicklung der Politik und Recht.
5. Die Entwicklung der Kultur und Kunst.
6. Die Entwicklung der Religion und Geist.

the first time in history that the people of the United States have been compelled to pay a tax on their property to support a foreign war.

7. NDRE MJEDA

Një periudhë e lidhur më strikt pas rregullave të metrikës së shkolluar, megjithëqë ndikimi i poezisë popullore ndihet kurdoherë, ku më haptazi ku më i brendshëm, nis me Mqedën, Asdrenin, Nolin, Poradecin etj. Është një periudhë kjo, kur poetët përpinqen të pasurojnë metrikën tonë edhe me forma, vargje, strofa e ritme të marra nga letërsitë e huaja dhe të përshtatura, shpesh, më shumë mjeshtëri. Megjithatë edhe te këta poetë, siç u tha, ndihet në thellësi fryma popullore, që hetohet në brendinë e poezisë së tyre, por edhe në përdorimin e pasurisë së gjuhës së popullit, frazeologjisë, sintaksit dhe ritmeve popullore. Është pikërisht kjo frymë që i bën të afta edhe format e skemat metrike klasike të përdorura të tingëllojnë të afërtë për lexuesin tonë, që shqipja të kumbojë me kaq émbëlsi e forcë, që, për shembull, soneti, strofat safike, stancat, trioleti etj. të vishen me një muzikalitet të qartë shqiptar.

Te Ndre Mjeda ne hasim një mjeshtër të rrallë të vargut. Ai i përpunon vargjet, i instrumenton ato me mjetë të pasura, duke mos rënë thua jse kurrë në një ftohje të tyre e duke farkëtuar kështu një formë të

përshtatshme për brendinë e poezisë së tij plot drithë. I disiplinuar nga kultura që ka marrë, adhurues i klassikëve dhe duke pasur parasysh poetë, që shquhen për pasionin e tyre jo vetëm për botën e vjetër klasike, por edhe për metrin e vargjeve klasike, Mjeda u përpoq, dhe me sukses, të pasqyronte në poezinë e tij këtë kulturë. Megjithatë ai nuk ra kurrë në një ksenomani të verbër, që është kurdoherë me pasoja katastrofale për **krijimtarinë e një artisti**. Mjeda nuk i shkëputi kurre rrënjet që e lidhnin me popullin e thjeshtë, me malësorët e tij, po, përkundrazi, u përpoq kurdoherë t'i shtojë e t'i forcojë këto lidhje. Kjo shpjegon, në radhë të parë, pastërtinë dhe origjinalitetin ideoartistik të veprës së tij. Kjo duhet thënë edhe për metrikën, edhe për gjuhën artistike, edhe për tërë mjetet dhe procedurat artistike, që ai përdori me mjeshtëri në poezinë e tij të fuqishme. Kjo shpjegon përsë, edhe kur përdor vargje të marrë nga letërsia e huaj (njëmbëdhjetërokrëshin, shtatërokrëshin etj) ndihet kurdoherë fryma e truallit shqiptar, ndihet bukuria dhe forca e gjuhës shqipe, e ritmit dhe e muzikalitetit të gjuhës popullore.

Mjeda ia arrin kësaj edhe me përdorimin e disa mjetave artistike tipikisht popullore, siç janë llojet e ndryshme të përsëritjes, të cilat në poezinë e tij janë të shumta e të përdorura sipas mënyrës popullore. Gjëj-më kështu tek ai shumë anafora, shumë përsëritje të thjeshta, mjaft epanastrofe etj. Le të mjaftojnë këta shembuj:

Lamtumirë, o mori Shkodër!

Lamtumirë, o ti Cukal!

Zhduket Buena nën një kodër,

zhduket Drini nën një mal!

(I tretuni)

Del, o bijë, prej shprijës sate,
del prej t'vorfënit katund...

(Andra e jetës)

*O murlan, njat frys men ndale,
 ndal ti, o akull, mos me ngri...* (Dimni)
*Nuk di-gjak, nuk di vllazni,
 atdhe sidi atdhe zemra e dinakut...* (Bashkonju)
*U zgjue pérherë Shqipnija,
 pérherë me e té lumnioi.*
Pér një shkollë shqype (Pér një shkollë shqype)
*Ktheni ndér shpija, o djelm, sokola
 ktheni...
 krahas me ju vjen nami e vjen lumnija...* (Lissus)
 Te vargjet e Mjedës hasim një rregullsi në shpërndarjen e theksave ritmikë sipas normave të metrikës së kultivuar. Megjithatë, edhe pse artist i prirë drejt rregullit, Mjeda i ka shpëtuar monotonisë së shkaktuar nga vargjet me theksime ritmike strikte, jo vetëm duke përdorur vargje të ndryshëm, shpesh edhe në një poemë, por, c'ka më tepër rëndësi, duke u përpjekur të thyenjë monotoninë me anë të sistemit të përsëritjeve (sic mund të kuptohet lehtë edhe nga ato pak shembuj që sollëm më lart), me anë të inversioneve dhe, sidomos, të bartjeve. Në fakt mund të themi se Mjeda është mjeshtër i rrallë i bartjeve, të cilat, na thotë mendja, ai i futi i pari me kaq forcë në poezinë tonë dhe i përdori me një sens të vërtetë artistik. Bartja te Mjeda zakonisht vë në dukje një figurë a një ide, që kërkon të nënvízohet.

*E kqyrë: ndér male po pérhapet shkëndija
 e lirimt t'Atdhet; mbishehtas shetiti
 kësollë pér kësollë rreth buneve e soditi,*

*frymë t're tui shprazun për gjithkajna hija
e Skanderbegut.*

*Oh, zbrit ndër ne, mbretinore
shqipe, edhe 'j herë, si zbrite...
(Shqypes arbnore)*

*Plot me burra e trima plot
Ti 'j ditë ishe...*

(Gjuha shqipe)

*Del, mizuer, këndenaj, del, prej mërzijet
zgaq i përbuzshëm, Shqipnija, t'volli...*

(Mustafa Pasha)

*E duel me mijelce te burgu
Lokja, xuer viçin jashtë...*

(Andrra e jetës)

Té gjësh shembuj bartjesh në poezitë e Mjedës
është puna më e lehte, po le të mjaftojnë edhe këta
të paktë tek të cilët, megjithatë, duket qartë dora e
mjeshtrit. Po që këto vargje (e përgjithësisht vargjet
e Mjedës) të arrinë të kumbojnë me ritmin e përshtat-
shëm në récitim, duhet pasur patjetër mirë párasysht,
veç të tjerave, teknika e bartjes. Siç dihet, bartja është
një procédurë ritmike, e cila përfthohet nga mospërputh-
ja e njësise sintaktike me njësinë e vargut, kur fraza ose
fjalia del tej rimës duke mbaruar tek një nga fjalët
e paratë vargut pasardhës. Po të besosh (siç ndodh
herë herë me ndonjë recitues) se kjo mospërputhje nuk
është gjë tjeteri veçse një hiqje e pauzës në fund të
vargut, dhei se fraza duhet lexuar krejtësisht si një
copë proze, do të thotë të mos njohësh cilësitë e rit-
mit klasik dhe të mos njohëshi as funksionin e rendësi-
shëm të bartjes për të vënë në dükje idenë. Në fakt
bartja është një procédurë që ka një teknikë fare të
qartë e të përcaktuar: zëri në lexim ngrihet te rimia, si

kur kërkon të pérjetësojë zanoren, duke lënë kështu të kuptohet se është arritur kulmi i vargut, po mbi të gjitha duke lënë të kuptohet se ka një vazhdim dhe, me këtë pauzë të vogël, sikur kërkohet një fjalë e sortë pér të shprehur idenë. Kjo pritje, domosdo, i bën dëgjuesit kureshtarë dhe përqëndron vëmendjen e tyre. Ja përsë fjalë që vjen duhet të jetë e tillë që të bëjë përshtypje, mbasi ajo do të ngarkohet me një domethënie të madhe ideoartistike.

Te shembujt e mësipërm, në të gjitha rastet, vërejmë se Mjeda e ka shfrytëzuar në maksimum këtë funksion të bartjes dhe kështu nëse p.sh. «kësollë pér kësollë» tregon që ndjenja patriotikë ndezi zemrat e popullit të varfër e jo të bejlerëve e të bajraktarëve, te «Lokja» forca përfytyruese bëhet edhe më e madhe, aq sa të ngjan sikur sheh në hyrje të haurit figurën e gjallë të kësaj malësoreje...

Sic vihet re edhe nga shembujt e pakë që sollëm, inversioni është një procedurë tepër e preferuar nga Mjeda, aq sa e gjejmë herë-herë të gërshetuar, edhe me bartjen. Megjithatë, inversioni, ashtu si çdo mjet apo procedurë tjeter artistike, nuk kthehet kurrë te Mjeda në qëllim në vetvete. Kurdoherë ai është në funksion të një ideje, të një ndjenje, të një figure dhe pér këtë të ngjan kaq i natyrshëm, dhe në përputhje të plotë me gjuhën, tonë, ritmin, fushën e kësaj kompozitë.

Përsa u përket vargjeve të përdorur, ata janë të ndryshëm, po sidqoftë vendin, kryesor, e zë tetërrorkëshi, të cilin e gjejmë në mbi gjysmën e poezive të Mjedës. Nje fakt i tillë nuk mund të mos jetë kuptimplotë dhe të mos flasë me të madhe në të mirë të frysës kombëtare, të poezisë së këtij poeti. Mjeda përdori, sic u tha, më lart, edhe vargje tek (shtatërrorkëshin, njëmbëdhjetërrorkëshinjet), dhe me këto, e jo vetëm me këto, ai kontribuoj në pasurimin e ritmit të poezisë shqiptare, i cili sic dihet është zbritës pér vetë natyrën e trokeut; Mjeda duke përdorur vargje tek futi ritmin ngjitesh, kryesisht nëpërmjet jambit. Po ky ritëm ngjitesh hetohet

mjaft edhe te vargjet çift. Le të shërbijnë si shembuj këto vargje:

Paske, o bylbyl i shkreti...

(Vaji i bylbylit)

Lirinë e keni ju, na hekra kemi

$v - /v$ $- /v$ $- /v$ $- /v$ $- /v$

Na terr e mjegull deri n'ditt ma t'vona

(Lirija)

A zverdh fusha, e ndér grunore

v-/- v/- v/- v

Po vëlojnë korrcat porsi zoqj...

v -/- v/- v/-

de 1876, en la que se nombró a Francisco José de Vera.

Interesante janë sidomos dy tetërokëshat e fundit ku kombinohen këmbët dhe ku ritmi ngjites krijohet nga jambi i parë. Në muzikë do të thoshnim se melodja fillon me një levare.

8. ASDRENI

Asdreni paraqet në mënyrën e vet shqetësimin e poetëve të kohës për të pasuruar metrikën shqiptare me ritme e vargje të reja. Ai ka qenë në këtë vështrim një kërkues dhe shpesh me sukses.

Nga vëllimi në vëllim, prej të parit, «Reze dielli» (1904), tek i dyti, «Endrra dhe lotë» (1912), e deri tek i fundit, «Psallme murgu» (1930), vihet re një përpjekje e vazhdueshme për t'u përsosur edhe në punë të metrikës. Ai ishte i vetëdijshëm për një gjë të tillë dhe këtë e thotë shkoqur në një letër, ku shkruan veç të tjerave: «... se, nëse ka rimën apo gjasaramën, por i mungon kadenca, se n'atë kohë, tue qenë i ri edhe me mani për me vjershërue, pata vënë re se Naim Frashëri në vjershat e tij s'ka pasë metrikë, ashtu siç e don rregulli i poezisë, edhe unë, tue e marrë atë shpeshherë si pasqyrë, nuk u kujdesova për t'i ramë pas metrikës; në vëllimin e parë kjo, pastaj në të dytin «Endrra e lotë» e ndryshova sistemin, por jo të pakta ishin edhe kuvendimet që pata dendur me të ndjehunin Luigj Gurakuqi... Dihet se sot poezia ka marrë një tjetër udhë, se fatalisht nuk mund me qëndrue në formë ri-

gide të klasicizmit, i cili kishte për poezinë një kallëp; sot poezia mori një sulm dhe i këputi vargonjtë, që e mbanin të shternguar në një formë, por megjithkëtë prapëseprapë rregulli i poetikës lypset mbajtur medomes, simbas prozodisë të çdo gjuhe, që ti përshtatet sa më mirë, edhe traditës së saj.¹⁾

Nga kjo letër kuptohet para së gjithash kujdesi i vazhdueshëm artistik që ka pasur Asdreni. Nga ana tjetër, vetë vëllimet e tij me poezi sikur shpjegohen, përsa i përket anës metrike, nga fjalët e poetit në këtë letër. Duke bërë të vetat mendimet e ndonjë letrari, që i nisur nga koncepte klasikegjante nuk mund të arrinte të kuptonte prirjen popullore të Naimit edhe në punë të metrikës, Asdreni pa të drejtë shprehet në mënyrë negative për vargëzinën e Naimit. Megjithatë, atje riga fundi i letrës duket qartë se ai nuk është as me formën «rigide të klasicizmit». Të gjitha këto dëshmojnë për Shqetësimin e vazhdueshëm të Asdrenit në konceptimin metrik të poezisë së tij.

Eshtë e vërtetë se tri vëllimet e tij me poezi dallojnë në mënyrë të dukshme në vështrimin metrik njëri prej tjetrit. Vëllimi i parë, i pasigurt edhe për mungesë përvoje, mjeshterie artistike, paraqitet disi amorf metrikisht; vëllimi i dytë dëshmon për një dorë më të sigurt, për një vetëdije artistike më të formuar, më të kristalizuar; vëllimi i tretë është shprehje e një pjekurie artistike, pavarësisht shkarjeve të theksuara filozofike dhe ideomencionale që burojnë më shumë nga letrat se së ngajeta. Në këtë vëllim vargu manovrohet me shkathtesi, i matur dhe i limuar me kujdes, derisa të humbasë, ndonjëherë, ngrohtësinë e frymëzimit të parë. Duhet pohuar këtu, se për metrikën e poezisë së Asdrenit që një fatkeqësi fakti që ai nuk e kuptoi si duhet mësimin e Naimit në këtë vështrim dhë më pas u largua akoma

1) N. Jorgaqi, «Antologji e mendimit estetik shqiptar», Tirana, 1979, f. 218.

edhe më shumë prej këtij mësimi (e mbasë kjo duhet thënë jo vetëm për metrikën).

Asdreni thotë në letërën e cituar më lart, se te vëllimi i tij i parë ai kishte ndjekur modelin e dhënë prej Naimit. Ai është plotësisht i singertë në këtë po-him, po nga ana tjetër, duhet thënë se askund (ose fare pak) në këtë, vëllim duket konceptimi naimjan për vargëzimin që, siç e kemi parë, lidhej kaq ngushtë me përvojën popullore. Asdreni nuk mundi të shihet e ca më pak të vlerëson te Naimi «lirinë» e shpërndarjes së theksave ritmikë, mjetet e instrumentimit tipikisht popullore, sintaksën e frazeologjisë popullore etj. Të gjitha këto nuk flasin për mungesë rregulle të Naimit, po përrregulla të tjera, që s'kanë të bëjnë ose kanë të bëjnë fare pak me ato të metrikës së «shkolluar» të kohës. Kurse, me sa duket, Asdreni në vëllimin e tij të parë «lirinë» e shpërndarjes së theksave ritmikë e interpreton paktikisht si shkelje të masave metrike, si «arbitraritet»... Kështu shpjegohet, në një përqindje të mirë, çrrëgullimi i mjافت vargjeve të tij në këtë vëllim, fakti që në të njëjtën poezi mund të hasësh aksidentalish vargje tetë, nëntë apo dhjetërrokëshe. Dora e Asdrenit nuk është e siguri, veshi i tij lajthitet kollaj. Po në këtë mes, domosdo, s'kemi të bëjmë aspak, siç pretendon Asdreni, me një shkollë të Naimit, por e shumta e shumta me një keqinterpretim të shkollës së Naimit. Po kjo pasiguri vijet re, nga ana tjetër, edhe në mungesën e ekilibrit gjuhësor, ku dy dialektet kryesore të shqipes krijojnë ndonjëherë një hibridizim të papranueshëm si p.sh. të kjo rime:

*Shqipëri e mjerë,
prit, prit nga bijt e tu,
ky gjum 'q'i ka blerë
ndë vdekje i ka çu!*

(Dyshim)

Anë Megjithatë, edhe pse hetohet pasiguria metrike në këtë vëllim të parë, prapë ndihet edhe një nga kërke-

sat kryesore të Asdrenit në këtë lëmë: dëshira e vazhdueshme pér të përdorur një vargëzim të shkolluar që, herë me dashje herë pa dashje, priret nga format e vargjet thjesht popullore. Dhe në fakt edhe në këtë vëllim, krijimet më të mira i janë besuar tetërrokëshit, pavarësisht se nuk është ai gjenuini popullor. Bile ka ndonjë rast, si te poezia «Kthime», ku hasim strofa gjash-tëshe me vargje tetërrokëshe e monorimë që nuk mund mos të të kujtojnë popullin. Në këtë poezi çdo strofë është një frazë e vetme e përderisa është e tillë ajo lidhet me një rimë të vetme, pikërisht siç ndodh zakonisht me monorimën popullore dhe që e kemi parë të praktikuar prej Çajupit:

*Kur të pashë më s'të lashë
t'u afruash e s't'u ndashë,
dhe me zë t'ëmbël të thashë:
sa të dua, o moj vashë!*

*Edhe më gjunjë të rashë,
t'u luta gjersa u vrashë!*

(Kthime)

Hasim te Asdreni edhe një strofë tipike popullore, që u përdor me kaq sukses nga Çajupi dhe, më pas, aq shumë prej Memo Metos. Te poezian e tij «Kësollës» lexojmë:

*O kësollë që më rrite
ndë vogëli
Dhe ndë diellë që më qite
me ëmbëlsi...*

Kjo strofë duket qartë se është ajo e poezisë «Shqipëtar» të Çajupit.

Kurse te ndonjë poezi, si te «Balashi», hasim theksimin popullor duke i kthyer në fundore fjalë që pér nga natyra e tyre nuk janë të tillë. Këtë procedurë popullore ne e kemi hasur te Çajupi, siç e pamë. As-

dreni e përdor te kjo vjershë, e cila praktikisht i ka rripat të gjitha oksitone:

*Shih sa vend plot bukuri
ku del ar, ku del flori...
Si në vend të prallave
trimave dhe pallave!*
(Balashi)

Po te kjo poezi lexojmë më poshtë:

*Malit lart t'i ngjitemi —
jemi trima e s'vritemi!*

...

*Si luan' t'i hidhem
prej tij ne mos dridhem!*

Tetërokëshi i Asdrenit është përgjithësisht tepër i standartizuar pas skemave fikse. Ai preferon sidomos një tetërokësh me cezurë tepër të ndieshme në mes të vargut, aq sa të bëhet të besosh ndonjëherë se kjo simetri buron nga bashkimi i dy katërokëshave. Ja disa shembuj tipikë të vargut tetërokësh asdrenian, që të rrëmben me muzikalitetin e kadencës së tij të matur mirë:

*Fest' e këngë, // fest' e bukur
m'i lumt' dora // kujt të bëri...
(Himni i festës)*

*Vlorë, Vlorë, // zall e det
hyll prej qiellit // je pikuar...
(Vlorës)*

*Shkrihen ujrat // nën liqene
qjelli fletët // nis i hap...
(Ora e zemrës)*

Fjal' e bukur, // fjal' e shenjtë,
(Mëma)

*Tire leshtë-e // bardha nuse
merr shtëllungën // se shkon vera...*
(Nusja e mbarë)

*Hën' e verdhë, // hën' e bardhë
s'je as mollë, // s'je as dardhë,
po je tokë // pa një plagë,
plot me rrudha, // plot me plagë...*
(«Himn hënës»)

Ky pëlqim për një simetri të tillë ritmike flet për rregull, në mos për respektime skemash. Në poezinë popullore vargje, të tillë, hasen sidomos për efekt të përsëritjes të së njëjtës fjalë p.sh.:

Sheg'e amël, sheg' t butë

Në të njëjtën kohë ky mbisundim i simetrisë duhet sikur e largon mjaft tetërrrokëshin e Asdrenit prej atij popullor e kjo ndodh domosdo, jo vetëm për shkak të skemës së theksave, por, siç e thamë edhe më lart, për shkak, të një përdorimi të pamjaftueshëm nga ana e tij të instrumentimit dhe organizimit popullor.

Gjashtërrrokëshin e hasim te Asdreni më tepër të dyzuar, në formën e një dymbëdhjetërrrokëshi, Kështu e gjejmë p.sh. teopoezia «Apollonia».

*Rrëname të shenjtë // të kohës së shkuar
gë sot, kryenaltë // zbuloni një jetë...*
(Apollonia)

Asdreni përdor edhe dhjetërrrokëshin, të formuar nga dy pesërrrokësh:

*U vra Thomsoni, u vra Thomsoni...
(U vra Thomsoni)*

Ose nga një gjashtërrorkësh e një katërrorkësh:

... me shtëpi të bardha // si gjithmonë...
(Letër prej katundit tonë)

Përdor Asdreni edhe vargjet tek, sidomos njëmbëdhjetërrorkëshin, nëntërrorkëshin dhe shtatërrorkëshin. Njëmbëdhjetërrorkëshi i tij vjen e përsoset nga vëllimi në vëllim dhe është i skemave të ndryshme ritmike. Le të mjaftojnë këta shembuj:

O bij t'atdheut, o bij të Shqipërisë, (2.4.10)
shaiponja mali mveshur trimëri... (2.4.10)

(Himn kombëtar)

Nës'duam paqen, prehjen që t'ju prishim (4.6.10)
(Zëri i kryengritësve)

Kosovë, o vend i famishëm i trimnis' (2.6.10)

(Kosovës)

Mjaft na është kur këtë emër e kujtojmë... (3.6.10)

(Krujës)

C'ke ti në qajnjë foshnjat, pleq e femra (2.6.8.10)
(Deshe të këm...)

Bukur ka përdorur Asdreni edhe nëntërrorkëshin duke i dhënë, nëpërmjet organizimit sintaksor të frazës, një aromë popullore. Të tillë e gjejmë të përdorur te poezi të «Lulja e zemrës», «Lutje e vonuar», «Mall vellazerie», «Fytyrë», «Këndomë, çun» etj. Ja disa shembuj:

Këndomë, çun, gjësent të re
një këngë malli ti këndomë...
(Këndomë, çun)

Të njoh, shtëpia ime e mjerë,
të njoh nga muret ngrënë, nxirë,

*të njoh; të njoh ty; shumë mirë;
se brenda atje kam unë lerë
dhe sisë atje kam unë pirë.*

(*Shqipëria e sotme* (*Shtëpia imes*) 1999, 10/11)

Në të dyja rastet nabihet se në mienyrë të vëçantë përdorimi i përsëritjeve kontribuon për t'u dhënë këtyre vargjeve nënëtëfokësh diçka të muzikalitetit populor.

Të shumta janë edhe poezitë të shkruara prej poetit në vargun shtatërrokësh ose, në ndonjë rast, edhe me dyzimin e tij duke përfituar kështu vargun aleksandrin sic ndodh p.sh. te poezia «Excelsior!» apo «Shih si endet bota». Ja dy vargje nga poezia e parë:

*Sa herë jam menduar krejt pendën që ta thyej,
më mos e marr në dore, në llo më mos e ngjyjej...*

Duhet thënë se në një pjesë të mirë të poeziave me vargje tek, Asdreni përpinqet të rregullojë ritmin me përdorimin e apostrofave, po ky përdorim herë-herë është i tepruar, saqë pengon në një farë mënyre rrjedhën e natyrshme të bisedës poetike. Mjaftojnë këta pak shembuj për t'u bindur:

*Që keni për tan' botn' luftu gjithmon'
nër dëjës vall; gjakù ma nuk ju vlon...*

(Kosovës)

Ky 'e mijera, për tyn', o djal', o bir...

(Mall i nënës)

Por edhe vargjet çift nuk shpëtojnë lehtë nga apostrofat e shumta si: dëshmojnë edhe këta shembuj, i pari një gjashtërrokësh, i dyti tetërrokësh: *Kur do t'vijivaj' rotëkës* (Dyshim) sëmundje shkurtë.

*Atje nd' at' vend të Shqipërisë
(Atje)*

Në instrumentimin e vargjeve hasim te Asdreni përsërhitje të ndryshme, shpesh thjesht popullore, siç janë sidomos disa epanastrofe si këto:

*Nga fund' i zemrës lotonj!
Lofonj... se më nuk mundet...*

(Mentime)

*Që të duket ylli i zjarrtë.
Ylli i zjarrtë, ylli i rrallë...*

(Ylli i zjarrtë)

Por hasim edhe shumë bartje, që flasin për prirjen e poëtit për t'u dhënë vargjeve të tij një dukuri sa më të «shkolluar»... Ja disa shembuj:

*Qelli i bukur që dëfrente
trupin tonë, sot u terr...*

(Vieshta)

*I thotë Markua sa her' e gjen
ndë krua kur ujë vet' e merr...*

(Një zakon)

*Po t'e pyesësh: Pse s'flet mirë
shqip, siç i ka folur jot'ëmë...*

(Grekomaniët)

*Gjakrat rrithnin edhe mbulonin
rrugat, sikur kurrë s'kishte mbarim!*

(Një ëndërr)

Mjaftojnë edhë këta shembuj për të kuptuar natyrën e bartjeve të Asdrenit, e cila nuk i ngjan asaj të Mqedës, por më shumë asaj të Naimit e Çajupit, mbasi më tepër se funksion evidencimi ka për qëllim të prishë simetrinë ritmike dhe të japë ritmin e një

bisede gati-gati të zakonishme. Kur të tilla bartje janë pranë njëra-tjetrës, efekti i tyre për të dhënë një ritëm si, atë të prozës lështë tepër i ndieshëm siç mund të kuptohet edhe vetëm nga kjo strofë ku ka dy bartje:

*Shumë thonë se vjershat duhet të sjenë
të shkruara ashtu që të jesh ndëri gëzim,
të mos e helmojnë zemrën, të mos kënë
çaste hidhërimi që t'bi shëndë trishtim.*

(Lumtëria)

Duhet pohuar se Asdreni është kujdesur shumë që vargu i tij të rrjedhë lirshëm e kjo bie në sy të poezitë e tij më të mira e dora-dorës që ai fitonte përvojën e nevojshme në trajtimin e vargut. Për këtë ai edhe i përpunonte disa herë vjershat, siç nă dëshmojnë edhe variantet e ndryshime të disa poeziive që na kanë arritur. Nga një studim i këtyre varianteve mund të kuptosh jo vetëm kujdesin përrjedhshmérinë ritmike të vargut, por edhe përpjekjen për të vendosur fjalët e figurat qëndrore në vende të përshtatshme.

Duke mos u ndalur gjatë të pasuria e strofave të Asdrenit duam të përmendim këtu se ai përdori distikun populor p.sh. te «Letër prej katuhudit», «Cilët jemi», «Kënga e bashkimit», «Balashi» etj., pavarësisht grupimeve që u bën këtyrë distikëve në poezi ku herë i jep (në monokoloni, herë në strofa katërishe, herë në strofa gjashtëshe etj.

Te Asdreni gjejmë të përdorur edhe strofën trishe popullore, të cilën më vonë do ta gjejmë edhe te Poradeci e ndonjë tjeter.

Ja një strofë e tillë nga poezia «Lumtëria e shpirtit»:

*Lark nér vise dat kerkonj
pakë prëhje të ngjeronj;
ta gjenj gazin, ta pushtonj!*

Asdreni është i pari në letërsinë shqiptare që përdori vargun e lirë. Këtë e bën te vëllimi i tij i fundit

«Psallme murgu» në pesë poezi: «Pamje», «Juda i ri», «Dëshirë pagane», «Rruzullimi» dhe «Në udhëtim». Çështë e vërteta në dy poezitë e fundit hasim më tepër një varg të përzier se sa të lirë, kurse në tri poezitë e para kemi të bëjmë me vargje të lira, prej të cilave e para ka si konstante metrike njëmbëdhjetërrrokëshin, e trejtë nëntërrrokëshin, ndërsa e dyta ndërtohet duke i pasur si konstante metrike të dy këta vargje, d.m.th. nëntë dhe njëmbëdhjetërrrokëshin. Vargu i lirë i Asdrenit ruan ende mjaft alternime të rregullta, një shpërndarje ritmike që më tepër është e gliruar se sa e lirë, një prirje për t'u rilidhur hera-herës pas ritmit të rregullt. Megjithatë te ndonjë poezi, si p.sh. «Pamje» ai është përdorur me bukuri jo të zakonshme. Sado i vogël të ketë qenë hapi i tij në lëvrimin e vargut të lirë shqiptar, duhet pohuar se edhe në këtë përvojë metrike shfaqet edhe një herë sensibiliteti e kujdesi i Asdrenit për formën metrike të krijimtarisë së tij poetike.

Më së fundi duhet të flasim këtu për vlerësimin që i bëri Asdreni në poezitë e tij pauzës si element ritmik. Mjeshtër të pauzës u bënë më vonë në poezinë tonë poetë si Poraadeci e Migjeni, e pas tyre, edhe shumë të tjere. Megjithatë Asdreni është nga të parët që u kuidet në një farë mënyre për pauzën. Zakonisht ai e përdor pauzën në vargun e fundit të disa poezive të tij duke e evidencuar praninë e saj me tri pika (...):

*S'sheh gjë, veg hij' e tija —
Qesh nd' ujët... èndërron!*
(Bukuria)

Vështron flakën që del zjarrit:

*Lark menjtohet... loton shpesh!
(Aphdha e dimrit)*

Kot e kujtonte trupin' e saj të kjartë:

se ishin èndrra plaku... shpesh që dehet!
(Tingëllimi)

*Kish shtëpinë si një burrë:
plot me pasje dhe... fëmijë!
(Prej katundit)*

*Kështu bëjnë sot neronët
mendje shkurtër... epigonët!
(Ngjyrat)*

Pauza e Asdrenit shërben për të vënë në dukje një fjalë, një figurë që jo rrallë merr edhe ndonjë nuancë ironike. Një funksion i tillë të detyron në të lexuar jo vetëm që ta mbash ca zërin në tri pikët, pra të «lexosh» pauzën, po jo rrallë ta lexosh atë që vjen pas tyre me një timbër tjeter zëri, sipas rastit me nuancë ironie, sankazme, befazie, entuziazmi etj.

Në përgjithësi, me Asdrenin poezia jonë edhe në vështrimin e saj metrik pati një kontribut të ndjeshëm e të qartë. Mjaft poetë, që erdhën më pas, u mbështetën në përvojën e tij. Ata mësuan prej Asdrenit që të përpilen të akordojnë, të shkrijnë në veprat e tyre kërkесat e metrikës popullore me ato të shkolluara. Asdreni në mjaft poezi të tij dha shembuj të bukur në këtë vështrim. Të tjerë e quan dhe po e cojnë më tej këtë mësim.

9. FAN NOLI

Fan Noli është një poet, i cili paraqet interes të veçantë edhe përsa i përket trajtimit struktural e ritmik të vargut. Me Fan Nolin poezia shqiptare hasi në një poet, që e bëri vargun të buçasë me ritme marciale. Këtë efekt kumbues, poeti e arrin me një seri procedurash, duke u nisur që nga zgjedhja e fjalëve (të cilat duhet të jenë prej natyrës kumbuese, plot zanore dhe bashkëtingëllore tingëlluese) e duke vazhduar me pëlqimin për fjalët oksitone, për ritmin ngjitës, për rimat e pasura të llojeve të ndryshme, shpesh e më shpesh edhe për rimat e brendshme, për aliteracionin e bollshëm, kontrastet etj. Tek ai, veç kësaj, nën ndikimin e gjuhëve që dinte (e kryesisht të anglishtes) vihet re një prirje për të përshtatur edhe vargje nga letërsia e huaj. Megjithatë, duhet të jeshë shumë i kujdeshshëm për të kuptuar se kjo apo ajo strukturë vargu është përshtatur nga vargje të huaj, sepse talenti i Fan Nolit, sensibiliteti i tij prej poeti thellësisht kombëtar, ka ditur ta veshë kaq bukur me rrobën **shqiptare**, ta **shqiptarizojë** kaq **me mjeshtëri**, saqë vargu i ri ka fituar plotë-

sisht muzikalitetin e gjuhës sonë duke iu përshtatur asaj
deri në hollësitë më të vogla.

Vargu i preferuar i Nolit është kurdoherë tetërrokëshi, i ndarë rregullisht në dy hemistikë, mundësish me një jamb fillestar që i jep tonin ngjitës ritmit të vargut dhe me theksa ritmikë, që nuk lëvizin ose lëvizin shumë rrallë nga një varg te tjetri, pra duke ruajtur me kënmëngulje skemat 3.7 ose, më mirë 3.5.7. Ja disa shembuj:

*Nëno, moj, mbaj zi për vllanë,
me tre plumbë na i ranë...*

(Syrgjyn vdekur)

*Kur tufani e çthuri fenë,
kur tirani e krrusi atdhenë...*

*Atje nisi, atje mbaroi,
atje krisi, atje pushoi...*

(Shpell' e Dragobisë)

Dy vargjet e parë mund të jepen me këtë skemë:

v-/-v/-v/-v - v- v- v- v

Dy vargjet e dytë:

v-/-v/-v/-v

Ndërsa dy vargjet e fundit:

v-/-v/-v/-v

Te vargjet dhjetërrokësh, zakonisht, hasim bashkimin e dy vargjeve pesërrokësh, ose më mirë dy vargje adonikë (-vv/-v). P.sh.:

Ngjitet përpjetë // Malit të shkretë
-v v/ -v // -v v/ -v

(Moisiu në mal)

Kurse amfibraku ndihet fare shkoqur te vargjet e poezisë «Thomsoni dhe kuçedra»:

Te Ura, te Ura

v -v/ v-v

Vraponi, o burra,

v -v/ v-v

Me armë, me topa, me kordh' e me shpata...

v -v/ v-v/v-v/v-v

Me këtë sistem është ndërtuar edhe vargu anapestik, të cilin ai e ka përdorur në tri poezi. Tetrapodi anapestik është shumë i përhapur në letërsinë angleze, po Fan Noli ka ditur t'i japë dukuri të kulluar shqiptare:

Allalla, o rrezil e katil, allalla...

vv-/v v-/v v-/vv-

Nuk është e rastit (dhe kuptohet lehtë përse) që Fan Noli, i cili ka përdorur kaq dendur jambin dhe anapestin dhe ka pasur një pëlgim të dukshëm përritmin ngjitet, të ketë përdorur shumë fjalët oksitone. Kështu, ta zëmë, vetëm te strofa e parë e «Marshit të Barabajt» ndër 23 fjalë, 14 janë oksitone; ose, te strofa e fundit te «Shpell’ e Dragobisë» ndër 13 fjalë, gjysmat janë oksitone.

Rëndesi i ka dhënë Noli aliteracionit për të forcuar muzikalitetin e vargut dhe për ta bërë më të aftë në shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave të tij të fuqishme. Është punë fort e lehtë të gjenden aliteracione në poezitë e tij e nga më të bukurat e tërë poezisë shqiptare. Ato janë ndërtuar zakonisht me bashkëtingëllore të fuqishme, që gati-gati shkrepëtijnë kur bashkohen me njëratjetrën (janë dentale, pëlcistëse etj. si p.sh.: t, d, r, rr, ç, xh, etj.), por edhe aliteracionet me, zanore janë të shpeshta e ndër to vendin e parë e zë zanorja *a*, e cila bashkë me zanoren e është më e preferuara prej Nolit.

mbasi tingulli i saj i hapur i përshtatet bukur hovit të poeziës së tij. Ja disa shembuj aliteracionesh:

Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe...
(Marshi i Barabajt)

*Dif dragoj i Dragobisë,
trim tribun i vegjëlisë...*
(Shpell' e Dragobisë)

Jo rrallë aliteracioni kombinohet me rimën apo rimën apofonike¹⁾ në një lodër të vërtetë poetike plot efekt. Në raste të tilla apofonia përfaqëson varietetin kurse aliteracioni *unitetin*:

*Se ç'përmbyshesh, kamçikohesh,
rrihesh, ngrihesh, çdehesh, zgjohesh...*
(Kirenari)

Përsa i përket rimës, Fan Noli përdorimë e mirëfilltë duke iu shmangur asonancës dhe konsonancës. Rima e tij është, pra, e qartë dhe e llojeve të ndryshme, po nuk gabojmë të themi se (duke përjashtuar në disa raste mbasë Varibobën) është poeti shqiptar që ka përdorur më shumë dhe në mënyrë më funksionale rimën e brendshme, që tek ai paraqitet tepër interesante qoftë për muzikalitetin që krijon, qoftë për forcën evidencuese të saj. Ja disa shembuj të paktë nga moria e shembujve të shumtë që mund të sille-shin këtu:

*Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,
zemër-krund-e-gërdhu: Hosana, baraba!*
(Marshi i Barabajt)

Te strofa që vjen më poshtë kumbon rima në -anë:

1) Rimë apofonike quhet konsonanca (p.sh. dera-dora)

Nëno moj, mbaj zi për vllanë,
me tre plumbë na i ranë,
na e vran' e na e shanë,
na i thanë tradhëtor.

(Sýrgjyn vdekur)

Kurse te «Shpell’ e Dragobisë», me përjashtim të strofës së katërt, të gjitha strofat i kanë dy vargjet e parë me rima të brendshme, që japid një melodi plot harmoni marciale me evidencimin simetrik të hemistikëve:

Kur tufani e çthuri fenë,
kur tirani e krrusi atdhenë...

Atje nisi, atje mbaroi,
atje krishi, atje pushoi...

Vendi dridhej, ai mbeti
se s’troндitej nga tërmeti...

O Bajram, bajrak i gjallë
more nam me gjak në ballë...

As je vrar’ e as po vritesh
legjendar Ante po rritesh...

(Shpell’ e Dragobisë)

Rima që pëlgjen Noli është ajo e puthura, e cila priret për monorimë:

Nëno, moj, ma qaj në Vlorë,
ku të dha liri, kurorë,
shpirt i bardhë si dëborë,
ti s’i dhe as varr për hor.

(Sýrgjyn vdekur)

Një mexhlis të madh na çeli
Pandeli Janë Vangjeli
me sultani – llokum na veli
sì kofini pas të vjeli.

(Kënga e Salep Sulltanit)

Sofokliu ishte budalla,
kur u mplak, edhe Kupidi e la,
tha: «Shpëtova nga një maskara!»
Goja, pra, iu tha.
(Sofokliu)

Ka raste kur rima është përdorur për të ndihmuar në vënien në pah të kontrastit, siç mund të hetohet lehtë edhe të ndonjë shembull që kemi prurë më lart, po kjo bie në sy sidomos te dy poezi të njoitura. Kështu nuk ka se si mos të të bëjë përshtypje fakti që poezitë «Marshi i Barabajt» dhe «Marshi i Krishtit», të cilat kontrastojnë midis tyre në ide, kanë thuajse të njëjtat rima:

«Marshi i Barabajt»

Strofa I

- allala
- turfanda
- batëрма
- Baraba

- atdhe
- çdo fe
- na dhe
- Baraba

Strofa II

- bari
- na pi
- bën fli
- Baraba

«Marshi i Krishtit»

- hosana
- hurma
- zurna
- hosana

- atdhe
- kryefe
- na dhe
- hosana

Strofa III

- Bari
- verri
- bëhesh fli
- hosana

Strofa IV

- *u mallkofsh*
- *u harbofsh*
- *u shurdhofsh*
- *Baraba*

- *u bekofsh*
- *mbretërofsh*
- *u kändofsh*
- *hosana*

Strofa V

- *për hu*
- *mi gju*
- *pa tru*
- *Baraba*

- *Jesu*
- *mi gju*
- *tëhu*
- *hosana*

Mjeshtëria në organizimin dhe instrumentimin e vargut nga ana e Fan Nolit, zbulohet edhe në përkthimet e tij të shumtë. Do të meritonte një studim më vete puna e bërë prej tij në transmetimin e muzikalitetit të pasur të Shekspirit, që di të marrë një harmoni të rrallë ndër monologë dhe një ritëm të përshtatshëm për tonin e dialogëve nga më të ndryshëm; do të ishte interesante të shikohej puna e tij e hollë prej mjeshtri të vargut në rikrijimin me rrobe shqiptare të rubaireve të O. Kahjamit apo në përkthimin e një kryevepre si «Korbi» të E. A. Poes etj. Këto vëzhgime do të hidhnin dritë edhe një herë në konceptimin që kishte Noli për vargun dhe për vlerën e vargëzimit në përgjithësi. Nuk gabojmë nëse themi se për atë kishte rëndësi të madhe vlera muzikore e gjuhës, vlera muzikore e cdo tingulli, pasuria harmonike e të folurit të artikuluar e përtërë këto vlera muzikore ai mendonte se duheshin gjetur format e mënyrat më të përshtatshme për t'i vënë në dukje.

10. LASGUSH PORADECI

Lasgush Poradeci, si F. Noli, e ndien me sensibilitetin e tij të hollë prej poeti muzikalitetin e fjalës e të tingullit të artikuluar. Nga ana tjetër, mbasë më tepër se te Noli, te Poradeci shohim të qartë përpjekjen pér të kombinuar normat e poeziës së kultivuar më ato të poeziës popullore. Një konceptim i tillë ka të bëjë, në radhë të parë, me esencën, brendinë ideoartistike të poeziës, po kuptohet lehtë se në të implikohet edhe forma, pra edhe vargëzimi. Poradeci dëshmon me krijimtarinë e tij se është një njoħes i hollë i artit popullor, i frymës dhe mjeshtërisë së poeziës popullore, ashtu siç dëshmon, në të njëjtën kohë, se është një njoħes jo i zakonshém i pasurisë metrike të poeziës së shkruar shqiptare dhe të huaj. Ai përpiqet t'i shkrijë këto dy rrugë, që, ndonëse nuk janë në kundërshtim, kanë se cilë specifikën, dhe kërkesat e veta; ai përpiqet t'i ekuilibrojë pér të dhënë diçka që të përfaqësojë edhe këtë edhe atë, domosdø këtu duke pasur kurdoherë parasysh vargëzimin. Është pikërisht kjo që të krijon përshtypjen, duke lexuar pjesën më të mirë e më të shëndoshë të poeziave të Poradecit, se ajo edhe është

popullore edhe është rrëptësisht e shkolluar, sikur karakteristikat e vargëzimit popullor janë inkuadruar në për ligjet e rregullat e kataloguara të metrikës të poezisë së shkolluar.

Poradeci niset nga folklori dhe tradita e poezisë së kultivuar shqiptare. Mësues i tij është sidomos Naimi, por ndihet — së paku në organizimin e vargut — se për atë ka pasur një vlerë të madhe përvoja e Asdrenit, sidomos kur ajo flet për nevojën e një përtëritjeje të vargëzimit, për ta lidhur më mirë poezinë me zhvillimin shoqëror edhe në aspektin formal, për nevojën që të ndihet kultura edhe në këtë vështrim. Megjithatë, Poradeci, poet me talent e sensibilitet të rrallë, diti të jetë më i ekuilibruar, më i matur, më i natyrshëm, më i ngrohtë muzikalishët e ritmikisht në krijimet e tij më të mira. Tek ai nuk të krijohet kurrrë përshtypja se është një qytetar që kërkon të hiqet si fshatar, siç mund të na ndodhë hera-herës me ndonjë poet tjetër të së kaluarës; te Poradeci fryma popullore, folklori, në poezitë e tij më të goditura, ruan tërë mushtin e poezisë, na vjen me tërë ngrohtësinë dhe sinqeritetin e frymëzimit popullor.

Të Poradeci hasim edhe ndikimin e prozodisë gjermane, rrjedhim i studimeve të tij. Siç dihet vargëzimi gjerman është i tipit ritmik (silabo-tonik). Mbësë këtu Poradeci gjeti pikën e bashkimit midis vargëzimit të folklorit tonë dhe atij të shkolluar. Folklori ynë, i lidhur ngushtë me muzikën, ka një strukturë të theksuar ritmike (silabo-tonike). Me këlimin e kohës kjo strukturë është duke evoluar dhe krahas sistemit të parë ritmik ne hasim sot në të edhe në sistemin silabik. Vetë evoluimi i melodisë, çirimi i saj nga shumë detyrime, liria që marrin sot këngëtarët popullorë në thurjen e këngëve dhe interpretimin e tyre, ndikimi, nga ana tjetër, në folklor i poezisë së shkruar, bënë të mundur që ca nga ca të forcohen disa tipare të sistemit silabik. Ky është një proces në zhvillim e sipër ende sot. Sidoqoftë për Poradecin folklori zbaton parimet e sistemit silabo-tonik dhe është pikërisht nëpërmjet kësaj që ai arrin ta inku-

adrojë në mjaf poezi të tij në përshtatje me kërkesat e poezisë së shkruar.

Te Poradeci hasim shumë vargje popullore, si tetërrokëshin, gjashtërrokëshin etj. Po, p.sh. te tetërrokëshat e tij ruhet përgjithësisht skema 3.7:

*Haj të mirremi për dore,
nepma zemrën që ma more,
gjarpërushë pikëlore.*

(Gjarpërushja)

*Kur e kur, mes arratisë,
vjen më merr një mall i lehtë...*

(Vogëlushja)

Vargje të tillë janë ndërtuar me këmbë trokaike (-v). Megjithatë, ka ndonjë rast që kjo skemë prishet, si te vargjet:

Leshërat e tu, moj çupë...

(Vogëlushja)

*Fjalëzë me ëmbëlsi,
fjalëzë me dhëmbshuri...*

(Po qan vasha në shtëpi)

Venitu, vashë, venitu...

(Baladë)

Këto vargje nuk mund të theksohen në rrökjen e tretë mbasi, kuptohet, do të kishim përdhunimin e theksave tonikë. Sidomos në rastin e fundit, trokaizmi është prishur nga këmba e parë jambike. Po siç vihet re lehtë, vargje të tillë janë tepër popullore përsa i përket konstruktit të tyre sintaksor e ritmik.

Duke përdorur këmbë të ndryshme e, në mënyrë të veçantë jambin dhe amfibrakun, Poradeci i dha ritmit të shumë poezive të tij një karakter ngjitet.

Jambin e gjemjë të përdorur te shumë vjersha, si-

domos katërkëmbëshin jambik ose, ndryshe, nëntërrorëkëshin. Ja disa shembuj:

*Të ritë e viteve të mi
ma fryri fati zall më zall...*

(Të ritë e viteve të mi)

*Mi zall të pyllit vjeshtarak
dremit liqeni pa kufi...*

(Dremit liqeni)

*Si shpirti i zi në kraharuar,
u mbyll liqeni nënë male...*

(Mëngjes)

*E mora shoqezën përkrah
e matmë rrugën ca nga ca...*

(E mora shoqezën përkrah)

Në të gjitha këto vargje zbatohet rreptas skema e katërkëmbëshit jambik (v-/v-/v-/v-) dhe vetëm rrallë hasim ndonjë varg me një rrokje atone më tepër, siç janë i pesti dhe i gjashti në shembujt që kemi prurë.

Hasim edhe nëntërrorëkësh të formuar nga peonë të përzier me amfibrakë, daktilë, jambe a troke. Mjafton t'i krahasosh midis tyre këto vargje pér të zbuluar ndryshimin. Kështu p.sh.:

*Ku pshëretin dëshirë e djegur,
në shesh të kuq të Qerbelasë,
mes trimësish stërgjyshërishte
të shoh ndaj po m'i bje xhurasë...*

(Naimit)

Me mjeshteri të rrallë është përdorur amfibraku sidomos në poezi, brendia e të cilave kërkonte një ritëm, ta themi kështu, lëkundës, gati-gati pér të imituar lëvizjen e valëve të detit etj. Në të tilla poezi poeti kujdeset në mënyrë intuitive që të shtjerë në punë sa më shumë

fjalë amfibrake. Zakonisht ai përdor trikëmbëshin am-fibrak (v-v/v-v/v-v) që në ndonjë rast mund të jetë edhe katalektik¹⁾:

Vështroni si shket sipër vlash V-V/V-V/V-V
e tundet anija më nge.
Me krismë e me prush prej stërkalash V-V V-V
mi të shkrepëtin një rrufe!

• • •

Prej zallit që sot po largohem,
fillova mërgimin e ri;
hepohem... anohem... humbohem...
po sulmin s'e ndal kurrsesi

(Gjëmim i anijes)

Poradeci ka përdorur edhe vargun naimjan, po duke e përshtatur me kënkesat e tij, sidomos për t'i dhënë një ritëm ngjitës. Ndërsa te Naimi gjashtëmbëdhjetërrrokëshi është i formuar nga dy tetërrrokësha me një cezurë të dukshme në mes, me theksa ritmikë, që lëvizin, po, sidoqoftë, duke ruajtur jehonën e trokeut, te Poradeci ky varg është më shumë një katërkëmbësh me peonë (vv-v). Ritmet e ndryshëm që përfshohen nga të dy procedurat kapen lehtë me vesh. Le të krahasojmë të dy vargjet:

Te Naimi:

O malet e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë,
fushat e gjëra me lule që u kam ndër mend dit'
e natë...

Te Poradeci:

Fluturoi dhe shtërg' i fundit, madhështor, me
shpirt të gjorë
duke shkuar që me natë sipër malesh me dëborë...

1) Katalektik quhet një varg, të cilil i mungon rrökja fundore.

Po' kjo ndodh edhe te poezitë «Ti po vjen që prej së largu», «Poradeci» etj.

Këto mënyra në trajtimin e vargjeve, të përdorura me mjeshtëri e me kujdesin e vazhdueshëm që të mos cënojnë aspak natyrën e shqipes dhe fryshtën popullore, kanë pasur shumë sukses në dorë të Poradecit. Vargje të tillë, të instrumentuar edhe me mjete të tjera tipikë popullore, siç janë llojet e përsëritjeve, ruajnë kurdoherë një aromë të qartë të këngës popullore. Kjo shpjegon edhe suksesin që kanë pasur vargje të tillë edhe në vepra të poetëve pasardhës. Për të mos përmendur të tjerë, mjafton të thëmi se p.sh. te vargjet e Silit dhe Kadaresë haset dendur amfibraku, jambi etj., që në ndonjë rast duket sheshit se ndodh si rrjedhim i ndikimit të poeziës së Poradecit.

Te Poradeci, siç e vëmë re, hasim praninë njëkohësisht të dy sistemeve të vargëzimit — të atij ritmik dhe të atij silabik. Kjo nuk cënon aspak unitetin e konceptimit të tij metrik.

Jo vetëm te një poet, por edhe në krejt një periudhë të letërsisë së një vendi, siç ndodh faktikisht me letërsinë tonë sot, mund të bashkëveprojnë sisteme të ndryshme metrike. Domosdo midis këtyre sistemeve njëri mbisundon (tek ne sot sistemi silabik), po prania e sistemeve të tjerë është e ndijshme. Te Poradeci hetohet prania e të dy sistemeve me një epërsi të lehtë të sistemit ritmik. Që është e vërtetë kjo, pohohet jo vetëm nga ato që thamë, por edhe nga ndonjë rast, kur për të, qenë në ujdi me kërkесat e sistemit, të njëjtën fjalë poeti na bën, që ta theksojmë në dy mënyra, domosdo, kur nuk prishet natyra e gjuhës meqë janë fjalë, që dëgjohen në dy mënyra të ndryshme, si flámur e flamûr etj. Kështu gjejmë te Poradeci fjalën *pluhur*, të cilën poeti zakonisht e thekson në rrökjen e fundit siç del edhe nga këto vargje:

*Sot çela përrlëmbën e dorës
q'u çika gazmore dikur —*

*si pah verbimtar prej dëborës
sërish po më ndrin një pluhûr...
(Erë trëndelinë)*

Ose te një varg tjetër i së njëjtës poezi, që është shkruar siç shihet si amfibrak:

...pluhûrin që ndrin posa prush...

Kurse te poezia «Lundra dhe flamuri» të njëjtën fjälë e gjejmë të theksuar ndryshe, pér t'iu bindur tri-këmbëshít jambik. Poeti, pér të na têrhequr vëmendjen në këtë fakt, shkruan edhe shenjën e theksit, gjë që s'e bën në rastin tjetër:

*...e s'duket gjë kur humb
veç pluhûrës si shkrumb...*

Siç shihet fjala *pluhûr*, që nga poeti shqiptohet si jambik, mund të marrë formën e një amfibraku *pluhûrin*, ose atë të një daktili *pluhûrës*.

Përsa i përket grupimit të vargjeve, Poradeci ndjek së afërmni poezinë popullore. Atij i pëlqejnë së tepërmë distikët, strofat trishe me rimë të puthur, vargjet monokolonë me monorimë, etj. Në distikë të frymës popullore e tepër, elegantë janë shkruar disa nga lirikat më të holla të tij si: «Kroi i fshatit tonë», «Baladë», «Vate prilli», «Kush po shkon ashtu», «Del ne porta» etj.

*Del ne porta nga mulliri
vashë leshërafloriri.*

*Dëgjo bota se ç'po thonë,
vasha po na prish zakonë.
(Del ne porta)*

Kurse strofa trishe si këto kanë lëvizjen e valles nëpërmjet përsëritjes së rimave të puthura:

*E mora shoqezën përkrah,
e matmë rrugën ca nga ca,*

*sikur na ndillte larg diçka.
Pa zuri dita perëndoi,
pa zuri nata na mbuloi,
pa zura shoqen ta pushtoj.*

Me strofra të tilla janë shkruar: «E mora shoqezën pérkrah» (nga janë nxjerrë strofat e mësipërme), «Gjarpérushja», «Lundra dhe flamuri», «Vdekja e nositit» etj.

Kurse grupimi i vargjeve në monokolonë e me monorimë haset në mjaft poezi, që bartin kështu një frymë të dukshme popullore. E gjejmë te «Ç'u mbush mali», «Po qan vasha në shtëpi» etj. Te kjo e fundit të terti-heq vëmendjen fakti se të njëzet e dy vargjet e poezisë kanë vetëm një rimë (-i). Kjo është një procedurë tipikisht popullore, që mbahet veç të tjerave si një farë bravure prej poetëve popullorë. Në letërsinë e shkruar e hasim për herë të parë të poezia satirike e Çajupit «O bobo e ububu». Po te Poradeci rima me -i ndihmon shumë në dhëni e hidhërimit të vajzës që qan. Sido-qoftë, Poradeci ka zakonisht prirjen popullore që monorimën ta shtrijë në vargje, që në një farë mënyre bëjnë pjesë në një frazë ose vërtiten rrëth një ideje kryesore. Kështu p.sh. te poezia «Ç'u mbush mali», nëntë vargjet e parë lidhen midis tyre nëpërmjet rimës -orë, kurse shtatë vargjet e tjerë lidhen me rimat dhe asonancat -ardhë, -alë, e kështu me radhë.

Një strofë trishe e marrë nga këngët popullore është ajo, që poeti përdor te poezia «Ku m'u rrite vogëloshe», në të cilën dy vargjet e fundit përbëjnë refrenin thuajse përherë të njëjtë:

*Ku m'u rrite vogëloshe,
vogëlo si flutura,
mes-hollë-këputura.*

*Të pashë më zbulu kuroshe,
bukuro si flutura,
mes-hollë-këputura.*

Domosdo, te Poradeci hasim edhe strofa të llojeve të ndryshme, për të cilat është e tepërt të zgjatemi këtu, mbasi në përgjithësi nuk largohen shumë nga ato të zakonshmet ose nuk shquajnë për diçka origjinale. Me gjithatë nuk mund të mos flitet këtu për ndonjë formë strofike të huaj, qoftë edhe mesjetare, siç është trioleti dhe, së cilës ai ka ditur t'i japë një rrobë të përshtatshme shqiptare e, do të thoshja, popullore, mbasi vëtë trioleti me përsëritjen e vargjeve është i prirë për t'u përshtatur me muzikalitetin e poezisë popullore, ku siç dihet, hasen mjafit lloje strophash të përfshuar nga përsëritje apo repriza të ndryshme vargjesh.

Te Poradeci hasim të parin rast të thyerjes së vargut në letërsinë tonë. Kjo ndodh te poezia «Poradeci», në strofen e fundit:

*Tërë fisi, tërëjeta, ra... u dergji... e zuri gjumi...
Zotëroi në katër anë errësira...*

Po tashi:

*duke nisur udhëtimin nëpërmes në Shqipëri,
Drini plak e i përmallshëm po mburon prej
Shëndaumit.*

Kjo thyerje, siç kuptohet lehtë, është bërë me një efekt të dukshëm artistik, plotësisht në përshtatje me kriteret që ndiqen edhe sot prej poetëve në të tilla raste e për të cilat do të fasin më tutje. Sidoqoftë, ky mbetet te Poradeci një rast i veçuar, të cilin ai nuk e përgjithësoi në praktikën e tij, ndaj edhe nuk mund të mendohet se ka ndikuar në këtë vështrim te poetët pasardhës.

Te Poradeci hasim edhe përdorimin në ndonjë rast të pauzës me funksion artistik ashtu siç do ta gjejmë më pas te Migjeni etj. Rrokjet që mungojnë (zakonisht dy) dhe që formojnë pauzën, Poradeci i zëvendëson me tri pikë (...), siç ndodh në këto vargje katërkëmbësh jambikë:

*Që larg po vij... që larg,
më turren valët varg e varg...
(Lundra dhe flamuri)*

*Me zjarr ju flas... me zjarr,
në gjirin tim kam hapur varr...*

(Vdekja e nositit)

Siç kuptohet lehtë, në vargjet e para të këtyre shembujeve mungon një këmbë jambike, pra dy rrokje, për këtë arsyё edhe gjatë leximit, në mënyrë që të ruhet ritimi, duhet «lexuar» dhe pauza, d.m.th. duhet heshetur për aq sa vlen koha e dy rrokjeve.

Herë tjetër pauza nuk zëvendëson asnjë rrokje, por është një sasi kohe, që i shtohet ritmit të vargut, vendoset midis rrokjeve për të zgjatur më tepër cezurat. Poeti duket sikur kujdeset për recitimin e vjershës dhe, ashtu si një kompozitor, vë edhe shenjat e duhura për çdo vlerë dhe nuancë interpretimi. Edhe këtë radhë pauza vetë shënohet me tri pika (...), që ndajnë fjalët e vëçaura prej pauzës. Në të tilla raste një poet i ri do ta thyente vargun. Kështu p.sh. te strofa e fundit e poeziisë «Poradeci», në dy vargjet e parë ka katër pauza:

*Tërë fisi, tërëjeta, ra... u dergj... e zuri gjumi...
Zotëroi në katër anë errësira...*

Po tashi...

Duket sheshit se në pauzën e fundit, që duhet të jetë edhe më e gjata, poetit nuk i kanë mjaftuar tri pikat, prandaj, përvëç atyre, ai edhe e ka thyer vargun.

Ja dhe disa shembuj të tjera:

*...ja dredh e përvëluar... ja zjen... e ja heq zvarrë...
pastaj fillon të ngrihesh e nis e ja thërret:
dhe aq lehtë e ngreh së poshti... aq fort e shpjë
përpjetë...*

*aq duke mërmëruar me zë të përpëlitur
rënkim i zemrës sate tonitet më të ngjitur...
sa... që nga lartësia ku vate fluturoj...*

(Kënga pleqërishte)

*...fillova mërgimin e ri;
hepohem... anohem... humbohem...*

(Gjëmimi i anijes)

Edhe në të gjithë këta shembuj të fundit, mund të ishte përdorur thyerja e vargut sipas mënyrës së Majakovskit, aq më tepër që në vargun e fundit kumbon edhe rima e brendshme.

Rima është përdorur më kujdes dhe sens të hollë artistik. Poradeci thuajse nuk ë njeh fare bartjen, ashtu si poezia popullore, për këtë rima në fund të vargut shërben tek ai për të mbyllur vargun, për të mbyllur frazën apo ndarë pjesët e një fraze. Dhe ashtu si poezia popullore, Poradeci përpinqet për rimë të mirëfilltë, prandaj tek ai gjejmë pak asonanca dhe asnjë konsonancë.

Përsa i përket cilësisë së rimave të përdorura, duhet thënë se ai pëlqen rimat parafundore, me tinguj zanore e bashkëtingëllore që nuk zhurmojnë tepër, porrjedhin qetë-qetë. Rimat e tij të preferuara janë prate tipit: dëborë-pamporë-dasmorë, zbardhë-na ardhë-gunëbardhë; retë-fletë-jetë; të kotë-botë; flakë-pakë etj. Mbisundojnë zanoret e hapura *a*, *o*, *e*, ka fare pak rima me *y*. Megjithatë Poradeci përdor mjafit rimën fundore, po në më të shumtën pëlqen që kjo të mos mbarojë me një zanore e tingulli i fortë i zanores të mëvishet, të topitet disi nga një bashkëtingëllore që e ndjek pas. Kështu hasim rima fundore të tilla: tem-ujem; vish-pleqërish; mal-dalngadal; vdes-përmes; det-vet; mall-zall etj. Karakteristikë është se, pikërisht i shtyrë nga një prirje e tillë, në poezinë «Poradeci» e ndien se fjala *kufi* do të kumbonte tepër e ashpër si rimë fundore, për këtë e shkruan *kufir...* *R*-ja që shtohet në fund me mjeshteri dhe që është pjesë e trajtës së shquar, duket sikur e bën këtë fjale të zbutet dhe të aftë për të dhënë edhe në mënyrë figurative ndjenjën e pafundësisë së horizontit...

*Perëndimi i) vagëlluar mi ligjenin pa kufir...
Nëtuke zëritur që kësia qjelli përmbi fshat po bëhet fir...*

Në ndonjë poezi tjetër, domosdo, mund të mos

ndihet nevoja për një artific të tillë artistik dhe atëherë kemi:

*Mi zall të pyllit vjeshtarak
dremi liqeni pa kufi,
ai ndaj fundesh u përfshak
posi me zjarr e me flori...*

(Dremi liqeni)

Me mjeshtëri përdor Poradeci rimat e brendshme duke ndjekur edhe këtu procedurat që hasen në poezitë popullore.

Te këto vargje rimat dhe rimat e brendshme në -u sikur japin një harmoni imitative të vajit:

*C'më le korben si kërcu!
Ku më fluturove, ku?
Bubu, shtatë vjet pa parë!*

(Malli i vjershëtorit)

Kurse te kjo strofë, rimat sikur endin një ind me fille mëndafshi:

*Dhe të shoh të pasqyruar
vetëveten fije-fije,
fije-fije poeziqe,
që mban erë Shqipërije.*

(Trashëgimi)

Në shembullin e mëposhtëm rima e brendshme është në fillim të vargjeve:

*...me flamur të kuq në dorë,
si dhëndurë me kurorë...*

(C'u mbush mali)

Te ky shembull tjetër rimat enden vargjeve dhe lulëzojnë brenda tyre plot harmoni dhe efekte artistike:

*...e rrjedh për tatëpjetë prej kulmit qieluar
si breshër i thërrmuar... si lot i përvëluar...
pastaj të shuhet zëri... e rrëhesh... edhe vdes,
mjerimi i vetvetes të theu me për mes,
së thelli e pa mëshirë të theu dhembja jote
dëshirë e varfëruar e këngës magjiplotë!*

(Kënga pleqërishte)

Ose ky shembull plot kumbime dhe efekte, ku rima kombinohet dhe me aliteracionin në tingujt r dhe s:

*E njaty, që prapa krastës
unë rri dhe pres si rrasë;
pres që krismë e trimëruar
të buçasë e të godasë*

(Gjahtari)

Shembuj rimash të tjera të brendshme, të cilat tē bëjnë përshtypje përfunksionin e tyre, janë edhe këto që rimojnë dy hemistikë:

*Flamuri u ngrit në çdo katund,
atdheu u ndrit!*

(E fundit mërzitje)

*E ylli, ditës perëndon
në qetësi dhe dashuri*

(Dremit ligjeni)

*Edhe balt' e ndotur,
edhe llum' i ndyrë,
i patnë përlotur
me ngjyrë e mynxyrë*

(Maja e çelun)

Nënë drizës iku pikë e vapës iku

(Korrik)

Përse buçet ligjeni i qet!

(E mora shoqezën përkrah)

E pasur është poezia e Poradecit edhe me përsëriten, e cila ndjek thuajse kurdoherë modelet që hasim në popull. Gjejmë kështu mjaft anafora:

*C'u mbush mali me dëborë,
C'u mbush deti me pamporë...*

(C'u mbush mali)

*Ti po vjen që prej së largu magjiplotë e dalngadalë,
Ti po vjen që prej së largu duke shkitur më lëndina.*
(Ti po vjen që prej së largu)

Edhe shembujt e epanastrofës ndjekin modelin e poezisë popullore:

*...kanë zbritur mu në Vlorë,
mu në Vlorën e lirisë....*

(C'u mbush mali)

*E çasin kur e sjell ndër mend,
kur sjell ndër mend, ah, atë vend...*

(E mora shoqezën përkrah)

*...dh'aty pranë i varen palët,
palëshumëshmes silae...*

(Gjahtari)

*C'm'i ka hije shtati i hedhur,
hije kraharuar...*

(Vallja e luleve)

*...ja pa trimin mermëni,
mermëni, moj, thermëni...*

(Po qan vasha në shtëpi)

Një përsëritje që haset shumë në popull e bën tè përfekt me ndërtimin e saj dhe që sot është përhapur shumë edhe në poezinë tonë të re, është edhe kjo që e gjejmë te Poradeci:

*...o fjalë e pikave qiriri,
e pika lotëve, o fjalë!*
(Naimit)

*Ti det, brohori fshehtësie!
Kuptim i potershëm, ti det!*
(Gjeniu i anijes)

*Dh'i shtija sytë gjith' përdhe,
gjithë përdhe m'i shtije sytë...
(Ku shkohet vala)*

Nuk po zgjatemi më në tiparet e vargëzimit të Poradecit, tipare që janë të shumta dhe që kërkojnë një studim edhe më të thelluar, po nuk i mbyllim dot këto radhë pa thënë edhe dy fjalë për natyrën e aliterationit të këtij poeti. Poradeci ka sensin e harmonisë, sens që nuk i mungon kurrë një poeti të vërtetë. Harmoninë poeti e sheh edhe në tingujt e fjalëve. Shembulli i r-së në fjalën *kufir* te poezia «Poradeci», për të cilën u fol më lart, do të mjaftonte për të na bindur se për Poradecin, në vargjet e poezisë, tingujt-zanorë apo bashkëtingëllorë — janë si notat muzikore, në një pentagram. Kjo gjë e shtyn nganjëherë të shkelë edhe ndonjë rregull ortografik apo morfollogjik, mjafton që tingulli të marrë vlerën apo nuancën e kërkuar prej tij. Kështu, për shembull, te fjalët *i qetë*, dhe *të shkretë*, siç dihet, e-të janë të gjata, po poeti, duke dashur që në këto pozicione, e-të të janë të shkurtëra, mbasi kërkon që për efekt ideoartistik të përdorë rimën e fortë, shkel ortografinë dhe shkruan:

*Përse buçet ligen i get?
Ligen, t'i ç'thua ndaj buçet?
Cfar' pe, ligen, mi zall të shkret?*
(E mora shoqezën përkrah)

Po kjo gjë duhet thënë edhe për foljen *fundos*, që

përdoret prej tij në vetën e tretë njëjës të së tashimes dëftore në formën *fundet* në vend të *fundoset*:

*Drejt në zemër ndaj fundét
malli i përvëluar,
fundét zemëra si det
duke uturuar!*

(Që larg)

Këtu, domosdo, si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin kemi shkelje të rregullave, gjë që nuk lejohet; megjithatë askush nuk proteston, se thua jse askush nuk e vë re i rrëmbyer nga harmonia e poe zisë...

Duke u kthyer tek aliteracioni, duhet thënë se edhe në përdorimin e tij zbulohet sensi i harmonisë. Aliteracioni i Poradecit dallon nga ai i Nolit, siç dallojnë midis tyre dy poezitë e këtyre mjeshtreve. Ndërsa te Noli, siç u tha, hasim aliteracione me tinguj të kumbueshëm, të fuqishëm; do të thoshnim që shkrepëtijnë, te Poradeci ata janë të butë, të krijuar në më të shumtën nga bashkëtingëllore jo tepër të zhurmshme, në mos të shurdhëta. Kontribuojnë të tilla kombinime pér t'i shtuar tonet lirike një melodie gjuhësore që në vetvete është e tillë te ky poet, qoftë nga zgjedhjet e fjalëve, qoftë nga ritmet e shtruar. Te shembujt e më poshtëm bie në sy qartë një gjë e tillë:

Vijnë vashat valle-valle...

(Vallja e luleve)

*...dhe' i hape truallin pér varr,
e varrit vet i vure zjarr...*

(E fundit mërzitje)

më turren valët varg e varg...

(Lundra dhe flamuri)

*Vate dimri, vate vera,
vate vjeshta përngahera...*

(Baladë)

...më shkon shog' i miturisë...

...lulëzonte lul' e kuqe...

(Vogëlushja)

Edhe kur kërkon një përsëritje tingujsh të fortë, harmonia e Poradecit largohet nga zhurma, nga buçitja e trompetës, i shmanget përplasjes së tingujve të tillë që do të krijonim «potere», siç janë *t*, *r*, *d*, *k*, ç etj. në kombinime togjesh. Në të tilla raste Poradeci nuk shkon më tej *k-së* apo *s-së* dhe *sh-së*, po në pozicione të hapura, që të mos kenë shumë forcë. Kështu për shembull:

E kudo krahinë e gjërë më s'po qet as pipëtimë,

në katund kërcet një portë...

(Poradeci)

vV-/y-v/v-v/vV-

...kush me këmbë e kush me kalë...

(C'u mbush mal)

Jo rrallë aliteracioni kthehet në një harmoni imitative të vërtetë që na bën të ndiejmë herë fluiditetin e ujit, si te ky varg:

E si mbushin ujë, bubu, ç'm'ju ka hije...

(Kroi i fshatit tonë)

Herë këngën e një zogu:

*...e si shtohet cingërima... ja, se ku dinak dhe' i vocërr
nëpër gardhe e nëpër ferra dërdëllët gazmor një*

çoçërr!

(Mbarim vjeshte)

Kurse në këto vargje përfytyrimi auditiv thua jse merr plastikën e hapit të vashës:

*...do të tretem të kullohem në kalim të këmbës sate
t'i pushtoj i llahtarisor ato hapëza mëkate...*

(Ti po vjen që për së largu)

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për këta shembuj:

*...Me krismë e me prush prej stërkalash
mi të shkrepëtin një rrufe!*

(Gjeniu i anijes)

*...dirgjet heshtur nënë brymë,
fryn veriu në pyll të thatë me zemrim e me
fërtymë...*

(Mbarim vjeshte)

Nuk ka asnjë dyshim se përvoja e Poradecit në punë
të vargëzimit dhe, të instrumentimit, ashtu si ajo e Mje-
dës dhe e Nolit, qe shumë dobiprurëse për poezinë tonë.
Ajo është një pasuri e vërtetë artistike, që hapi horizonte
të reja metrike, që vuri në dukje vlera të reja harmoni-
ke të gjuhës sonë, duke u bërë kështu një model pune për
shumë poetë që erdhën më pas.

“Poradeci” është një libri i shumë i interesantës së këtij vjeti, që
meritet qëndrimi i tij i rafiontë, i riktheqësuar me vlerat e
vërtetë artistike, që i përmendin poeziat e tij.

“Poradeci” është një libri i shumë i interesantës së këtij vjeti, që
meritet qëndrimi i tij i rafiontë, i riktheqësuar me vlerat e
vërtetë artistike, që i përmendin poeziat e tij.

“Poradeci” është një libri i shumë i interesantës së këtij vjeti, që
meritet qëndrimi i tij i rafiontë, i riktheqësuar me vlerat e
vërtetë artistike, që i përmendin poeziat e tij.

“Poradeci” është një libri i shumë i interesantës së këtij vjeti, që
meritet qëndrimi i tij i rafiontë, i riktheqësuar me vlerat e
vërtetë artistike, që i përmendin poeziat e tij.

“Poradeci” është një libri i shumë i interesantës së këtij vjeti, që
meritet qëndrimi i tij i rafiontë, i riktheqësuar me vlerat e
vërtetë artistike, që i përmendin poeziat e tij.

“Poradeci” është një libri i shumë i interesantës së këtij vjeti, që
meritet qëndrimi i tij i rafiontë, i riktheqësuar me vlerat e
vërtetë artistike, që i përmendin poeziat e tij.

“Poradeci” është një libri i shumë i interesantës së këtij vjeti, që
meritet qëndrimi i tij i rafiontë, i riktheqësuar me vlerat e
vërtetë artistike, që i përmendin poeziat e tij.

11. TIPARE TË VARGUT TË LIRE NË POEZINË SHQIPTARE

Para se të vazhdohet më tutje, na bëhet se tani ka ardhur koha të flitet për vargun e lirë, për të cilin është diskutuar shumë, e jo vetëm te ne. Në letërsinë shqiptare e ndeshim për herë të parë, siç u tha, tek Asdreni më 1934, po mund të themi se ai që i dha «nënshtetësi» shqiptare qe vetëm Migjeni, i cili e shpalli që në titull të librit të tij më 1935. Siç shikohet, në letërsinë tonë nuk është fort i ri, ka afro gjysmë shekulli që poetët shqiptarë po e lëvrojnë përherë e më tepër. E, megjithatë, akoma sot e kësaj dite, për këtë varg ka paqartësi. C'është vargu i lirë? A ka ritëm apo nuk ka ritëm? C'është ritmi i brendshëm për të cilin flitet tutje tëhu pa u sqaruar deri në fund sikur vargjet e tjerë nuk paskan ritëm të brendshëm? Ku qëndron dhe si realizohet fryma kombëtare në këtë varg? Përse, fundi i fundit, nevojitet vargu i lirë? Mos vallë tërë «sekreti» i vargut të lirë qëndron në grafinë, sepse asgjë nuk e dallon në të vërtetë nga proza? Pyetjet

nuk mbarojnë dhe janë të atilla që duan patjetër përgjigje.

Po t'u hedhim një sy përkufizimeve që hasim përkëtë varg te ne, do të vëmë re se ato ndryshojnë dhe herë-herë ke përshtypjen se janë bille në kundërshtim midis tyre në mjaft pika.

Në librin «Metrika shqipe» të Dh. S. Shuteriqit lexojmë:

«Varg i lirë quhet, përgjithësisht, një varg që nuk e respekton ritmin dhe rimën, rrëgullin e vargut të kon-sakruar nga poezia popullore dhe poezia e shkruar. Lindi në Francë e në Belgjikë, aty nga fundi i shekullit XIX dhe si krijestar i tij duhet të jetë poeti francez Gustav Kahn. Ky lloj vargu lindi si reaksion kundër teknikës parnasiane dhe klasike. U përhap shpejt në të gjithë Evropën dhe në të gjithë botën. U përdorua dhe u shpërdo-rua, sepse ra, më të shumtën, në dorë njerëzish që injorancën e tyre artistike u munduan ta shesin si artin më të përsosur. Megjithatë, poetë të shquar dhanë përfun-dime të vlefshme në vargje të lira. Mjaft të përmen-dim këtu belgun Verhaeren dhe sovjetikun Majakov-ski.»¹⁾

Në «Fjalorth termash letrare» (1965) lexojmë:

«Varg i lirë. Varg në të cilin është e lirë sasia e rrokjeve të theksuara e të patheksuara, nuk është i domosdoshëm numri i barabartë i theksave në vargjet e vjershëve, nuk ka strofa uniforme që përsëriten, mund të mos ketë edhe rimë. Në bazë të tij qëndron organizimi sintaksor homogjen që përcakton një intonacion homogjen; në këtë intonacion homogen shqiptohet secili nga vargjet-fraza të vjershës.»

Kurse përkufizimi që jep «Fjalorthi shpjegues i termave të letërsisë» (1972) është ky:

«Varg i lirë. Lloj vargu që nuk u nënshtrohet ske-mave tradiçionale të metrikës në lidhje me sasinë e cak-tuar, të rrokjeve, të theksave ritmikë, të pauzave, të ndarjes në strofë, të rimave etj. Paraqitet herë i gjatë,

1) Vepër e cituar, f. 87.

herë i shkurtër e nganjéherë pérzihet me vargje që ruajnë deri diku formën tradicionale. Në vargun e lirë theksi ritmik i përgjigjet brendisë poetike, valës së ndjenjave e të mendimeve që do të shprehë poeti. Është vargu i preferuar i shumë poetëve modernë. Në letërsinë evropiane është dukur aty nga fundi i shekullit XIX dhe lindi si reagim kundër virtuoizmave të poetëve që imitonin për së tepërmë skemat klasike (p.sh. parnasianët).»

Mund të silleshin edhe përkufizime të tjera, po gjithmonë do të vinim re se ato edhe afrohen midis tyre edhe largohen, Afrohen përsa u përket vijave të përgjithshme e një toni herë-herë të papercaktuar, largohen kur ndalen te ndonjë hollësi rregulle teknike etj. Nu janë përkufizime të pabazuara dhe të tilla që nuk qëndrojnë në këmbë. Përkundrazi, Megjithatë një poet i ri e ka të vështirë të depërtojë plotësisht në të fshehtat e vargut të lirë nëpërmjet tyre. Dhe vërtet, edhe pas këtyre përkufizimeve mund ende të pyesësh: A kanë ritëm apo nuk kanë ritëm vargjet e lira? A kanë apo nuk kanë rimë? A janë vargjet e lira një shenjë mosrespektimi i vargjeve popullore dhe i atyre të kultivuar? E vëmë re se pas këtyre përkufizimeve, pyetjet, në vend që të vijnë duke u pakësuar, shtohen.

Para së gjithash duhet sqaruar se nuk është plotësisht e vërtetë, ose është pjesërisht e vërtetë, që vargu i lirë lindi për herë të parë në Francë dhe si reaksion i simbolistëve kundër parnasianëve. Studiuesit francezë ngulin këmbë në një gjë të tillë, saqë vargun e lirë e quajnë pa një pa dy *varg i lirë simbolist* dhe për këtë lindje caktojnë vitin 1886.¹⁾ Ata kanë të drejtë, mbase, kur flasin për vargun e tyre të lirë, po nuk kanë aspak të drejtë kur absolutizojnë një rrëthanë të tillë. Dihet se pikërisht në vitin 1886 në Francë, në Nr. 10 të revistës «*La Vogue*», u botuan për herë të parë përkthimet e dy poezive të U. Uitmanit të shkruara në varg të

1) Shih p.sh. Henri Morier «*Dictionnaire de poétique et de Rhetorique*» Paris 1961, f. 462.

lirë («Kushtim» dhe «O yje të Francës»). Për këtë arsy e shtë e domosdoshme të vendoset lindja e vargut të lirë së paku diçka para 1886 dhe, nga ana tjetër, kemi të bëjmë me një lindje që, kuptohet lehtë, nuk ka të bëjë me simbolizmin. Lidhja e vargut të lirë me simbolizmin e shtë krejt arbitrare. Ky e shtë edhe mendimi i mjaft studiuesve, të cilët pohojnë se në fakt nuk e shtë nevoja pérasnijë lidhje midis vargut simbolist dhe atij mbas-simbolist, nga një anë, dhe përdorimit të vargut të lirë, nga ana tjetër. Një poet i traditës simboliste, siç ishte p.sh. Jits (Yeats), iu shhang vargut të lirë gjatë gjithë karrierës së tij, ndërsa poetë aspak simbolistë siç qenë Uitmani në Amerikë dhe Hopkinsi në Angli përdorën vargun e lirë ose i hapën rrugën atij nëpërmjet përvojës së tyre.

Në qoftë se, pra, në Francë vargu i lirë lidhet me simbolizmin, në Rusi me simbolistët dhe futuristët, në Itali me krepuskolarët dhe futuristët etj. kjo nuk e shtë një arsy që të përgjithësohet e të pohohet diçka që historikisht duhet parë në mënyrë më dialektike. Vetë në Francë e kudo gjetkë, vargu i lirë nuk e shtë pa paraprijës, pa një përvojë paraprake të grumbulluar nga ky apo nga ai poet. Vetë vargu i përzier, i përdorur gjere-sisht nga La Fonteni, Molieri etj. (ndonjë studiues franzez e quan *varg i lirë klasik*), nuk mund të mos ishëtë një urë kalimi prej vargjeve të rregullt në vargjet e lira. Nga ana tjetër arsyet e lindjes së vargut të lirë janë parë gjer më sot vetëm në tentativën pér shkëputje nga tradita, po kjo nuk e shtë e drejtë, mbasi vetë kjo shkëputje nuk mund të bëhej veçse në rrugën dialektike, duke u mbështetur në disa elementë (dhe janë elementë të qenësishëm) të traditës. Për këtë arsy e shtë e udhës që vargu i lirë të mos shikohet vetëm si një reaksion, si një shkëputje, si një mohim metafizik i traditës, por edhe si një rivlerësim i disa arritjeve të kësaj tradite, një përdorim i ri i elementëve themelorë të metrikës tracionale, një interpretim më i shpenguar i vlerave ritmike dhe instrumentuese të vargut. Në këtë rast vargu i lirë nuk e shtë një varfërim mjetesh, po

një përpjekje për një pasurim të tyre, për një përdomrim të tyre të ri. Vargu i lirë nuk është në këtë mënyrë kundër vargut të rregullt, po një interpretim i ri i këtij vargu të rregullt. Në mos tjetër kjo duhet thënë për vargun tonë të lirë. Vetëm po të shikohet vargu i lirë në këtë prizëm, ai nuk mbetet më mister për ne po inkjadrohet në familjen e madhe të sistemeve të ndryshëm metrikë.

Vargu i lirë lind ashtu siç lind çdo sistem tjetër metrik: për t'iu përgjigjur më mirë disa aspekteve të ritmit të kohës, për të depërtuar në mënyrë më të lehtë, pa shumë artifice e skema, në vetëdijen e lexuesit, për t'u bërë më i përshtatshëm për shprehjen e realitetit, të psikologjisë dhe të gjuhës së kohës. Kuptohet se këtu, në analizë të fundit, është shqëria me zhvillimin e saj të pandalshëm, që shërbën si shtytëse kryesore. Jo së sistemet e mëparshëm të vargëzimit nuk janë në gjendje të shprehin këtë ritëm (me kusht, domosdo, që të dinë të rinovohen në strukturën e tyre të brendshme). Dhe është pikërisht për këtë arsyе që duke folur për sisteme të ndryshme vargëzimi të një gjuhe, në asnjë mënyrë nuk duhet të vëmë njérën kundër tjetrës. Megjithatë është fakt se çdo epokë sjell edhe në lëmë të metrikës kontributin e vet original. Kjo nuk do të thotë aspak, e përsëritim, se vargu i lirë është vargu i kohës, ndërsa vargjet e tjerë jo.

Historia e vargëzimit tregon se ai është një fenomen që zhvillohet, pasurohet, heq dorë nga disa procedura, pajiset me disa të tjera duke marrë kurdoherë trajta e forma të reja. Kjo për vetë faktin se ai është i lidhur me një fenomen të gjallë siç është poezia, që, nga ana e saj, reflekton në analizë të fundit dialektikën e vetë jetës. Dhe janë pikërisht dy faktorë konkretë jetësorë që kushtëzojnë në radhë, të parë këtë evoluim: faktori historiko-shqëror dhe faktori gjithësor. Në sistemin e vargëzimit ne i hasim të qarta shënjet e ndikimit të këtyre dy faktorëve. Mbështetet më e lehtë për t'u kup-

tuar që zhvillimi i gjuhës të pasqyrohet edhe në mënyrën e thurjes së vargjeve dhe disi më e vështirë të kapet se si reflektohet faktori historiko-shoqëror në këtë fenomen formal e teknik të poezisë. Por e vërteta është se faktori historiko-shoqëror është përcaktues dhe i fuqishëm edhe në këtë mes e, në të vërtetë, aspak i vështirë për t'u kapur. Para së gjithash, duke qenë se vetë brendia e poezisë e reflekton vazhdimisht dialektikën historiko-shoqërore, evoluon, zhvishet nga ide dhe emocione të vjetruara e pasurohet me ide, përfjetime, ndjenja dhe ëndërrime të reja, nuk ka se si që kjo lëvizje dialektike e brendisë të mos reflektohet edhe në mjetet e formës, në gjuhë, në sistemin e figuracionit, në ritmin, muzikalitetin, pra dhe në krejt sistemin e organizimit dhe të instrumentimit të vargut. Kjo është një çështje që ka të bëjë edhe me vetë destinacionin e poezisë. Në rrymë të kohës, gjatë historisë, ky destinacion nuk ka qenë kurdoherë i njëjtë; ai ka ardhur duke u zhvilluar, mbasë ka pasur zigzage, po kurdoherë ka shkuar drejt një demokratizimi që sa vinte e bëhej më i dukshëm. Poezia, siç dihet, lindi edhe si shoqëruese e punës së njeriut, si një farë elementi ritmik organizues i punës së tij të përbashkët dhe që prej saj ajo mori ritmin që e mban ende sot e kësaj dite në këmbë. Ajo lindi në punë e sipër e shoqëruar me melodinë dhe gjestin. Një sinkretizëm i plotë që pati zhvillime dhe rrjedhime të shumta. Është pikërisht nga ky sinkretizëm që lind muzika, vallja, pantomima, teatri etj. Që këndej lind edhe poezia me tërë llojet e saj e, meqë për këtë po flasim, edhe sistemi i organizimit të saj ritmik e gjuhësor. Po në qoftë se shoqëria e hershme, që e lindi, mund të kënaqej nga ky sinkretizëm, zhvillimi i mëtejshëm historiko-shoqëror e ndjeu të nevojshëm prishjen e tij dhe zhvillimin e veçuar, fuqizimin, përsosjen e komponentëve të ndryshëm të këtij fenomeni. Kështu shkëputen nga njëra-tjetra poezia, muzika, vallja, pantomima etj. Megjithatë kjo bashkëjetesë nuk u shua

kurrë, ajo edhe sot e kësaj dite, me gjithëse në një stad, brendi e formë të re, jeton ende. Opera e kinematografia — për të mos përmendur të tjera — janë dy lloje që nuk mund të konceptohen pa këtë bashkëveprim, që, domosdo, ka marrë sot përmasa, kuptim dhë forma të reja. Sidoqoftë prishja e sinkretizmit të hershëm solli si rrjedhim zhvillimin e pavarur, konsolidimin dhe kristalizimin e trajtave, qoftë të muzikës, qoftë të poeziës. Destinacioni i kësaj të fundit nuk qe më vetëm ai për të konkretizuar do-methënien e tingullit, të muzikës, po për të poetizuar një ngjarje apo një ndjenjë, për të shpallur një mesazh duke u mbështetur vetëm në bukurinë dhe fuqinë e fjálës së artikuluar të njeriut. Te kjo fjalë u zbulua një muzikalitet, një harmoni dhe një zhđervjellshmëri që nuk ishte vënë rre herë tjetër. Në këtë fjalë, që organizohej në vargje, hetohej ende bashkëjëtesa e dikurshme me muzikën (ajo hetohet ende sot) po zhvillimi i pavarur bëri që të krijueshin mjete të reja harmonie, instrumentimi, intonacioni, ritmi. U vu rre kështu muzikaliteti i intonacionit të ligjëratës poetike, që buronte nga struktura sintaksore, u vu rre harmonia fonetike, që buronte nga përbërja e tingujve, u vu rre ritmi i mendimeve dhe ndjenjave që lëvizte në vargje sipas organizimesh dhe instrumentimesh të caktuara etj. Tashmë poezia po bënte jetën e saj të pavarur, me gjithëse ajo kurrë nuk ka qenë e nuk është bukëshkalë ndaj muzikës.

Gjithë ky proces ndodhi në gji të popullit, i cili është poeti e muzikanti i pari, farkëtuesi i artit të vërtetë në të gjithë kohët. Poetët, që erdhën më pas dhe i hodhën në letër krijimet e tyre, mësimet e para, me vëtëdije apo pa vëtëdije, i morën para së gjithash në popull e pastaj nga njëri-tjetri. Poezia, nuk mësohet në librat e metrikës. Poezia buron ngajeta. Ajo të jep idetë, mendimet, ngjarjet, fenomenet etj., që do të përbëjnë brendinë e poeziës, ajo të jep edhe formën, ritmin, kadencën, harmoninë etj., për të plaz-

muar këtë brendi. Domosdo këto nuk bëhen veç e veç, d.m.th. më parë të krijojmë brendinë e më pas formën, këto krijohen njëkohësisht, në lidhjen e tyre dialektikë. Sepse nëse është e mundur që për voli studimi brendia e forma të veçohen, në krijim ato janë në unitetin e tyre të pandarë dialektik. Kështu problemet e formës kthehen e bëhen probleme të brendisë.

Ritmi i poezisë është një element formal që buron nga brendia. Çdo brendi, çdo fenomen, çdo epokë a periudhë historiko-shoqërore ka ritmin e vet. Dhe është pikërisht ky ritëm një nga elementët e shumtë që e lidh poezinë me kohën.

Nuk janë pa interes në këtë vështrim ato që Asdreni shkruante në një letër, të cilën e kemi cituar më parë. Duke folur për evoluimin në veprat e tij të konceptimit struktural të vargjeve, ai e paraqet këtë më tepër si një nevojë objektive, të diktuar nga rrëthanat historiko-shoqërore të kohës, nga realiteti rrëthues që evoluon vazhdimisht.

Asdreni e ndien thellë si artist se pasqyrimi i brendisë së re, reflektimi i realitetit të ri në poezi, është i lidhur ngushtë me një varg kërkeshash të reja, që kanë të bëjnë edhe me konceptimin e saj metrik.

Majakovski në librin e tij «Si thuren vargjet?», një libër i shkruar më shumë me intuitën dhe fantazinë e një artisti, se sa me logjikën dhe argumentimet e një shkencëtari, arrin të japë qartë, më duket, këtë lidhje të brendshme ritmike të poezisë me ritmin e ambientit qark, me ritmin e shoqërisë në të cilën jeton poeti.

«Së nga vjen ky ritëm-gjëmim bazë, thotë Majakovski, nuk dihet. Për mua është çdo përsëritje që ndodh tek unë i një tingulli, i një zhurme, i një lëkundjeje ose përgjithësisht, përsëritja e çdo fenomeni që unë e hetoj me anë të tingullit. Ritmin mund ta sjellë edhe zhurma e vazhdueshme e detit, edhe shërbyesja që çdo mëngjes troket në derë dhe që duke u përsëritur ndërthuret duke zënë vend në vetëdi-

jen time, bile edhe rrrotullimi i tokës, që tek unë si te një dyqan me mjete demonstrimi, alternohet dhe lidhet në mënyrë karikaturale detyrimisht me férshëllimën e erës.

Përpjekja për të organizuar lëvizjen, për të organizuar tingujt qark vetes, duke gjetur karakterin e tyre, veçoritë e tyre, kjo është një nga punët kryesore dhe të vazhdueshme poetike — kjo përbën rezervën ritmike.¹⁾

Kurse Kadareja e ndien këtë fenomen, këtë rapport ambient-ritëm, kur thotë në një poemë të tij, «Anketa», këto fjalë për poezinë e vet dhe vendlindjen e tij, Gjirokastrën:

*Ne dolëm nëpër lagjen e çuditshme, të lashtë.
Mbi kaldrëmet e pjerrët ty gjunjët të thyheshin,
mbi sokakët e shtërbërit met na thyheshin,
por ne ecëm, ecëm përkrahu bashkë.
Atëherë ti çdo gjë ma shndërrrove, përpara syve.
Befas në muret e shtëpive të stilit të shkuar
skelat e strofave dhe të vargjeve u ngritën
gjithë botën me llaçin e poeziës duke suvatuar.*

• • •

*Mbi kaldrëmet e pjerrët ritmet thyheshin,
rimat përplaseshin mbi gurët dhe binin.
Ti the: s'ka gjë,
dhe kështu mund të shkruhet
mjafton që në zemër ngriçat mos binin.*

Kuptohet se në këto vargje — dhe Kadareja flet jo rrallë për rima, ritme e vargje në poezitë e veta — flitet para së gjithash për diçka esenciale të bredisë së poeziës, diçka që ka të bëjë me konceptimin psikologjik, me përjetimin e realitetit që poetizohet, po nuk ka asnjë dyshim që në to bëhet fjalë pikë-

1) V. Majakovski — Kak djellat stihi? — Moskva 1952, f. 24.

risht edhe për strukturën ritmike të poezive, pra përdicë që lidhet me organizimin e brendshëm të vargjeve e që, sipas Kadaresë, buron prej vetë objektit të poetizuar.

Nuk është vështirë të gjenden vargje edhe tek poetët tanë të tjerë, ku të duket qartë shqetësimi i tyre për të dhënë kohën e, për q'na intereson ne, edhe ritmin e kohës. Kështu te F. Arapi gjejmë këto vargje:

*Dhe vet' këto ditë, — kështu siç janë,
gjysmëpunëtore, gjysmëfshatare,
gjer në brez nën ujë të lara, —
të gjitha
do të vërshojnë, si vërshon lumi,
tunëleve e poemave,
që të vërtitin fletët e çelikta të turbinave,
që të rrezellejnë qelizat e panumërtat
të ritmeve e të rimave.*

(Vargje për dritat)

Ose të marrim këto vargje të D. Agollit, ku thuhet:

*Mundohem e vuaj mbi rrrokje e vargje
se dua ta ngre poemën në këmbë,
djersët më rrjedhin nga balli në fage
dhe majën e lapsit pastaj ha me dhëmbë,
se dua që vargu të mbajë jo vetëm një agim,
dua të mbajë me shpatulla kohën që zjen e
gjemon.*

*Poema ngjan me digat në Drin,
që mbajnë liqene me miliarda ton!*

(Nënë Shqipëri)

Pra ritmi i kohës, ndonëse është vështirë për tu përkufizuar me fjalë, poetikisht është diçka konkrete, diçka që hetohet qartë nga intuita e poetëve. Është pikërisht kjo lidhje me kohën që i bën ata të kër-

kojnë dhe ritmin e përshtatshëm, i bën që të interpretojnë një mënyrë sa më të re vargjet tradicionale, mjetet formale të poezisë derisa të arrijnë një ndonjë rast edhe tek vargjet e lira.

O Nga tërë këto që u thanë këtu, kuptohet qartë se vargjet e lira nuk ka si konceptohen pa ritëm, prandaj është një keqkuptim i pafalshëm ai që i supozon këto vargje pa ritëm. Nuk ka poezi pa ritëm. Mund të ndryshojnë mjetet, procedurat për arritjen e këtij ritmi (dikur arrihej me anë të alternimit të rrrokjeve të shkurtra e të gjata, në sistemin metrik; më pas, nëpërmjet sistemit të rrrokjeve duke u ndihur edhe nga rima; më pas akoma duke i dhënë rëndësi ritmit të organizimit sintaksor të frazës-varg etj.), po në asnjë mënyrë nuk mund të mendohet poezia pa ritëm (bile edhe proza nuk mund të mirret me mend pa ritmin e saj specifik). Vetëjeta rrjedh sipas një ritmi të dhënë, prandaj është absurdë të mendohet që poezia dhe arti në përgjithësi, që pasqyrojnë jetën, ta injorojnë ritmin e të bëjnë pa të.

Po si arrihet ritmi në vargjet e lira? Domosdo as me këmbët e sistemit metrik apo atij ritmik, as me rrrokjet e sistemit silabik, as me parimet e sistemit tonik. Këtu kemi të bëjmë, patjetër, me një specifikë origjinale. Megjithatë mund të themi se *vargjet e lira e organizojnë ritmin pa këto sisteme, por edhe me tërë këto sisteme bashkarisht*. Nga ana tjetër, në këtë punë rol të madh luan gjuha, natyra e gjuhës në të cilën shkruhet, veçoritë sintaksore e fonetike të saj. Sepse vargu i lirë është i lidhur tepër ngushtë me veçoritë e qenësishme të një gjuhe, aq sa mendoj se duhet folur jo për një varg të lirë në përgjithësi, po për tipe vargjesh të lira dhe veçoritë e tij në një letërsi të caktuar.

E para gjë që duhet të sqarohet këtu është, domosdo, *ritmi i brendshëm*. Ritmi i brendshëm nuk është një karakteristikë vetëm e vargut të lirë. Edhe vargjet e tjerë e kanë një gjë të tillë, po ndërsa në

vargjet e ndërtuar me sisteme të ndryshme (metrik, ritmik, silabik, tonik etj.) ky ritëm organizohet në përmjet rregullash fikse, që lidhen me numrin e këmbëve, të rrokjeve, të theksave ritmikë, të rimavë etj., me elementë, do të thoshim, të jashtëm, tepër të dûkshëm, vargjet e lira e arrijnë këtë me mjete më pak të dukshme, që veprojnë si *in sordina*, duke nisur që nga organizimi i brendshëm i frazave sintaksore e deri tek instrumentimi i vargjeve me mjete të shpërndara në mënyrë të çrrëgullt ose, më mirë, të lirë. Kjo gjë e bën ritmin e vargjeve të lira të një poezie të mos përsëritet në një poezi tjeter. Thua se qdo poezi ka ritmin e vet të veçantë, tepër vetjak, që lidhet me brendinë ideore apo emotive të temës së trajtuar.

(2) Një rol të rëndësishëm në organizimin ritmik të vargut të lirë shqiptar luan patjetër konstantja metrike. Poetët tanë, me vetëdije apo në mënyrë intutive, kanë punuar duke përdorur konstanten metrike në thurjen e vargjeve të lira.

Konstante metrike quhet një element metrik fiks, që përihet me vargje masash të ndryshme, nxjerr krye hera-herës, po më këmbëngulje, megjithëse jo në intervallë të rregulla, duke krijuar kështu një atmosferë të veçantë ritmike. Konstantja metrike është këtu si majaja, që shërben për t'u dhënë vargjeve të lira një farë boshti, një farë pike referimi ritmik, një farë fizionomie ritmike unifikuese.

Në poezinë tonë kjo është një procedurë që e hasim që te Asdreni dhe Migjeni. Te Migjeni mund të gjejmë të përdorur mjaft gjashtërrokëshin si konstante metrike siç ndodh p.sh. të «Shkëndija» apo të «Kangë në vete»:

*Veri frynë pa mshirë, si veri që frysni,
dhe si hajn në shtëpijat e kojshive hynë —
edhe për çudi
këta kojshit e mi*

*sa mirë e presin... megjithëse nuk asht ditë vere
ata në gjuhë të huej i thonë: mirë se erdhe!*

Këto vargje, po të shkruhen ndryshe, e zbulojnë lehtë ritmin e gjashtërrokëshit populor:

*Veri fryn pa mshirë
si veri që frynë
dhe si hajn në shtëpijat
e kojshive hynë...*

Po te Migjeni hasim edhe vargjet tek si konstante metrike. Kështu, p.sh. te «Të lindet një njeri» apo te «Zgjimi» konstante metrike është shtatërrokëshi. Nga ana tjetër edhe njëmbëdhjetërrokëshi përdoret den-dur prej tij si konstante metrike, si p.sh. te «Vuejtja»:

*Ka do dit
që po shof fare mirë
se si nga vuejtja syt po më madhohen
nëjërr ball dhe ftyrë rrudhat po më shtohen
e si buzqeshja m'asht e hidhun...
...dhe po ndij
se si mëngjeset e mijë
nuk janë ma mëngjese hovi e pune
as ndërtimi, por të shtyamt dita më ditë
e një jete që s'durohet...*

Te Dh. S. Shuteriqi e Ll. Siliqi hasim më shumë var-gun njëmbëdhjetërrokësh si konstante metrike. Bile ke përshtypjen nganjëherë se shumë poezi të këtyre dy poetëve nuk janë gjë tjetër vegce njëmbëdhjetërrokësha të shkruar në mënyrë të copëzuar. Ja një shembull nga Shuteriqi:

*Mos ma vë re
dëshprimin tim ti sot,
motër Anë;
dhe mos u shqetëso*

për këta lot,
që pe
të zbresin fakes branë.

Po,
kam qarë.

Mosha nuk ma lejon...

(Vangjush Mios)

Këto vargje mund të shkruhen:

Mosha vë re dëshprimin tim ti sot,
motër Anë; dhe mos u shqetëso
për këta lot që po të zbresin fakes branë.
Po, kam qarë. Mosha nuk ma lejon...

Po kështu ndodh edhe te Ll. Siliqi, p.sh. te poema
«Borizanët»

Dritat fiken radhaz në qytezë.
Ai ngrihet,
radion ndez.
Ai don të dijë çdo gjë:
me se rron vendi,
sivjet sa mbolli e si mbolli
i shtrejti miku i tij
Devolli...

Këto vargje mund të shkruhen:

Dritat fiken radhas në qytezë.
Ai ngrihet, radion ndez. Ai don të dijë
çdo gjë: me se rron vendi, sivjet sa mbolli
e si mbolli i shtrejti miku i tij,
Devolli...

Poetët që érdhën më pas mörën prej Migjenit dhe, domosdø edhe prej Shuteriqit e Silit. Nga këta të fundit përdorën jo vetëm përvojën e teknikës së konstan-tes metrike, por edhe atë të zbërthimit të strofave të

rregullta, për të cilën do të bëjmë fjalë më tutje. Tani për tani të qëndrojmë ende te konstantja metrike.

Në një pjesë të mirë të poezeve të F. Arapit, është përdorur si konstante metrike gjashtërrokëshi popullor. P.sh.:

*Mbrëmë i kisha miq dhe me mua fjetën
revolucionet e ardhshme, republikat e reja proletare,
hidrocentralet ndërkombëtare dhe universitetet,
udhëtimet e largëta...*

(Mbrëmë i kisha miq)

*Plumbi tejpërtej ta çan ballin.
Gjaku gurgullon nga tëmthat
e nga goja.*

— Ku të të vendos?

Si të të térheq?

Rreth e qark gurishtë

Armiku gjuan keq.

(Alarme të përgjakura)

Në shumë poezi në vargje të lira, të I. Kadaresë, konstante metrike është gjashtërrokëshi, po prej tij përdoret mjaft edhe dhjetërrokëshi apo nëntërrokëshi.

Fëmijnia ime me gishtat lyer me mellan.

Në mëngjes këmbanat.

Myezini në muzg.

Koleksione gazetash e pullash të vjetra,

shkëmbimi i Cejlonis

me dy Luksemburg.

(Fëmijnia)

Jo rrallë konstantja metrike merr të ndonjë poet trajtën e lajtmotivit. Kështu ndodh sidomos me Migjenin, i cili kërkoi dhe e arriti me këmbëngulje muzikalitetin e lajtmotivit në poezitë e tij. Lajtmotivi në të tilla raste shërben jo vetëm për të theksuar apo vënë në dukje një ide apo ndjenjë të qenësishme, sidoqoftë

qëndrore për poezinë, por edhe për të ndihmuar në organizimin ritmik të saj. Në këtë funksion e gjejmë të përdorur, dhe me mjeshtëri, p.sh. te poezia «Zgjimi», ku vargjet

*O vullnete të ndrydhuna!
O vullnete të shtypuna!*

përsëriten tri herë, duke e ndarë poezinë në pjesë kryesore dhe duke të dhënë përshtypjen e një orkestracioni që regëtin i shqetësuar thuajse *in sordina* gjatë tërë harmonisë së poezisë.

Teknikën e lajtmotivit të përdorur si konstante metrike e gjejmë edhe te Kadareja, i cili di të nxjerrë nga ky përdorim nuanca harmonike tepër sugjpressive. Kështu, p.sh., te poezia e tij «Malli i Shqipërisë», gjejmë të përdorur gjashtë herë vargun gjashtërokësh «Më ka marrë malli». Një përsëritje e tillë, domosdo, lë gjurmën e vet të fortë në organizimin ritmik të mbarë poezisë.

Na bëhet se është me rëndësi të thuhet se përdorimi apo mospërdorimi i konstantes metrike, reflektohet në mënyrë të ndijshme në dallimin ose jo të vargjeve të lira nga proza, qoftë dhe nga një prozë e kadencuar. Është e vërtetë se poezia (dhe në këtë mes edhe vargu i lirë) kërkoi dhe kérkon ende sot e kësaj dite të shembë kufijtë artificialë, që e ndajnë atë nga proza. Po kjo nuk ka të bëjë me ritmin dhe mjetet instrumentuese të poezisë. Këto kufij, që janë shembur apo duhen shembur gjer në fund kanë të bëjnë me konceptimet formaliste, estetizante, me recidivet e një konceptimi abstrakt për poezinë, për «aristokratizmin» gjuhësor e tematik të saj, që e dallonte atë prej prozës. Me fjalë të tjera, për një poet realist nuk mund të ketë tema apo subjekte «poetike» dhe «prozaike», apo gjuhë të «veçantë» për poezinë e tjetër për prozën. Për poetët e rinj, sidomos për poetët e realizmit socialist qdo temë apo subjekt mund dhe duhet të trajtohet në poezi, ashtu si qdo fjalë e gjuhës së përditshme mund e duhet të përdoret në vargjet

e një poezie. Ky konceptim i drejtë niset nga fakti që poezia nuk është e veçuar nga jeta, nuk është një surrogato e saj, një kalim kohe, një lodër, një fantazmagori tinguish jashtë realitetit (në mos në kundërvënie me realitetin), po përkundrazi është vetë jeta me tërë pasurinë, bollëkun e detajeve, shumanshmërinë dhe poliedritetin e saj. Vetëm në këtë vështrim kuptohet «futja» e prozës në poezi. Vetëm në këtë mënyrë poezia, qoftë edhe e shkruar në varg të lirë, mbetet poezi, mbasi organizimi i saj ritmik, instrumentimi i saj (për të mos përmendur domosdo esençialen — përjetimin apo poetizimin e realitetit) e bën të dallohet prej prozës. Dallimi midis njerës dhe tjetrës nuk mbahet domosdo në dallime grafike, po ka të bëjë esencialisht me përjetime të brendshme. Në këtë mes, ritmi, organizimi i vargut, instrumentimi i tij ka vendin e vet, funksionin e tij të rëndësishëm e shumë delikat. Këta kufij nuk duhen shembur. Ndryshe kemi shembur vetë poezinë.

Ka pasur orvatje pér të vënë shenjën e barazimit midiš poezisë e prozës. Disa studiues të huaj kanë prirje nganjëherë ta shikojnë prejardhjen e vargut të lirë nga prozat poetike (pér francezët, p.sh., nga prozat poetike të Bodlerit, Rimbosë etj.). Studiues të tillë orvaten e djersijnë pér të gjetur, në këto proza, vargje, embrione vargjesh... Kjo, domosdo, është njësoj sikur të orvatesh të gjesh forma të qëndrueshme te retë në qiel... Ndonjë poet francez, duke u nisur nga kjo prirje e gabuar, nuk ngurroi të parqesë në një formë grafike tjetër prozat e tij të mëparshme dhe t'i shesë pér poezi. Kështu veproi, p.sh., Marie Krysinska, e cila në tetor të vitit 1882 botoi «Këngë vjeshte» në prozë, kurse në dhjetor të po atij viti «Simfoninë në ngjyrë gri», dy poema në vargje të lira. Në të vërtetë ajo nuk bëri gjë tjetër veçse mori tekstet e mëparshëm të shkruar në prozë, i ripunoj dhe i shpërndau rreshtat e prozës në vargje të lira duke përdorur me të tepërt kryeradhët. Ky do-

mosdo nuk është veçse një artifc i kulluar tipografik, që nuk ka të bëjë aspak me poezinë.

Është e vërtetë që vargu i lirë nuk ka një teknikë *a priori*, tepër fikse dhe tepër strikte dhe se çdo poet ka këtu edhe stilin e tij, lirinë e tij në organizimin e vargut, në konceptimin e vargut, po sidoqoftë kjo liri nuk do të thotë kurrë *arbitraritet, çrregullim*. Konceptimi i vargut si varg mbetet kurdoherë i vlefshëm. Dhe kur thua varg, qoftë dhe varg i lirë, thua ritëm me të gjithë aksesorët që parakupton kjo fjalë.

Nga ana tjeter, vargjet e lira nuk duhen barazuar as me vargjet e përzier. Këto të fundit, siç u tha, mund edhe të mendohen se kanë shërbyer deri diku si urë kalimi nga vargjet e rregullt te vargjet e lira. Po vargu i lirë ka një natyrë tjeter, prandaj nuk është e drejtë të quhet vargu i përzier *varg i lirë klasik*, siç u tha se bën ndonjë studiues i huaj. Vargu i përzier njihet prej kohësh edhe te ne. Mjaf-ton të përmenden këtu Naimi dhe Çajupi, të cilët janë treguar mjeshtër në përdorimin e vargjeve të përzier, siç patëm rast të vemë në dukje kur folëm për vargëzimin e tyre.

Atëherë vumë re jo vetëm mjeshterinë e këtyre dy poetëve në vargjet e përzier, por edhe konceptimin që ata kanë pasur për këto vargje. Kështu pamë se Naimi pëlqen të përziejë sidomos vargje tek, duke i dhënë tonit të tregimit një ecuri tepër të afërt me ritmin e prozës. Kurse Çajupi pëlqen të përziejë sidomos vargjet çift, duke i dhënë kështu tregimit një ritëm tepër të gjallë, plot gjetje e befasit ritmike, gati-gati atë të një këngë apo balade popullore. Të dy këta poetë e shpërndajnë rimën tutje tëhu dhe ajo shpërthen herë këtu, herë atje po përherë në shërbim të idesë. Megjithatë, jo rrallë, sidomos te Çajupi, ajo bëhet shkas evidencimi, shkas humorë, shkas fshiku-limit... Hasim dhe vargje të formuar nga një fjalë e vetme, e cila, si rregull, përforcohet edhe nga rima.

P.sh.:

*Kur vate s'gjeti një ve,
thirri, briti;
ulëriti...*

(Çajupi: Shqiponja dhe brumbulli)

*Ljepuri s'ish i gëzuar,
ngulçonte,
rënkonte...*

(Çajupi: Ljepuri dhe kakëzoza)

Vihet re lehtë në këta shembuj, veç të tjerave, edhe fakti që Çajupi krijon dy vargje nga një varg i vetëm.

Nuk ka dyshim se përvoja e këtyre dy poetëve në punë të vargut të përzier nuk mund të mos ndikonte te poetët që erdhën më pas. Dhe në fakt edhe poetë si Shuteriqi, Siliqi, Çomora, Varfi, Agolli, Çaci, Bubani, etj. morën shumë nga përvoja e Naimit dhe Çajupit për vargjet e tyre të përzier, si në trajtimin e vargjeve tek apo çift, si në shpërndarjen e rimave, si dhe në copëzimin e vargjeve.

Do t'ia vlente të flitej më gjatë për vargjet e përzier, të cilat, g'është e vërteta, janë përdorur me shumë efekt nga poetët tanë. Po këtu ne u ndalëm sa për të bërë të qartë faktin se vargjet e përzier kanë një konceptim dhe organizim të ndryshëm nga vargjet e lira. Në qoftë se vargu i lirë e përcakton gjatësinë e tij ashtu edhe ritmin e tij në bazë të idesë së shprehur, te vargjet e përzier vargjet në vetvete janë ato të zakonshmet, vargjet e rregullt, që përzihen e copëzohen sipas cezurave kryesore apo të dyta. Si rregull, vargjet e përzier mund të rindërtohen (të bashkohen pjesët e copëzuara apo të thyera) e të japin vargje pak a shumë të rregullt, kurse kjo gjë mund të mos ndodhë me vargjet e lira.

Kur flitet për vargje të lira, duhet folur edhe për strofa të lira, sepse ashtu si ka vargje të lira ka edhe strofa të lira. Një gjë e tillë nuk është pasur kurdoherë parasysh kur është folur për vargjet e li-

ra. Po kjo është shumë e rëndësishme. Ka poezi në vargje të lira që përbëhen nga një strofë e vetme (p.sh. «Një grusht dhë mbi varr» e F. Arapit, «Peizazh nga ballkoni» e D. Agollit, «Natën në bregdet» e Ll. Siliqit etj.) ka të tjera që përbëhen nga dy ose më shumë strofa të lira. Karakteristikë e strofave të lira është pikërisht numri krejt i papërcaktuar i vargjeve që i përbëjnë. Si rregull nuk mund të ketë dy strofa të lira identike përsa i përket numrit dhe llojit të vargjeve, mbasi tipar i përgjithshëm i konceptimit të vargjeve të lira është përpjekja për të plazmuar ritmikisht në mënyrë origjinale e të pa-përsëritshme çdo mendim apo ndjenjë të shprehur.

Ajo që shërben si një strumbullar rrëth të cilin mblidhen vargjet e një strofe të lirë, është një mendim apo ndjenjë e qenësishme. Pak a shumë një gjë e tillë haset domosdo edhe në strofat e rregullta. Nuk do të ishte aspak e vështirë të gjëndeshin shembuj strofash të tilla, të cilat janë të plota në mendimin e tyre dhe, siç është bërë zakon të thuhet, i mjaftojnë vvetvetes. Po në organizimin e një strofe të lirë kjo lidhje pas një ideje apo ndjenje qëndrore prek çdo gjymtirë, si prirjen sintaksore ashtu dhe çdo element të veçantë — *epitet, figurë, mijet plotësues, aliteracion, asonancë apo rimë* etj. **Ke përshtypjen sikur të gjithë gjymtirët vibrojnë nga ritmi i mendimit apo ndjenjës që shërben si qendër rrezatuese.**

Në vargjet e lira të poetëve tanë mund të hasen strofa të tilla që janë ndërtuar me mjeshtëri. Le të shikojmë, p.sh., këto dy strofa të Gaspër Palit nga poezia «Muzg mërgimi»:

*Mbi syt t'lodhun, dalngadalë,
nji tymtajë ndehet.*

*Në dhomë nga çdo anë,
hije burojnë e qasen me hap t'ploshtë.*

Dielli ka mshelë ballin e gjanë.

Poshtë

i njellë zogu zogut, gjumë.

*Hije t'hjellta si selvi,
më murmurojnë:
— Shkëputi syt' e librat treti,
n'ara dil, si dikur fmi.*

Ndërsa në strofën e parë vargjet organizohen rrëth idesë së hijeve të muzgut që ndjell gjumin, në strofën e dytë ato mblidhen qark mendimit se ai çast mbrëmjeje e grish poetin të sjellë ndër mend fëmijërinë. Strofa e parë flet për tymtajë, për hije... Në mënyrë të veçantë aliteracioni në *a* dhe *o* kalon si një fill melodioz për të lidhur gjymtyrët pa zënë në gojë këtu rimat (në fund të vargjeve apo e brendshme) që janë vendosur me kujdes, si piketa paralajmëruese në momente kyç të strofës, në fjalë që të tërheqin vëmendjen (dalngadalë — tymtajë — çdo anë — e gjanë; t'ploshtë — e poshtë etj.). Po kështu edhe te strofa e dytë veprohet me anë të aliteracionit dhe rimës. Në këtë mënyrë të duket sikur fjalët konvergojnë të gjitha te një pikë — te fjala *fmi*, që bart edhe mendimin kryesor të strofës.

Kurse te kjo strofë e Kadaresë, dhëmbja dhe vuajtja e Ilirisë së mundur regëtin te fjalët e zgjedhura posacërisht me *u*, me *k* dhe *r*, *rr*.

*Kur mbreti Genc i krrusur
karrocën têrhiqtë në Harkun e Triumfit
të Romës kreñare,
u nxinë nga turpi këto male.
U nxinë, po s'u dhanë,
u mbështollën me mjegulla.
Nga uria
rrufetë hanin,
dhe prisnin
që turpi të lahej
këto male të shkreta.*

(Shënime për brezin tim)

Aliteracionet e shumta, anaforat (vini re tri u në tre vargje) dhe në mënyrë të veçantë përsëritja e fjalëve këto male, i lidhin vargjet e kësaj strofe si në një vandak të vetëm.

③ Një procedurë e përdorur me të tepërt në vargjet e lira është ajo e anakrusës. Anakrusa është një element muzikor ritmik. Në muzikë ka dy lloj anakrusash: anakrusë përbërëse dhe anakrusë plotësuese. Anakrusa përbërëse është e domosdoshme për melodinë, kurse plotësuesja mund edhe të hiqet pa dëmtuar menjithëkëtë shprehjen e përgjithshme melodike.

Për analogji, në vargjet e lira, anakrusë do të quajmë një rrrokje, një fjalë apo dhe dy, të cilat janë jashë masë se vargut pasardhës e shërbijnë si prelud për kadencën metrike që vjen pas. Rrokja apo fjalë në anakrusë është pra e shkëputur nga thurja ritmike që pason. P.sh.:

Amin!

Priftërit dhe ca poetë në gjumë të vinin...

(Kadare: Përse mendohen këto male)

Tërmet.

U trand Librazhdi e Dibra.

(Siliqi: Në trupin e dheut)

Mbrëmë,

kur nëna ndante bukën në tryezë...

(Arapi: Në tryezë)

Po vallë,

mund të dergjem në dhomë?..

(Agolli: Mendime në vjeshtë)

*...E flisje për èndrra
ti,*

*që vet' ishe èndërr,
e flisje për shpresa*

*ti,
që vet' ishe shpresë...*
(Arapi: Alarme të përgjakura)

Në rastet e mësipërm, e mund të silleshin edhe të tjerë, vëmë re se kemi të bëjmë jo rrallë edhe me anakrusa plotësuese, të tillë që mund të hiqen, mbasi ose nuk janë lidhur sintaktikisht me frazën pas ose janë lidhur dobët ose janë pjesë të tillë, që mund fare lehtë të lihen mënjanë. Kështu janë p.sh. fjalët «Amin!», «Mbrëmë» etj. Nganjana tjetër, te shembulli i fundit vëmë re se praktika e anakrusës muzikore, që e ka vendin kurdoherë, në fillim të melodisë, mund të shtrihet edhe në trungun e poezisë e jo vetëm në fillimin e saj. Kjo është një anakrusë mbasë jo e mirëfilltë, po ka të gjitha vlerat strukturale ritimike të anakrusës së mirëfilltë dhe shërben si për të evidencuar ashtu edhe për të futur ritme të reja në një poezi.

Domosdo, ka anakrusa të cilat nuk mund të hiqen mbasi jo vetëm janë të lidhura sintaktikisht me tërë frazën, po bartin edhe një pjesë të rëndësi-shme të kuptimit. Të tillë anakrusa përbërëse do të ishin:

*...dhe pranvera erdhi...
Nëpër ftyra tona rrëshqiti një gëzim...*
(Migjeni: Ekstazë pranverore)

*Labëria —
hakërrim i rreptë i maleve përqark.*
(Arapi: Baladë për Muço Matohitin)

*U linde
n'atë vit të tymosun...*
(Q. Stafa: Higes së tim vëllai)

*Popujt
janë si anije të mëdha...*
(Kadare: Shënimë për brezin tim)

Anakrusa u jep vargjeve hera-herës një ton disi deklamues, gati-gati oratorik, pra shumë të përshtatshëm për poezi me tematikë shoqërore apo politike, me një frymë të theksuar debati apo polemike. Këtë përshtypje të lënë, për shembull, anakrusat e shumta të poemës të Kadaresë «Shënime për brezin tim». Po kjo mund të thuhet për mjaft anakrusa në poezi të e Ll. Siliqit si: «Kur flet Partia», «Flasin heronjtë» etj. Këtë ton të ngritur oratorik e hasim edhe te shumë poezi të Agollit, Arapit, Matos, Xh. Spahiu, Papplekës, Isakut etj.

Siq mund të vihet re lehtë, anakrusa shërben për të thyer simetrinë ritmike, për të futur kadenca të reja ritmike në trungun e një poezie, sidoqoftë, pra, përti dhënë poezisë në tërsëi mundësinë e një manovrimi më të lirë ritmik. Që këndej kuptohet lehtë se anakrusa në poezi, ndryshe nga ç'ndodh në muzikë, ku përdoret vetëm në krye të melodisë, mund të përdoret, siç e thamë, disa herë në trungun e një poezie, sidomos kur nisin pjesë të ndryshme të asaj poezie apo edhë strofa të ndryshme që kanë një farë pavarësie mendimi, pra edhe ritmi.

Një mendim i gabuar, që ka qenë i përhapur prej kohësh në mes të letrarëve tanë dhe që ka rrjedhur, besojmë, nga një keqkuptim, është ai i vendit që zë rima në vargjet e lira. Keqkuptimi qëndron në faktin se për një farë kohe është pohuar se vargu i lirë nuk e pranon rimën. Kështu psh. në një tekstu shkollar, që është përdorur për vjete me radhë te ne, «Elementet e para të teorisë së letërsisë», Tiranë 1966, thuhet: «Varg i lirë quhet përgjithësisht një varg që nuk i mbahet rregullës së ritmit dhe rimës». Për të provuar këtë përkufizim, që nuk është aspak i drejtë, sillen ca vargje nga poezia e Migjenit «Të birt e shekullit të ri», të cilat kanë edhe ritëm edhe rimë!

Vargjet e lira mund të jenë të bardhë, asgjë nuk e pengon një gjë të tillë, ashtu siç mund të jenë të bardhë edhe vargjet e rrëgullt. Po rima, ky thekës muzi-

kor, siç është quajtur, është një element shumë i rën-dësishëm për ritmin dhe prandaj është tepër e vështirë që një poet ta injorojë kaq lehtë. Aq më tepër, kur në vargjet e lira hiqet dorë nga skemat e vargjeve, nga simetria e hemistikëve, nga alternimi i rregullt i theksave etj., kur, pra, mbeten shumë pak elementë për të ndërtuar ritmin e poezisë etj. Dhe në fakt poetët më të mirë te ne, që shkruajnë në varg të lirë, që prej Asdrenit e deri te Siliqi, që prej Migjenit e deri te Kadareja, që prej Palit e deri te Xh. Spahiu etj.. e kanë përdorur me dashuri të madhe rimën, janë kujdesur së tepërmë për të, kahë bërë çmos që të gjejnë rima të pasura, të reja, jo të kollajta, në mënyrë që të arrijnë efekte sa më të shumta artistike. Ata kanë shfrytëzuar këtu përvojën e popullit si edhe përvojën e poetëve tanë më të mirë, që janë shquar veçanërisht në përdorimin e rimës, si Noli apo Poradeci, dhe kanë dhënë kështu një kontribut të çmuar në trajtimin e rimës së re, në hapjen e horizonteve të reja për thesarin e rimave.

Nuk do të ndalemi këtu te zgjedhja e kujdeshme e me sens të rrallë artistik e fjalëve që mbërthehen në rima, as te rimat e brendshme, te llojet e rimave të forta apo të buta, te rimat e përbërë apo mbështetëse, te asonancat etj. Megjithëse për këto është mirë të flitet. Këtu duam të ndalemi te një fenomen që te ne del për herë të parë me poetët e vargut të lirë, e kemi fjalën për *konsonancën* apo, si i thonë ndryshe, për *rimën apofonike*. Konsonanca në poezinë shqipe nis me Migjenin, po sidomos me poetët më të rinj si Kadare dhe Agolli, përdorimi i saj u konsolidua dhe u përhap shpejt të thuajse gjithë poetët e tjerë. Konsonanca është një fenomen tipik e që theksohet më tepër te vargjet e lira, në tërë botën. Po do të ishte gabim të mendohej se ky është një fenomen i bartur nga gjuhët e huaja. Konsonanca është një fenomen që del shumë në dukje, sidomos me vargun e lirë, lind nga ekzigjencat e këtij vargu, i cili duke dashur të pasurojë fondin e rimave, iu drejtua apofonisë dhe

zbuloi kështu muzikalitetin e konsonancës. Po konsonanca, megjithatë, më shumë sesa të vërë në dukje bashkëtingëlloren (siç do ta kërkonte edhe emri i saj) na thotë mendja se evidencon në të vërtetë zanoren, luan me shndërrimin e zanoreve, duke zbuluar kështu sensibilitetin, shijen e artistit. Megjithatë kjo nuk do të thotë se natyra e bashkëtingëllores te një konsonancë nuk ka asnje vlerë artistike. Përkundrazi. Shpesh vlera artistike e një konsonance mbështetet në natyrën e fortë apo të butë të një bashkëtingëlloreje, po, sidoqoftë, lodra e tingujve zanorë ke përshtypjen se të tërheq më tepër vëmendjen. Ja disa shembuj, ku me pak kujdes mund të zbulohen ato që thamë:

Kur shetis tek lumi

Kur pushoj për gjumë.

Kur nata stoliset

Nënë qiparisat

(Kadare: Berjoza)

Kjo grua që bje erë çokollatë

Tani jeton me burrin në pallatë
(Agolli: Kjo grua)

Përpara gojave të zjarcta të tyre

È me maskën e rëndë në fytyrë
(Agolli: Metalurgët)

Thyerja e vargjeve është diçka që njihet prej kohësh në letërsi. Tragjeditë në vargje, sidomos të klassikëve, janë të mbushura me vargje të thyer, që ua dikton vetë natyra e dialogut.

Kështu vepron Çajupi te «14 vjeç dhëndër», duke i thyer varjet vetëm te cezura e madhe.

Tana: **Dëgio, burrë...**

Vangjeli: **Ç'ke, moj grua?**

Më pas thyerjen e vargjeve, siç e kemi thënë duke folur për Poradecin, e gjejmë herë si fenomen të rastësishëm, herë si praktikë të bërë me ndërgjegje. Kështu, p.sh., te poezia «Poradeci» e Poradecit hasim sidomos:

Zotëroi më katër anët errësira...

Po tashti...

Është fare e qartë që një thyerje e tillë është bërë me qëllim të caktuar artistik.

Poëtët që përdorën vargun e lirë zbulojnë apo, më mirë, rizbulojnë vlerën e pauzave në ritmin e vargjeve. Pauza luan një rol të madh në ritmin e një poezie, sidomos e një poezie që është caktuar përfshirë deklamuar, siç është përgjithësisht poezia politiko-shoqërore e kohëve tonë. Duke dashur të vënë në dukje pauzat, poetët bëjnë çmos përfshirë ndihmuar në *leximin* e pauzës me anë të zberthimit dhe thyerjes së vargjeve. Gjatë zberthimit të vargjeve (d.m.th. kur, një varg, ta zemë, një mbëdhjetërrrokëshi shkruhet si dy apo më shumë vargje njëri ndën tjetrin), poetët kujdesen shumë përfshirë (e jo vetëm ato të cezurave), përfshirë përgatitjen e këtyre pauzave, përfshirë nënvizimin e tyre edhe me rima të brendshme etj. Kështu, p.sh., te Siliqi në poezinë «Me malet, të çuditshmit udhëtarë» lexojmë:

**Cdo gja — solide:
shkambijtë,**

*muret e kullave,
bunorël.
Por jetën n'dorë e mbanin shtrigat,
orët
dhe misërnikja gur në mide.*

Që të kuptohet më mirë puna e kryer prej poetit, le t'i bashkojmë këto vargje të zbërthyer:

*Çdo gja — solide
shkambijtë, muret e kullave, banorët.
Por jetën n'dorë e mbanin shtrigat, orët
dhe misërnikja gur në mide.*

Siq vihet re, vargu i parë ka tiparet e një ana-kruze përbërëse, kurse vargu i dytë ndahet në tri pjesë pér të krijuar më mirë pauzat e enumeracionit, ndërsa vargu i tretë orët veçohet me një pauzë që bëhet më e ndjishme nga rima.

Ky kriter sundon edhe në zbërthimin e strofave që më Shuteriqin e, sidomos më Siliqin e këndej është bërë një fenomen shumë i përhapur në poezinë tonë. Le të shikojmë disa shembuj:

*Më lypset sot:
një kangë, që të mos prante,
goditje,
zjarr,
hakmarrje anembanë,
vargjet-stuhi të zemërakut Dante,
zemrimi i shenjtë i zemërvrames nanë.
(Ll. Siliqi: Borizanët)*

Këto vargje janë në të vërtetë ato të një strofe katërshe:

*Më lypset sot: një kangë, që të mos prante,
goditje, zjarr, hakmarrje anembanë,
vargjet-stuhi të zemërakut Dante,
zemrimi i shenjtë i zemërvrames nanë.*

Kurse këto vargje të D. Agollit janë në të vërtetë distikë të zbërthyer:

Shkëlqejnë mijëra ngjyra,

mijëra drita,

Reklama të verbon sa shuhet dita.

Gulçet

ndër kabaretë rrokenrolli,

përplasen

femrat posи top futbolli...

(Reklama)

Të shkruara ndryshe, kemi:

Shkëlqejnë mijëra ngjyra, mijëra drita.

Reklama të verbon sa shuhet dita.

Gulçet ndër kabaretë rrokenrolli,

përplasen femrat posи top futbolli...

Duke u kthyer përsëri te vargu i thyer ose, siç është bërë zakon të thuhet, vargu majakovskian, duhet poħuar se Majakovskit i përket merita që e ngriti këtë fenomen nga një rastesi në një rregull të qëndrueshëm metrik. Në librin e tij «Si thuren vargjet?» që përmendëm, dhe më lart, ai shpjegon pikërisht edhe se ç'e shtyn të thyejë vargjet e nga c'kritere niset në thyerjen e tyre. Duhet thënë se këtu arsyet që kanë të bëjnë me evidencimin e ideve zenë vendlin kryesor. «Kur bëjmë poezi të caktuara për t'u botuar, shkruan Majakovski, duhet pasur parasysh se si do të mirret (kuptohet, lexohet — Gj. Zh.) ajo që kemi krijuar kür të jetë e botuar. Duhet pasur parasysh lexuesi i mesëm, duhet bërë çmos që lexuesi ta marrë atë që është botuar, pikërisht në atë formë që ka pasur në mendje autori i vargjeve. Shënjat tona të pikësimit me pikat, presjet, pikëpyetjet dhe pikëçuditëset janë tepër të varfëra dhe pak shprehëse në krahasim me nuancat e emocioneve, të cilat i vendos tani njeriu i zhvilluar në një vepër poetike. Përmasat dhe ritmi janë sende shu-

më më të rëndësishme sesa pikësimi dhe ata ia nënshتروjnë vetes pikësimin kur ky mirret sipas shabllonit të vjetër.¹⁾

Duke marrë për model edhe punën e poetëve evropianë, që përdorën vargun e lirë apo edhe atë të Uitmanit, Majakovski arrin të interpretojë në një mënyrë shumë origjinale vargëzimin. Ai e di mirë se mjeshtëria e një poeti qëndron pikërisht edhe në aftësinë për të nënvizuar lëvizjen e mendimit me një lëvizje origjinale të ritmit, për ta bërë vargun sa më të përshtatshëm, sa më të puthitur me idenë e shprehur. Dhe Majakovski dha shembuj të shkëlqyer. Ai nuk mohon asnjë nga arritet metrike apo instrumentuese tradicionale dhe nuk pranon në asnjë mënyrë shkëputjen metafizike nga tradita poetike. Ai vlerëson me të tepër e si askush rëndësinë e ritmit, të rimës, të pauzave, të aliteracioneve etj. Poeti duhet të jetë kërkues, novator edhe në punë të metrikës, po, thotë Majakovski, «novatorja, domosdo, nuk presupozon që të shpallen sentanca për të vërteta të paqena. Ja mbi, vargu i lirë, aliteracioni, asonanca nuk krijohen çdo ditë».²⁾ Ndërsa duke folur për rimën, ai thotë: «... pa rimën (duke e kuptuar rimën në mënyrë të gjerë) poezia thërrmohet. Rima ju kthen te vargu i kaluar, ju bën që ta kujtoni atë, i bën të gjithë vargjet që formojnë një mendim, të qëndrojnë së bashku».³⁾ Dhe pasi quan të pamjaftueshme rimën e mirëfilltë, Majakovski flet për dobinë e asonancave dhe të konsonancave, për rimat e brendshme etj.

Nga tërë këto që u thanë në këto faqe për vargun e lirë, del e qartë një çështje e rëndësishme, e cila nuk duhet lënë kurrë mënjanë, përkundrazi, duhet pasur kurdoherë parasysh nga çdo poet. Kjo çështje ka të bëjë me frymën kombëtare të vargut të lirë. Vargu i lirë, si çdo varg, tjetër, duhet të lidhet mirë me këtë frymë për të fituar personalitetin dhe originalitetin e vet, për

1) Vepër e cituar, f. 36.

2) Vepër e cituar, f. 8.

3) Po. aty, f. 28.

t'u bërë i aftë të lidhet me njerëzit dhe të reflektojë botën shpirtërore të këtyre njerëzve. Vargu i lirë, dhe poezia jonë e re e ka provuar, i ka të gjitha mundësitë të pajiset me këtë fryshtë kombëtare. Ai ia arrin kësaj, para së gjithash, me tematikën e trajtuar, duke dhënë psikologjinë e kombit, historinë dhe shoqërinë shqiptare, po në punë të organizimit formal, nëpërmjet dhënieve poeziës së sintaksit shqiptar, të gjuhës e frazeologjisë shqiptare, të një figuracioni thjesht shqiptar; nëpërmjet përdorimit sidomos të vargjeve popullore si konstante metrike, nëpërmjet ritmit të kohës sonë, nëpërmjet muzikalitetit të rimave dhe instrumentimeve, të ndryshme të vargut duke huajtur kurdoherë nga populli e duke e përdorur në mënyrë krijuarës thesarin artistik të poeziës popullore apo edhe të poeziës së kultivuar të së kalluarës. Vetëm kështu e reja, novatorja do të jetë me të vërtetë e tillë.

12. MIGJENI

Sensibiliteti muzikor te një poet luan një rol të madh edhe në organizimin formal të veprës së tij. Fjala është një mjet përfiksimin, realizimin dhe transmetimin e mendimit, mjet ndërlidhjeje midis njerëzve, një fenomen fiziologjik e shoqërор, po, të mos harrohet, është një tingull, është melodi, është harmoni. Në art, e veçanërisht në poezi, ajo ngarkohet me një përgjegjësi të madhe artistike edhe në këtë vështrim dhe e luan këtë funksion me tërë strukturën e saj si tingull, duke shtënuar në punë përkthimët e gjitha pjesat e saj përbërëse, zanore e bashkëtingëlllore, rrokje tonike apo atone, bashkime më të dendura bashkëtingëllorë apo më pak të dendura etj., kuptohet, domosdo, kur tërë këto vlera muzikore-poetike nuk mirren si qëllime në vetvete, po si mjete përmishërimin e një ideje qëndrore, të cilën e ndihmojnë përtu evidencuar sa më mirë. Për një shkrimitar, pra, fjala është diçka shumë me vlerë.

I themi tërë këto, mbasi me Migjenin, poetin tonë të parë, që punoi tërësisht me varg të lirë, ne hasim një poet që shquhet, vec të tjerave, për një sensibilitet të rrallë muzikor të fjalës, të bisedës së artikuluar. Mi-

gjeni mori shumë prej poetëve tanë të mëparshëm, vëçanërisht prej Mqedës, ashtu siç mori mjaft prej folklorit, sidomos prej atij të veriut, si përsa i përket strukturës poetike sintaksore të frazës së ndertuar, ashtu edhe përsa u përket disa mjeteve karakteristike të instrumentimit popullor. Të gjitha këto ai diti t'i shkrijë dhe t'i pershtasë me mesazhin e ri të poezisë së tij, me personalitetin e tij original, që ngrihej me kaq vendosmëri e guxim në mes të një shoqërie të amullt dhe rakinike, siç qe ajo e viteve tridhjetë. Poezia e Migjenit, edhe në vështrimin formal të saj, ishte antiteza e kësaj shoqërie, ishte zëdhenësja e shpresës, e rinisë, e së ardhmes, e revoltës.

Duke e vështruar në tërësi strukturën formale të poezisë së Migjenit, bindesh se ke të bësh me një dorë mjeshtri në organizimin dhe instrumentimin e vargut. Bindesh, nga ana tjetër, se Migjeni nuk mohon në mënyrë metafizike kanonet e vargëzimit të mëparshëm, se ai e shikon nëpërmjet prizmit dialektik trashëgimin e pasur të metrikës së kaluar, e shikon lidhur ngushtë me nevojat dhe prirjet e tij ideoartistike si qytetar e si poet. Bindesh, veç kësaj, se Migjeni e merr në tërësi përvojën e mëparshme, ligjet metrike dhe rregullat themelore të saj dhe i interpreton ato në një mënyrë të re, herë-herë tepër të pavarur. Shpesh atij i mjafton, për shembull, një konstante metrike për të krijuar mbi të variacione të ndryshme, ashtu si një kompozitor, mbi një motiv të njojur, krijon variacione të ndryshme, që edhe janë edhe nuk janë më po ai motiv. Pikaqështë kështu ndërtohen prej Migjenit vargjet e lira, të cilat, tek ai, janë të lira edhe kur kanë pamjen e vargjeve apo strofave të rregullta. Po në fakt poezi si «Recitali i malësorit» apo «Ekstazë pranverore» janë në esencë të shkruara në varg të lirë, për vetë rrëgullimin e shpërndarjes së rrokjeve, të theksave, të sinkopave, të kundër-theksave, për vetë tonin e bisedës gati-gati të përditshme që ato marrin, për vetë faktin që poeti bën çmos të zhdukë kufijtë fundorë të vargjeve nëpërmjet përdorimit të bartjeve etj. Ajo që e nxit, në ana

lizë të fundit, poetin të veprojë në mënyrë të këtillë, është koncepti që ai ka për poezinë si një bisedë e ngrrohtë, imediate, tepër e afërt me bashkëbiseduesin e përditshëm.

E para gjë që të bën përshtypje te poezitë e Migjenit ~~është ritmi i tyre i përkryer, përherë origjinal, që nuk përsëritet nga një poezi te tjetra, që lidhet në mënyrë kaq organike dhe plot efekt me brendinë ideoemocionale të poezisë~~. Nëse te «Vjeshta në parakalim» ritmi ecën ngadalë, duke i ngarkuar vargjet me një melodi plot brengë e vuajtje, te «Recital i malësorit», poezi e ndërtuar me të njëjtën konstante metrike (njëmbëdhjetërrokëshin), ritmi është disi më i shpejtë, po madhështor, i fortë, të merr me vete, të bën ta lexosh poezinë duke e mbajtur fryshtë për disa herë me radhë në mënyrë që të bucasë mllefi e revolta e malësorit...

Muzikaliteti i ritmit është një komponente me shumë rëndësi në poezinë e Migjenit. Vargjet e tij janë të lidhur kurdoherë ritmikisht me vlerat ideoemocionale dhe sa herë këto vlera ndryshojnë, ndryshon edhe ritmi. Kjo mund të ndodhë edhe brenda së njëjtës poezi. Kështu, p.sh. te poezia «Baladë qytetse», kur vjen puna për të folur për *vallen* e gruas së mjerë nëpër rrugët e qytetit, në mënyrë që sarkazma të dalë më e dukshme dhe therëse, poeti ndryshon menjëherë ritmin, ndërton vargje me aliteracione, me rima të pasura etj. Kështu, nëse në këto vargje thuhet për varfanjakën:

... *një hije grueje,*
... *një kens këso bote,*
... *një fantom uje...*

menjëherë më pas vijnë vargje me një ritëm tjetër, te-për të kadencuar:

...*vallzonte valle* në rrugë të madhe.
Dy hapa para, dy hapa mbrapa
me kambë të zbatun,
me zemër të plasun...

Vini re në vargun e parë aliteracionin dhe rimën e brendshme, ndarjet e qarta të dy vargjeve të parë në hemistikë pesërrrokësh, përsëritjet etj.

Zakonisht Migjeni nuk i ka preferuar vargjet shumë të gjatë, përtej njëmbëdhjetërrrokëshit. Kemi pak poezi me vargje tepër të gjatë si p.sh. «Kanga e perndimit» apo «Shpirtent shtegtar». Konstantet e tij të preferuara janë gjashtërrrokëshi, shtatërrrokëshi dhe njëmbëdhjetërrrokëshi. Migjeni e caktion poezinë e tij më te-për për t'u deklamuar se sa thjesht për t'u lexuar. Në këtë vështrim poezia e tij nuk është, siç thuhet, një poezi syri, po poezi veshi. Duke qenë e tillë, ajo i zbulon vlerat e saj muzikore pikërisht në recitim e sipër. Intuita dhe sensibiliteti i hollë poetik e kanë bërë Migjenin që ta instrumentojë pikërisht vargun, me të tillë mjete kumbuese, tingëlluese, muzikore, që do të shërbenin për të térhequr estetikisht vëmendjen e dëgjuesve — siç janë rimat, asonancat, konsonancat, aliteracionet, përsëritjet, pauzat etj.

Përsëritja, në fakt, është një element artistik i përdorur me shumë efekt prej poetit. Hasim përsëritje fjalësh, vargjesh derisa gjajnë një lulëzim të vërtetë lajmotivesh në poezitë e tij. Dhe në përsëritjet, në mënyrat e përdorura prej tij, na bëhet se nuk gabojmë nëse themi që zbulohet diçka e sensibilitetit muzikor të Migjenit dhe, në të njëjtën kohë, diçka që e lidh atë me vargëzimin dhe instrumentimin populor ku, siç dihet, përsëritja është një normë.

Hasim në anafora interesante:

Ndrithë shkëndi e gjallë në qielë plot me yje,
ndritë shpirti i ri, lidhë me t'arta nyje...
(Shkëndija)

Jetën e rrrokullonte
nëpër udha të ndyta
nëpër skaje t'errta
nëpër pragje të ngurta
ndër besime të rrejta.
(Fragment)

**Kangë Perndimi, kangë njeri të dehun nga besimi
në vete...**

Kangë e tij një fe tjetër...

(Kangë Perndimi)

**... nipat e stërgjyshnavet meleza dhe të lehtë,
nipa donë me mbetë,
nipa të vërtetë...**

(Kangë në vete)

**Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,
kafshatë që të mbetë në fyt...**

(Poema e mjerimit)

Hasim në epanastrofa që të bëjnë përshtypje, si te
ky shembull ku epanastrofa gërshtohet me anaforën:

**... jo! jo! s'i duem humbjet prore –
duem ngadhnjim!**

Ngadhnjim ndërgjegje dhe mendimi të lirë!

S'duem për hirë...

(Të birtë e shekullit të ri)

Apo këta shembuj të tjerë:

**Mjerimi s'ka fund. Por ka vetëm zhelle,
zhelle fund e maje...**

**Mjerimi s'ka gëzim, por ka vetëm dhimba,
dhimba paduruese që të bajnë të çmendesh...**

(Poema e mjerimit)

Gjejmë te Migjeni përsëritje të shumta të llojeve të
ndryshme. Shpesh është e njëjtë fjalë që nis disa vargje,
apo strofa, sic është p.sh. fjala *mjerimi*, me të cilën ni-
sin thua jse të gjitha frazat e «Poemës së mjerimit» —
plot katërmëbëdhjetë herë. Ose përsëritje të tillë:

*...e kjo prapë shtatzanë, mallkon zot e dreq
mallkon sryt'n e vet, mallkon barr'n e randë...*
(Poema e mjerimit)

*Vjeshtë në natyrë dhe vjeshtë ndër ftyra tona
ufshon erë e mekun, lëngon i zymtë dielli,
lëngon shpirt'i smum ndër krahnore tona...*
(Vjeshta në parakalim).

Te vargu i dytë e i tretë i shembullit të fundit, rimat e brendshme e bëjnë edhe më të dukshme përsëritjen.

*Veri frysë pa mshire, si veri që frysë,
dhe si hajn në shtëpijat e kojshive hynë...*
(Kangë në vete)

Te ky shembull, nëpërmjet përsëritjes krijohet një farë harmonie imitative që, duke u organizuar me të gjithë tingujt e tjerë të strofës, të jep përshtypjen e një gulshi ere...

Te shembujt:

Por unë, kur? heu! kur kam pér t'u qeshë?
(Recital i malësorit)

*Pse votrën e le?
Më thuej pse? pse?*
(Shkëndija)

nuk gabojmë nëse shohim një kolorit tepër popullor në këto përsëritje: e para është ndërprerë nga një pasthirrimë (heu!), tepër karakteristike, një detaj i përdorur më shumë mjeshtëri pér të dhënë atmosferën malësore, që kërkon edhe vetë tema e poezisë; e dyta të kujton shumë pér së afërmi përsëritjet popullore, në të cilat vargu i dytë mbaron me fjalën me të cilën, fillon vargu i parë.

Por është pikërisht kur përsëritja merr trajtën e lajtmotivit që ajo bëhet një tipar karakteristik për Migjenin. Në thaujse gjysmën e poezeve të tij ne gjemë një përdorim mjeshtëror të këtij mjeti kaq muzikor. Dhe ashtu si në muzikë, te Migjeni lajtmotivi nën vizion jo vetëm mendimin apo ndjenjën qëndrore, por i jep tonin e atmosferës muzikore krejt poezisë. Kështu te poezia «Të birtë e shekullit të ri», vargu «na të birtë e shekullit të ri» përsëritet katër herë, në krye të çdo strofe. Po kështu përdoret edhe te poezia «Të lindet njeriu», ku vargu «të lindet njeriu» përsëritet katër herë në krye të katër strofave, duke i lidhur si me një fill muzikor strofat, menjimet dhe ndjenjat e shprehura në to. Me këtë procedurë përdoren edhe vargjet

*O vulnete të ndrydhuna!
O vulnete të shtypuna!*

te poezia «Zgjimi». Kurse te «Vjeshta» në parakalim», vargu i famshëm «Vjeshtë në natyrë dhe vjeshtë ndër ftyra tonë» përsëritet te strofa e parë dhe te strofa e fundit. Pikërisht po kështu përdoret edhe në poezinë «Kangë në vete» vargu «Veri frynë pa mshirë, si veri që frynë», kurse te poezia «Ndeshja» vargu «O grue që të ndesha në dit'n e fatkobit tem» përsëritet tri herë: në krye të vjershës, në fillim të strofës së dytë dhe si varg i fundit i krejt poezisë.

Nganjëherë nuk përsëritet i gjithë vargu, po një pjesë e tij si te «Zgjimi» apo edhe te «Kanga skandalozë» (Një murgeschë e zbetë...) etj. Sidoqoftë, Migjeni preferon që lajtmotivin ta vendosë në krye të strofave, me to të nisë e jo të mbyllë poezinë.

Një mjet artistik i përdorur me mjeshteri të madhe prej Migjenit, që dëshmon pa dyshim edhe për shkollën e Mjedës, është bartja. Te Migjeni hasim bartje, që shërbejnë me forcë për të rritur dendësinë emocionale të një figure, si për të nën vizuar një detaj, një ide apo

ndjenjë. Vëreni, për shembull, me sa mjeshtëri vendoset në bartje fjala *rrkajë* te këto vargje:

...që të rrëmbe qetsin' e ban gjaku të të vlojë
rrkajë, e ban synin...

(Të lindet njeriu)

Ose vini re forcën që merr epiteti të *neveritshme* i vendosur në bartje dhe, më poshtë, detaji në fyt:

Në pijetore të qelbta, pranë tryezës plot zdrale
të *neveritshme*, shpirti me etje derdh gotën
në fyt për me harrue nandhetenand' halle.

(Poema e mjerimit)

Kurse te këto vargje, ngjyra e syve jepet me forcë duke fuqizuar epitetin vetëm me anë të bartjes:

...me ftyrë të zbehtë edhe me sy
të zez sijeta e saj...

(Baladë qytetse)

Duhet thënë se bartja është një nga procedurat e preferuara prej krejt poetëve që përdorin vargun e lirë dhe shërben, veç të tjerave, për të thyer në një farë mënyre simetrinë ritmike që do të mund të krijohej në qoftë se në fund të çdo vargu do të mbollej një frazë ose, sidqoftë, një pjesë e saj pak a shumë e plotë në kuptimin e vet. Kësisoj, bartja shërben jo vetëm për të fuqizuar e nënvizuar ide, ndjenja apo figura, por edhe për të ndihmuar së tepërmët në organizimin ritmik të vargjeve të lira. Kjo shpjegon përsë janë kaq të shumta bartjet edhe në poezitë e Migjenit.

Te Migjeni hasim një përdorim me tepër efekt të pauzës. Pauza te poezia e tij zëvendëson zakonisht një ose më shumë rrokje që mungojnë. Praninë e pauzës, në këto raste Migjeni e shënon në më të shumtën me një vizë (-) ose me tri pika. Domosdo pauza shërben

këtu si një prelud i heshtur për një fjalë me një fare
peshe ideoemocionale apo figurative. Ja disa shembuj:

... *vetëm unë me ju po kënaqem si fëmija,*
unë – djepi i juej: ndoshta vorr i huej.

(Kangët e pakëndueume)

... *shpejt mbi te kaluen*
dhe e ...qetsuen.

(Fragment)

Të rroki, të puthi kanga, të nxisi me dashnu
me zjarrin tand, rini... Dhe të na mbysi dallga...

(Kanga e rinisë)

... *një ngjarje të trishtueshme panë:*
Hije... jo! – por një grue...

(Baladë qytetse)

... *e varrosën lagjen pranë,*
dritë, jetë, gjallsi – askund...

(Lagja e vorfun)

Në të tilla raste Majakovski, në vend të vizës apo
të tri pikave, do të përdorte thyerjen e vargut.

Kjo procedurë, siç vihet re, ka një efekt artistik, që
duhet të reflektohet patjetër në recitim për të dhënë
me besnikëri si idene e veprës ashtu edhe muzikalitetin
që ka pëlqyer poëti në atë rast. Nuk gabojmë nga ana
tjetër nëse themi se Migjeni, fill pas Poradecit, është
i pari në poezinë tonë që e përdor në mënyrë kaq
të vetëdijshme efektin e pauzës në krijimtarinë e tij
poetike.

Rëndësi në leximin e vargjeve të Migjenit ka edhe
sqarimi i pozitës së ë-së. Ke përshtypjen se ai merr
një liri të tepruar në leximin apo mosleximin e saj.
Sidoqoftë, të bëhet se, në më të shumitën ai nuk e lexon,
sidomos kur nuk është e theksuar dhe zë vend pas
rrokjes së theksuar apo kur bën pjesë në fjalë të shkurt-

tra, veçanërisht njérrokëshe si nyje, parafjalë, përemra etj. Kështu p.sh. nuk duhen lexuar ë-të në këto vargje:

*Thelltë në veten teme flejnë kangët e pakëndueme
të cilat ende vuejtja as gëzimi s'i nxori
të cilat flejnë e presin një ditë ma të lumnueme,
me shpërthyje, m'u këndue pa frigë e pa zori.*

Karakteristikë e poetëve që përdorin vargun e lirë është, veç të tjerave, pranimi i hiatusit. Dhe në fakt edhe në vargjet e lira të Migjenit, ashtu si dhe në vargjet e lira të poetëve tanë të rinj, ne hasim hiatuse jo vetëm të rastëshëm, por edhe të kërkuar. Kështu, p.sh. te Migjeni gjemjë të dyja llojet:

*a asht zoti pjella e tij
apo ai – vetë pjella e zotit...
... ka ardhë një kohë...*

(Parathanie e parathanieve)

*... se dheu i ynë qe kafshatë e hënëj...
(Të birtë e shëkullit të ri)*

*... të cilat ende vuejtja as gëzimi s'i nxori...
(Kangët e pakëndueme)*

*... aq largë asht dielli nga e emja gropë, –
e kjo gropë e eme e ka emnin burg.
(Kanga e të burgosunit)*

*... dhe e ... qetsuen.
(Fragment)*

*... e akorde t'arië.
(Lutje)*

Disa nga këto hiatuse janë të rastit, megjithatë mund të shambaheshin, po poeti nuk e ka bërë, sepse ai e ndierente që edhe hiatusi mund të shërbëjë për të prishur

simetrinë ritmike dhe të kontribuojë për të dhënë afri-
min me ecurinë e një bisede të zakonshme. Kurse ka
hiatuse, edhe në këta shembuj, që janë të kërkuar. Kësh-
tu, hiatuset e shembujve të katërt e të pestë duket si-
kur kanë funksione artistike — i pari për të bëri më
të ndieshëm edhe muzikalish, me hapjen e gojës, llah-
tarën e *gropës*, kurse te shembulli tjetër hiatusi e bën më
të theksuar pauzën që vjen pas.

Sic e kemi thënë diku edhe më lart, Migjeni përdor,
megjithëse jo shumë, edhe anakrusën e jo vetëm në krye
të poesisë, por edhe në trung të saj, domosdo kur fi-
llojnë strofa apo pjesë të reja të një poezie. Në pjesën
më të madhe janë anakrusa përbërëse. P.sh.:

*Mbramë
qiella dhe hyjt' e vramë
një ngjarje të trishtueme*
(Baladë qytetse)

Ndërsa dy vargjet që vijnë pas janë shtatërrorësh,
Mbramë si një anakrusë përbërëse mbetet jashtë ritmit
të përgjithshëm të konstantes metrike për të theksuar
me këtë thyerje ritmike, që të detyron të bësh një pauzë,
vlerën figurative të kësaj fjale. Po te kjo poezi, në
trung të saj, ka edhe anakrusa të tjera sic janë:

*Dikur,
kur gjit' e saj me kreni...
...
E sot?
Jeta e saj asht kjo vall' e çmendun...*

Një vëmendje të veçantë kërkon patjetër puna e
hollë që ka kryer Migjeni me rimën. Mund të thuash
pa frikë se Migjeni është i dashuruar pas rimës dhe
përpiqet që ajo të kumbojë në vargjet e tij me të gjitha
mënyrat dhe Hojet e saj. Prej Migjenit rima është
përdorur me shumë funksione: si faktor i rëndësishëm për
të krijuar harmoninë ritmike për t'u dhënë vargjeve

të lira një pamje të organizuar muzikore; si mjet për të nxjerrë në pah ide apo emocione të caktuara dhe, së fundi, si fill lidhës për organizimin e strofave të lira. Atë e hasim të llojeve të ndryshme përsa i përket vendit. Nëse gjejmë të preferuar prej tij rimën e përputhur me prirje herë-herë për monorimë, rimat e brendshme, rimat midis hemistikëve apo në pozicione nga më të ndryshmet janë shpesh të tilla që të befasojnë më praninë e tyre. Po, më mirë, le të shikojmë disa shembuj:

*Na të birtë e shekullit të ri
që plakun e lamë në «shejtnin» e tij,
e ćuem grushtin për me luftue
ndër lufta të reja
dhe me fitue...*

(Të birtë e shekullit të ri)

*... i cili fatin tonë mbytë në mnijë të vet përpise
ta dijë se të Birt' e Shqipes folen ja ngrehën vetvedit.*
(Zgjimi)

*...Mbi lëkurë të tij, në lojë varrimtare
kërkojë më gjetë një kafshitë ma të mirë.*
(Recital i malësorit)

*... me gjoksa të lakuartë e të thatë
e gratë... fëmi po u lejnë...*
(Lagja e vorfun)

Vëreni, përvëç rimave fundore, rimat midis fjalëve, diku pranë cezurave:

*Ndritë shkëndi e gjallë/ në qiellë plot me yje,
ndritë shpirti i ri/ lidhë më t'arta nyje...*
(Shkëndija)

*Mjerimi rrítë fëmin/ në hijen e shtëpive
të nalta, ku nuk mrrinë/ zani i lypsis...*
(Poema e mjerimit)

*Nëpër ftyra tonal rrëshqiti nji gëzim
dhe ndër zemra tonal ngrehi një fole...*

(Ekstaza pranverore)

Kjo lloj rime e brendshme mund të marrë edhe forma
të tillë:

*Sa bukur shkëndija xhixhillon n'errësinë,
vallzon bashkë me hyje dhe andrron lumnin...*

(Shkëndija)

Këtu, përveç rimave fundore, kemi dhe rimat midis
fjalëve *xhixhillon* – *vallzon* – *andrron* si edhe rimën
apofonike (konsonancën) midis *shkëndija* – *hyje*.

Po kjo ndihet, me asonancën e rimën, edhe te vargjet
e fillimit të po kësaj poezie:

*Nga zjarrmi i votrës u shkëput nji shlcëndi
dhe nëpër oxhak u vërsul në liri...*

Apo te këto vargje:

*Ta dij dhe ai se ç'do me thanë i dobët –
n'agoni të përdihet si vigan i vramë.*

(Recital i malësorit)

Ke përshtypjen se në mjaft poezi Migjeni i jep
rëndësi cilësisë së zanoreve apo dhe të bashkëtingëllorreve
për të përfthuar me përdorimin e tyre një farë
harmonie (herë-herë plotësisht imitative) për qëllimet
e veta ideoartistike. Kështu p.sh. te strofa e parë e
poezisë «Vjeshta në parakalim», nëpërmjet mbisundimit
të o-së dhe të y-së, kombinuar kjo me pasurinë e rimave
të brendshme ku është e pranishme sidomos o-ja, përfthohet një muzikalitet plot trishtim...

*Vjeshtë në natyrë dhe vjeshtë ndër ftyra tona,
afshon erë e mekun, lëngon i zymtë dielli,
lëngon shpirti i smum ndër krahnore tona,
dridhet jet' e vyshkun ndër gemba të nji plepi.*

Kjo gjë bie në sy në mënyrë flagrante te një poezi si «Melodi e këputun», ku përdorimi i u-së, thua jse në të gjitha rimat e poezisë dhe në mjaft aliteracione, krijon melodinë e përvajshme kaq shumë të përshtatur me temën e trajtuar. Le të shikojmë për këtë qoftë edhe vetëm dy strofat e para:

Melodi e këputun — lot i kjartë nga syni

i një grues së dashun...

andje e përplasun,

xhevahir i tretun,

një andërr e shkelun,

buzë e paputhun

në melodin' e këputun.

Nga vaji i heshtun shkunden supat e zhveshun,

verbojnë nga zbardhimi...

e therë, therë hidhnimi

për çastet e rrëshqitun,

për fatin e hikun,

për gëzimin e humbun,

në melodin' e këputun.

Këtu, siç u tha, të gjitha mjetet — rimat, asonancat, aliteracionet (shih p.sh. vargun e parë të strofës së dytë, aliteracionin me *u* dhe *sh* etj.) lajmotivi e sidomos mbisundimi i *u*-ve kontribuojnë me forca të përbashkëta në krijimin e muzikalitetit të kërkuar.

Siç doli edhe nga shembujt që kemi prurë gjer tani, Migjeni është i pasur me asonanca dhe ka shtyjen e intuitsës që të kujton jo pak F. Nolin për t'u kujdesur për cilësinë fonetike të fjälëve të përdorura, duke zgjedhur tingujt sipas rastit. Por ajo që duhet nën vizuar këtu është fakti se Migjeni është i pari në poezinë tonë që përdori rimën apofonike (konsonancën). Të tillë janë:

...therin qiellën kryqat e minaret e ngurta,

profetent dhe shëjtent në fushqeta të shumngjyrta

(Poema e mjerimit)

Kaloi rrugës së qytetit si ejll i arratisun...

*...me buzë të holla të kuqe, dy gajtana pshertimet
që mbysin...*

(Kanga skandaloze)

Na shtypi fati e na bani krymba...

...shpirtet tanë skyftëra deshën të bahan pëllumbat.
(Pesha e fatit)

Nuk mund të mos të të tërheqë vëmendjen te vargjet e lira të Migjenit, siç u tha, fakti i sensibilitetit muzikor që ka poeti dhe që e bën të shikojë afrim tingujsh, gati-gati si embrione rimash, te fjalë që nuk mund të katalogohen as si rima të mirëfillta, as si konsonanca apo asonanca. Megjithatë në këto fjalë, të marra dy e nga dy, ndodhen thuajse tinguj të njëjtë, vetëm se janë të shpërndarë në pozicione të ndryshme. Kështu p.sh. te poezia «Hidhet e përhidhet» gjemë të tilla «rima»:

*...se qiellat e huaja premtojnë gëzime t'ambla
nëpër shkalla të huaja, nën të ngjyrtat llampa...*

*...e mbrenda krahnorit gati të pëlcasë zemra,
nga majet e këpucvet shkaravasin germa...*

*...në thalbin e mollës... e syni i të riut
merr hijën e vendit, hijën e murit...*

Po të marrim çiftet *t'ambla* — *llampa*, *zemra* — *germa*, të *riut* — *murit* vemi re se me një zhvendosje e ri-vendosje të re të tingujve, që i formojnë, këto fjalë do të ishin bërë ose rima të plota ose asonanca. Afëria që kanë në përbërjen e tingujve e bën intuitën, e poetit që t'i çiftëzojë. Kjo ndodh edhe me shumë fjalë të tjera, brendaperbrenda të njëjtit varg, duke zbuluar kështu një prirje të natyrshme të poetit drejt aliteracionit apo harmonisë imitative. Shembujt janë të shumtë e do të meritonin secili një vëmendje të veçantë për të parë, veç të tjerave, intuitën muzikore të poetit. Po citojmë disa shembuj aliteracionesh apo harmonish imitative,

të cilat, kuptohet, janë lidhur kurdoherë ngushtë me kuptimin ideomocional të poeziës:

*Tash shëgjetat e flakta të shprehjes suej zharritse...
(Zgjimi)*

...profetent dhe shejtent në fushqeta të shumngjyrta shkëlqejnë...

*...mbi pecat e mykta, të qelbta, të ndyta, të lagta...
...kafshojnë, përpijnë, thithen, puthen buzët,*

e ndragta edhe shuhet uja, dhe fashitet etja...

(Poema e mjerimit)

Vini veshin se si kumbojnë o-të dhe u-të te këto vargje plot trishtim e me ritëm të ngadaltë:

*Në vendin tonë
kudo valojnë
flamujt e një melankolije
të trishtueshme...
...dhe askush s'mund të thotë
se këtu rron
një popull që ndërton
diçka të re.*

(Nën flamujt e melankolisë)

Ose e-të dhe t-të te këto vargje:

Thelltë në veten teme flejnë kangët e pakëndueme...

Thelltë në veten teme kangët e mia jeshin...

(Kangët e pakëndueme)

Nuk ka dyshim se aliteracioni dhe harmonia imitative, së bashku me mjete të tjera, shërbejnë te Migrjeni, veç të tjerave, edhe për të kontribuar në organizimin ritmik. Interesante është të ndjekësh punën e Hollë, e do të thoshja prej filigrane, që bën poeti për të organizuar strofat e tij të lira. Ai bën qmos me

anë të ritmit, me anë të rimave, aliteracionit, me anë të bartjeve apo edhe inversioneve, që janë kaq të shumtë në poezitë e tij, që gjithçka në strofat e tij të pështillet qark fjalës qëndrore, gjithçka të të cojë drejt mendimin apo ndjenjës që shërben si bosht. Nga ana tjetër, Migjeni pëlqen në më të shumtën që çdo strofë ta nisë me përsëritjen e vargut lajtmotiv dhe ta mbyllë thuajse kurdoherë me një rimë oksitone. Po më mirë le t'u drejtohem shembujve, mbasi është krejt e pamundur të zbulosh ligje dhe rregulla strikte në organizime të lira, siç janë vargjet dhe strofat e Migenit.

Te «Poema e mjerimit» thuajse çdo strofë nis me fjalën «mjerimi», një lajtmotiv i vërtetë. Në këto strofa rimat, asonancat, konsonancat, aliteracionet etj., gjarpërojnë midis vargjeve për të térhequr vëmendjen tonë rrëth fjalës kyç. Ja një shembull nga kjo poezi:

*Mjerimi gjithashtu len edhe në trashigim
— jo veç nëpër banka dhe në gja të patundshme,
por eshtnat e shtrembta e në gjoks ndoj dhimbë,
mund që të len kujtim ditën e dikurshme
kur pullaz' i shtëpis' u shemb edhe ra
nga kalbsin' e kohës, nga pesha e qiellit,
kur mbi gjithçka u ndi një i tmerrshmi za
plot mallkim dhe lutje si nga fund i ferrit,
ish zan' i njeriut që vdiste nën tra.*

Figura qëndrore që bart edhe mendimin kryesor në këtë strofë është pullazi i shembur në krye të varfanjakut. Strofa nis me sarkazmën që na térheq menjëherë vëmendjen te «trashigimi». Térë kjo lidhet me rimën që kalon nëpër vargje: trashigim-dhimbë-kujtim-kalbsin'-mallkim. Por edhe kjo lidhje rimash të shtyn drejt fjalëve që bartin idenë kryesore dhe që lidhen edhe ato me fillin e rimave: gja-ra-gjithçka-za-tra. Strofa mbyllitet pikërisht me rimën tra. Të gjitha këto rima që thamë e téré elementët e tjerë, që nuk u përmendën në këtë strofë, po që bien në çast në sy, të bëj-

në ta parafytyrosh vetë strofën si një grumbull rrënojash, mbi të cilat përplaset dhe trari i fundit...

Poezia «Zgjimi» është e përbërë nga tri strofa, që shquhen fare qartë. Ato nisin të gjitha me lajtmotivin «O vullnete të ndrydhuna! O vullnete të shtypuna!». Te strofa e dytë, sidomos, intuita e poetit punon më të madhe në mënyrë që gjithçka të verë në dukje fjalën qëndrore «turnju», që bart kushtrimin për lüftë. Drejt kësaj fjale kushtrimdhënëse, që është vënë me mjeshtëri në krye të vargut dhe thuaçse në qendër të strofës, konvergojnë të gjitha mjetet si aliteracionet në *sh*, së të vargjeve të para ashtu dhe *i-të* e shumta të vargjeve pasardhës; këto i nga ana tjeter të përgatitin përimat *Illyri-liri*, që shpjegojnë kaq bukur përsenë e kushtrimit, qëllimin e luftës dhe shembullin që duhet marrë.

Nuk mund të mbyllim këto radhë kushtuar Migjenit pa u ndalur qoftë edhe vetëm për një çast të proza e tij. Jo rrallë ke përshtypjen duke lexuar ato proza, se midis tyre dhe poëzive shpesh kufiri ritmik është shumë i dobët. Ke përshtypjen sikur Migjeni nuk mund ta përfytyronte prozën pa ritëm, në një farë mënyrë të kadencuar. Kjo gjë zbulohet thuaçse në tërë prozat e tij, në strukturën e tyre sintaksore, në tempo-ritmin që vendos në to poeti nëpërmjet përsëritjeve, lajtmotiveve, vargjeve, rimave, aliteracioneve etj.

Përvoja e Migjenit në trajtimin e vargut të lirë duhet të studiohet shumë më gjërë e shumë më thellë nga ç'u bë në këto faqe, që kanë për qëllim të jatin vetëm një skicë të këtij poeti si lëvirues i shkëlqyer i vargut të lirë. Dhe duhet theksuar se ai i ka shokët të rrallë në poezinë tonë si mjeshtëri i këtij vargu. Brezat që erdhën më pas e morën si model punën e tij edhe në këtë vështrim dhe kjo u shërbeu dhe u shërben akoma me forcë për ta çuar përpara poezinë shqiptare. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshe, mbasi poezia e fuqishme e Migjenit, e lidhur kaq bukur me popullin dhe idealet e tij të mëdha, është me një fuqi të jashtëzakonshme ndikuese. E ky ndikim u ndje që kur ishte gjallë poeti. Poëzia e Migjenit ndikoi jo vetëm më tema-

tikën, me idetë, me përjetimet, me qëndrimin ideoemocional, por edhe me formën e saj, me organizimin e vargjeve të lira. Muzikaliteti i ri, që shpërthente në vargjet e tij, i befasoi njerëzit. Kristaq Tutulani, një adhurues i zjarritë i Migjenit, ka shkruar më 1940: «...megjithëse ndiesia muzikore e tij është diçka e veçantë, që s'i përgjan melodisë melankolike e të butë të ndonjë poeti tjetër shqiptar, prapëseprapë kushedi sa vargje na magjepsin me muzikalitetin e tyre».¹⁾

Ndikimin e vargut të lirë të Migjenit do ta gjejmë te poetë si Gaspër Pali, Platonicus, Helenau, Qemal Stafa etj. bashkëkohës të tij. Këta poetë, kush në një drejtim kush në një tjetër, u lidhën me përvojën e re që kishte sjellë në poezinë shqiptare Migjeni dhe, duke u përpjekur të përfitojnë nga teknika e tij e re, bënë çmos që ta përdorin atë në mënyrë origjinale duke iu kundervënë edhe me këtë poeziს estetizante, klasikegjante dhe klerikale të kohës. Ata nuk mund të pranonin formalizmin, i cfarëdolloj natyre të ishte ai, qoftë edhe ai i një folklorizmi të sofistikuar. Poetët e rinj e kapën me përgatitjen dhe intuitën e tyre, kush më herët e më lehtë e kush më vonë e më me vështirësi, mësimin e Migjenit. Kjo poezi duhej të ndryshonte patjetër edhe në formë ashtu siç ndryshonte në brendi nga poezia zyrtare dhe e kurorëzuar e kohës. Të qepeshe pas formave të jashtme të folklorit, duke marrë nëpër këmbë e flakur tutje brendinë e tij të fuqishme realiste, donte të thoshte për këta poetë të rinj të kryeje punën e një mistifikatori. Duhej synuar, para së gjithash, në psikologjinë e popullit, që është fiksuar me aq mjeshtëri në folklor. Këtë bëri Migjeni me esencën e bredisë së vargjeve të lira dhe të prozës së tij, duke sheshuar udhën për një afrim të ri ndaj folklorit. Këtë mësim kuptuan poetët më të mirë bashkëkohës të tij, duke u orientuar me vështirësi në kaosin ideo- logjik e artistik të asaj periudhe.

1) Migjeni, Veprat, Tiranë 1962, f. 35.

14. POEZIA E RE. MEMO METOJA

Poezia e re, që lindi që gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe u zhvillua nëpërmjet një revolucionarizmi të brendisë dhe një ripërtërítjeje të gjithanshme të formës në unison me kërkosat ideoartistike dhe ritmin e kohës, u formua duke mbajtur kurdoherë një lidhje dialektike me poezinë e së kaluarës. Ajo u kap pas traditës më të shëndoshë të saj, pas krahut të saj demokrat të përfaqësuar nga Naimi me shokë, në luftë me krahun e saj konservator të përfaqësuar nga Fishta me shokë. Poezia konservatore, klerikale dhe antipopullore e kredhur në ujërat e akullta të neoklasizmit apo dhe të një formalizmi antiartistik, që jo rrallë mërrte dukuritë e një folklorizmi anemik, e dënoi vetyveten me pozitën antipopullore e profashiste të hapur reaksionare që mibajtën përfaqësuesit e saj, sidomos gjatë luftës së popullit përçirimin nga zgjedha nazifashiste. Qëndrimi i tyre formalist ndaj folklorit duket veç të tjerash edhe në konceptimin përfolklorin si një ornamënt i jashtëm dhe ekzotik, me të cilin mund të pajiset një poëzi, pavarësisht brendisë së saj. Ky është mësimi që del nga

vargjet e Fishtës dhe që, i çuar më tej, dha nëpër poezi psikologji zotërinjsh e zonjash salloni që shtiren si barinj e baresha, e borgjezë që lektisen pas dashurisë duke marrë hua qëndrime dhe frazeologji fshatarake... Me dashje a padashje, një poezi e tillë të kthente në kohën e eklogave baritore të periudhës së rënies së poezisë klasike greke e latine apo në pastoralet e pudrosura të aristokracisë mesjetare... Një konceptim i tillë i folklorit mohon, domosdo, esencën e folklorit, vlerat e tij klasore, pasurinë e tij ideoartistike, që përbën thelbin e brendisë së tij. Në një konceptim të tillë edhe veçoritë metrike nuk janë veçse një lodër e kotë ritmi e melodie, që nuk kanë asnje funksion të lidhur me brendinë, janë ornamepte të jashtme që shërbejnë vetëm sa për të krijuar një dukuri të rrreme të frysës popullore.

Poezia e re shqiptare, sidomos ajo prej Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare e gjer në ditët tona, vuri në bazë të saj popullin me tërë aspiratat, kërkesat, pëlqimet dhe qëndrimet e tij. Poezi e destinuar për popullin, vetëm për vegjelinë e qytetit e të fshatit, ajo nuk mund të mos spastronte para së gjithash nga rruga e saj çdo gjë që, në një mënyrë apo në një tjeter, e pengonte për të realizuar gjer në fund demokratizimin e saj, shkrirjen e plotë me tiparet më të forta, më të bukura e më përparimtare të poezisë popullore. Ky raport dialektik i saj me folklorin prek të gjithë elementet, qofshin të brendisë, qofshin të formës. Sot flijtet për nevojën e përsosjes së këtyre raporteve, për ngritjen e tyre në një nivel më të lartë cilësor. Dhe kjo duhet thënë, domosdo, edhe për organizimin dhe instrumentimin e vargut. Nuk ka asnje dyshim se në këtë lëmë janë arritur suksese të mëdha. Poetët tanë kanë ditur të përfitojnë nga tradita jonë e vjetër apo dhe ajo e krijuar gjatë këtyre viteve duke e ngritur nivelin e përgjithshëm cilësor të poezisë sonë, duke theksuar përherë e më shumë frysën e saj kombëtare popullore.

Do të ishte gabim, megjithatë, po të mendoje se

poezia jonë e re, në vazhdën e traditës më të mirë, është mbështetur vetëm në folklorin tonë të pasur për të çarë përpara. Në qoftë se lidhjet e saj me folklorin sot janë të forta, pavarësisht se ato lipset të jenë akoma edhe më të thella e më të përsosura, nuk duhet thënë aspak se jeta e poezisë sonë zhvillohet e shkëputur nga ajo e poezisë përparimtare botërore, qoftë të së kaluarës qoftë asaj bashkëkohore. Përkundrazi, lexuesit shqiptarë, e me ta edhe poetët tanë, u njohën me vlerat e shëndosha përparimtare e revolucionare të poezisë botërore pikërisht pas qirimit, kur nisi të njihet gjerësisht ky thesar te ne me përkthime që sa vjen e po bëhen më të goditura. Ne njohëm e po njohim të plota kryeveprat e Homerit dhe të Pushkinit, të Bajronit dhe ato të Hajnes, të Dantes dhe të Majakovskit, të Hygosë dhe të Uitmanit, të Lukrecit dhe të Breshit, të Gëtes dhe të poetëve zezakë amerikanë, të Bërsnit dhe të Petëfit, të Horacit, dhe të Lorkës, të Atilës, të Volkerit, të Varnalosit, të Preverit, të Kuazimodos etj. Nuk ka asnje dyshim se një kontakt i tillë me poetë të fuqishëm nuk mund të mos ndikojë për të mirë. Dhë kjo ndihet qartë në poezinë tonë, e cila duke u lidhur me traditën e përvojën përparimtare botërore, por e brumosur siç është me filozofinë dhe estetikën marksiste-leniniste, ka ditur të ruajë e të forcojë personalitetin e saj, ka ditur të mos bëhet epigone, po përkundrazi ka qenë kurdoherë e freskët, origjinale, qind për qind shqiptare e duke tërhequr pikërisht me këtë origjinalitet vëmendjen edhe të lexuesve të huaj. Kjo njohje e gjithanshme dhe e thelluar me poezinë botërore, hodi poshtë, nga ana tjeter, dhe vizionin e gabuar të paraçlirimt për këtë poezi, që paraqitej prej «krrëve» të poezisë shqiptare si e mbërthyer në trajtat e ftohta të neoklasizmit, e ndrydhur nga një varg i tërë rregullash e ligjësh përbrendinë dhe formën e saj, që kishin si rezultat pengimin e trajtimit të temës së kohës, të temës aktuale, të botës shpirtërore të njeriut të dalë nga populli etj.

Poetë si Meto, Musaraj, Jakova, Shuteriqi, Varfi, Çaçi, Gjata, Qafzezi etj. duke çuar më tej mësimet e Naimit e Migjenit, Çajupit dhe Nolit kryen hapin e parë të madh drejt demokratizimit të mëtejshëm të poezisë shqiptare. Ata vunë në qendër popullin, njeriun e ri që po lindte nga Lufta Antifashiste Nacionalçirimtare dhe për një brendi të tillë të re ditën të farkëtojnë edhe një ritëm të ri, ditën t'i japid vargut të tyre mjete të tillë organizuese që ta bënin atë të aftë për të reflektuar brendinë e re. Këtë varg ata nuk e shpikën, por e morën në popull. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshtësi që se dëshiron të kuptohesh prej popullit, duhet patjetër që t'i flasësh me gjuhën e tij.

Na bëhet se një rezultat tepër i dukshëm, që bie menjëherë në sy në poezinë e re shqiptare, është harmonia, që sa vete bëhet më e plotë midis folklorit dhe poezisë së kultivuar. Kjo harmoni, kuptohet, ka të bëjë në radhë të parë më brendinë e pastaj me formën (e në këtë mes edhe me vargëzimin). Kjo harmoni qëllimësh e mjetesh artistike të përdorura arrihet, nga ana tjetër, në mënyrë dialektike nga të dy palët — poezia e shkruar mbështetet fuqimisht në poezinë popullore, por edhe kjo ndikohet nga poezia e shkruar. Si rrjedhim i ndodh nganjëherë një fenomen i tillë kur një poet anonim popullor kthehet ca nga ca e bëhet një poet i afirmuar popullor. Ky është rasti i një poetit të fuqishëm si M. Metoja apo edhe i Sh. Pegit, L. Çipës e mjaft të tjerëve.

Edhe poetë të tjerë si D. Agolli, Ll. Siliqi, I. Kadare, F. Arapi, K. Petriti, P. Jorgoni, A. Mamaqi, N. Gjetja, N. Pappleka etj. kanë ditur të forcojnë lidhjët me praktikën popullore dhe me krejt traditën e shëndoshë të vjetër e të re e në të njëjtën kohë ta pasurjoinë edhe vargëzimin shqiptar me procedura, mjete dhe mënyra të reja metrike. Duke futur një tematikë të re në poezitë e tyre, duke futur ambiente, situata, personazhe dhe përfjetime të reja, ata e ndienë nevojën për të përshtatur edhe hapin ritmik të var-

gjeve të tyre me hapin ritmik të kohës. Në një gjendje të tillë edhe përvoja përparimtare botërore nuk miret prej tyre si një klishe apo si një kallëp i gatshëm. Në vargjet më të mira të këtyre poetëve ndihet kurdoherë kumbimi shqiptar, ritmi dhe instrumentimi i vargut shqiptar, që rrreh të mishërojë psikologjinë e re shqiptare. Nëse do të flitej përmodele, këta poetë kanë para së gjithash modelet e poetëve shqiptarë. Kështu Siliqi merr shumë prej Mjedës e Migjenit, ashtu si Kadareja merr prej Naimit e Migjenit, apo Agolli prej Naimit dhe Çajupit e kështu me radhë, pa zënë në gojë këtu që përvoja e Nolit apo dhe e Poradecit vazhdon të ndihet. Poezia e re shqiptare ka sot një përvojë të madhe dhe të shumëyer në punë të metrikës, jo vetëm në vargëzimin me vargun e rregullt, por edhe me atë në vargun e lirë. Kjo ka bërë që në të të përforcohet edhe në çështjet metrike një fizionomi kombëtare, një origjinalitet që shtrihet që prej vargut të rregullt deri tek ai i liri. Këtu duhet bërë akoma më shumë sepse, vec të tjerave, ende thesari metrik i vargut populor nuk është zbuluar krejtësisht e ca, më pak përdorur krejtësisht — në përshtatje, domosdo, me niyelinje kërkuesave të shoqërisë sëndaj artit.

Vargjet e Memo Metos, të analizuar përnga struktura metrike dhe përm nga instrumentimi i tyre, lidhen ngushtë me popullin, me mjetet dhe procedurat që gjemë në popull, prej kohësh. Po brendia e re i bën të reja edhe procedura e mjete, që ndryshe do të tingëllolin, në mos tjetër, anakronike. Në dorën e M. Metos struktura e brendshme e vargut është shkathësuar. Vulli ritmik i renditjes së theksave, duke marrë kryesish një prirje ngjitëse, reflekton kohën dhe është, në përputhje të plotë, me brendinë e re që solli Lufta Antifashiste Nacionalclirimtare.

M. Metoja, shembull i përkryer i një poeti të ri

popullor, në krijimtarinë e tij pati shumë parasysh përvojën poetike të Naimit dhe Çajupit. Kjo ndihet në shumë anë të krijimtarisë së tij, si në mënyrën e poetizmit të realitetit shqiptar, si në gjuhën e përdorur ashtu edhe në vlerat metrike. Kjo të bën të mendosh se ndonëse u nis nga populli, nga poezia më gjenuine popullore, nga konceptimi thjesht popullor për poezinë ku këngë e poezi janë një, prapëseprapë modeli për të ka qenë Naimi e Çajupi. Këtu nuk ka asnje kontradiktë, përkundrazi, mbasi si Naimi dhe Çajupi janë në esencë e në mënyrën e vet dy poetë autentikë popullorë.

Para së gjithash duhet thënë se M. Metoja e mbështeti tërë krijimtarinë e tij te tetërrrokëshi popullor. Nga njëzet e pesë poezi, që na kanë mbetur prej tij, njëzet e tre janë shkruar në tetërrrokësh. Dhe ky varg haset si në poezi epike ashtu dhe në poezi lirike apo edhe satirike. Ky besim në tetërrrokëshin të kujton besimin e patundur, ta zemë, të Naimit që, siç e kemi thënë, shkroi me të shumicën dërrmuese të vepgrave e kryeveprave të tij. Tetërrrokëshi i M. Metos, megjithatë, fiton një muzikalitet të ri për nga vetë brendia, për nga fenomenet, ngjarjet dhe realiteti i ri që poetizon. Nuk gabojmë shumë, nga ana tjetër, nëse themi se në vargjet e tij, për herë të parë në poezinë shqiptare, hasen kaq dendur fjalë të tillë, që më pas do të bëhen krejt të zakonshme si: partizan, Parti, proletar, shok, komunizëm, komunist, grupi i çetës, grupi i rini-së, direktivat e Partisë etj. Të gjitha këto shprehin bagazhin e ri ideoemocional të poezisë së M. Metos.

Tetërrrokëshi i M. Metos është i instrumentuar plotësisht sipas frysës popullorë, ku vendin kryesor e zënë sidomos rimat. Ka poezi si «Po gjëmon shuri përpjetë» që kanë prej fillimit e gjer në fund një rimë, kurse poezia «Kurvelesh, zemëra ime» e ka monorimën të shtrirë togje-togje, sipas frazës e kuptimit të saj, krejt ashtu siç ndodh në popull: nëntë vargjet e para kanë rimë në -ime, kurse vargjet e tjera, që përbëjnë pjesën e dytë, kanë rimë tjetër. Po kjo duhet thënë edhe

për poezinë «Vajtimi i italiankës», që përbëhet nga strofa me vargje të gjatë (tetërrokësh) e të shkurtër (katërrrokësh) dhe ku rimat e vargjeve të shkurtër të pjesës së parë (tetëmbëdhjetë vargje) janë të gjitha në -e, në pjesën e dytë, gjashtë vargje janë të gjitha me rimë në -an, ndërsa në pjesën e tretë me rimë në -isë. Përdorimi që i bëhet monorimës me këtë poezi është patjetër original, ai të kujton popullin, megjithëse është vështirë të haset në popull. Pra, këtu kemi të bëjmë me një përpunim, novacion nga ana e poetit duke u mbështetur në praktikën popullore.

Përsa i përket tubëzimit, M. Metoja ka përdorur jo vetëm monokolonën, por edhe mjaft strofa popullore. Gjejmë tek ai distikët, p.sh. te «Lotët e Hitlerit e të Musolinit», «Këngë e Brigadës VI Sulmuese» etj. Në distikë, në të vërtetë, është shkruar edhe poezia tashmë shumë e njobur «Seneja tridhjet’ e nëntë», e cila grafikisht është paraqitur si e shkruar në tetërrokësh, kurse në fakt është shkruar në gjashtëmbëdhjetërrokësh, gjë për të cilën të flasin edhe rimat. Kështu këto vargje:

*Seneja tridhjet’ e nëntë,
frym një er’ e një stuhi,
gjithë skelatë ç'u nxinë,
zbret fashizmi n'Shqipëri.*

duhen shkruar në të vërtetë në formën e distikut:

*Seneja tridhjet’ e nëntë, frym një er’ e një stuhi,
gjithë skelatë ç'u nxinë, zbret fashizmi n'Shqipëri.*

Nëntë poezi të Metos janë shkruar sipas strofës katërshe popullore, të cilën e përdori me shumë sukses edhe Çajupi te poezia «Shqipëtar». Ja p.sh. një strofe e tillë nga poezia e Metos «Neve vuajm’ neve heqim»:

*O fshatar’ e punëtorë
anembanë,*

shihni gjakun si na thithet
në Tiranë...

Megjithatë Metoja i bën kësaj strofe disa novacione, që i sjipin një originalitet të spikatur. Siç dihet një strofe e tillë është edhe në popull, po strofa popullore ka rimë të alternuar (ABAB) si p.sh.:

Bën konak, moj gjeraqinë,
bën konak,

bën konak e shtro shtëpinë,
bën konak!

Me një skemë ritmike të tillë e përdori edhe Çajupi, megjithëse te ky vargu i shkurtër nuk është menjë përsëritje, një lloj refreni, po një varg i mirëfilltë.

Shqipërinë e mori turku
i vu zjarr!
Shqipëtar, mos rri po duku,
shqipëtar!

M. Metoja merr praktikën e Çajupit përsa i përket vlerës funksionale të vargut të shkurtër, po nuk ruan skemën e rimës ABAB. Te strofa e Metos rimojnë vetëm vargjet e shkurtër, siç duket qartë edhe te strofa që sollëm më lart nga një poezi e tij. Po nuk mjafton me kaq. Modelit popullor dhe praktikës së Çajupit Metoja i sjell edhe novacione të tjera. Dhe në fakt, duke lexuar strofat e Metos, vë re se në më të shumtën e rasteve vargu i shkurtër nuk është gjë tjetër veçce një bartje. Poeti bën çmos që para kësaj bartjeje të krijohet një pauzë dhe pas kësaj të vijë bartja vetë, e cila përbëhet, si rregull nga një fjalë më rëndësi të veçantë kuptimore. Këto që thamë ilustrohen fare bukur edhe nga këto pak shembuj:

Ne, sa ditë që ka viti,
të munduar,

*dhe pér buki e rröba trupi,
dëshiruar... (Neve vuajm' neve hegim)*

Si vargu i parë ashtu dhe vargu i dytë formohen nga fjali eliptike, në të dyja rastet mungon folja *jemi*, e cila zëvendësohet nga presja, pra pauza. Pas kësaj pauze fjalët në bartje (*të munduar, dëshiruar*) marrin një vlerë dhe evidencim, më të madh si epitete. Po te kjo poezi lexojmë:

*Ne të djegur e të naирë,
pluhurosür, nupra e
atâ veshur, mbathür mir e
atë lüstrosür...*

kurse te poëzia «Si underohen luftetarët» është e njohur qëndruesisht si poëzi i poetit Shai Périsé. Në këtë poëzë është përdorur një teknikë poetike që ka qenë e njohur si *Labérise*. Teknikë e cila përmes saj poëzia është ekipazuar me shprehëse e përgjithshme. Poemës sëmundur e cila përmes saj poëzia është ekipazuar me shprehëse e përgjithshme. Poemës sëmundur e cila përmes saj poëzia është ekipazuar me shprehëse e përgjithshme.

Në poezine «Bashkëfjalim më një bej», kjo procedure fiton forcë të madhe shprehëse të ngjyrave të ndryshme, edhe satirike:

*Më dëgjo, të lutem shum',
o imi bej, do kuvendoj pak me ty e
do rrefej... Hallin populli ua qau, or
të uruar, kaqë vjet me këto ligje
të munduar...*

Edhe nga këta shembuj duket qartë se M. Metoja e merr përvojën popullore dhe e kalon me kujdes në laboratorin e mjeshtërisë së tij artistike duke kryer me sukses edhe novacione me sensibilitetin dhe talentin e tij jo të zakonshëm. Ai nuk heziton të futë edhe ndonjë element që haset rrallë ose nuk haset fare në poezinë popullore, siç ndodh me bartjen, po këtë di ta përshtasë kaq bukur me ritmin dhe harmoninë e gjuhës, saqë ajó fiton një frymë të qartë popullore.

Një strofë tjetër interesante popullore Metoja përdor te poezia «*Shyqyr që shpëtoi çeta*». Ja një shembull:

*Atje poshtë në Tragjas
u shqye fshati në gaz
me një batalion të Ballit
që pérroit u pérplas.*

Skema e rimës në këtë strofë është AABA. Në fakt vargu i tretë është thuajse i cliruar nga rima dhe rrallë herë rimon me vargun e tretë të strofës pasardhëse. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një strofë popullore që, siç dihet, paraqesin një larmi jashtëzakonisht të madhe në skemat e rimave të katrenit.

Një strofë e tillë është tepër e përshtatshme sidomos për satirën. Vargu i tretë duket sikur heq dorë nga rima, e cila ruhet kështu për vargun e fundit, që luan rolin në këtë mënyrë të një batute finale dhe përqëndron vlerën kryesore kuptimore të strofës, siç kuptohet lehtë edhe nga këta dy shembuj:

*Po shyqyr, shpëtoi çeta,
se ish e shumë si bleta,
batalion a ç'dreq i thonë, —
me Azizin... njëzet vate
...
Katr' a pes u kthyen parë,
si barinj e si stanarë*

*për të mos i kuptuar,
ngisnin lop' edhe gomarë*

Përsa u përket mjeteve të instrumentimit populor, siç janë llojet e ndryshme të përsëritjeve, M. Meto i përdor ato me bukuri dhe shije. Le të mjaftojnë këta shembuj:

*... do bashköhemi me Këshillin
Nacional,
me Këshillin Nacional, e
me Partinë...*

(Do dal malit)

*...i prin përpara ngaherë
grupi i çetës,
grupi i çetës, partizane...*

(Grupi i çetës partizane)

*...Kërkoni të ziun popull
ta verboni,
ta verboni, të mos duket
Italia...*

(Bashkëfjalim me një bej)

Puna e kryer prej M. Metos në ripërtëritjen e vlerave të metrikës popullore, në shkathtësimin e ndonjë elementi të saj, në aftësimin e mjeteve të saj për të shprehur realitetin dhe ritmin e kohës përbëjnë një kontribut, nga i cili përfituan e përfitojnë sot e kësaj dite poetët tanë të rinj. Ai është në vazhdën më të mirë të poetëve që e lidhën krijimtarinë e tyre me folklorin ose, sidogoftë, mbajtën me të raporte të qëndrueshme dhe tepër të dukshme siç qenë De Rada, Naimi, Çajupi, etj. Ai është formuar në një farë mënyre, sidomos në shkollën e këtyre dy të fundit, veçanërisht përsa i përket satirës ai lidhet me përvojën e Çajupit, i cili, ashtu si Metoja, mori forma strofash,

praktika rimash dhe i përdori me sukses në satirën e tij të fuqishme.

Megjithatë, problemet metrike të poezisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nuk ezaurohen në asnjë menyrë vetëm me krijimtarinë e M. Metos. Përkundrazi, M. Metoja është këtu vetëm përfaqësuesi, mbasë më i miri, i një plejade të tërë poetësh populorë të njohur apo anonimë. Në përvojën e tij është patjetër edhe përvoja e bashkëkohësve të tij që luftonin malit me armë, në dorë e këngë në gojë.

REFERENCES

REFERENCES

— 1 —

Planning along a ridge

1996-01-01 1996-01-01

- 2 -

Journal of Health Politics, Policy and Law, Vol. 35, No. 3, June 2010
DOI 10.1215/03616878-35-2-333 © 2010 by The University of Chicago

卷之三

1999-01-01 00:00:00.000000

1. *Leptodora* tip. este spum. cu o creastă de adâncă
înălțime până la mijlocul vârfurilor, unde se închidă într-o
cavitate în formă de semicerc. Creasta este săpată și
înălțată în partea superioară. Să treacă de
înălțimea crestei și să se extindă în partea superioară. Să
fie adâncă și să se întindă în partea superioară. Să
fie adâncă și să se întindă în partea superioară.

15. KOLË JAKOVA DHE DHIMITER S. SHUTERIQI

WABA) says the arrangements will be made by the
with the American Indians or the
and the Indians, the Indians, the Indians, the Indians,

Do të shkonte shumë gjatë të ndaleshim këtu të gjithë poetët e kësaj perjudhe dhe, nga ana tjetër, kjo do të sillte një shpërndarje të vëmendjes. Për këtë arsy kemi menduar të ndalemi të disa prej tyre, duke u përpjekur të hetojmë e të vemi në dukje tek ata tipare që janë të përgjithshme, procedurë artistike metrike që gjenden dendur edhe te të tjerët. Kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë se nuk hasim asnjë originalitet edhe te poetët e tjere, që nuk do shqyrtojmë më tutje. Përkundrazi, Shumë prej tyre meritojnë të studiohen në këtë vështrim aq sa dhe të tjerët (si Musaraj, Çaçi, Gjata, Varfi, Qafzezi etj.) dhe kapercimi i tyre në këtë studim përbën në një farë mënyrë një të metë. Pó, nga ana tjetër, ky shkrim është vetëm një përpjekje fillestare dhe ka përfshirë të ndjekë kryesisht depërtimin e metrikës popullore në poezinë tonë të kultivuar, proceduraf që përdorin poëtë të ndryshëm në përfitimin e kësaj përvoste si dhe të shohë shkurtimisht, disa nga rrugët që ka ndjekur e ndjek sot e kësaj dite poezia jonë e re në ripërtëritjen e vlerave

metrike, në puniën e saj novatore që përfshin jo vetëm brendinë por edhe formën. Duke qenë ky qëllim më tepër sesa ai që të japë fizionominë e këtij apo atij poeti të veçuar, kuptohet se të ndalurit në vetëm disa përfaqësues është një rrugë e domosdoshme dhe, mendoj, e mjaftueshme.

Kolë Jakova shquhet përgjithësisht me krijimet e tij poetike për një prirje herë-herë shumë të theksuar popullore. Duket qartë në veprat e tij më të mira se përvoja popullore ka qenë kurdoherë modeli i parë e kryesori. Kjo të bie në sy që te krijimet tashmë të famshme «Kënga e tre heronje të Shkodrës» dhe «Shqiponjat partizane». Në këngën e parë duket qartë se modeli i strofës popullore (katreni AAAB) është rivlerësuar ritmikisht duke marrë një ritëm marcial. Mjafton të krahasosh këto dy strofa për t'u bindur. Dëgjoni p.sh. ritmin e këtij katreni popullor shkodran.

*Karajfil në kodër,
drandofill në kodër,
vajza e mir' në Shkodër,
molla e vogël-o!*

Ja dhe katërshja e Jakovës:

*C'ka po thot' Jordani?
— Punt' i ndan mejdani,
ta marr vesh taljani
si luftojm' na, sot!*

Para së gjithash është krejt e qartë se Jakova ka marrë këtu modelin popullor duke i bërë vetëm një ndrvshim: vargun e katërt, që në strofen popullore përsëritet i njëjtë në të gjitha strofat, si punë refreni, ai e ka bërë një varg si gjithë vargjet e tjerë të strofës duke e lidhur me rimë me vargun e fundit të strofës pasardhëse. Megjithatë ritmi i përgjithshëm, që përfshin nga kënga popullore, është ai i lirizmit,

gëzimit, i valles, i haresë, kurse ritmi i përfthuar te kënga e Jakovës është ai i betejës, i epizmit, i guximit. Strofa e Jakovës, e formuar nga vargje të shkurtër, nga gjashtërrokësh tepër të lëvizshëm, jep një ritëm gati-gati të papërbajtur, zemërak, që s'ka të bëjë aspak me tonet elegjiake (jo më kot në titullin e saj është fjala «kangë») dhe kumbon me lodrën e rimave, me mbisundimin e fjalëve monosilabike, me mbisundimin e tingujve *t*, *d* (sidomos të *ndan mej-dani, ta... taljani*) si një notë e fortë e një kushtimi luftë partizane.

Në poemën «Heronjtë e Vigut» K. Jakova shquhet për instrumentimin me mjete krejt popullore, që i bën vargut të tij tetërrokësh. C'është e vërtetë tetërrokëshi në këtë poemë është mjaft i lidhur pas skemës së shkolluar 3.7, megjithatë mjete tipike popullore si llojet e përsëritjeve, përdorimi i monorimës etj., i japid këtij vargu një aromë të spikatur popullore. Një mënyrë të tillë trajtimi, të vargut tetërrokësh të skemës 3.7, e hasim edhe të poetë si *Noli e Poradeci*. K. Jakova e bën një gjë të tillë në një situatë të re e përnjë tematikë e brendi krejt të panjohur më parë. Në vargje si këto hasim përsëritjen:

S'e lodh buka as s'e lodh moti...
Djal' i gojës, djal' me kokë...
Lufton natë e lufton ditë...
Zmrapu, natë e zmrapu ditë...
Heshtin tanke e heshtin topa...

Apo hasim anaforën:

Fjala mjaltë i rrjedh prej goje
fjala mjalt' zemra barot...
Ku ma e majme preja t'jetë,
ku ma e majme, ku ma e letë...
S'i tremb pushka e tradhtisë,
s'i tremb pushka as s'i tremb deka...

Apo hasim epanastrofën:

Gjith petrita djem të letë,
djem të letë, djem të ri...
S'del kollaj as kapedani,
kapedani me gjith' shokë...
Me ia fal Shqipnin' Talisë
Talisë e Gjermanisë...

Apo një përsëritje të tillë.

Lum Stalini për ushtrinë,
bota mbar lum për Stalinë...

Edhe shumë vargje të tjera si këta shembuj, duket qartë se janë ndertuar sipas modelit populor në një kombinim të përbashkët të përdorimit të frazeologjisë, të figuracionit, të llojeve të përsëritjeve, rimave, zgjedhjes së tingujve etj. Një instrumentim i tillë, domosdò, u jep atyre një kumbim krejt populor.

Interesante është të vërehet edhe përdorimi i rimës në këtë poemë. Në të hasim kryesisht rimën e mirëfilltë, pak asonancë dhe ndonjë konsonancë të rrallë të tipit tym-trim, mizore-dorë, fjalë-male etj. P.sh.

Enver Hoxha u ka çu fjalë
t'i clironi ato male...

Në rimat e mirëfillta poëti pëlqen më tepër rimën fundore dhe thuajse të gjitha këngët e poemës i përfundon me rima të tillë. Kështu te kënga e parë:

... hjeksi i Gjonit fort po i ndjek,
hap për hap e shtek për shtek...

Në fund të këngës së dyte:

... n'arka grash pas e stoli,
n'hise s'due ksaj her' m'u hi...

Kurse mbyllja e këngës së gjashtë fiton së tepërmi forcë dhe kumbim burrëror edhe nëpërmjet rimave që ka zgjedhur poeti me mjeshtëri:

*Por po deshe m'u përpjekë, ...
për me m'vra e për me m'djege, ...
hajde, bujrum në Milot, ...
kulla ime vendit s'lot,
ta shtroj sofrën me barot.*

Metri me një kadencë të rrëgullt, përdorimi me shumicë i rimave fundore dhe mbisundimri në tërë poemën i fjalëve monosilabike e bëjnë muzikalitetin e këtyre vargjeve të marrë një kumbim marcial, plot vrull dhe patos luftarak.

Poema është shkruar në monokolonë dhe në monorimë. Ashtu siç e kemi zënë në gojë edhe më parë, poeti, duke ndjekur poezinë popullore, ka prirjen përtë grupuar me të njëjtën rimë vargjet që përbëjnë një frazë sintaksore apo një të tërë ideoemocionale. Këtë prirje e kemi vënë re dhe te Cajupi, Metoja e në ndonjë rast edhe te Poradeci.

Hasim te «Heronjtë e Vigut» në vargje të tillë që grupohen nëpërmjet rimave:

- *More Ndoc, more zambak,* ...
kush ta lau trupin me gjak, ...
pa ia pasun borxh' as hak?
- *Nuk më, vrau borxh' i shtëpisë,* ...
po m'ka vra pushkë e tradhtisë, ...
sepse i dola zot, Shqipnisë. ...
- *Fol, o Ndoc, pse rrin largue,* ...
n'Vig të that' në grop' mbulue, ...
nanë e bab' ku t'kan' gandue; ...
që s'po din sot me i takue?
- *Pra burrnisht jan' tue qindrue!* ...
- *Nanë e bab' s'i marr meni,* ...
por ia la një porosi, ...
mos harroni shok't e mi. ...

Te kjo poemë hasim rima të brendshme që bëjnë shumë efekt, si:

... Kalon shtigje plot rrreziqe
malit t'Velës brigje brigje.
... me iu ba hise n'tradhti
kur t'i vi sahati i ti...

qoftë rimën dyfishe si:

... i përgjigjet prap' një tjetër
ti na ke hesap të vjetër...

qoftë rimën e kombinuar në lidhjet më të ndryshme, po kurdoherë jo si lodër të kotë, po me një funksion të qartë ideoemocional:

Le t'gjimojë sa të dojë
Gjadri i zi kurr mos t'pushojë
se s'asht dasëm ësë gosti...
... me nazista lyp derman
me gjerman han n'një kazan...
... Veç Naimi ka teprue
plague randë e tue u rrëxue...
... kuj ndër mend mos t'i bie ma
me sha Gjonin për tradhti...
... gjaku jon' t'u baftë dritë
na ke pritë e na ke qitë...

Hasim zgjedhje rimash foljore në mënyrën habitore, që nuk mund të mos të bëjnë përshtypje me efektin dhe me përputhjen e tyre të plotë me idenë e shprehur në vargje. P.sh.:

... s'i tremb pushka as s'i tremb deka,
plumbja ata kur po i preka
nëpër mish ë gjak s'po vëka,
porse 'i depo plot po haska
shum barot mbrendë ajo paska,
vaj medet aty ku plaska!

Janë këto lloje instrumentimi dhe organizimi të var-gut që, duke u përputhur me brendinë ideoemocionale, u japid vargjeve një aromë kaq popullore. Më vonë Jakova u përpoq të përsërítë këtë procedurë, mbase te poema e gjatë kushtuar Skënderbeut, te ndonjë përrallë përf fëmijë, te ndonjë poemë tjetër. Megjithatë, në shumë poezi, ai, më pas, provoi edhe vargje të tjera. Kështu te poezitë e ciklit «Frymëzime ngajeta në fshat» ai përdori vargun e bardhë njëmbëdhjetëro-kësh me një përpjekje përtatësuar përfjetën e re të fshatit. Megjithatë vargjet e kësaj poeme, plot bartje dhe inversione, jehojnë metrikisht më tepër si reflekse të një praktike neoklasike sesatë ngarkuara me ritmin e ri të kohës, përtatësuar përpjquet poeti.

Interesante, përsa i përket vargëzimit, paraqitet për-voja poetike e Dh. S. Shuteriqit. Që prej dy vëllimeve të tij të parë paraçlirimt e gjer te vëllimi i tij i fundit, ne hasim në një kërkim, në një shqetësim të poe-tit edhe në punë të vargëzimit. Duke pasur në vëllimet e para si model librat e poetëve të huaj (sidomos frane-zë), po duke pasur nga ana tjetër një prirje të fortë përtatësuar lidhur me popullin, që e çonte të folklori dhe te Migjeni, Shuteriqi kalon nga vargjet e rregullt në vargjet e përzier e në vargjet e lira, nga vargjet e bardhë në ato të rimuar, nga vargjet e zbërthyer në vargjet me një fizionomi popullore... Ai e ndien si poe-tët e tjerë bashkëkohës e bashkëmoshatarë nevojën e ripërtëritjes së poezisë shqiptare edhe nëpërmjet vargë-zimit. Këtë nevojë e kishte treguar me të madhe Migjeni dhe të tjerët e kishin bërë të tyre menjëherë shqe-tësimin e tij. Shuteriqi përpjket, duke ndjekur shembullin e Migjenit, ta çlirojë vargun nga rreptësia e rregullave dhe e ligjeve tradicionale shkollore, por nái e di se, siç thotë Majakovski, «jambë e trokeu nuk shpiken përditë», përtatësuar sado të përpjket, vargjet e tij të parë janë më tepër vargje të përzier apo të zbërthyer sesa vargje të lira. Kështu, përtatësuar, në poezitë «Një trandafil picërrak» (1934), «Era» (1935), «Përbuzja» (1935) etj. hetohet lehtë një-

mbëdhjetërrorëshi jo vetëm si konstantë metrike, po dhë si varg i mirëfilltë që përbën këto poezi. Në të tillë vjersha ky varg është zërthyer duke dhënë herë vargje të përzier, herë të lira, po sidoqoftë ai, në shumicën e rasteve, mënd të rindërtohet lehtë.

E deti m'tha:

— Kështu e desh jeta, kangëtar.

— O det i qetë,

si ti i qetë due të jem.

C'ëtë baj të jem si ti,

dallgë të mos kem?

T'lus si' i herë retë?

(Përbuzje)

Këto vargje të zërthyer, që kanë pamjen e vargjeve të përzier, po të rindërtohen kthehen thuajse të gjithë në njëmbëdhjetërrorësh (duhet pasur parasysh që poeti ë-në më të shumtën nuk e lexon fare):

E deti m'tha: «Kështu e desh, jeta, kangëtar»

— O det i qetë, si ti i qetë due të jem.

C'ëtë baj të jem si ti, dallgë të mos kem?

T'lus si' i herë retë?»

Po kjo gjë mënd të bëhet edhe me poezinë «Migjeni» (1938), etj.

Në vargjetë tillë, dëmosdo, bartjet janë të shumta si dhe inversionet, rimat e brendshme etj. Bartjet e tepërtat më këtë fazë të krijimtarisë së poetit u japin edhe vargjeve tetërrorëshe të tij një pamje mjaft larg tetërrorëshit popullor. Lë të vlejë ky shembull nga poezia «Natë dimni» (1934):
*Bota muer sonte shkëlqime
prej kristali. Vërshëllimi
i erës q'frym 'n'fyej metali,*

*vjen nga thelle, si vjen kumbimi
i kambanes. Tejke për telash
akulli t'holle, po bie nji lirë.*

Këtu, sic shohim, kemi manovrimin me anë të bartjeve për ti dhënë struktures së vargjeve, dhe strofave një ecuri më pranë tonit të bisëdes, një ri-tëm sa më pak emfatik. Është e qartë se këtu duket përvoja e Migjenit e jo vetëm në punë të bartjes por edhe të zbërthimit të vargjeve etj. Po ka rëndësi të vihet në dukje këtu sidomos praktika e zbërthimit të vargjeve e të strofave, mbasi poetët tanë, që erdhën më pas. Siliqi, Agolli, Kadare etj. e morën dhe e çuan më tutje. Kjo praktikë është ende sot e kësaj dite te-për e përhapur te poetët tanë të rinj.

Përsa i përket Shuteriqit, ai, me kalimin e kohës i bëri një rishikim krejt koncepteve të tij në fushë të metrikës. Një shenjë e këtij mendimi është nga ana tjetër dhe libri i tij «Metrika shqipe» (1948), për të cilën kemi folur. Në këtë periudhë Shuteriqi ngre me të madhe nevojën për të studiuar, njojur dhe futur në përdorim teknikën e vargëzimit popullore. Si rezultat i kësaj ai duket sikur heq dorë për një farë kohe nga vargu i lirë dhe afrohet me vargjet e rregullt, kryesisht ato me frymë popullore. Janë pikërisht të kësaj periudhe «Gruri i ri», «Kangë për sulmuesen e tisazhit», «Traktoristi dëshmor», «Himarës», «Mbi xhade» etj. Në këto poezi përsëritjet përdoren më dendur, frazeologjia popullore dhe organizimi sintaksor i frazës ndjek më për së afërmi gjuhën e popullit, tetërokëshi zë vendin kryesor. Kështu gjejmë p.sh.:

*Lule, shoku Ibrahim,
lule, komunisti im,
se ç'u hodhe përmbi flakë,
sikur s'ishe mish e gjak,
sikur s'dije vdekjen, trim.*

(Traktoristi dëshmor)

Kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë që në këtë periudhë poeti nuk përdor dhe vargun e përzier e ndonjë tjetër, përkundrazi. Por është e qartë se vargu i tij vjen duke u bërë përherë e më i rregullt. Kjo nga ana tjetër nuk e pengon poetin që, në vëllimin e tij të fundit «Poemë e pambaruar» (1972), t'u japë vargjeve tonin e një bisede nëpërmjet përdorimit sidomos të vargut të lirë.

16. LLAZAR SILIQI

Lazar Siliqi është një krijues origjinal në poezinë e re shqiptare që dallon lehtë nga të tjerët. Kjo është shenjë e pjekurisë së artit të tij. Poezia e Siliqit shquhet si për mënyrën me të cilën trajtohen temat, një mënyrë tepër personale, duke krijuar që në krye një lidhje thuajse intime me çfarëdolloj teme, si për qartësinë e tramës poetikë, kompozicionit të poezisë së tij, ku evitohet qdo mbingarkesë që do të sillte një farë koklavitje në mos vështirësi vizioni, si për faktin që ai synon të jetë transparent, tepër i dukshëm si në konceptimin ashtu edhe në organizimin poetik të përjetimeve të tij. Tërë kësaj i duhet shtuar një sensibilitet i hollë muzikor i edukuar në shkollën e Mqedës e të Migjenit.

Siliqi kërkon në organizimin e vargut të tij që ky metrikisht të jetë i këmbueshëm dhe i qartë. Ai mësoi prej Mqedës rregullin, harmoninë, edukatën e ritmit; ai mësoi prej Migjenit zhdërvjelltësinë e manovrimeve, bukurinë e pauzave dhe vlerën poetike të ndërtimeve sintaksore. Të gjithë këtë prirje ai e merr duke u përpjekur ta inkuadrojë me brendinë e re,

Domosdo, për një gjë të tillë atij nuk do t'i mjaftonte vetëm as poezia e Mqedës as ajo e Migjenit. E reja ideoemocionale e poeziës së Siliqit duhej patjetër të shprehej duke u pasuruar përvaja e kaluar me elemente të rinj, me procedura dhe mënyra të reja. Kjo përpjekje e sukseshme përbën edhe origjinalitetin e këtij poeti. Siç del qartë edhe nga një vëzhgim i shpejtë i poeziës së tij, Siliqi shquhet për një thjeshtësi metrike, pa koklavite e ndërlikime. Megjithatë me këtë thjeshtësi ai arrin të transmetojë në vetëdijen e lexuesve një muzikalitet të hollë. Mbi të gjitha, ritmi i poeziës së Siliqit është kurdoherë i qartë, i dukshëm, bille tepër i theksuar. Dhe është pikërisht kjo qartësi ritmike që i bën edhe bartjet (të cilat ai i ka të shumtë), edhe inversionet, edhe rimat e brendshme që të «shkrihen», të «fshihen» dhe të «humbasin» në vrullin e lumenit ritmik. Nga ana tjetër, Siliqi e koncepton poezinë kryesisht për t'u deklamuar dhe kjo shpesh kushtëzon edhe punën e tij si në zberthimin e vargut e strofave ashtu dhe në vendosjen e pauzave e në thyerjen e vargjeve.

Siliqi përdor më tepër vargjet me një numër tek rrökjesht, ku vendin e parë e zë njëmbëdhjetërrokëshi. Pavarësisht kësaj, këto vargje, për të cilët ka një përvoyejë të mirë, në poezinë e kultivuar shqiptare që herët, të organizuara dhe të instrumentuara prej poetit me mjete tipike të poeziës popullore (përsëritjet, pasuria e rimave, struktura sintaksore) marrin kumbime thjesht shqiptare dhe shprehin me fuqi ritmin e realitetit të shoqërisë sonë bashkëkohore. Nga ana tjetër, Siliqi i grupon vargjet në strofa kryesisht katërshe dhe dyshe, pavarësisht formës së jashtme që ato marrin si rrjedhim i zberthimit apo i thurjes së vargjeve. Vendosja e rimave ndihmon për të përcaktuar kufijtë e strofave. Në fakt, në shembujt e mëposhtëm kemi strofa katërshe:

Un nou me
Un zogje
mbanë gjithësia

Në kopësht dal

*e frymë marr thelle,
Me fluturue
të grish thue kaltërsia
e qielit aq të kthjellë!*

(Ringjallje)

*O miqtë e mi!
Kërkuet prej meje
në vargje
të shpreh cka ndjej tash n'zemer unë...
Merrni këto strofa!
Prej hareje,
prej dashunisë
sonte u krijuen!*

(Në një mbramje dëfrimi)

Sado e quditshme që të duket, te shembulli i fundit, po të bëhet ribashkimi i vargjeve të zberthyer, edhe strofa nuk është më e zberthyer dhe merr këtë pamje:

*O miqtë e mi! Kërkuet prej meje
n'vargje të shpreh cka ndjej tash n'zemer unë...
Merrni këto strofa! Prej hareje,
prej dashunisë sonde u krijuen!*

Pikërisht duke zberthyer strofat e vargjet, më shumë sesa duke i thyer vargjet, Siliqi arrin të krijojë një fizionomi që i afrohet atij të vargut të lirë, po më parë është varg i përzier se i lirë, në mos goftë krejt varg i rregullt. Dhe në essence Siliqi ka shumë pak vargje plotësisht të lirë. Më shumë tek ai gjemë vargje të rregullt e të përzier, të interpretuar lirshëm, pa paragjykime rregullash dhe ligjesh fiksë e dogmatike metrike.

Në instrumentimin e vargut, Siliqi përdor mjaft përsëritjen në të gjitha llojet, dhe me mjaft efekt:

*... e mbajmë nalt
e nalt kemi me e ngritë...*
(Flamurin tand)

*... si rreh zemra trime e Avniut
zemra e mbarë popullit si rreh...*
(Kujtimi i Leninit)

*Fluturo, o shqipe, nalt ndër qiej të rij,
fluturo, o bir, me hovin guximtar...*
(Atdheut)

*Ja, flakët shoh si ngjiten nalt në quell!
Britmat dëgjoj si ngjiten nalt në quell!*
(Rapi)

Domasdo, kur përdor vargje tipike popullore, atëherë edhe përsëritjet janë më të shumta e më të larmishme:

*...t'rrojm' si njerëz, t'na çelen sytë,
t'kemi bukë e t'kemi dritë;
t'kalojm' ditët pa u mërzitë,
t'kalojm' vitet kurr' pa u plakë...
... shum pak gjim' ke pa mbi dhe
shum pak gjim' n'kët jet' ke pa...*
(Miku)

Interesante është të vërehet se kur përdor vargjet popullore Siliqi, herë-herë zbaton praktikën e popullit duke e plotësuar numrin e rrokjeve me tingullin o, siç del edhe nga ky shembull:

*... po lufton-o hypun majë kali
... krahu yt çdo dit-o u forcoftë,
gjith' ku janë anmiqt-o i çfaroftë...*
(Pesë kangë)

Bartja, siç patëm rast ta themi dhe më parë, përdoret së tepërm prej Siliqit. Dhe përdoret me funksion të qartë ideoemocional, ashtu siç mëson praktika e Mjedës. Mjaftojnë pak shembuj për tu bindur për këtë;

... *Kush traktatet, q'ishin për coptimin e Shqipërisë, botës ia zbuloi...*

(Kujtim i Leninit)

... *Të vërtetën thë, megjithse shum të zorshme e pate sot kështu me folë!*

(Erë pranverore)

Lidhur me bartjen është edhe përdorimi i fundit të vargut nga ana e poetit, i cili evidencon kështu ide, emocione e figura të rëndësishme. Ja disa shembuj:

Shqipni, atdhe i shitenjtë! Pa kursim stoli të rrallë ty natyra t'dha.

(Atdheut)

... *e nuk duem në tym të zi
ta çojmë jetën. Përse dona
t'rrojm si njerz, t'na çelen sytë...*

(Miku)

*Vala,
që Mjeda thirri të rraposë
mbretna e mbretin,
vërshoi!*

*Mbi atdhe
ndrit dielli i ri!*

(Gëzojmë sot)

Në poezinë e Ll. Siliqit rima është një element i rëndësishëm. Tek ai hasim sidomos rimën e mirëfilltë, që

kumbar e plotë, hasim' pak asonanca dhe konsonanca.
Ja disa shembuj nga këto të fundit:
... edhe sodis si jeta nis të zjejë,
e ndjej se si më ndizet nëpër deje...
(Partia jonë nanë)

Zhurm', pëshqellim, s'merr vesh i pari t'dytin...
... «baballar't e kombit» kacafyten!...

Ja disa shembuj (Kujtim i Leninit)

Edhe, zemra vec thotë...
n'dete t'hueja kur lundrote

(Erë pranverore)

Jibrini i fushatës së vjetër, qëndrojnë këto vende, këtu
është Rima te Siliqi dendur, e shtë edhe e brendshme, po
sidoqoftë është karakteristike për këtë poet fakti që ai
përdor mjaft rimën e përbërë (qoftë edhe në formën
e një asonance apo konsonance). Me sa dimë ai është
i pari në poezinë shqiptare që përdor një rimë të tillë.
Ja disa shembuj:

I lumtur asht gjith populli i ynë...
... Të përkendesim Ty nel...
(Partia jonë nanë)

Ndërsa bosh gjithmonë asht një karrike...
... fërkon duart, lakmija larg i hikë
n'kokë i vijnë...

...
...
...

... e ndër sytë e tij, të ardhmen shoh un',
plumbat e mallkuem të helmatosun
(Kujtimi i Leninit)

Duert i ka t'zeza si toka...
... porsë zemrën plot barot ka...

... *pyet a u vijn' kulakev,*
që duen fshatit me i pi gjak'n e...
(Miku)

sa un e ndatu se me dukej

njeriun malli aq leht, jo, nuk e

lesson per njerzit e tij!

когда в деревне был час ...
и час был часом ...

*...показът на всички епизоди е във
всички телевизорни програми.*

E qe *Agroni* për gjith kolektivin

... ndodh kështu, që endset para tij vinë...

... *T'lumtë, vil Shpresëgjigojas tyntë. Iumtë*

... té vörteken thé megjithse shumé té

zorshme er pate...n kora luruw em ...

... (Erëspranverore) ...

... Provo ec e më mbaj ti...

... zemrën e kam

મુખ્યમાં સાથે Dajjîઃ વિદ્યાર્થી

... בְּרִית מָנָסֶה – וְאַתָּה בְּרִית מָנָסֶה ...

३५८

Vargjet e reja t'it se tħalli minn u kieni t-tid. Do t-ee wnaq
do t-ee tħalli minn u kieni t-tid. Do t-ee tħalli minn u kieni t-tid.
tēn-viendija diti s-sit. Iu t-ee tħalli minn u kieni t-tid.
meħ-dorën t-ee tħalli minn u kieni t-tid. Iu t-ee tħalli minn u kieni t-tid.
għidnejha kif tħalli minn u kieni t-tid. Iu t-ee tħalli minn u kieni t-tid.
prej kazmës se **kalitn** (Ringjallie)

Pa dyshim kjo, është një mënyrë, e re për të pa-suruar fondin e rimave dhe Siliqi, duket qartë edhe nga këta shembuj, ka arritur ta përdorë me mjeshtëri dhe me shumë efekt. Këtë përpjekje për të rritur fondin e rimave e gjemjë tek ai edhe në një mënyrë tjetër – te rimat me shtesë, siç mund t'i quajmë, pra një lloj asonance. Në të tilla raste njëra nga fjalët e rimuara ka zakonisht një t apo n'më tepër nga shoqja me të

cilën rimon. Ja disa shembuj, ndër të shumtët që hasen te ky poet:

*Jashtë acar. Në sall' djersiten xhamat
... që t'mos ketë nga të hyjë gjama...
— Për Leninin?! Djäl' zanin ule!
... Edhe sytë nga djaloshi i ngulën...
Një pranverë, që filizat nxori...
... në Revoluconin e Tetorit...*

(Kujtimi i Leninit)

*...nanës përpara i dalin
...prani saj qëndron Mihali
... Me vrull rreh zemra; me vrull meqikët
... Fijet këputen, ajo me frikë*

*Përpara teje qëndrojn' pengesat
... Betejën humbe? — Në luft' lum Shpresa...
(Gëzojnë sot)*

Do të mund të ndaleshim këtu te përdorimi i rimes, që jo rrallë si domos në vargjet e thyer-me manovrime rimash të brendshme kontribuon për lidhjen e gjymtyrëve kryesorë të një fraze dhe për evidencimin e një ideje bazë. Le të mjaftojë ky shembull nga poema «Ringjallja»

*O tokë e rime,
djersë e lot e gjak,
o tokë e ambël
dhe e idhët,
o tokë ime,
po të puth një plak
me buzën që i dridhet!*

Anafora, rimat e brendshme (rime-ime), rima e mirefilltë (gjak-plak) dhe rima apofonike (idhët-dridhet) e bëjnë këtë strofë katërshe të ketë një unitet ritmik plotësisht në përputhje me idenë dhe strukturën sintaksore. Shembuj të tillë mund të sillen mjëft nga Siliqi. Edhe këto dëshmojnë për punën e tij të kujdeshshme në organizimin dhe instrumentimin e vargut. Nuk ka dyshim se edhe në këtë vështrim përvaja e tij poetike ka ushtruar dhe ushtron ende sot e kësaj dite ndikim te pasardhësit, sidomos te më të rinjtë. Sot zërthimi i vargjeve, i strofave, thyerja e vargjeve etj. te poetët e rinj, të kujton jo rrallë e jo rastësisht përvojën dhe kontributin e këtij poeti.

17. ISMAIL KADARE

17. ISMAIL KADARE

Ismail Kadareja, me krijimtarinë e tij të pasur poetike, e tërheq vëmendjen e studiuesit edhe me punën e tij të larmishme në organizimin dhe instrumentimin e vargut. Kadareja shquhet për sensibilitet muzikor, për intuite jo të zakonshme në punë të ritmit, të muzikalitetit dhe të harmonisë së krejt elementeve përbërës formalë të poëzisë. Sensibiliteti i tij muzikor, i edukuar me gurrën popullore dhe me përvojën e poetëve tanë më të mirë, jo vetëm të Naimit, De Radës, Migjenit, Poradecit, por edhe të më të rinjve, si p.sh. të Ll. Siliqit e ndonjë tjetri, e bën të kërkohet vazhdimi i sistemit vargëzimi. E në fakt në vëllimet e tij hasim si sistemini silabik, si atë silabo-tonik ashtu edhe sistemin e çoklavitur të vargut të lirë. Kadarenë e shqetëson estetikisht ritmi i kohës në të cilën jeton dhe ai bën çmos që këtë ritëm ta bëjë të jehojë edhe në vargje. Nga ana tjeter duhet thënë se dora e tij është e sigurt. Jo vetëm në vëllimet e vona, ku hetohet një përvojë kaq e madhe në manipulimin e vargut, po kjo siguri hetohet që në vëllimin e tij të parë të botuar

që kur ishte shtatëmbëdhjetë-tetëmbëdhjetëvjeçar. Që në këtë vëllim duken qartë edhe në vështrimin metrik, shenjat e një mjeshtri të ardhshëm. Është e vërtetë se në këtë vëllim hasim të qarta gjurmët e Poradecit, të Naimit, të Mqedës, të Siliqit, të ndonjë poezie të lexuar në gjuhë të huaj, por është e vërtetë në të njëjtën kohë se personaliteti i tij bën përpjekje të dukshme, që në këtë vëllim, për t'u shquar, për t'u afirmuar e për të qenë origjinal.

Kadareja ka një prirje të qartë për të përdorur gjithçka që atij i duket e mirë, e bukur dhe e shëndoshë e që shërben për të pasuruar gamën ritmike e muzikore të poezisë së tij. Ai ka një prirje jo vetëm intuitive, por edhe të arsyetuar për të shkrirë në përpjekjet e tij përvojën e pasur që merr nga populli me përvojën e studiuar nga poezia e kultivuar. Kështu shpjegohet larmia e tij metrike.

Të Kadareja gjejmë të përdorur vargjet popullore krahas vargjeve të marrë nga poezia e kultivuar.

Kadareja përdor vargun tetërrrokësh megjithëse jo shpesh:

- 1) *Muzgu ra. Po heshtin pyjet, (3.5.7)
fusha shtrihet pa mbarim (3.7)
tek e tuk vështrojnë yjet (3.5.7)
mbi katundin në qetim. (3.7).*

(Mbrëmje fshati)

- 2) *Rruge e lagure vështore...*

(Rruge)

- 3) *Shligjeve, fushës së kalter...*

Po të tjeratë ku janë?

(Gjurma)

4) *Ajo tha: «Jo, nukë dua!»...*

Qullur-o shamija yte...
(Xhuraja)

5) *Në vals dridhu, nuse e re!*

Për inat të plakave!

...

Flë mbuluarë me baltë.

(Si gdhieu një ditë me këngë)

Sic shihet edhe nga këta shembuj, mbisundon skema ritmike e theksave në rrokjen e tretë dhe të shtatë. Nga ana tjeterë është e qartë se kjo skemë, më tepër se rezultat i zbatimit të rregullave të metrikës së shkolluar, për të cilën kemi folur, rrjedh nga zbatimi i sistemit silabo-tonik, sipas mënyrës së këngëve popullore. Kemi të bëjmë pra me katërkëmbësha trokaikë (-v/-v/-v/-v). Kjo shpjegon dhe përdorimin e ë-së jash-të rregullës ortografike, te: lagurë (2), tjeratë (3), nukë (4) mbuluarë (5); të zanores o te: qullur-o (4) apo të theksimit fundor të një fjale tejfondore: plakave (5). Të gjitha këto procedura të kujtojnë popullin dhe jo rregullat e poezisë së shkruar. Një shembull për përdorimin e një praktike të tillë ai e gjen, domosdo, edhe te poetët e mëparshëm, që prej Naimit, Çajupit e Pora-decit e deri te Ll. Siliqi.

Më pas, sidomos te vëlliimet «Shekulli im» apo «Motive me diell», tetërrokëshi i Kadaresë vjen e merr trajtë tepër të shpenguar, jo fort të lidhur pas rregullave, sikur bëhet gati të çlirohet për t'u bërë plotësisht i lirë. Zakoni është të tilla raste përdoret në kombinim vargjesh të tjerë, po sidqoftë herë-herë e ke vështirë t'i nxjerrësh skemën e saktë. Poeti rreh me këtë praktikë t'i shpëtojë edhe nuancës më të vogël të ritmit të rregullt, kadencës uniforme dhe përpinqet që vargu i tij t'i afrohet ritmit të bisedës së përditshme

të shpenguar me lexuesin. Të tillë janë për shembull këta tetërrokësha:

*Mizat ulen me zukatje
mbi vijat e pizhameve
dhe avionet me uturimë
mbi pistat e aeroporteve...*

(Jetë e madhe)

Kadareja përdor mjaft gjashtërokëshin, qoftë të thjeshtë qoftë si pjesë për të bërë vargje më të mëdhënëj:

*Në buzë të lumi
frynte er' e lehtë.*

(Lamtumirë)

*Rri penxhere, moj,
rri sa të të rrighet...*

(Rri penxhere, moj)

Nëse në këta shembuj ndihet modeli popullor, më pas edhe gjashtërokëshi «shkrifërohet» ritmikisht. Nga vëllimi «Shekulli im» po sjellim këtë shembull:

*Titanë të virgjër
s'ju tundin shtëngatat,
rrufetë, bubullimat
ererat e thata.*

(Alpeve)

Po kështu ndodh edhe te poezia «Embëtha» te vëllimi «Motive me diell»:

*Nga kaosi i gërmadhave
që koha pas la,
u ngrit e na erdhë
kjo fjalë: embëtha.*

v- / v - / v - / v - / v -

Edhe dhjetërrokëshi përdoret dendur. Te vëllimi i parë i poetit gjemë:

O ju valë, valë madhështore!
Det' i kaltër shtrihet pambarim...

(Përhëndetje brigjeve të atdheut)

Në këtë shembull sundon parimi silabo-tonik; në këtë rast kemi një pesëkëmbësh trokaik (-v/-v/-v/-v/-v). Po dhjetërrokëshi i Kadaresë mund të jetë edhe një trikëmbësh anapestik (vv-/vv-/vv-/v).

Këto skema janë të vlefshme thuajse për të gjitha dhjetërrokëshat e përdorur më pas prej poetit p.sh. te «Ishujt e Italisë», «Varri i Skënderbeut» etj.

Kaltërsi. Larg në det, mjegull blu
(Ishujt e Italisë)

Dhe u ulën tmerrshëm prap' osmanët...
(Varri i Skënderbeut)

Kadareja përdor dendur vargje të gjatë të formuar nga bashkime vargjesh të ndryshëm. Ja disa shembuj.

1) Ja pluhur i artë, nën qiellin e qartë...

- v - v/v - v/v - v/ v - v
(Rrugët me pluhur)

2) Rrugë e fshehur, rrugë mali pambarim
- v/ - v/ - v/ - v/ - v/ - v/ - v
(Ruga partizane)

3) I sheh këto mure me pirgje më tej një kështjelle
v - v/v - v/v - v/ v - v/v - v
(Koha e Partisë)

4) Thua heshtje, vëtëm heshtje?... Fle liqeri këtë natë
- v/ - v/ - v/ - v/ - v/ - v/ - v/ - v
(Në ujrat e kufirit)

5) *Dritares vajza rri, veshtron pertej né mal*

v — / v — / v — / v — / v — / v —

(Vasha qne zjarri partizan)

Ne shembullin i dñe/z keñi cymbednjeterrokesna, por i pari eshte formuar nga dy gjasnterrokesna kurse i dyti nga një katerrokesn one një teterrokesn. Naersa vargu i pare, formonet nga amfibrake, i ayti formonet nga troke. Kurse vargu i shembullit té tete eshte një pesembednjeterrokesn apo pesekembësh amfibrak ose, narysne eshte një varg i formuar nga një nënterrokësh dhe një gjashterrokësh. Te shembulli i katërt kemi një gjashtembedjhjetërokokësh trokaik që më shumë të kujton Lasgushin sesa Naimin. Trembehjetërokokëshi i shembullit té pestë eshtë formuar nga jambe. Në fakt këtu kemi dyzimin e dy shtatërokokëshave oksitone, pra një varg aleksandrin.

Tepër përdor Kadareja dhe vargun nëntë dhe njëmbëdhjetërokokësh. Por edhe për këto vargje nuk ka vetëm një skemë. Kështu hasim nënterrokësha té tillë:

1) *E heshtur qëndron turm e vrenjtun...* (Mos i fshih lotet, shok)
2) *U nisën zogjtë shtegëtim...* (Zogjite)

Shembulli i parë eshtë një trikëmbësh amfibrak që përdoret shpesh prej Kadaresë, kurse i dyti eshtë një katërkëmbësh jambik. Në té dyja rastet kemi një ritëm ngjitës, sic ndodh zakonisht edhe me vargjet e tjerë tek.

Kurse gama te njëmbëdhjetërokokëshit té Kadaresë eshtë më e pasur që tregojnë i vetë vlera i teknikës së muzikës, siç është duke studuar astronomië (Duke studiuar astronomië)

2) Përmbi ligen thellimi duke fryrë
(I vetëm po kthehej peshkatari)

3) Pranvera! Erdh pranvera, mir' se érdhi!
v - v / v v - v / vv - v

4) Kurora(dhe kurora)pa mbarim
v - v / vv - v / vv - (v)
(Erdh pranvera)

kurora gjithë lule gjithë yje
v - v / vv - v / vv - v /
(Lamtumirë e fundit)

5) Lulet po çelin në brigjet e blera
vv - vv / - vv / - v
(Pranvera dhe Stalini)

Qëndruam në llojet e vargjeve të Kadaresë për të treguar atë të vërtetë për të cilën kemi folur edhe më lart, se sistemet e vargëzimit mund të bashkëveprojnë të një poet, mund të gëshetohen, pavarësisht se në këtë fenomen herë mbisundon njëri apo tjetri. Një gjë të tillë është pamë edhe te Çajupi, Noli, Poradeci ashtu siç e vëmë re edhe te Siliqi, Kadareja e ndonjë tjetër.

Kadareja ka përdorur me sukses edhe vargun e lirë. Ai pati këtu shembullin jo vetëm të Migjenit, por edhe të poetëve më të rinj bashkëkohës të tij dhe ka ditur të përfitojë nga kjo përvojë e pasur. Nga ana tjetër, duhet theksuar se ai kurrë nuk e hoqi nga sytë, edhe kur shkroi në varg të lirë, vargun popullor, fryshtën popullore. Kjo zbulohet jo vetëm në faktin që shpeshi përdor si konstante metrike vargjet popullore, duke zhvilluar në vargjet e lira ritmet e këtyre masave, por edhe me një seri mjetesh për organizim e instrumentimin e vargjeve që hasen dendur në popull, siç janë llojet e përsëritjeve etj. Edhe Kadareja niset nga zberthimi i strofës dhe i vargut për të arritur të vargu i lirë. Në vëllimin «Endërrimet» (1957) ka poezi e poema të tëra që janë shkruar në strofa të zberthyera, siç ndeshim p.sh. te Siliqi, dhe që të jepin pamjen e vargje-

ve të përzier, në mos të vargjeve të lira. E tillë është poema, «Një ngjarje në pushime», balada «Sekretari» etj. Ja, pér shembull, sesi është zbërthyer një strofë katershë të «Sekretari»:

*Frym erë
dhe pylli i shurdhër buçet
me zhurmë të rreptë stuhije.
Djalosh, ngreje kryet,
shikoje!*

Medet!

Shikoje, djalosh, atë hije!

Kurse, e rindertuar, kjo strofë e zbërthyer pér efekte intonative, evidencimi, paragjet:

Frym erë, dhe pylli i shurdhër buçet

me zhurmë, të rreptë stuhije.

Djalosh, ngreje kryet, shikoje!

Shikoje, djalosh, atë hije!

Vetëm te vëllimi «Shekulli im» (1961) Kadareja nis të shkruajë vargje të lira të mirëfillta. Shkollë - kryesofë pér atë është përvaja e Migjenit e pastaj e ndonjë poeti tjetër; qoftë vëndas qoftë të huaj. Sidoqoftë vargu i lirë i Kadaresë merr mjaft prej Migjenit. Merr p.sh. përdorimin e lajmëritivit, që është karakteristike pér Migjenin, merr lodrën e rimave, dhe të aliteracionit pér të organizuar strofat e lira etj. Nga ana tjetër ai nuk heq dorë, bile ke përshtypjen se këtu ai e shton përdorimin e mjeteve artistike kaq popullore siç janë përsëritjet në të gjitha llojet e tyre, e në mënyrë të veçantë përdorimin e strukturës së veçantë popullore. Kadareja arrin të japë kështu një varg të lirë original, ashtu siç është origjinale esenca e poëzisë së tij.

Karakteristike e vargjeve të lira të Kadaresë është ritmi i tyre ngjitës, pavarësisht nëse kanë si konstante metrike një varg tek apo çift. Përsa i përket kon-

stantes metrike, ai përdor më shpesh gjashtërokëshin pullor, pastaj vijnë me radhë njëmbëdhjetërokëshi, shtatërokëshi, nëntërokëshi dhe pesërokëshi. Kështu, kanë si konstante metrike gjashtërokëshin poezitë «Peizazh gjeneral», «Statuja pa krahë», «Malli i Shqipërisë», «Fëmijnia», «Pranverë», «Në këtë qytet gjigant», «Do të vijë koha», «Dallgët me rrëmuje» etj. Kurse njëmbëdhjetërokëshi si konstante metrike gjendet te «Razliv», «Poemë vjeshte», «Afrika», «Ardhja e tij», «Edhe kur kujtesa» etj. Shtatërokëshi te «Qiell dimri», «Pizhamet dhe aeroplanët», «Në kishë» etj. Jo rrallë në një poezi si konstante metrike janë marrë dy vargje bashkë. Kështu për shembull te «Percjellje vargjeve» është gjashtërokëshi dhe pesërokëshi, te «Natë viti 1960» është pesërokëshi dhe shtatërokëshi, te «Kështu u ndamë» është nëntërokëshi dhë njëmbëdhjetërokëshi.

Duke matrë shembull nga Migjeni Kadareja, siç e thamë, i jep një rëndësi të madhë lajtmotivit. Lajtmotivi i tij është zakonisht bartës i idesë kryesore të poesisë dhe në më të shumtën vendoset në krye të strofave. Kështu p.sh. te «Malli i Shqipërisë» të trija strofat fillojnë me këtë gjashtërokësh: «Më ka marrë malli». Po kjo nuk do të thotë se po në këtë poezi ky lajtmotiv të mos përsëritet dhe në vende të tjera. Dhe në fakt e gjejmë edhe një herë të strofa e parë:

*Por unë s'do ta marr për keq
se malli më ka marrë.
Si edhe te strofa e dytë:
Për qiparizat, kubetë dhe varret,
malli më ka marrë,
I s'na malli më ka marrë,
për shqipëtarët.*

Po kjo dukuri ndodhet poezia «Atdheu», ku thuajse çdo strofe fillon me Atdheu është, te poezia «Poezia e

deklasuar», ku buçet katër herë apostrofimi qoftë dhe në forma të ndryshme:

Hapeni udhën, poetë të poezisë të deklasuar...

...

Hiquni nga udha, poetë bimore!

Hapni rrugën, fanatikë të artit...

Hiquni udhëve, poetucë të mjerë!

Nganjëherë Kadareja pëlgjen ta fillojë e ta mbyllë një poezi me të njejtën fjalë apo varg, sidomos kur ajo është e shkurtër, mbasi jehona është e kapshme. Kjo jehonë e vargut të parë kumbon domosdo si lajm-motiv dhe e inkuadron ritmikisht poezinë si diçka të mbyllur, plotësisht të përcaktuar. Kështu vjersha «Poezia» fillon me vargun *Poezi*, dhe mbaron po me vargun *Poezi; poezia «Kitaristi»* fillon me vargun *Kokën si shpellë e ka mbështetur mbi kitarë* dhe mbarón me vargun *Ngrihet kokë e tij si një shpellë krenare.*

Anakrusa përdoret jo rrallë prej Kadaresë. Te ky poet hasim më tepër anakrusën perbërëse, të tillë me një fjalë, që është vështirë të higjet. Më një anakrusë fillon poema «Shënime për, brezin tim».

Brezi im
jotja qoftë kjo këngë!
Dhé unë qofsha kudomë ty!

Anakrusa janë edhë këto:

Nga supet
pushkën e gjatë s'e hoqe kurrë,
nga supet e tua plot plagë...

Amin,

priftrit dhe ca poetë në gjumë të vinin
(Përse mendohen këto male)

Shekulli XX,

shekulli i ri dhe i drejti...

Shekulli im,

përmbi kullat feudale, mbi kryet e kambanareve...
(Shekulli XX)

Vend i rëndësishëm në vargjet e lira të Kadaresë
është fundi i vargut apo dhe fundi i strofës. Zakonisht
në këto vende vendosën fjalë me rëndësi dhe përgji-
thësisht me rimë. Vëreni, për shembull, forcën që
marrin këto fjalë të vendosura kështu:

*Tek dera e ashensorit, e hekurt,
të përcolla për të fundit herë; kur
do të shihemi më vallë?*

(Mbrëmja e fundit)

*Plumbat të më vërvshellenin në vesh. Dëbora
e përgjakur...*

(Shqiponjat fluturojnë lart)

*Atdheu i ritmeve,
temperamenteve,
rebelja Afrikë.*

(Afrika)

*Që ju pas nesh kur të vini,
ato mos t'u pëlcasin ndënë këmbë
si mina.*

(Shënimë për brezin tim)

*E shtrenjta barrakë,
e rralla.*

(Kinemaja e vjetër)

*Nga duart vigane tē kohērave
tē varrosura.* (Statuja pa krahë...)

Nuk duam tē ndalemi te bartjet dhe inversionet (te këto tē fundit është karakteristike për Kadarepë sidomos vendosja e atributit para emrit: *kaçurelja Afrikë*, punojnë tē çuditçmit njerëz, një tjetër malësor do tē zbressë etj) as te anaforat dhe epanastrofat, që janë aq tē shumta dhe në vargjet e lira tē këtij poeti. Duam tē përmendim këtu vetëm një lloj përsëritjeje që e hasim në popull, po, që Kadareja e përdor mbasë më shumë se qdo poet tjetër. E kemi fjalën për përsëritjet e tipit tē këtyre shembujve::

*U ngri pelerinat përrparë,
këpucët e gjelbert u ngri* (Pranverë)

*I tha ai drojtur:
«Liljana...»
Diçka mes furtunës i tha
(Një ngjarje në pushime)* (Ankete)

*Eshtë koha që më shumë ndjen gazin e fitoreve
dhe hidhërimin e humbjeve ndjen, më shumë
(Pranverë)*

*Dhe në s'gjetsha shokë,
dhe tē dashur në s'gjetsha...
(Në këtë qytet gjigant)*

*Cdo stinë sjell lule tē ra,
dhe bar tē ri bije cdo stinë.
(Ankete)*

*Taksi për zogjtë,
për zogjtë taksi
(Poemëivjeshte)*

Përsëritja e tingujve, aliteracioni, grupimi i fjalëve me tinguj të përafërt është një karakteristikë e qartë e instrumentimit të vargut nga e ana e Kadaresë. Kështu te poezia «Razliv» në strofën e dytë, mbisundimi i tingujve *sh*, *s* dhe *i* krijon një harmoni imitative sugjestionuese për shiu:

*Ish fund i gushtit,
natën rigonte shi;
pikat në fijet e kashtës rëshqisnin,
pëshpërisnin;
sikur roniteshin mbi kasolle lirika të freskta
shkruar diku në qielin e zi.*

Kurse te këto vargje të poezisë «Aeroporti i Rinasit» mbisundojnë tingujt *m*, *a* dhe *u* si për të rikthyer vëmendjen te fjala «lamtumirë».

*Lamtumirë, mullarë. Lamtumirë, misër, thekër, grurë.
S'do të shihemi më kurre, kurre, kurre.*

...

*Lamtumirë. Përmes ulërimave të motorëve reaktivë
si nëpër gjumë fëshfërima juaj do më vijë.*

Rima luan një rol të rëndësishëm në poezinë e Kadaresë. Si Siliqi, dhe ai përpinqet që ajo të jetë sa më e pasur dhe jo një ornament i kotë, po më funksione të qarta ideoemocionale. Rimat, e jo vetëm te vargjet e rrugjillt, por edhe në vargjet e tij të lira, shërbjenë për të organizuar strofën, për të piketuar ritmin, për të vënë në dukje fjalë me një peshë të veçantë ideoemocionale. Dhe për këtë rima përdoret në të gjitha llojet e mundësítë e saj, qoftë në fund të vargut, qoftë e brendshme, qoftë fundore apo rrëshqitëse, qoftë e mirëfilltë apo rimë apofoniqe (konsonancë) etj.

Vëreni p.sh. se ç'efekt kanë rimat e brendshme të këtyre dy shembujve:

*Po asnjë tren mua s'do më sjellë.
Ti e mbëshjellë me natë dhe dallgë
si statujë mbi ujrat, po vjen që largë...
(Në gjirin e Rigës)*

*Ish koha, kur gishtat dhe hekurudhat, e Hitlerit
si metastaza të kancerit mbi trup t'Evropës*

*zgjateshin
(Shqipohjat fluturojnë lart)*

Kurse rima e fundit te këto vargje është përgatitur në mënyrë të tillë që të dëgjohet me forcë, siç e kërkon edhe vetë ideja:

*Ajo s'ish firmë
ajo ish vetëtimë
në qiell të revolucionit me re dhe suferinë,
Duke nënshkruar dokumentin e parë,
Shoku Enver Hoxha nënshkroi
stuhinë
(Shqiponjat fluturojnë lart)*

Jo rrallë rima shërben si përtë dashur të vërë, në dukje ritmin e konstantes metrike, në mënyrë që ky ritëm të imponohet në krejt organizimin e vargjeve të lira. Kështu p.sh. të poemë «Shënime përbresin tim», me konstante metrike shtatërrrokëshin, nuk është vështirë të vësh re se si rimat në pjesën më të madhe janë vendosur pikërisht në fund të kësaj konstanteje. Kurse te poezia «Malli i Shqipërisë» te gjashtërrrokëshi, konstantja metrike e saj.

Te strofat e lira, Kadareja end një rrjet të vërtetë rimash (të mirëfillta, asonanca apo konsonanca qofshin), edhe bën çmos që fjala e fundit e vargut të fundit të jetë përherë e rimuar. Kjo rimbë sikur nënvizon diçka

dhe nga ana tjetër shënon fillimin e një pauze. Kështu ndodh thuajse me të gjithë strofat e poemës «Endërr industriale» nga e cila po sjellim këtu vetëm një strofë sa për të dhënë idenë e kësaj procedure.

*Po do të vijmë dhe ne,
poetët e realizmit socialist,
me ndonjë defter vjershash në xhep,
atje ku derdhet çelik do drejtohemi.
Vargjeve t'u themi
«Vini syze dielli
që të mos verboheni!»
Vargjet klorofilianë të mos afrohen,
më të fortët më ne le të vijnë,
djersët t'u venë palë.
metal i shkrirë
në sy të shohë vargjet,
vargjet,
metale.*

Ashtu si Silici, edhe Kadareia së bashku me Agolli. është nga ata poetë që u përpdqën për të shtuar fondin e rimave. Po ndërsa Silici e bëri këtë krvesisht me rimat e përbërë apo me rimat me shtesë, Kadareia dhe Agolli e bëjnë këtë sidomos me rimën anofonike (konsonancën). Rima të përhëra është vështirë të giesh te Kadareja. Ja një shembull:

*«Bardhul, ti ie? Eja!»
Traktoristi mbi qerren u ul
vajza këmbët lëvizzi më teji e
drejt asaj ai lehtë u përkul
(Një ngjarje në pushime)*

Kurse shembujt e rimave apofonike janë të vanumërt dhe të kombinimeve nga më të ndryshmet.

Ngadalë një zë të tronditur

...

Dhe tinguj muzike të mbytur
(Mos i fshih lotët, shok)

Që pjet në udhë një dasmë të pamatë

...

Pas një shfaqjeje gjigante, pas mesnatë...
(Shënime për brezin tim)

Me sy nervozë (Lindja e vajzave)
i shtrëngon qafën muskulozë

...

Dhe ujqët vetë po t'u delte përpara
do t'i hapnin udhën kafshës ushtare (Qeni i kufirit)

Edhe nga këto pak gjëra që u thanë këtu për Kadarënë, kuptohet lehtë se kemi të bëjmë me një mjeshtër që e ka formuar tërë këtë arkitekturë të formës së poeziës së tij duke u mbështetur në poezinë popullore, në muzikalitetin e sintaksit të gjuhës shqipe, në traditën më të mirë të poeziës së kaluar dhe në përvojën e shëndoshë të poetëve përparimtarë botërore. Është e qartë se edhe vlerat e formës së këtij poeti, ashtu si edhe të çdo poeti tjetër të mirë të ditëve tonë, nuk mund të kuptohen dhe të çmohen të shkëputura nga brendia, nga vlerat ideoemocionale dhe vetëm duke i parë në këtë lidhje mund të nxirren në pah edhe arritjet e tij në formë edhe tiparet dalluese të tij pikërisht në këtë lëmë.

18. DRITERO AGOLLI

Dritero Agolli në punë të vargëzimit, ka prirjen për të ruajtur format e vargut të rregullt. Megjithatë kjo ruajtje nuk nënkupton heqjen dorë nga përpjekja përtarë ciluar vargun nga shumë elemente. Agolli ruan format e rregullta; por, nga ana tjetër, këto forma interpretohen e përdoren prej tij fort lirshëm. Ai përpigjet, dhe me sukses, që brendapërbrenda këtyre formave të rindërtojë strukturën e tyre përti bërë të afta si në dhënen e plotë të vlerave ideoemocionale ashtu dhe në dhënen e ritmit të kohës. Në një qëndrim të tillë Agolli shtyhet nga dëshira e tij përtë qëndruar sa më pranë vargut gjenuin popullor. Dhe në fakt te Agolli, duke folur kurdoherë në vështrim të metrikës, hasim përvojën edhe të poetëve tanë apo të huaj, hasim kulturë në organizimin e instrumentimin e vargut, një elegancë që flet edhe për studime, edhe për mjeshtëri të edukuar nëpërmjet njohjes së procedurave metrike të poetëve tanë e të huaj, po hasim, mbi të gjitha, një bagazh mjetesh dhe procedurash të shumta të poezisë popullore. Kjo lidhje me përvojën popullore sa vjen e bëhet më e madhe dhe më e përpunuar, në radhë të

parë në elemente të brendisë e të gjuhës popullore. Po kjo lidhje hetohet më shumë sesa te përdorimi i vargjeve tipike popullore (siç janë tetërrokëshi, gjashtërrokëshi, dhjetërrokëshi etj.) te mjetet e organizimit dhe instrumentimit, te është ashtuquajtura poezi e ndërtimit të frazës popullore, te mjetet e përsëritjes, te efektet e rimave, te mjetet e humorit dhe satirës popullore etj).

Duhet thënë se në thurjen e vargjeve, Agolli bën çmos që të krijojë tonin e një bisede të zakonshme, paritme tepër të kadençuarë, pa bujën e rimave të ploterishme etj. Bile ka përshtypjen sikur tërë këto mjetet dhe tërë këtë pasuri efektesh artistike ai përpinqet t'i fshehë ose, sidooftë, të bëjë çmos që ato të mos na lëbyrin sytë. Kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë se këtò mjetet janë përdorur pa efekt, përkundrazi, (dhë ato që do të themi më poshtë do ta vërtetojnë pikërisht këtë) po poeti ruhet shumë që të mos japë qoftë edhe njëngrimë idenë se po kérkon efektin përfekt; tërë mjetet se përdorura duhet të janë përfekt. Të përfekt mjetet e përdorura duhet të janë përfekt. Duke qënë pjesë e saj, të shkrihen me të. Duke kaluar nga vëllimi në vëllim, vëmë re, nga ana tjeter, se edhe në punë të vargëzimit Agolli ka një farë evoluimi. Nëse te «Në rrugë dola» (1958) kemi përgjithësisht një varg shumë të rregullt, te vëllimi i dytë: «Hapat e miatë asfalt» (1961) nis trajtimi më i shpenguar i vargut. Te yëllimet e mëpastajme «Shtigje malesh dhe trotuare» (1965) ekskursioni i poetit drejt viseve të vargjeve të lira duket sikur merr fund dhe në fakt te vëllimet pas këtij «Mesditë», «Nënë Shqipëri» etj. poeti sikur kthehet plotësisht në format e rregullta pavarësisht se ato interpretohen prej tij i lirshëm, siç e thamë dhe më lart. Një prirje e tillë vihet re, qoftë dhe lehtazi, edhe te vëllimet e fundit të Kadaresë. Kjo është një shenjë, sipas mendimit tonë, se këta poetë kanë gjetur tashmë ekilibrin e vetvetes, ekilibrin e artit të tyre, e komponentëve të poezisë së tyre, ekilibrin midis brendisë dhe formës, kjo është shenjë nga ana tjeter është asaj që kemi pohuar më se një herë në këtë shkrim se poezia

nuk ka paragjykime ndaj sistemeve të vargëzimit dhe se mund të bashkëveprojnë të një poet sisteme të ndryshëm, mjaft që ato t'u përshtaten qëllimeve të tij ideoartistike, të reflektojnë kohën, të janë në harmoni me gjuhën duke i dhënë asaj mundësi që të shprehë tërë vlerat e veta.

Tek Agolli hasim të përdoren, siç e thamë, më tepër vargjet tek. Edhe sikur vetëm tri vëllimet e para të marrim gjejmë 28 poezi me gjashtërrrokësha, 13 poezi me tetërrrokësha, 7 poezi me gjashtërrrokësha, kurse 42 poezi me njëmbëdhjetërrrokësha dhe 24 me nëntërrrokësha etj. Ky pëlqim për këto vargje na bëhet se shkaktohet nga dëshira për të pasur vargje me ritëm ngjitës, pra duke përdorur jambin dhe amfibrakun, në vend të trokeut dhe daktilëve. Dhe në fakt, po të marrim nëntërrrokëshin, edhe tek Agolli atë e gjejmë si te Kadareja të formuar nga jambe apo amfibrakë, menjë preférencë për vargun jambik:

O Frashër, ty/të përshtëndes

v - / v - / v - / v /

(Frashërit)

Kur Arkimedi thosh: «Eureka!»

v - / v - / v - / v - / v /

(Eureka)

Rëndon lulëdielli nga farat

v - v / v - v / v - v

(Rapsodi vjeshte)

Polici

v - v

ende nuk ka shkuar...

v - v / v - v

(Mëngjes)

Pas detit në bregun e Barit...
v - v / v - v / v - v
(Cubi)

Tetërrokëshat dhe gjashërrrokëshat përdoren prej Agollit duke ndjekur tuper për se afermi modelet popullore.

*Tungjatjeta, nëna plakë,
flokëbardha ime moj...*
(Tungjatjeta)

Hëna brirët lau në lumë
(Mall) (Mall)

*Lumi shket ngadalë - ✓ - ✓ / ✓
rrëzë portës sónë - ✓ - ✓ / ✓*
(Lumi)

Përdorimi i dhjetërrokëshit prej poetit vjen duke u shtuar nga vëllimi në vëllim.

*Po, Devoll,
i tillë qen kam unë,
paskam marrë baltën tênde arave...*
(Devoll, Devoll)

*Bie dëborë këtej,
bie dëborë...
Malet duken të bardhë si èndërr...*
(Kur bie dëborë)

Në shembullin e parë kemi një dhjetërrokësh të formuar nga pesë këmbë trokaike, kurse në shembullin e dytë dhjetërrokëshi është formuar nga dy

këmbë trokaike plus dy këmbë amfibrake, pra me
këtë skemë:

(dritë) — v / — v / — v / — v

Përsa u përket astrofave, Agolli përdor shumë katërvargëshin, po ka një pëlgim të veçantë edhe përdistikun popullor. Shumë poezi të tij edhe të gjata, janë shkruar në distikë. Domosdo strofat e tij shpesh mund të marrin pamje të ndryshme përfektë të zbërthimit të tyre apo të zbërthimit të vargjeve si dhe përfshikat e thyerjes së vargjeve, po sidoqoftë rimat janë kurdoherë atje përfshikat e piketuar strofat. Këto janë nga ana tjetër mënyra që i këmni gjetur edhe te poetë të tjera. Ja disa shembuj strofash katërshe.

Dhe në vargjet
mbeti ajo bältë,
mbeti ai bar,
ai tërfil,
mbeti ai fyell,
ai mjaltë,
mbeti ai gjemb e trëndafil.

(Devoll, Devoll)

— Qëndro — të thotë nëndë e gjorë —
Ja dardhët,
mollët,
po na pige...

Babai ta shtriu të ashprën dorë,
vëllezërit s'duan të të higen...

(Thirrje)

Qëndro,
gjeolog,
lere, torbën tënde
te ky obelisk pishe
mbi përrua.

Ne me pëllëmbë (Dhjetë sy)
i njohim këto vende
dhe frymën, dehëse
të pishave e duam! (Dhjetë sy)

Po kjo ngjet edhe më distikët

Trëndelinë, Trëndelinë,
buze lumit ke shtëpinë
(Buzë lumit ke shtëpinë)

Kur ka pare,
restorantet
frekuenton;
rosto,
shnicel,
verë
Narte
préférón.

(Criticus)

Shkëldejnë në mijra ngjyra,
mijra drita.

Reklama të verbon sa shuhet dita.

që si është (Reklama)

Citjanet mjegulla
i ngriti si shtriga
dhe hidhet në shelqje
dhe bredh ndër boriga...

(Vjeshta)

Agolli ka një sistem të téré përsëritjesh, që i përdor me mjeshteri dhe ato kontribuojnë për tu dhënë vargjeve një aro më të kulluar popullore. Ai përsërit tinguj, përsërit fjale, përsërit vargje, bile edhe strofa, po përherë se kupton se modelet i merr më shumë nga folklori sesa gjetkë. Le të ndalemi vetëm nate sepasë.

trofat, anaforat dhe lajtmotivet. Të parat janë të përhapura tutje-tëhu në vargjet e këtij poeti dhe jo rrallë të duken sikur janë marrë pezull nga folklori. Të tillë janë këta shembuj:

*Seç e hodhi lumin,
lumin për matanë...*

*C'e kërkova urën,
urën nuk e gjeta...
C'e kërkova trarin
trarin përbimi lumë...*

(Nat' e errët)

*Zlyftar e humbe nderin
nderin tënd në çetë...
Por mban udhën Zlyftari
udhën balt' e shi...*

(Fundi)

*Pastaj nga valët kraharorin nxjerrin,
nxjerrin gjithë shtatim, më në fund...*

(Vajzat notare)

*Ndiqmë se shkodë shumë larg
shumë larg,
ndiqmë arave, mes fletëve.*

(Poezia)

*Një varkë druri lëkundet nga vala,
nga vala e kaltër adriatike,
dhe bri vaporit të madh hesht,
hesht e vjetër, melankolike...
Eshtë interesante se si gërs hetohet nganjëherë te Agolli epanastrofa me bartjen si te ky shembull:*

C'm'i zgjon kujtimet
e largëta prej gjumit,
kujtimet e largëta të rinisë që qeshte...
(Mendime në vjeshtë)

Përsa i përket anaforës, nuk gabojmë nëse themi që ky është mjeti më i përdorur në poezinë e Agollit. Atë e gjejmë që në vëllimin e parë dhe doradoreës përdorimi i saj vjen duke u shtuar derisa në një poemë si «Nënë Shqipëri» të zërë vendin kryesor të mjeteve.

Ku je, vërsnikja im' e shtrenjtë?
Ku je, e dashura Fatime?
(Ku je, vërsnikja ime?)

Pranë jush janë rritur gjyshër dhe etër,
pranë jush kaluan vitet tona fëminore.
(Kllanikët)

Shpesh anafora gërshetohet me enumeracionin, sidomos te poema «Nënë Shqipëri» apo dhe gjëtkë.

... drejt qytetit
ku unë jetoj,
ku unë ngre mur,
ku unë shtroj
rrugën me asfalt,
ku unë vargje thur,
ku unë shkoj në teatër,
ku unë ngre flamur...

(Hapat e mia në asfalt)

Përsa i përket lajtmotivit, ai përdoret mjaft prej Agollit po ndryshe nga ndonjë poet tjeter, që zakonisht ka një vend të çaktuar për të në trungun e poezisë, te Agolli vemë re se lajtmotivi përdoret kur ta ndiejë poeti se ai duhet përdorur, pavarësisht vendit, pavarësisht se po citohet shumë etj. Kështu, te poema «Hapat

e mia në asfalt» vargu *Do të mbajë mend koha* (ose dhe në formën tjetër *Do të mbajë mend historia*) përsëritet shtatë herë në vendet më të ndryshme. Te poemë «Devoll, Devoll», lajtmotivi është formuar nga një strofë që përsëritet një herë në krye, një herë diku në mes, herën e tretë disa vargje para mbylljes së poemës.

Agolli është një poet i ndijshëm përkundrejt rimbës. Ashtu si dhe poetët tanë më të mirë, ai ka sensibilitetin muzikor të tingujve, të harmonisë apo disonancës së tyre. Shpesh e ndien se rima endet në vargjet e tij, në krye, në fund apo dhe brenda vargjesh, shpesh e ndien se diçka përsëritet nëpër këto vargje, qofshin bashkime tingujsh të ngjashëm, qofshin gërshtime zanoresh apo bashkëtingëlloresh që kumbojnë si jehona të njëra-tjetrës, të largëta apo të afërta, dhe megjithatë nuk je përherë në gjendje të përcaktosh saktë e konkretisht se nga të shkaktohet një përshtypje e tillë.

Nuk po ndalemi te rimat në fund të vargjeve, megjithatë duhet të themi se në to hasim tepër rima rrëshqitëse si p.sh.:

*C'do të bëni ju, o burrat e shteteve,
që qani nëpër botë brenda materniteteve...*

(Burrave të ardhshëm të shteteve)

Sic bën kopështari në kopsht me fidanat e rritura

...

Ndaj rrënjet i nxjerr çdo peme me kokrra të hidhura...

*Në pallatet e ministrave, xhambazëve, gjeneralëve,
ku derdhej llumi dhe balta e shekujve,
zbriti llava e kuqe e maleve,
zbriti hakmarrja e të gjallëve dhe të vdekurve.*

(Nënë Shqipëri)

Te poezitë e Agollit rimën e brendshme e gjejmë të shpërndarë në vendet më të ndryshme, pa një rregull fikse, po përherë me një funksion të qartë organizues të strofës apo evidencues të një fjalë. Vëreni p.sh. se si janë të shpërndara rimat, asonancat e konsonancat te kjo poezi e shkurtër.

*Zemra sot
me rima e ritme
m'u mbush.*

*Një kovë eskavatori
me trishtim
e zbraza.*

*U bëra gazmor
e nga gazi
në fage kam prush.
Rinia godet me grusht
në thinjë e brazda*
(Cast gjëzimi)

Në këto vargje të thyer gërshtohen rimat në pozicione të ndryshme: mbush-prush-grusht; eskavatori-gazmor; zbraza-gazi-brazda.

Kurse te këto vargje kemi jehona shumë të harmonishme.

*Dashuria ime s'është pozë,
pozë
e poetëve lirikë,
që këndojnë
ndënë qielin rozë,
buzë lumit rozë
si me frikë*
(Devoll, Devoll)

Pak a shumë po kjo ndodh edhe te këto vargje të pasura me rima:

*Ati plak të foli me mërzi,
lopa jote,*

*Larëza brihollë,
sytë-xham t'i hodhi me çudi,
cjapi qesharak e tundi mjekrën,
geni të lëpiu e ndenji në prak,
turtulli me vrap braktisi thekrën,
fluturoi korijsë ditën larg...
... Dhe të gjeti
shtigjeve poeti...
(Endrra)*

Rimat gjarpërojnë nëpër vargjet: ati-cjapi, plak-qesharak-prak, vrap-larg, foli-hollë-hodhi, mérzi-bri-çudi, gjeti-poeti etj.

Bashkë me Kadarenë, Agolli përdor më shumë mbasë se cilido poet tjetër rimën apofonike. Atë e gjejmë të përhapur në të gjitha poezitë e tij jo vetëm në ato me varg të lirë. Le të mjaftojnë pàk shembuj:

*Ku linda unë bënin gjithë bejte...
Nazim Berat' i thoshin me të drejtë...
Syt' i mbyll dhe mbrohesh ndënë strehët...
Dhe gyximi yt tani nuk ndjehet.
(Qeni im implakur)*

*Pinin bejtexhinjtë në çajhane...
Nëpër gojë ç'e merrnim dynjanë.
(Firdusi)*

*Kjo grua që bie erë çokollatë...
Tani jeton me burrin në pallate...
(Kjo grua)*

Do të shkonte gjatë të ndaleshim te mjete të tjera të përdorura prej Agollit në instrumentimin e vargut të tij. Do të mund të flisnim për aliteracionin, që 'nuk' e ka të rrallë, do të mund të vinim në dukje lodrën dhe rolin e theksave, sidomos në zberthimin e vargjeve

apo dhe tē strofave etj. Megjithatë, me aq sa thamë, na bëhet se kemi vënë në dukje disa nga tiparet e qenësishme tē punës së tij në përpunimin metrik tē vargut. I lidhur me poezinë popullore, Agolli bën çmos që vargu i tij tē kumbojë nëpërmjet organizimit që ai i bën sa më afër ritmit tē gjuhës së folur, sa më pranë kumbimit tē bisedës së përditshme, duke fituar kështu një aftësi komunikuese që është një nga karakteristikat kryesore të poezisë së tij.

WATER ROUNDS 97

19. FATOS ARAPI

Poezia e F. Arapit shquhet për një ton të rrëmbyer, për një kumbim që të kujton debatet. Në të ndjehet herë-herë një jehonë luftarake, jo rrallë e potershme. Tërë kjo, domosdo, reflektohet edhe në strukturën metrike të vargut të tij. Arapi është një poet që shkruan thuajse kurdoherë në varg të lirë. Vargu i tij i lirë reflekton në të njëjtën kohë (do të thoshim më tij njëjtën masë) edhe traditën e shkolluar, edhe elemente të traditës folklorike të poezisë sonë. Dhe kjo nabit se është fare e qartë kur thua se konstantet metrike më të përdorura prej tij janë vargu njëmbëdhjetërrokësh dhe vargu gjashtërrokësh popullor. Kështu njëmbëdhjetërrokëshin e hasim në njëmbëdhjetë poezi te «Shtigje poetike» («Kur nisi fëmijnia jonë», «Lirisë», «Pse erdha në jetë», «Kemi shumë kaltërsira», «Edhe sonte», «Ti do të vish» etj.) dhe në dhjetë poezi të vëllimit «Ritmet e hekurta» — sikur vetëm këto dy vëllime të marrim («Deti», «Asaj», «Zjarr nuk ka» etj.). Më gjithatë prirja e përgjithshme, që vihet re në krijimtarinë e poetit, është fakti se vargjet çift, gjashtërrokëshi, tetërrokëshi dhe dhjetërrokëshi po përdoren përmes.

herë e më tepër prej tij si konstante metrike. Kështu për gjashëtërokëshin mund të përmendim «Drashovica», «Si të harroj ty», «Republikës», «Dy sy nën ombrellë», «Baladë për M. Matohitin», «Vargje pér dritat», «Anti-burokratike», «Në vdeksha i ri», «Elegji pér babanë», «Xheladin Beqiri» etj.

F. Arapi është nga poetët tanë që përdor së tepërmë anakrusën përbërësë. Thua jse të gjitha poezitë e tij nisin me një copëz vargu dhe pastaj vazhdojnë me vargje të masave më të mëdha, që bartin dhe ritmin e përgjithshëm të poezisë. Kështu ndodh p.sh. te poezitë «Vargjë» «Ku nisi fëmijnia jonë», «Si erdhë tek ne shekulli XX», «Dy sy nën ombrellë» etj. Dhe ja si tingëllon konkretisht anakrusa përbërësë e Arapit në disa poezi:

Laberia— hakërrim i rreptë i maleve...
(Baladë pér Muço Matohitin)

Partia vjen si ai prindi që birin ka këtu.

(5 Maj)

Atdheu im që ngriheshe me natë...

(Alarme të përgjakura)

Edhe në trung të poezisë, sidomos kur nisin pjesë të saj apo strofa të ndryshme, Arapi përdor shpesh anakrusën. Ke përshtypjen nga ana tjeter se në ndonjë rast është krijuar prej tij një farë klisheje. Kështu ka shumë poezi që nisin me një anakrusë e pastaj vijnë tre ose katër vargje me të njëjtën masë. Për shembull:

Mbrëmë kur nëna ndante bukën në tryezi, mora një çopë në duart e mia.

**Dhe, m'u duk sikur ngrita ashtu
një grusht dheu, të ngrohtë,
(Në tryezë)**

**Thellë
dragoi i nëndheshëm
lëviz.
Nën këmbë toka na ikën,
thua fluturon, në erë,
(Nëpër tërmete)**

Po kjo, klishe haset, edhe në trung të poezië.

**Rrjedhin
kullojnë gjak në duart e mia,
si mbi ballin tënd
kjo tufë flokësh bjonde
(Alarme, të përgjakura)**

**Hap dritaren
në parmak të orës së vonë të natës
pështetur,
shoh jashtë
nëpër shi e shtrëngatë
punëtorët vërsulen te Vau i Dejës.
(Poemë, më vete)**

Sidoqoftë ky është një kombinim tepër i preferuar prej Arapit dhe që formon një farë muzikaliteti karakteristik pér vargëzimin e tij. Vargjet e Arapit paraqiten tepër të zberthyer e të thyer. Ai nuk e ka pér gjë të copëzojë vargun, të veçojë fjalë, të kalojë nga një varg i gjatë, në një varg të formuar vetëm nga një fjalë... Térë kjo jep qartë karakterin e papërbajtur e të rrëmbyer të poeziës së tij. Po kjo nuk duhet kuptuar në asnjë mënyrë sikur ai është kundër vlerave të qenësishme të vargëzimit sigurisht rithmi, muzikaliteti, rima, përsëritjet, pauzat etj. Përkundrazi, Ai kërkon të arrijë me këto

zbërthime e thyerje pikërisht vizione të reja për këto vlera. Dhe duhet thënë se shpeshherë ia arrin me sukses një gjëje të tillë, edhe pse jo rrallë thyerjet e tepërtë, këmbimi i befastë i ritmeve, bartjet etj., sikur e çorientojnë rrjedhën e vështirësojnë në ndonjë rast. Arapi është tepër sensibël ndaj përsëritjeve, duke u nisur nga më të thjeshtat e duke mbaruar deri te lajtmotivet që i përdor së tepërmë. Ka mjaft poezi, sidomos të shkurtra, që fillojnë e mbarojnë me një varg lajtmotiv si p.sh. «Çelën portokallét», «Ku nisi fëmijnia jone», «Erdhën poetët hamenj», «Duke të pritur ty», «Ti do të vish», «Mbi supin e kohës sime», «Mos më urre» etj.

Sidoqoftë te përsëritjet të bën përshtypje përdomimi i mënyrave të folklorit, gjë që ndihmon përtu dhënë vargjeve të lira të Arapit një fizionomi popullore. Le të mjaftojne këto pak shembuj:

*Qofsha hap që shtrihet nëpër hapin tuaj,
qofsha fjalë, fjalë që shkrihet nëpër klithmën tuaj
breshërimë urrejtjesh popullore qofsha...*

*Nëpër këmbë — copëra xhaketash
copëra gunash
të shqyera ndër këmbë...*

(Alarme të përgjakura)

*Drita prozhektörësh kryqezohën, thyhen
nëpër trup të hëtve drita prozhektorësh...*

(Drashovica)

*Një jetë njeriu në një varg pushon
në një varg pushon fëmijnia jone.*

(Republikes)

Përsa i përket rimës (ka sidomos rimë të mirëfilltë e asonancë dhe pak konsonancë) duhet thënë se

e gjejmë të përdorur me efekte të qarta idcoemocionale, shpesh të kombinuar dhe me aliteracione që bëjnë të pér efekt.

E përsërisim edhe një herë se nuk i kishim vënë vetes si qëllim të analizonim të gjithë poetët tanë të vjetër a të rinj duke parë karakteristikat e vlerat e tyre në punë të vargëzimit. Deshëm vetëm të jepnim një pasqyrë të përgjithshme e të thjeshtë, qoftë edhe duke dhënë tiparet e fizionomisë të disave prej tyre, në, mënyrë që të kuptohet se c'mundësi hapen për studimin e kësaj përvoje të pasur. Qëllimi ynë kryesor ishte, pra, të dëshmonim me ato që thamë e vumë në dukje se poezia jonë përparimtare e revolucionare ka ecur duke mos i shkëputur as edhe një herë sytë nga poezia popullore dhe kjo lidhje ka ardhur duke u bërë përherë edhe më e vetëdijshme. Poëtët tanë më të mirë kanë përdorur me shumë aftësi dhe, përfitim ideoartistik mjete të ndryshme të organizimit dhe instrumentimit popullore, megjithëse shumë arritje të përvojës popullore presin ende të përdoren në mënyrë krijuese. Pëlqimi përkëtë apo atë varg kthehet e bëhet një paragjykim letar kur nuk shikohet i lidhur ngushtë para së gjithash me tematikën, me brendinë, me psikologjinë dhe ritmin e kohës, në të cilën shkruhet e për të cilën shkruhet. Turrja symbyllurazi drejt këtij apo atij vargu nuk mund të fë shpjerë larg, në mos të kredhtë në një formalizëm të kulluar që është vdekjeprurës për artin e një poeti. Poeti i vërtetë mëson nga populli, pikërisht e para së gjithash, aftësinë për të harmonizuar në mënyrë të përsosur brendinë me formën, idenë me gjuhën artistike, lëvizjen ideoemocionale me lëvizjen e përshtatshme të ritmit. Historia e poezisë sonë, e vjetra dhe e reja, është e mbushur me shembuj të tillë pozitive, që duhen studjuar dhe, c'ka më tepër rëndësi, duhen vlerësuar në praktikën konkrete të poetëve më të rinj.

Poeti i ri shqiptar duhet të jetë i bindur katërcipërishët se thesari folklorik yni është i pashtershëm edhe në punë të vargëzimit dhe se shmanjia apo, edhe më keq, mosnjohja e këtij thesari do të reflektohet në mënyrë shkatërrimtare në ngrehinën poetike. Sot asnjë arkitekturë poetike (dhe jo vetëm poetike) nuk mund të ngrihet në mënyrë të qëndrueshme pa mbështetjen në përvojën popullore, asnjë mesazh poetik nuk mund të pretendojë për jetëgjatësi dhe forcë komunikuese për masat pa u mbështetur jo vetëm në bordinë ideoëmocionale të folklorit por edhe në përvojën e tij formale. Për meritë të poetëve tanë të talentuar ne kemi në letërsinë tonë një përvojë jo të zakonshme në këtë vështrim. Poetët tanë të së kaluarës, Naimi, De Rada, Çajupi, Dara, Noli, Mjeda etj. kryen një punë të madhe në evidencimin dhe përdorimin mjeshtëror të disa tipareve tipike popullore edhe të metrikës së poezisë folklorike. Ata i dhanë p.sh. vargut tetërrokësh një fizionomi plotësisht shqiptare në poezitë e tyre. Poetët që erdhën më pas (Poradeci, Migjeni etj.) çanë akoma më tutje duke shtuar edhe më tepër përvojën e duke sheshuar udhën për poetët tanë më të rinj. Poetë si Siliqi, Agolli, Kadareja etj. u treguan shumë të ndijshëm ndaj kësaj përvuje.

Poetët tanë kanë grumbulluar, pra një përvojë tashmë të madhe, duke u bërë mbështetje për brezat e poetëve më të rinj, të cilët vijnë në poezi më të sigurt, më të përgatitur e më të armatosur jo vetëm në vështrimin ideor, por edhe në atë artistik, e, në këtë mës, edhe përsa i përket përvojës metrike.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
<u>Hyrje</u>	3
Vlerat metrike dhe studimi i tyre	7
Larmia e vargjeve popullore shqiptare	14
Instrumentimi në poezinë popullore shqiptare	39
Pasuria e strofës më poezinë popullore shqiptare	51
Disa tipare të metrikës së poeziës së rilindësve. <u>Naim Frashëri</u>	80
<u>A. Z. Cajupi</u>	97
<u>Ndre Mjeda</u>	121
<u>Asdreni</u>	118
<u>Fan Noli</u>	130
<u>Lasgush Poradeci</u>	137
Tipare të vargut të lirë në poezinë shqiptare	155
<u>Migjeni</u>	186
Poezia e re. Memo Metoja	205
Kolë Jakova dhe Dhimitër S. Shuteriqi	217
<u>Llazar Siligji</u>	227
<u>Ismail Kadare</u>	236
<u>Dritëro Agolli</u>	252
<u>Fatos Arapi</u>	264

Zheji, Gj.

Vëzhgime metrike, T., «Naim
Frashëri, 1980.

272 f...

B-ka të mëdha dhe

B-ka të vogla : 891. 983. 08

Zh 39

Tirazhi 2000 kopje Format 78x109/92 Stazhi: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK - Shtypshkronja e Re, Tiranë, 1980